"Libri 'Kombformimi dhe përpjekjet e shqiptarëve për liri dhe barazi', i autorit Fatmir Lekaj, i shtohet bibliotekës së literaturës për kombformimin dhe shtetformimin te shqiptarët. Libri risjell në vëmendjen tonë çështje tejet aktuale, duke i lidhur me diskutimet teorike mbi nacionalizmin dhe multikulturalizmin. Ai patjetër që do të bëhet pjesë e kurseve universitare e pasuniversitare që merren me këto tema, por edhe publiku i gjerë do ta gjejë me vlerë leximin e tij, sidomos ata të pasionuarit pas leximeve në shkencat sociale dhe humane."

Enis Sulstarova,
pedagog në Departamentin e Shkencave Politike të Universitetit të Tiranës



Fatmir Lekaj (1971) lindi në Pejë. Që tridhjetë vjet jeton në Norvegji. Fillimisht ka studiuar për të drejtat e njeriut dhe për trajtimin e konflikteve, ndërkohë edhe për shkencë politike. Ka magjistruar për shkencë politike në Universitetin e Oslos, kurse për studime postmagjistraturale është përqendruar në temat që kanë të bëjnë me nacionalizmin, multikulturalizmin dhe integrimin. Merret me veprimtari të kërkuesit të pavarur dhe të këshillëdhënies për çështjet e integrimit etj. Është përkthyes i kualifikuar norvegjisht-shqip dhe sekretar i Rrjetit të Profesionistëve Shqiptarë në Norvegji.

ISBN 978-9951-780-55-1

KOMBFORMIMI DHE PËRPJEKJET E SHQIPTARËVE PËR LIRI DHE BARAZI • FATMIR LEKAJ

ARMAGEDONI

FATMIR LEKAJ

KOMBFORMIMI DHE PËRPJEKJET E SHQIPTARËVE PËR LIRI DHE BARAZI

një qasje teoriko-interpretuese

ARMAGEDONI

FATMIR LEKAJ

KOMBFORMIMI DHE PËRPJEKJET E SHQIPTARËVE PËR LIRI DHE BARAZI

një qasje teoriko-interpretuese

Autor:
FATMIR LEKAJ

Titulli:
KOMBFORMIMI DHE PËRPJEKJET E SHQIPTARËVE PËR LIRI DHE BARAZI
një qasje teoriko-interpretuese

Redaktor:
BERAT ARMAGEDONI

Lektore:
KIMETE KASUMI

Faqosjen dhe kapakët:
VENERA ALSHIQI

Botoi:
ARMAGEDONI
+383 44 835 499
shbarmagedoni@gmail.com

Prishtinë, 2021

©Të gjitha të drejtat e botimit, autori.

FATMIR LEKAJ

KOMBFORMIMI DHE PËRPJEKJET E SHQIPTARËVE PËR LIRI DHE BARAZI

një qasje teoriko-interpretuese

ARMAGEDONI

Prindërve të mi,
për sakrificën dhe dashurinë

PËRMBAJTJA

KREU I
TEORITË E KOMBFORMIMIT DHE KOMBFORMIMI I SHQIPTARËVE

Hyrje 10
Paradigma moderniste 12
Ernest Gellner 12
Benedict Anderson 18
Erik Hobsbawm 22
Paradigma etnosimboliste 27
Kontinuiteti kulturor dhe përsëritja/rishfaqja e etnisë shqiptare 43
Faza A dhe B e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare 60
Faza C e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare 78
Përfundim 86

KREU II
NACIONALIZMI SHQIPTAR PAS VITIT 1912

Hyrje 91
Prapavija historiko politike e Kosovës deri në vitin 1912 92
Lëvizja Kombëtare Shqiptare për çlirimin e Kosovës me vise pas vitit 1912 105
Lëvizja Kombëtare Shqiptare për çlirimin e Kosovës me vise pas Luftës së Dytë Botërore 122
Pikënisja konkrete dhe themelimi i UÇK-së 142
Faktorizimi i UÇK-së 152
Dy ndodhitë e mëdha 166
Përfundim 186

KREU III
MODELET PËR ORGANIZIMIN E BASHKËSIVE POLITIKE NË MES TË MAJORITETIT DHE MINORITETEVE DHE ORGANIZIMI I BASHKËSISË POLITIKE NË KOSOVË

Hyrje 190
Modeli qytetar dhe modeli kulturor..... 191
Modeli multikulturor..... 197
Qasja e OKB-së për organizimin e bashkësisë politike në Kosovë 226
Faza I..... 228
Faza II..... 238
Faza III 248
Kosova pas vitit 2008 258
Përfundim 283

PASTHËNIE……..291

BIBLIOGRAFIA:..... 296

KREU I

TEORITË E KOMBFORMIMIT DHE KOMBFORMIMI I SHQIPTARËVE

Hyrje

Pyetjeve, a janë kombet fenomene natyrore, shumë të vjetra, tërësisht fenomene moderne apo fenomene moderne me rrënjë në etnitë paramoderne, në debatin akademik mëtojmë kryesisht t'u përgjigjemi nëpërmes katër paradigmave kryesore: primordializmit, perenializmit, modernizmit dhe etnosimbolizmit.

Primordialistët e përkufizojnë kombin si fenomen natyror. Pikënisja teorike e primordialistëve është se kombet ekzistojnë që prej se ekziston njeriu, përkatësisht në rrënjët e proceseve dhe zhvillimeve të njerëzimit.[1] Perenialistët e përkufizojnë kombin si fenomen historik. Pikënisja teorike e perenialistëve është se kombet janë fenomene që ekzistojnë nga ato periudha historike që ka të dhëna historike për kombet, dhe duke mos e bërë një ndarje të qartë në mes të etnive paramoderne dhe kombeve, aludojnë se kombet kanë qenë të pranishme në vazhdimësi gjatë historisë. Megjithëkëtë, sipas perenialistëve, kombet nuk janë domosdoshmërisht fenomene natyrore.[2] Me fjalë të tjera, një dallim i rëndësishëm në mes të primordializmit dhe perenializmit nënkupton se është dallim të thuhet se kombet janë pjesë e natyrës njerëzore (primordializëm), dhe të thuhet se kombet janë të konstituara gjatë historisë (perenializëm).

Modernistët kanë qasje tërësisht të kundërt krahasuar me primordialistët dhe perenialistët. Pikënisja e përbashkët e teoricienëve modernistë (Ernest Gellner, Benedict Anderson, Eric Hobswam etj.), është se kombet janë fenomene moderne, në

[1] Smith 2008: 51
[2] Smith 2006: 159

kuptimin se nuk kanë ekzistuar në mesjetë ose më herët.[3] Mitet paramoderne konsiderohen vetëm mite dhe konstruktsione, njëkohësisht kombet konsiderohen rezultat (më pak ose më shumë i domosdoshëm) i tranzicionit nga shoqëritë tradicionale në shoqëritë moderne. Megjithëkëtë, teoricienët modernistë kanë mendime të ndryshme kur është në pyetje se cili ka qenë shkaku kryesor i modernitetit për kombformimet.

Etnosimbolistët distancohen nga pikëpamja primordialiste dhe pozicionohen në mes të perenialistëve dhe modernistëve. Pikënisja e etnosimbolistëve është se kombet janë fenomene moderne, por të bazuara në etnitë paramoderne. Sipas përfaqësuesit më të spikatur të paradigmës etnosimboliste, Anthony D. Smith, debati në mes të teoricienëve të këtyre paradigmave (primordializmit, perenializmit, modernizmit dhe etnosimbolizmit), është zhvilluar në dy nivele, në nivelin teorik dhe në nivelin historik. Përderisa modernistët kanë qenë më të zotë teorikisht, perenialistët kanë qenë më të zotë historikisht dhe më të dobët teorikisht. Primordialistët ose e kanë teorinë e gabuar ose nuk kanë teori fare dhe, gjithashtu, janë shumë spekulativë dhe antihistorikë. Ndërsa etnosimbolistët, duke u bazuar në makrohistori dhe elemente sociokulturore, kanë kontribuar për korrigjimin e paradigmave të tjera të sipërpërmendura.[4]

Rrjedhimisht, në këtë kapitull do të përqendrohem fillimisht në dy paradigmat dominuese, modernizmin dhe etnosimbolizmin, të cilat (gjatë përafërsisht pesë dekadave të fundit), dominojnë në debatin akademik për nacionalizmin/kombformimet si qasje konkurruese e, shikuar nga këndvështrimi i qasjes etnosimboliste, edhe si qasje përmbushëse. Në këtë rast do ta zbatoj qasjen etnosimboliste në rastin e shqiptarëve dhe, që të mos ngatërrohet zbatimi i qasjes etnosimboliste në rastin e shqiptarëve, me qasjen perenialiste dhe primordialiste, do ta bëj një dallim të qartë në mes të etnisë shqiptare dhe kombit

[3] Po aty: 3

[4] Smith 2008: 60-61

shqiptar. Në kuptimin e dallimit në mes të kontinuitetit etnik të shqiptarëve (që ka shërbyer si bazë për kombformimin e shqiptarëve), dhe vetë procesit të kombformimit të shqiptarëve. Për ta bërë më të kapshëm procesin e kombformimit të shqiptarëve do të marr pikënisje në tipologjinë analitike të Miroslav Hrochut, në lidhje me periodizimin e procesit të kombformimeve nëpërmes tri fazave të lëvizjeve kombëtare: fazës a, b dhe c (të kombeve të vogla evropiane, në veçanti të kombeve eurolindore), të cilit i referohet edhe Smithi.

Paradigma moderniste

Ernest Gellner

Filozofi dhe socialantropologu Ernest Gellner është përfaqësuesi më i dalluar i paradigmës moderniste. Sipas tij, kombet janë produkt i industrializmit (produkt i tranzicionit nga shoqëritë agrare në shoqëritë industriale).

Qasja teorike e Gellnerit është sociokulturore ngaqë i jep rëndësi të veçantë analizës sociologjike të tranzicionit kulturor, që nënkupton një proces kumulativ të tranzicionit nga shoqëritë agrare në shoqëritë industriale; migrimin nga shoqëritë e vogla lokale në qytete, urbanizimin në kombinim me modernizimin e mjeteve dhe metodave të punës, shtimin e mobilitetit social etj. Ky tranzicion, duke shkaktuar ndryshime sociostrukturore, krijoi në njërën anë nevojën për një platformë të përbashkët terminologjike si e domosdoshme për shoqëritë industriale (që të mund të komunikohet mbi kontekstet lokale), në anën tjetër ky tranzicion, duke i zbehur/dobësuar identitetet/kulturat lokale - "kulturat e vogla", krijoi nevojën që të formohen identitetet/ kulturat mbilokale - "kulturat e mëdha".[5] Me fjalë të tjera, tranzicioni nga shoqëritë agrare në shoqëritë industriale ndikoi që nëpërmes gjuhëve dominuese të formohen kulturat mbilokale,

[5] Gellner 1998: 39-43

përkatësisht kulturat nacionale. Rrjedhimisht në shoqëritë industriale sistemet e përgjithshme dhe të institucionalizuara arsimore në gjuhët dominuese u bënë të domosdoshme dhe të rëndësishme për t'i shpërndarë kulturat nacionale që, në radhë të parë, nënkupton kodifikimin e gjuhëve nacionale nëpërmes gramatikave të qarta dhe stabile me rregulla të qarta të drejtshkrimit dhe fjalorit të mjaftueshëm për nevojat e komunikimit (mbi kontekstet lokale) në shoqëritë industriale.

Sipas Gellnerit, për dallim nga shteti dhe nacionalizmi, kultura dhe organizata janë fenomene universale ngaqë, shikuar historikisht, kultura në kuptimin e kultivimit të kulturave të ndryshme dhe organizata në kuptimin e të organizuarit në forma të ndryshme, kanë qenë të pranishme në shoqërinë njerëzore në vazhdimësi gjatë gjithë historisë, pa marrë parasysh fazat e saj. Në këtë vazhdë Gellner distancohet nga doktrina klasike për shtetin se "s'ka shoqëri pa rregull, s'ka rregull pa pushtet, s'ka pushtet pa shtet", dhe duke e bërë një dallim në mes të "shtetit" të brishtë paramodern (me aftësi të kufizuara në ushtrimin e ruajtjes së rendit) dhe shtetit të centralizuar modern (me aftësi të plotë në aspektin organizativ të organeve dhe personelit të specializuar, për ushtrimin e ruajtjes së rendit), konstaton se vetëm shteti i centralizuar modern mund të quhet shtet në kuptimin e plotë të fjalës. Prandaj, meqë shteti nuk mund të konsiderohet fenomen universal, nacionalizmi nuk mund të konsiderohet aspak fenomen universal sepse njerëzimi nuk ka dëshiruar/kërkuar ose protestuar gjithmonë në vazhdimësi gjatë historisë, që të ketë përputhje në mes të kufijve të njësive organizative dhe kufijve kulturorë; që të ketë ndarje (sipas principit nacionalist) në mes "nesh" dhe të "tjerëve". Kjo, sipas Gellnerit, na ndihmon të kuptojmë më lehtë se konstilacionet e ndryshme të kulturës dhe organizatës nganjëherë, por jo gjithmonë, e lindin nacionalizmin[6]. Por problemi, sipas tij, është se "… shumë njerëz, në veçanti ata që thellësisht janë të përfshirë në nacionalizëm, nuk janë në gjendje ta pranojnë dhe

[6] Po aty: 19-21

ta vërejnë faktin, edhe më pak janë në gjendje ta kuptojnë ose ta shpjegojnë, se ekzistenca e shtetit të centralizuar është një pjesë e rëndësishme e prapavijës së botëkuptimit të nacionalizmit…" (Gellner, 1998: 19).

Gellner insiston se kombet u krijuan nga nacionalizmi që, sipas tij, është një konsekuencë dhe formë e domosdoshme kulturore ("kulturë e madhe") e industrializmit dhe se vetëm shteti i centralizuar modern arriti ta zhvillojë dhe mirëmbajë "kulturën e madhe" që u arrit në radhë të parë nëpërmes një sistemi arsimor të centralizuar, të përgjithshëm dhe obligues, në një gjuhë dominuese të përbashkët. Madje, sipas qasjes teorike gellneriane, pikëpamja e monopolit të shtetit mbi sistemin arsimor/edukimin u bë më e rëndësishme në shoqërinë industriale sesa pikëpamja tradicionale weberiane e monopolit të shtetit mbi dhunën.[7] Me fjalë të tjera, socializimi nëpërmes sistemit arsimor krijoi një lidhje "martese" në mes të "kulturës së madhe" (kulturës nacionale) dhe njësisë së centralizuar politike (shtetit) duke rezultuar në nacionalizëm dhe duke i bërë nacionalistë në radhë të parë të shkolluarit. Kjo do ta kushtëzojë Gellnerin ta ketë një qëndrim relativisht reduksionist për nacionalizmin, duke mos e cilësuar si ideologji, por si një doktrinë politike e përputhjes në mes të kombit, i definuar si "kultura e madhe" (kultura nacionale) dhe shtetit si njësi politike. Kjo nënkupton se kombformimi nuk është i mundshëm (në praktikë) pa shtetin e centralizuar modern.

Në këtë vazhdë, Gellner konkludon se kombet, përkatësisht shtetet kombëtare, u formuan si konsekuencë e industrializmit nëpërmes centralizimit kulturor-politik dhe se parakushtet për këtë centralizim kulturor-politik nuk ishin të njëjta në të gjitha vendet/zonat në botë. Përderisa në Angli, Francë dhe Spanjë këto parakushte ishin të volitshme, në Gjermani dhe Itali parakushti kulturor ishte potencialisht i pranishëm, por mungonte parakushti politik (shtetëror) ngaqë ishin të fragmentuara në njësi të vogla politike. Megjithëkëtë, meqë potenciali i

[7] Gellner 2006: 33, 36-37

"kulturës së madhe" (kulturës nacionale) ishte zhvilluar në regjionet që donin të bashkoheshin në një shtet, si në Gjermani ashtu edhe në Itali, kjo kontribuoi që të mos ndodhin spastrimet etnike në këto dy vende siç, fatkeqësisht, ndodhën spastrimet etnike në shumë zona të tjera në botë gjatë përpjekjeve për t'i "spastruar kulturat nacionale nga elementet e kulturave të tjera nacionale". Rrjedhimisht, nacionalizmi si në Gjermani ashtu edhe në Itali rezultoi në nacionalizëm mobilizues për formimin e shteteve në përputhje me kufijtë e kulturave nacionale. Ndërsa në shumë vende/zona të tjera në botë, parakushtet e centralizimit kulturor-politik ishin të dobëta dhe thuajse aspak të pranishme. Madje edhe në Evropën lindore shumë pak vende kanë pasur kontinuitet kulturor dhe/ose politik ngaqë kryesisht ekzistonte një mozaik i kulturave dhe gjuhëve me dialekte të padefinuara qartë. Për shembull, në rastin e gjuhëve sllave ka qenë e vështirë të përcaktohet se ku përfundon një dialekt dhe ku fillon një tjetër, ose të përcaktohet qartë dallimi në mes të një gjuhe dhe një dialekti. Njëkohësisht, mungesa e shteteve të centralizuara dhe prania e shteteve të brishta ndikuan (gjatë shekullit XIX) për shfaqjen e një procesi me konsekuenca të dhimbshme; entuziazmit për konstruktimin e përnjëhershëm të "kulturave të mëdha" (kulturave nacionale) dhe shteteve nacionale, si realizim i imperativit nacionalist, gjë që shkaktoi spastrimet etnike.[8]

Gellner, duke qenë i vetëdijshëm se modeli i tij teorik për nacionalizmin dhe rrjedhimisht kombformimet nuk shpjegon shkaqet e një forme tjetër të nacionalizmit, të ashtuquajturin nacionalizëm i keq/i keqzhvilluar përpiqet ta kompensojë këtë shpjegim nëpërmes tre faktorëve që, sipas tij, ndërlidhen me modelin e tij teorik. Njëri faktor ka të bëjë me parakushtet socio-ekonomike dhe nënkupton se industrializmi rezultoi me zhvillim të ç'balancuar në botë, sidomos në fazën e parë, duke krijuar dallime shumë të dukshme në mes të pasurve dhe të varfërve dhe, në këtë vazhdë, rezultuan reagimet ndaj këtyre

[8] Gellner 1998: 63-70

ndryshimeve sociostrukturore të ç'balancuara, si frikë nga degradimi social.[9] Faktori tjetër ka të bëjë me traditat kulturore-organizative dhe nënkupton se në shtetet e brishta, kulturat lokale, duke pasur disa privilegje nga pushteti qendror, e futën një etos të nderit, të hakmarrjes dhe domosdoshmërinë e vetëgjyqësisë në shoqëritë e veta (shoqëri ku burrat nuk mund ta realizonin vetën nëpërmes një karriere të suksesshme, por vetëm nëpërmes përdorimit të armëve), dhe në vazhdën e trashëgimisë dhe reprezentimit të kulturës lokale, filluan të thirren në/dhe të riparaqesin një kategori tjetër kulturore, përkatësisht "kombin". Duke u bazuar edhe në novelat e Milovan Ðilasit, Gellner konsideron se kjo situatë është relevante për shumë pjesë të Ballkanit dhe se kjo ndihmon të shpjegohet mentaliteti i brutalitetit në këtë regjion në vitin 1912, por edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe në vitet '90.[10]

Faktorin e tretë, ideologjik, të bazuar në romantizmin si reaksion ndaj iluminizmit, Gellner e cilëson si faktorin kryesor për ta shpjeguar burimin e nacionalizmit të keq/keqzhvilluar. Sipas tij, iluministët, në veçanti Immanuel Kant dhe David Hume, duke u bazuar në dy veçoritë kryesore të përbashkëta njerëzore, përkatësisht në arsyen (duke e lokalizuar burimin e moralit në arsyen), dhe në ndjeshmërinë (në kuptimin se si qenie njerëzore jemi të predispozuara ta ndiejmë mirëqenien dhe dhimbjen dhe, po ashtu, jemi të predispozuara të jemi empatikë ndaj mirëqenies dhe dhimbjes së të tjerëve), kontribuuan për vetëdijesimin e një etike universale njerëzore pavarësisht prej kulturave dhe kufijve politikë.[11] Ndërsa romantizmi, duke i ndërlidhur ndjenjat me dallueshmëritë/veçoritë e shoqërive/kulturave specifike, sidomos duke mbivlerësuar rolin e ndjenjave karshi arsyes, iu kundërvu pikëpamjes universale të iluminizmit. Kritika ndaj iluminizmit fillimisht ishte e bazuar në letërsinë romantike, duke argumentuar se për letërsinë

[9] Po aty: 72
[10] Po aty: 73
[11] Po aty: 73-76

fokusi në ndjenja është më i dobishëm, sidomos në sferat e letërsisë siç janë dashuria, seksualiteti etj. Kjo kundërvënie e romantizmit ndaj iluminizmit u zgjerua gradualisht në kuadër të shkencave humane në krye me Johann Gottfried von Herder, i cili kritikonte pikëpamjen iluministe që parasheh se njerëzimi është në radhë të parë i përbërë nga individët e pajisur me arsyen si veçorinë më domethënëse dhe universale të njerëzimit. Sipas pikëpamjes herderiane, njerëzimi është i përbërë në radhë të parë nga kombet/kulturat dhe se vlerat dhe avantazhet e njerëzimit nuk bazohen në veçoritë e përbashkëta, por në dallueshmëritë kulturore, dhe se ky diversitet dhe veçoritë kulturore kanë domethënie më të madhe. Megjithëkëtë, sipas Gellnerit, pikëpamja herderiane nuk ishte rigjide në pikënisje ngaqë fillimisht ishte e shqetësuar pjesërisht me diversitetin kulturor si vlerë universale njerëzore dhe pjesërisht ishte një kundërreaksion ndaj imperializmit kulturor francez dhe komercializmit dhe empirizmit anglez. Mirëpo, kombinimi i pikëpamjes herderiane me darvinizmin, ashtu siç u interpretua nga Nietzche, dhe sidomos në fillim të shekullit 19, kur darvinizmit iu dha një përkushtim i veçantë në disa çarqe hulumtuese shkencore, ndikoi që pikëpamjes romantike të diferencimit kulturor t'i shtohet edhe pikëpamja e diferencimit biologjik. Rrjedhimisht, përderisa romantizmi ndikoi që ta reduktojë pikëpamjen për njeriun nga një qenie e arsyeshme/ racionale në një qenie esenciale kulturore, doktrina darviniste ndikoi ta ndërrojë pikëpamjen për njeriun duke e definuar si një qenie shtazore, të predisponuar për konkurrencë të dhunshme sikurse të gjitha shtazët e tjera. Në këtë vazhdë doktrina darviniste ka pasur implikime të mëdha politiko-filozofike dhe, si pasojë, ka përcaktuar formën më të keqe dhe më të jashtëzakonshme të nacionalizmit, përkatësisht fashizmin dhe nazizmin.[12]

Konkluzioni i Gellnerit është se riorganizimi dhe mobilizimi i shoqërive në kuadër të kulturave të përbashkëta të mëdha

[12] Po aty: 77-82

(kulturave nacionale) u ndikua nga romantizmi, duke bartur me vete shqetësimin për "rrënjët" e përbashkëta. Në këtë mënyrë romantizmi me argumentimin dhe idiomën e vet i shërbeu në mënyrë të shkëlqyer nacionalizmit, rrjedhimisht nacionalizmi u bë një forcë shtytëse për ndërtimin e shteteve kombëtare, i cilësuar nga Gellneri si Gesellschaft (një formacion shoqëror) i mbuluar me Gemeinschaft (me një relacion të afërt në mes njerëzve).[13]

Benedict Anderson

Politologu Benedict Anderson mëton ta shpjegojë shkakun e shfaqjes së kombeve, duke u thelluar më thellë në histori sesa Gellneri, përkatësisht përtej revolucionit industrial. Fillimisht merr pikënisje në disa ndryshime të mëdha që, sipas tij, janë: ndryshimi i pozicionit të fortë të religjioneve dhe i gjuhëve të mëdha, ndryshimi i parimit të legjitimitetit (ndryshimi nga parimi i legjitimitetit dinastik në parimin e legjitimitetit të sovranitetit të popullit) dhe në ndryshimin e perceptimit kohor; ndryshimin nga perceptimi për kohën si përsëritje (sirkulare) në perceptimin për kohën si linjë (linjare) që shkon kah e ardhmja, si sinonim me "zhvillimin" dhe "përparimin".[14] Megjithëkëtë, rëndësinë e veçantë ia adreson kapitalizmit të shtypit, duke e konsideruar si shkakun kryesor për shfaqjen e kombeve, në kuptimin se, në periudhën kur është shpikur makina e shkrimit, shumë pak njerëz kanë qenë në gjendje të lexojnë dhe të shkruajnë (ngaqë lexuesit kanë qenë të karakterizuar nga një shtrirje e hollë horizontale në gjuhën latine, përkatësisht nga një elitë evropiane dygjuhësore) dhe, në këtë vazhdë, kapitalizmi i shtypit, duke shpërndarë tekste në gjuhët lokale, respektivisht në gjuhët e shkruara popullore, dhe duke qenë më shumë i interesuar të shpërndajë sa më shumë tekste me përmbajtje të

[13] Po aty: 83-85
[14] Anderson 2006: 9-36

njëjtë sesa nga vetë përmbajtja e tekstit, ka ndikuar drejtpërdrejt në formimin e "bashkësive politike sekulare të imagjinuara" (kombeve). Veçanërisht tre faktorë kanë kontribuar në këtë drejtim. Reformacioni e ka dobësuar rolin e gjuhës latine si gjuhë të shenjtë dhe, duke u shtypur Bibla në gjuhët lokale/popullore, ka rezultuar një aleancë në mes të kapitalizmit të shtypit dhe protestantizmit. Nga ana tjetër, gjuha latine, duke u zhvilluar më shumë në drejtim "estetik", është bërë më pak e kapshme dhe, njëkohësisht, më e vështirë të përdoret nga masat popullore. Faktori i tretë ka ndodhur gradualisht dhe karakterizohet nga forcimi dhe shpërndarja e gjuhëve të shkruara popullore, ku dialektet e qendrave politike kanë qenë pikënisje e zakontë për këto gjuhë të shkruara, duke u bërë njëkohësisht edhe gjuhë administrative në shtetet e reja burokratike të centralizuara. Për logjikën e kapitalizmit të shtypit s'ka qenë e favorshme të kalohet arbitrarisht nga gjuha latine në gjuhët e shkruara popullore sepse s'ka qenë në interes dhe as s'ka qenë praktike që të shtypen tekstet në të gjitha dialektet. Prandaj kapitalizmi i shtypit është bazuar kryesisht në dialektet e qendrave politike, dhe shfaqja e kombeve si "bashkësi të imagjinuara" është bërë e mundshme nëpërmes bashkëlojës, në mes të kapitalizmit të shtypit dhe variacioneve gjuhësore të qendrave politike.[15]

Rrjedhimisht, Andersoni konstaton se kapitalizmi i shtypit ka qenë vendimtar për krijimin e kombeve ngaqë në radhë të parë i ka krijuar diskurset e përbashkëta të komunikimit (nëngjuhën latine dhe mbi dialektet lokale) të bazuara kryesisht në dialektet e qendrave politike, duke formësuar kështu edhe "gjuhët e pushtetit", ku gazetat, sidomos gazetat ditore, kanë pasur rol shumë të rëndësishëm. Ky stabilizim gjuhësor më pastaj nëpërmes standardizimit gjuhësor ka shërbyer edhe për formimin e "pikturës" të kontinuitetit historik.[16] Me fjalë të tjera, sipas pikëpamjes teorike të Andersonit, tregu kapitalist,

[15] Po aty: 37-43
[16] Po aty: 44-46

duke qenë i karakterizuar nga kufijtë gjuhësorë, ka luajtur rolin kyç për t'i standardizuar gjuhët kombëtare brenda kufijve gjuhësorë dhe, rrjedhimisht, ka krijuar bazën për kombet si "bashkësi komunikuese të imagjinuara". Zhvillimi i administratës, i institucioneve politike dhe, më pastaj, sistemi shkollor publik, e kanë institucionalizuar bashkësinë komunikuese të imagjinuar, duke integruar fillimisht shtresën e mesme dhe më vonë shtresën fshatare dhe shtresën punëtore. Mund të thuhet se modeli teorik i Andersonit nënkupton se "bashkësitë e imagjinuara" (kombet) shfaqen kur njerëzit në radhë të parë krijojnë një kornizë të referencave të përbashkëta. Dhe ky model i kombformimit, pasi që është bërë realitet, ka pasur mundësi edhe të simulohet duke formuar (në radhë të dytë) bashkësitë e imagjinuara (kombet) edhe pa një gjuhë të përbashkët. Për shembull zviceranët janë formësuar si komb nëpërmes një kornize të përbashkët të referencave (arsimimit të standardizuar etj.), pa një gjuhë të përbashkët.

Sipas Andersonit, kombet janë bashkësi të imagjinuara, të përkufizuara dhe sovrane. Ngjashëm sikurse bashkësitë e tjera sociale të mëdha, kombet janë bashkësi të imagjinuara në kuptimin se një anëtar i një kombi nuk ka kontakt të drejtpërdrejtë dhe personal me të gjithë anëtarët e kombit.[17] Me fjalë të tjera, sipas qasjes teorike të Andersonit, kombi është një bashkësi e imagjinuar sepse ekzistenca e një kombi bazohet në radhë të parë në perceptimin e popullit se i takon një bashkësie të përbashkët të imagjinuar, por kjo nuk nënkupton se kombet si bashkësi të imagjinuara nuk ekzistojnë fare. Kjo nënkupton se kombet ekzistojnë në bazë të perceptimit të popullit se i takon një bashkësie të imagjinuar, e definuar si bashkësi subjektive. Më tutje, kombet si bashkësi të imagjinuara janë të përkufizuara sepse, pa marrë parasysh se sa i madh është një komb, nga anëtarët e vet perceptohet si i përkufizuar, në kuptimin se i ka kufijtë e vet në raport me kombet e tjera, duke mos qenë i shqetësuar që ta ketë tërë njerëzimin pjesë të vetën. Dhe kombet

[17] Po aty: 6

si bashkësi të imagjinuara janë sovrane, sepse shfaqja e kombeve është e ndërlidhur edhe me iluminizmin dhe revolucionin francez, përkatësisht me parimin e sovranitetit të popullit. Gjithashtu, kombet si bashkësi të imagjinuara janë "shoqëri" të thella dhe horizontale, në kuptimin se të gjithë anëtarët e një kombi konsiderohen të barabartë (si anëtarë të një kombi), pa marrë parasysh pabarazinë sociale brenda një kombi.[18]

Ngjashëm sikurse Gellneri, edhe Andersoni ka qasje reduksioniste për nacionalizmin, duke mos e cilësuar si ideologji krahasuar me ideologjitë politike, në kuptimin se nacionalizmi nuk ka përfaqësues teorik sikurse që kanë ideologjitë politike. Sipas tij, bashkësitë nacionale ngjasojnë më shumë me bashkësitë farefisnore (edhe pse nuk e kanë bazën e njëjtë biologjike) dhe me bashkësitë religjioze (edhe pse nuk kanë pretendime misionare universale) sesa me ideologjitë politike.[19] Në këtë vazhdë, Anderson e përkufizon fillimin e nacionalizmit jashtë Evropës, në "botën e re", përkatësisht në Amerikën Latine. Në kuptimin se kolonializmi, duke i penguar funksionarët vendorë për ngritjen e karrierave të tyre, dhe duke i formësuar kufijtë administrativë në vendet e kolonizuara (njësitë/bashkësitë e komunikimit, nëpërmes institucioneve, infrastrukturës së komunikacionit, shtypit etj.), ka krijuar bazën e lëvizjeve nacional-çlirimtare, fillimisht në Amerikën Latine dhe më pastaj edhe në Azi dhe Afrikë.[20] Megjithëkëtë, duhet të kemi parasysh se ky përkufizim tejet reduksionist i Andersonit, për fillesën e nacionalizmit, e përjashton nga ky përkufizim i tij jo vetëm formën e nacionalizmit politik europerëndimor të kombformimit, por edhe formën e nacionalizmit kulturor eurolindor të kombformimit, ku në emër të kombit si njësi kulturore kërkohet formimi i shtetit si mburojë e kësaj njësie kulturore. Kështu që, vetëm po qe se e përjashtojmë formën europerëndimore dhe formën eurolindore të nacionalizmit

[18] Po aty: 7
[19] Po aty: 5
[20] Po aty: 47-65, 113-140

mund të bazohemi në konstatimin e Andersonit, se nacionalizmi ka lindur në Amerikën Latine, në kuptimin si një reaksion i elitave vendore kundër elitave kolonizuese, ngaqë në vendet e kolonizuara kufijtë administrativë-kolonialë kanë luajtur rol më të rëndësishëm sesa kufijtë gjuhësorë (siç është shembulli në Evropë).

Erik Hobsbawm

Krahasuar me Gellnerin dhe Andersonin, të cilët kanë qasje strukturore, duke e cilësuar kombformimin si rezultat i modernitetit dhe jo domosdoshmërisht i planifikuar ose i konstruktuar nga ndokush, historiani me orientim marksist, Erik Hobsbawm, ka qasje të kundërt, në veçanti në librin *The Invention of Tradition* (2012), sepse u jep rëndësi të veçantë aktorëve (elitave politike) dhe konstaton se kombet janë të konstruktuara nga elitat, duke i përdorur si mjete, llojet e ndryshme të "traditave të shpikura". Më konkretisht, këto tradita të shpikura kanë të bëjnë me simbolet nacionale (flamurin, himnin, heraldikën etj.), me kulturat popullore (kostumet popullore, këngët popullore etj.), me ceremonitë zyrtare (fjalimet drejtuar popullit, jubiletë etj.) dhe, gjithashtu, me monumentet (ndërtesat e caktuara, statujat etj.).

Sipas Hobsbawm, traditat e shpikura karakterizohen nga përdorimi i motiveve të vjetra për qëllime të reja, duke u dhënë përmbajtje rituale zakoneve që kanë skaduar ose që e kanë humbur qëllimin e origjinës së tyre, dhe duke e vendosur kështu lidhjen ose kontinuitetin me të kaluarën historike. Por, sipas tij, e veçanta me traditat e shpikura është se ky kontinuitet, nëse nuk është domsodoshmërisht inekzistent, është më pak ose më shumë artificial.[21] Rrjedhimisht, sipas pikëpamjes teorike të Hobsbawmit, përpjekjet e lëvizjeve kombëtare për ta etabluar kontinuitetin me të kaluarën historike janë të shkëputura nga e

[21] Hobsbawm & Ranger 2012: 1-14

kaluara historike. Sepse nuk e kanë ringjallur dhe nuk e kanë mirëmbajtur këtë kontinuitet të së kaluarës historike, por përmes shpikjes së traditave i kanë konstruktuar kombet. Shpikja e këtyre traditave është bërë shpeshherë në mënyrë të vetëdijshme dhe me qëllim të caktuar dhe ka qenë e suksesshme aq sa ka mundur të përçohet te masat e gjëra popullore.

Përderisa për Gellnerin, nacionalizmi, rrjedhimisht kombformimi, është pothuajse një efekt spontan i industrializimit, për Hobsbawm nacionalizmi, rrjedhimisht kombformimi, është një strategji krejtësisht e vetëdijshme e elitave politike, e konstruktuar nëpërmes traditave të shpikura. Në këtë vazhdë, shikuar nga pikëpamja teorike e Hobsbawmit, bashkësitë nacionale janë rezultat i përdorimit të nacionalizmit si mjet nga ana e elitave për të siguruar stabilitet social dhe unitet. Përkatësisht elitat, në veçanti nëpërmes traditave dhe simboleve të shpikura, u janë përgjigjur ndryshimeve sociale për ta siguruar integrimin social në periudha historike moderne, të karakterizuara nga ndryshimet socio-politike dhe të ndërlidhura me modernizimin politiko-ekonomik.[22]

Në librin *Nations and nationalism since 1780* (2012), Hobsbawm është më i balancuar ngaqë në këtë libër nuk është i shqetësuar veçanërisht vetëm me rolin e aktorëve (elitave politike), por i problematizon edhe parakushtet historike dhe ndryshimet politiko-sociale të ndërlidhura me modernizimin politiko-ekonomik në relacion me kombformimet. Parakushtet historike për kombformimet i shtjellon nëpërmes termit "lidhjet protonacionale" (lidhjet paranacionale: gjuha, etnia, religjioni, ikonat dhe historia e përbashkët). Kështu, tutje, duke e problematizuar rolin e parakushteve paranacionale, i kundërvihet shpjegimit të "doktrinës nacionaliste" për rolin e parakushteve paranacionale në relacion me kombformimet.

Pretendimi se gjuha është parakushti më fundamental paranacional për kombformim (ashtu siç pretendon doktrina nacionaliste) nuk ka bazë të fortë historike, sipas Hobsbawm.

[22] Po aty: 263-264

Sepse, shikuar historikisht, kur merret parasysh periudha historike paranacionale dhe bëhet një ndarje në mes të gjuhës së shkruar dhe gjuhës së folur, dhe kur njëkohësisht bëhet një ndarje në mes të të arsimuarve dhe analfabetëve, rezulton se vetëm disa njerëz të pushtetit dhe një grup i vogël i njerëzve të arsimuar, përkatësisht një elitë relativisht e vogël, e ka zotëruar shkrim-leximin. Rrjedhimisht, në periudhën paranacionale (duke e pasur parasysh se kanë ekzistuar shumë variacione dialektesh dhe jo "gjuhët-nacionale"), gjuha nuk e ka pasur potencialin që të mund të funksionojë si forcë diferencuese për kombformim. Ndërsa gjuhët amtare në epokën paranacionale, që fëmijët i kanë mësuar nga nënat e tyre, dhe i kanë folur për përdorim të përditshëm, nuk kanë qenë në asnjë sens "gjuhë nacionale" sepse "gjuhët nacionale" janë të kushtëzuara nga sistemi arsimor i përgjithshëm.[23]

Më tutje, sipas Hobsbawm, dallimi në mes të kufijve të bashkësive gjuhësore nuk është fondamentalisht i pastër dhe preciz ashtu siç pretendon "doktrina nacionaliste" ngaqë, shikuar historikisht, në kufijtë në mes të shumë shteteve kombëtare ka pasur rrëshqitje të ndërsjella ndërgjuhësore të bazuara në dialektet e mëhershme. Për shembull, rrëshqitje të tilla ndërgjuhësore ka pasur në mes të popujve sllavë, në mes të popujve skandinavë, në mes të çekëve dhe sllovakëve, në mes të gjermanëve dhe holandezëve etj. Gjithashtu, purizmi (tentimi për t'i përjashtuar elementet e "gjuhëve të tjera nga gjuha jonë" ose "tentimi për ta pastruar gjuhën tonë nga gjuhët e tjera"), ka qenë fenomen i zakontë i ndikuar nga nacionalizmi. Këtë fenomen të purizmit e vërejmë në një formë të avancuar edhe në ditët e sotme. Për shembull, në Francë kemi një përpjekje të vazhdueshme për ekskludimin e termave që përdoren nga anglishtja apo për ruajtjen/mbrojtjen e pastërtisë së gjuhës frënge nga gjuha angleze. Rrjedhimisht, sipas pikë-pamjes teorike të Hobsbawmit, gjuhët nacionale janë pothuajse në të gjitha rastet gjysmartificiale si rezultat (më shumë ose më

[23] Hobsbawm 2012: 51-53

pak) i vendimeve të rastësishme politike. Problemi kryesor gjatë këtyre konstruktimeve gjuhësore ka qenë se cili dialekt të merret për bazë. Në shumicën e rasteve janë marrë për bazë dialektet e qendrave politike, për t'i kodifikuar gjuhët e shkruara nacionale.[24]

Edhe pse i kundërvihet pretendimit të "doktrinës nacionaliste", se gjuha është fondamenti kryesor paranacional i kombeve, megjithëkëtë Hobsbawm konsideron se gjuha për tri arsye nuk mund të konsiderohet krejtësisht e parëndësishme për kombformim. Në radhë të parë, bashkësitë gjuhësore në kuadër të elitave politike në epokën e paranacionalizmit mund të kenë kontribuar për formësimin e bashkësive komunikuese dhe këto bashkësi komunikuese mund të kenë funksionuar si "pilot-projekte" duke shërbyer për formimin e bashkësive nacionale. Së dyti, gjuha e pushtetit ka mundur të kontribuojë për unitet paranacional sepse gjuha e pushtetit krijon një stabilitet të ri gjuhësor duke formësuar gjuhën e shkruar dhe, gjithashtu, gjuha e shkruar, duke marrë forcë permanente, ka mundur të ndikojë drejtpërdrejt për standardizimin dhe mirëmbajtjen e gjuhës së folur. Së treti, gjuha e pushtetit e ka pasur potencialin që të bëhet gjuhë faktike nëpërmes sistemit arsimor dhe mekanizmave të tjerë shtetërorë.[25]

Pretendimi se kombet janë të ndërtuara mbi prejardhjen e përbashkët etnike nuk qëndron, sipas Hobsbawm. Po sipas tij, është e rëndësishme të nënvizohet se grupet etnike janë ndërtuar mbi një fondament kulturor dhe jo mbi një fondament biologjik, sepse migrimet që kanë ndodhur gjatë historisë në Evropë kanë ndikuar që të gjitha kombet evropiane, më shumë e më pak, të kenë përzierje ndëretnike. Përzierje në mes të ilirëve pararomak, romakëve, grekëve, fiseve të ndryshme të sllavëve, duke përfshirë valët e pushtuesve nga Azia qendrore që nga avarët deri te turqit otomanë, madje këto variacione interne ndëretnike janë pothuajse gjithkund në botë. Njëkohësisht, Hobsbawm nuk e

[24] Po aty: 54-57
[25] Po aty: 59-62

përjashton tërësisht rëndësinë e dallimeve ndëretnike (variacioneve ndëretnike), të ndërtuara mbi themelet kulturore. Por, sipas tij, në periudhën historike paranacionale dallimet ndëretnike kanë funksionuar më shumë si vertikale sesa si horizontale. Etniciteti është përdorur më shumë për ta ndarë shtresën e lartë (aristokracinë) nga shtresa e ulët sesa që është përdorur t'i ndajë bashkësitë shoqërore horizontalisht me njëra-tjetrën. Gjithashtu, pikëpamja negative për etnicitetin (pikëpamja për dallimet e dukshme etnike: ngjyrën etj.), ka qenë pothuajse gjithmonë irelevante për të formuar unitet paranacional në periudhën historike të paranacionalizmit. Ndërsa në epokën e nacionalizmit dallimet e dukshme etnike (ngjyra etj.) e kanë një tendencë të jenë negative sepse krijojnë paragjykime negative për të "tjerët", por paradoksalisht këto paragjykime negative për të tjerët janë të verbëta për variacionin e dallimeve të dukshme etnike (ngjyrës etj.), brenda grupit të vet kombëtar.[26]

Religjioni mund të ketë qenë një faktor për unitetin paranacional, sipas Hobsbawmit, siç është shembulli i polakëve, irlandezëve etj. Mirëpo, sipas tij, relacioni më i afërt në mes të religjionit dhe unitetit nacional është i dukshëm më vonë, gjatë fazës së nacionalizmit të masave. Njëkohësisht religjioni është një fondament paradoksal duke e marrë parasysh se shumë pak kombe dallohen në mes vete, vetëm duke u bazuar në dallimin religjioz. Rrjedhimisht, bashkësia religjioze në një fazë paranacionale nuk ka qenë e domosdoshme për formimin e kombeve. Shembujt e rrallë, që Hobsbawm përmend, ku religjioni mund të ketë ndikuar si diferencues në mes të popujve (por jo gjithmonë te popujt me gjuhë, kulturë dhe prapavijë të përbashkët historike), janë serbët dhe kroatët të cilët tradicionalisht kanë një prapavijë gjuhësore, por ndahen si kombe në ortodoks dhe katolik. Ndërsa shqiptarët në mënyrë të qartë kanë një lloj vetëdije paranacionale pa marrë parasysh dallimet religjioze (ortodoks, katolik dhe mysliman).[27]

[26] Po aty: 63-66
[27] Po aty: 67-70

Hobsbawm u jep rëndësi ikonave në kuptimin e tyre si simbole, rituale ose si praktikë e përbashkët kolektive të cilat formësojnë një realitet të prekshëm (përndryshe imagjinar) për bashkësinë. Por, njëkohësisht, sipas tij, funksioni i ikonave varion nga ikonat me funksion shumë të gjerë (transnacional) deri tek ikonat me funksion shumë të ngushtë (lokal). Shikuar historikisht, ikonat më të përshtatshme në fazën paranacionale që mund të kenë pasur efekt për një unitet paranacional janë ikonat e identifikuara me shtetin, për shembull, të identifikuara me një mbret, perandor, udhëheqës fetar etj.[28]

Sa i përket historisë së përbashkët, vetëdija për një unitet historik mund të ketë luajtur një rol për unitetin paranacional, sipas Hobsbawm. Mirëpo, sipas tij, kjo vetëdije ka qenë kryesisht e kufizuar në çarqet e elitave politike, përkatësisht e kufizuar te një pjesë shumë e vogël e popullit. Kështu që, në periudhën paranacionale vetëdija historike ka pasur shumë pak forcë të shtrirjes te masat popullore.[29]

Konkluzioni kryesor i Hobsbawmit është se asnjëra nga këto parakushte paranacionale nuk kanë qenë krejtësisht të domosdoshme, por as të mjaftueshme për t'i formuar identitetet nacionale. Megjithëkëtë, aty ku kanë qenë këto parakushte paranacionale, ka qenë më e lehtë për lëvizjet kombëtare t'i mobilizojnë popujt. [30] Rrjedhimisht, Hobsbawm mund të interpretohet, se nuk e përjashton tërësisht rolin e parakushteve paranacionale në relacion me kombformimet.

Paradigma etnosimboliste

Etnosimbolistët mëtojnë të plasojnë ngritjen e kombeve moderne në kontekstin e identiteteve të mëhershme kolektive kulturore, të epokës paramoderne. Sipas përfaqësuesit më të

[28] Po aty: 71-72
[29] Po aty: 73-76
[30] Po aty: 77-79

spikatur të paradigmës etnosimboliste, Anthony D. Smith, tipari më i rëndësishëm i identiteteve kolektive të epokës paramoderne janë etnitë dhe, në këtë vazhdë, kombet janë rezultat i riinterpretimit dhe rikonstruktimit transformues të etnive. Ky transformim i etnive në kombe nuk nënkupton se janë domosdoshmëri, por nënkupton se disa etni i kanë ruajtur dhe zhvilluar, me kalimin e kohës, identitetet kolektive kulturore dhe se këto identitete riparaqesin një lloj kontinuiteti duke u bërë bazë për kombformimet gjatë epokës së nacionalizmit. Njëkohësisht: "… kjo nuk do të thotë se për çdo komb duhet të ketë qenë një etni e mëparshme që i shërben si bazë e vetme - ngaqë shumë pak kombe nuk janë të shumëllojshëm etnikisht - kjo nënkupton se kombet janë zhvillime të specializuara të (një ose më shumë) grupeve të lirshme etnike dhe se bashkësia etnike ka shërbyer historikisht si modeli dhe baza e shumë kombeve" (Smith 2008: 85-86). Prandaj, sipas qasjes etnosimboliste, studimi i etnive (termi francez *ethnie* për "bashkësitë etnike") është thelbësor për ta kuptuar formimin e kombeve, duke u fokusuar veçanërisht në mite, kujtime, vlera, tradita dhe simbole:

> "Miti i një origjine të përbashkët dhe unike në kohë dhe vend, është esencial për ndjenjën e bashkësisë etnike pasi shënon pikën themeltare të historisë së grupit dhe, rrjedhimisht, individualitetin e tij. Simbolet, gjithashtu, emblemat, himnet, festivalet, vendbanimet, zakonet, kodet linguistike, vendet e shenjta dhe të ngjashme, janë diferencuesit e fuqishëm dhe përkujtuesit e kulturës dhe fatit unik të bashkësisë etnike. Kështu janë shpërndarë kujtimet e ngjarjeve dhe të epokave kyçe në historinë e bashkësisë: kujtimet e çlirimit, migrimit, epoka (ose epokat) e artë, e fitoreve dhe disfatave, e heronjve, e shenjtorëve dhe e të diturve" (Smith 2006:191).

Rrjedhimisht, Smith është kritik ndaj teoricienëve modernistë (duke e përfshirë edhe ish-mësimdhënësin e tij, Ernest Gellner), që më shumë dhe më pak e shpërfillin rolin e etnive paramoderne si formacione sociale, në ndërlidhje me kombin.

Vlen të theksohet se Gellner, duke qenë pjesërisht implicit në teorinë e tij, nuk sqaron mjaftueshëm dallimin në mes të

shfaqjes së identitetit kombëtar dhe shpërndarjes së identitetit kombëtar, dhe kështu krijon përshtypjen se identiteti kombëtar shfaqet si rezultat i një sistemi të përgjithshëm arsimor. Por, shikuar historikisht, në të shumtën e rasteve identiteti kombëtar është shfaqur më herët, para krijimit të një sistemi të përgjithshëm arsimor dhe, në shumicën e rasteve, sistemi i përgjithshëm arsimor ka qenë rezultat i mobilizimit kombëtar.[31]

Idenë e Andersonit për kombet si fenomene të imagjinuara, Smith e konsideron si ide problematike, në veçanti është kritik ndaj mënyrës se si Anderson operon me termin "bashkësitë e imagjinuara". Ky term, duke mos qenë semantikisht i qartë dhe preciz, implikon një rrëshqitje nga cilësimi i kombeve si fenomene të imagjinuara në cilësimin e kombeve si fenomene të fabrikuara (false/inekzistente), duke e minuar në këtë mënyrë kombin si realitet sociologjik. Madje, sipas Smith, Anderson e ka një pikënisje intelektualiste sepse nuk sqaron se n'çmënyrë teoria e tij mund ta kuptojë forcën në identitetin nacional, në kuptimin se si ndodh që nga të imagjinuarit e kombit ta duam /dashurojmë kombin. Me fjalë të tjera, teoria e Andersonit nuk sqaron se kombet kanë vlera dhe interesa që ndërlidhen me identitetin dhe mbijetesën. Gjithashtu, konstatimi i Andersonit për ndryshimin e pozicionit të fortë të religjioneve të mëdha nuk qëndron, sipas Smithit, ngaqë religjionet ende luajnë një rol të rëndësishëm. Kombi dhe religjioni te shumë shtete janë në një shkallë të lartë të ndërlidhura në mes vete, veçanërisht në Izrael, Pakistan, Greqi etj. Dhe sa i përket perceptimit kohor linjar, si sinonim vetëm me zhvillimin dhe përparimin modern, nuk është diçka e re, por e ka nismën thellë në histori, përkatësisht që nga antikiteti.[32]

Për dallim të Andersonit, sipas të cilit nacionalizmi nuk është ideologji sepse, përveç të tjerash, nuk ka përfaqësues ideologjik sikurse që kanë ideologjitë politike (liberalizmi, socializmi etj.)., Smith konsideron se nacionalizmi është ideologji në

[31] Bakke 1995: 13

[32] Smith 2006: 137, 140 - 141

kuptimin e posedimit të parimeve të qarta të autonomisë, unitetit dhe identitetit: "Një lëvizje ideologjike për arritjen dhe ruajtjen e autonomisë, unitetit dhe identitetit për një popullatë që disa nga anëtarët e saj konsiderojnë se e përbëjnë një komb "aktual" ose "potencial" (Smith 2008: 9). Dhe përveç rëndësisë që e ka në sferën politike, nacionalizmi e ka rëndësinë e vet edhe në sferën kulturore, intelektuale dhe psikologjike:

> … Nga shumë kriza politike ndërkombëtare në dekadën e fundit apo më shumë, janë pak nga ato që nuk kanë përfshirë një komponent të fortë të ndjenjave etnike dhe aspiratës nacionaliste, ndërsa disa prej tyre, dukshëm ato në ish-Jugosllavi, Kaukaz, subkontinentin indian dhe Lindjen e Mesme, janë aktivizuar dhe madje janë përcaktuar nga ndjenjat dhe aspiratat e tilla. Këto konflikte kanë dëshmuar të jenë më të hidhurat. Por, përtej lajmeve dhe titujve të gazetave me përshkrimet për konfliktet dhe dhunën e nacionalizmave "të nxehtë", ne hasim një strukturë më të qëndrueshme dhe të marrë si të mirëqenë të "marrëdhënieve" ndërkombëtare, e cila formon dhe kanalizon proceset dhe ngjarjet e botës moderne. Kjo është diçka shpesh e referuar si "një botë e kombeve". Por një frazë e tillë nuk nënkupton ndonjë reifikacion esencialist të kombeve ose shteteve kombëtare por, më tepër, një hartë politike dhe kornizë institucionale dhe emocionale në të cilën personalitetet, ngjarjet dhe proceset më të gjera të ndryshimit lënë gjurmët e tyre dhe kontribuojnë në transformimet që i kanë dhënë formë dhe vazhdojnë ta formojnë botën bashkëkohore. *Micheal Billing (1995) i referohet kësaj harte dhe kornize në aspektin e një nacionalizmi të përditshëm "banal", që zakonisht "banon" brenda shoqërisë - i rrënjosur në shumë cilësi të jetës dhe politikës tonë, gjithnjë prezent, nëse edhe mezi duket, si "flamujt e pavëlvitur".* Por rëndësia e nacionalizmit nuk është e kufizuar në botën e politikës. Është, gjithashtu, kulturore dhe intelektuale për shkak se "bota e kombeve" strukturon pikëpamjet tona globale dhe sistemet simbolike. Unë nuk po pretendoj për nacionalizmin ndonjë shkallë të konsiderueshme të koherencës intelektuale, lëre më traditën e angazhimit filozofik të karakteristikës së traditave të tjera moderne politike, si liberalizmi ose socializmi. Megjithatë, edhe nëse i kanë munguar mendimtarë të mëdhenj, nacionalizmi - ose, mbase duhet të themi, koncepti i kombit, ka tërhequr një numër të konsiderueshëm intelektualësh me ndikim - shkrimtarë, artistë, kompozitorë, historianë, filologë, pedagogë - të cilët i kanë kushtuar energjitë e tyre zbulimit dhe përfaqësimit të identiteteve dhe imazheve të kombeve të tyre

> përkatëse, nga Herder, Burke dhe Rousseau te Dostoevskii, Sibelius, Diego Rivera dhe Iqbal. Rëndësia kulturore dhe psikologjike e kombit, dhe rrjedhimisht e nacionalizmit, është madje më e thellë. Gjithëpranishmëria e nacionalizmit, ndikimi i tij që ushtron mbi miliona njerëz në çdo kontinent sot, dëshmon aftësinë e tij për të frymëzuar dhe kumbuar në mesin e "njerëzve" në mënyra që vetëm religjionet më parë kanë qenë në gjendje t'i përfshijnë. Kjo zgjon nevojën për t'u kushtuar vëmendje të madhe elementeve simbolike në gjuhën dhe ideologjinë e nacionalizmit dhe aspekteve morale, rituale dhe emocionale të diskursit dhe veprimit të kombit (Smith 2008: 1-3).

Sa i përket këndvështrimit teorik të Hobsbawmit për kombformimet, Smith është kritik ndaj mënyrës se si Hobsbawm e parasheh konstruktimin e identiteteve nacionale, në kuptimin se deri në ç'shkallë mund të konstruktohen identitetet nacionale. Veçanërisht kritikon termin "traditat e shpikura" si term rrënjësisht të paqartë. Kjo paqartësi nuk është thjesht vetëm një çështje terminologjike, por një dilemë që nënkupton se termi "shpikje" nga njëra anë mund të interpretohet si fabrikim dhe ose *ex-nihilo* (krijim nga asgjëja) dhe, nga ana tjetër, mund të interpretohet se përfshin edhe elementet para-nacionale, në kuptimin e rikonstruktimit. Smith pajtohet se gjatë procesit të kombformimeve ndodh ripërpunimi dhe selektimi i traditave dhe kjo është krejtësisht e qartë. Megjithëkëtë, konsideron se gjatë procesit të konstruktimit ekzistojnë kufijtë se sa mund të fabrikohet ngaqë për të qenë të suksesshme përpjekjet e konstruktimit duhet të bazohen në lidhjet e rëndësishme sociokulturore paraekzistuese. Prandaj, sipas Smith, Hobsbawm në skemën e tij nuk është në gjendje të japë shpjegim bindës për përfshirjen e masave në nacionalizëm/kombformimet.[33] Në lidhje me ketë Smith, përveç të tjerash, shkruan:

> "Natyrisht, ka pasur shumë përpjekje për t'i manipuluar ndjenjat e masave dhe disa kanë pasur sukses, si në shembujt e njohur të Indisë së Tilakut dhe Gandit. Por, edhe në këtë rast, distanca kulturore në mes të elitave dhe masave ka qenë më e vogël sesa që

[33] Po aty: 129-130

> sugjeron kjo skemë; elitat shpesh kanë qenë aq shumë në kthetrat e pasioneve nacionaliste dhe të përgatitur për vetësakrificë idealiste sikurse 'masat' nga të cilat, në fund të fundit, shumë prej tyre kanë rezultuar. Nacionalizmi s'i shoi dallimet klasore apo antagonizmat, por pa dyshim mundi t'i anashkaloj ato në çaste të rrezikut nga jashtë, dhe t'i unifikojë përkohësisht klasat për t'i arritur qëllimet e përbashkëta. E tëra që kjo sugjeron, është se Hobsbawm ka anashkaluar mundësinë se lidhjet e tij të popullarizuara 'protonacionale' janë, në fakt, shumë lidhje etnike, që ai i kundërshton si bazë për kombet. Por, sapo të akceptohet ky ekuacion, mund të fillojmë ta vërejmë pse etnia është një forcë kaq e fuqishme në botën moderne, dhe pse kaq shumë kombe janë, apo kërkojnë për t'u formuar në bazë të *etnive* dominuese ose, të paktën, përpiqen të arrijnë atë sens të unifikimit kulturor dhe të intimitetit që etnia e furnizon" (Smith 2006: 128).

Në këtë vazhdë është me rëndësi ta qartësojmë edhe më shumë dallimin në mes të Smith dhe Hobsbawm në lidhje me pikëpamjet e tyre për kontinuitetin historik në relacion me kombin. Sipas pikëpamjes së Hobsbawm, kriterin e 'kontinuitetit efektiv historik' (në kontekstin evropian) e përmbushin vetëm disa shembuj të izoluar (sikurse Anglia, Franca, Rusia etj.), raste ku kanë mbijetuar institucionet e mëdha si, për shembull, shteti ose kisha, ndërsa lidhjet e tjera historike (lidhjet protonacionale) në relacion me kombin janë lidhje spurioze (false) sepse nuk e kanë lidhjen e domosdoshme me atë që ne sot e kuptojmë si 'komb'. Rrjedhimisht, sipas pikëpamjes teorike të Hobsbawm, bashkësitë paranacionale në periudhat paramoderne, të bazuara në kulturat regjionale (gjuhë, religjion etj.) nuk mund të konsiderohen si paraardhëse të kombeve. Smith e konsideron si të mangët këtë konstatim të Hobsbawm (për relacionin në mes të kontinuitetit historik dhe kombit) dhe shtron pyetjen: A janë krejtësisht të rreme lidhjet e tjera historike dhe çfarë saktësisht është 'kontinuiteti efektiv historik'? Smith pajtohet se historiku objektiv është i rëndësishëm për kontinuitetin historik, por konsideron se duhet të merren parasysh edhe narrativët që për masën popullore duhet të kenë pasur 'rezonancë' emotive aq të fortë sikurse "përmbajtja e vërtetë".

Kjo është një pikë qendrore teorike për etnosimbolistët, pohon Smith, ngaqë faktorë të rëndësishëm për shpjegimin e forcës/qëndrueshmërisë së kombeve dhe nacionalizmit janë narrativët dhe imazhet për kombin (gjatë procesit të kombformimit), që zgjojnë kujtime te populli në kuptimin e një komplementariteti. Nga njëra anë, elita, duke i apeluar popullit nëpërmes narrativëve dhe imazheve, nga ana tjetër populli duke iu përgjigjur apelit të elitës, janë kontribuues të përbashkët në procesin e kombformimit, sepse elita e arrin influencën dhe lidershipin e vet vetëm kur është në gjendje të paraqesë para masave popullore një imazh apo narrativ të pranueshëm për kombin. Prandaj Smith insiston që ta kuptojmë nacionalizmin edhe nëpërmes emocionit dhe jo vetëm nëpërmes kognicionit, përkatësisht si një lloj i sjelljes kolektive të bazuar në vullnetin kolektiv të një komuniteti me emocione të përbashkëta, për prejardhjen e përbashkët.[34] Kështu që, përderisa kriteri i Hobsbawmit për 'kontinuitetin efektiv historik' është rigjid dhe reduksionist, pikëpamja e Smithit për të kaluarën historike lë hapësirë për qasje alternative, përmbushëse dhe korrigjuese në lidhje me relacionin në mes të kontinuitetit historik dhe kombit.

Kritikën e modernistëve ndaj etnosimbolistëve (se etnosimbolistët janë fajtorë për "retro-spektivizimin e nacionalizmit" në kuptimin e të projektuarit/formësuarit të veçorive të hershme të kombeve dhe nacionalizmit), Smithi e konsideron si një keqkuptim dhe ngatërrim të etnosimbolizmit me perenializmin ngaqë etnosimbolistët (për dallim të perenialistëve) e bëjnë një dallim të qartë në mes të etnisë dhe kombit modern dhe, gjithashtu, nuk e kanë në qendër të shqetësimit të tyre 'analogjinë familjare' të nacionalizmit.[35] Shqetësimi kryesor i etnosimbolistëve është: "… çështja e gjurmimit historik, shpeshherë e diskontinuitetit të formacioneve të identiteteve nacionale deri te para-ekzistenca e themeleve të tyre kulturore dhe lidhjeve etnike - në radhë të parë si preokupim për

[34] Smith 2008: 81-82, 90, shih edhe Hobsbawm 2012: 75-79
[35] Smith 2006: 196

hulumtim empirik sesa si teoritizim aprioristik…" (Smith 2006: 196). Njëkohësisht, etnosimbolistët distancohen nga çdo version i primordialistëve në lidhje me konstituimin e etnive sepse, sipas tyre, etnitë nuk janë të konstituara bazuar në linjat e prejardhjes fizike (siç pretendojnë primordialistët), por në radhë të parë në linjat e afërsisë kulturore, në kuptimin e sendërtimit/mishërimit mbi mitin e prejardhjes së përbashkët, kujtesën historike, simbolet, vlerat etj. Kjo, sipas Smithit, e përcakton strukturën e bashkësive etnike dhe vlen për çdo komb të krijuar mbi bazën e afërsisë kulturore. [36] Gjithashtu, etnosimbolistët e kanë shprehur kritikën e tyre ndaj qasjes së modernistëve për të kaluarën historike duke e cilësuar si një "prezentizëm të bllokuar", në kuptimin se kur e formësojnë të kaluarën, u japin një fokus të veçantë pikëpamjeve dhe interesave të gjeneratës së re (të tashmes dhe të ardhmes). Dhe se kjo qasje e modernistëve për të kaluarën historike, përveçse krijon vështirësi, të kuptojmë se si e kaluara etnike e ka formësuar në shumë mënyra të tashmen, njëkohësisht përballet shumë sipërfaqësisht me historinë. Prandaj, sipas etnosimbolistëve, është e nevojshme që ta shohim ngritjen e kombeve moderne në kontekstin e identiteteve kulturore kolektive, të epokës paramoderne (bashkësive etnike).[37]

Smith konstaton se transformimi i etnive në kombe ka ndodhur nëpërmes dy mënyrave kryesore, përkatësisht mënyrës laterale dhe mënyrës vertikale. Mënyra e parë (laterale) nënkupton se shtresat aristokrate (shikuar historikisht) për ta ruajtur statusin e vet si shtresa të larta karshi shtresës së mesme nuk kanë pasur vullnet dhe interesim t'ia imponojnë kulturën e vet etnike shtresës së mesme, me qëllim që ta diferencojnë shtresën e mesme si shtresë më të ulët. Por, sipas të gjitha gjasave, për shkak të dështimit për të rikrijuar Perandorinë Romake (në Evropën Perëndimore), monarkët dhe aristokracia në Francë, Angli, Spanjë etj., pasi që u futën në një konkurrencë të ndërsjellë për

[36] Po aty: 192
[37] Smith 2008: 83, 85

t'u pasuruar, për mënyrën e udhëheqjes së luftërave dhe shfaqjen e madhështive të tyre etj., filluan t'i mobilizojnë shtresat e tyre të mesme në kulturat e politizuara nacional-territoriale, të bazuara në kulturat e etnive aristokrate. Në këtë mënyrë ka ndodhur transformimi lateral i etnive në kombe ngaqë një kulturë etnike, duke qenë e rezervuar vetëm për aristokracinë dhe klerin, u bë një kulturë e popullit, së pari një kulturë e shtresës së mesme, më vonë e shtresës punëtore etj. Kjo rezultoi më shumë me formimin e identiteteve kombëtare qytetare që kryesisht u realizuan nëpërmes nacionalizmave territorial, duke i asimiluar etnitë e tjera në kulturat e etnive kombformuese. Mënyra tjetër (vertikale) nënkupton transformimin e etnive në kombe-kulturore nën regjinë e elitave kulturore. Në Evropën qendrore dhe lindore elitat kulturore rizbuluan në mënyrë selektive historitë etnike të bazuara në mite, simbole dhe tradita. Kthimi te një e kaluar etnike është konsekuencë e kërkesës nacionaliste për "origjinalitet" në kuptimin se vetëm ajo që është "origjinale" dhe "e jona" mund të krijojë bazën e një identiteti nacional. Kjo rezultoi më shumë në formimin e identiteteve kombëtare kulturore që kryesisht u realizuan duke u bazuar në histori, gjuhë, kulturë dhe në mobilizimin masiv të popujve rreth historisë dhe kulturës së tyre. Smith potencon edhe një mënyrë të tretë të transformimit të etnive në kombe, por për dallim nga dy të parat, mënyra e tretë karakterizohet nga transformimi i disa etnive në një komb "pluralist". Kjo vlen në veçanti për Amerikën, Kanadanë dhe Australinë, ku ardhja masive e emigrantëve me përkatësi të ndryshme kulturore, inkurajoi formimin e kombeve "pluraliste" që pranojnë diversitetin etnik dhe kulturor brenda një identiteti politik, ligjor dhe gjuhësor-gjithëpërfshirës. [38]

Rrjedhimisht, dikotomia në mes të kombit qytetar dhe kombit etnik, shikuar nga këndvështrimi historik, është e pasaktë dhe, shikuar nga këndvështrimi sociologjik, është çorientuese dhe e tepruar sepse edhe Anglia, Franca, Holanda, Spanja, Rusia-

[38] Smith 2006: 193-194

Moskovite etj., janë formuar mbi bazën e etnive dominuese. Në këtë kuptim edhe kombi amerikan është formuar nga elita e një etnie dominuese (protestante britanike), edhe pse ky karakter etnik amerikan është transformuar më pas, duke rezultuar më shumë në një komb pluralist, në veçanti si rezultat i përshkallëzimit të valëve të emigrantëve në Amerikë. Kështu që, këto janë kombe etnike që gradualisht gjatë historisë janë transformuar më shumë në bashkësi politike territoriale dhe multikulturore. Prandaj, Smith sugjeron se nuk duhet të teprohet edhe me kontrastin midis *ius soli* dhe *ius sanguinis* (territorit dhe gjenealogjisë), që sociologu Rogers Brubaker e përdor për t'i ndriçuar dallimet në mes kombit politik francez dhe kombit kulturor gjerman, në lidhje me emigracionin dhe politikat e praktikat e shtetësisë (nënshtetësisë), sepse shumica e kombeve karakterizohen nga këto parime të organizimit shoqëror (të kombit qytetar dhe kulturor), edhe nëse në kohë të caktuara zgjedhin të theksojnë njërin prej tyre mbi tjetrin.[39] Madje Smith sugjeron se nuk duhet të keqinterpretohet kontrasti në mes të tipologjisë së dy llojeve më të gjata historikisht dhe më të njohura të nacionalizmit, përkatësisht voluntarizmit dhe organicizmit ngaqë, sipas tij, fragmenti (thënia) e njohur e historianit francez Ernest Renan (i cili ka argumentuar për një formë voluntariste të nacionalizmit) shpeshherë dekontekstualizohet:[40]

> "*Loci classici* (fragmenti i mirënjohur dhe shpeshherë i cituar) për debatin rreth dy llojeve të ideologjisë nacionaliste mund të gjendet në kritikën e Ernest Renan ndaj Heinrichvon Treitschke, në ligjëratën e tij të vitit 1882, të titulluar *Qu'est-ce qu'une nation?* Treitschke kishte përdorur një kriter etnolinguistik për ta legjitimuar aneksimin gjerman të territoreve të kontestuara të Alsace dhe Lorraine, duke pretenduar se, pavarësisht prej vullnetit të tyre politik të shprehur qartë dhe memorieve historike, alsasianët ishin 'objektivisht' gjermanë etnikë. Renan argumentoi për një qasje më shumë politike dhe deri në një masë të caktuar voluntariste. Ndonëse

[39] Smith 2008: 101-102
[40] Po aty: 36

pranoi diçka në lidhje me tezën "gjermane" të origjinës së Francës, deri në atë shkallë se fiset gjermane (franke) sollën qeverisjen monarkiste dhe ndarjet territoriale të qëndrueshme në Evropën Perëndimore, prapëseprapë afirmoi natyrën spirituale të kombeve dhe rëndësinë e memorieve historike dhe vullnetit politik. Kundër determinizmit etnik, Renan afirmon supermacinë e "kulturës njerëzore" mbi kulturat e veçanta kombëtare dhe nevojën për 'aprovimin, për të shprehur qartë dëshirën për të vazhduar një jetë të përbashkët. Ekzistenca e një kombi është (...) plebicit i përditshëm, mu ashtu sikurse që është ekzistenca e individit një pohim i përhershëm i jetës'. Ky fragment i njohur shpesh nxirret jashtë kontekstit për të demonstruar një ideal liberal dhe voluntarist të kombësisë, në kontrast me organicizmin dhe determinizmin e ideologjisë romantike gjermane. Për të qenë të sigurt, Renan përjashton determinizmin dhe analogjinë organike, por jo për të pohuar një doktrinë voluntariste të kombësisë ose të drejtën e individit për ta zgjedhur kombin e saj ose të tij. Parësisht, mëton të justifikojë një kuptim historik dhe aktivist politik të kombit, ku i jepet rëndësi 'kultit të paraardhësve' dhe të 'kaluarës heroike'. Analogjia e kombit me preferencat individuale ose analizat situacioniste të identiteteve grupore, përdoret për ta konfirmuar rolin e së kaluarës, të historisë dhe të kujtesës (dhe harresën), si dhe kontinuitetin e vullnetit politik në formësimin e kombeve: *Kombi, sikurse individi, është kulmi i një të kaluare të gjatë të përpjekjeve, sakrificave dhe përkushtimit. Nga të gjitha kultet, ajo e paraardhësve është më legjitimja, sepse paraardhësit na kanë bërë ata që jemi. E kaluara heroike, burrat e mëdhenj, lavdia (nga e cila e kuptoj lavdinë e vërtetë), është kapitali social mbi të cilin bazohet ideja kombëtare. Lavditë e përbashkëta nga e kaluara dhe vullneti i përbashkët në të tashmen, veprat e mëdha të përbashkëta, dhe dëshira për të bërë akoma më shumë, janë parakushtet esenciale për të qenë një popull.* Max Weber, që mendohet të ketë qenë nacionalist gjerman, erdhi te një përfundim i ngjashëm. Ai, gjithashtu, insistoi për rolin e kujtesës historike dhe vullnetit politik. Në lidhje me vizitën e tij në muzeun e Colmarit u shpreh se: *Arsyeja pse Alsasianët nuk e ndiejnë veten se i përkasin kombit gjerman duhet të kërkohet në memoriet e tyre. Fati i tyre politik ka marrë kursin jashtë sferës gjermane për një kohë të gjatë ngaqë heronjtë e tyre janë heronjtë e historisë franceze. Nëse kujdestari i Muzeut në Colmar dëshiron t'ju dëftojë se cilin prej thesareve të tij e pëlqen më së shumti, ai ju largon nga altari i Grunvaldit drejt një dhome të mbushur me trengjyrëshin (francez), pompierët, dhe helmeta të tjera dhe suvenire, në dukje të një natyre më të parëndësishme, të cilat janë nga një kohë që për të është një epokë heroike* (Smith 2008: 36-38).

Ngjashëm argumenton politologia dhe studiuesja e nacionalizmit pranë Universitetit të Oslos, Elisabeth Bakke, e cila konsideron se as kombet "qytetare" e as kombet "etnike" nuk janë veçanërisht voluntariste, se e vetmja pjesë e dikotomisë midis kombit qytetar dhe kombit etnik që ka ndonjë rëndësi, është aspekti që ka të bëjë me përmbajtjen kombëtare në kuptimin e gjërave që ndajnë kombet veç e veç sa i përket ndjenjës së përkatësisë së përbashkët. Kjo pjesë e dikotomisë është e dobishme për ta përshkruar variacionin në mes të kombeve, gjithashtu është edhe më e dobishme ta shqyrtojmë kombin "qytetar" dhe kombin "etnik" si pika përfundimtare të një kontinuiteti shkallë-shkallë dhe jo si forma të pastra (të papërziera), të kësaj dikotomie, sepse nuk ekzistojnë si forma të pastra në realitet. Prandaj, përshkrimi i kombeve "qytetare" si kombe gjithëpërfshirëse (të hapura), voluntariste dhe liberale, dhe i kombeve "etnike" si përjashtuese (të mbyllura), jovoluntariste dhe autoritare (ose joliberale), është çorientues[41], sepse:

> "Së pari, anëtarësimi në kombe është më shumë çështje e identifikimit dhe e pranimit/njohjes së ndërsjellë sesa zgjedhje individuale. Pas formimit të plotë të kombit hapësira për zgjedhje është mjaft shumë e kufizuar për shumicën. Në fazat e hershme të procesit të kombformimit, hapësira për zgjedhje është më e madhe si në aspektin e përmbajtjes së propozuar të identitetit, po ashtu edhe për sa i përket zgjedhjes individuale ndërmjet projekteve të kombit. Ngjashëm minoritetet dhe imigrantët mund të zgjedhin midis identitetit të tyre origjinal dhe (pjesërisht) përshtatjes me identitetin e majoritetit, por ndryshimi i identitetit nuk është kurrë i lehtë dhe kërkon njohjen/pranimin prej të tjerëve. Së dyti, kombet 'qytetare' janë më pak voluntariste dhe kombet 'etnike' janë më pak jovoluntariste sesa që sugjeron dikotomia. Në të dyja rastet, gjatë formulimit të përmbajtjes kombëtare, elitës kombformuese i është dashur t'i theksojë elementet e konsideruara përbashkuese për anëtarët e një kombi dhe, në të dyja rastet, kriteret e anëtarësimit përcaktojnë kufizimet për përfshirje dhe si rrjedhim për zgjedhje individuale. Disa kritere 'qytetare' për anëtarësim mund të jenë po

[41] Bakke 2000: 1, 12

> aq të vështira për t'u realizuar sa kriteret 'etnike' (p. sh., vlerat). Prandaj, dikotomia midis identiteteve 'qytetare' si gjithëpërfshirëse dhe identiteteve 'etnike' si përjashtuese është tepër fikse. Kombet 'qytetare' nuk janë të hapura për që të gjithë dhe kombet 'etnike' janë shumë rrallë çështje e karakteristikave gjenetike. Asnjë komb nuk është plotësisht i hapur ose i mbyllur për anëtarët e rinj, dhe shkalla e hapjes nuk përkon domosdoshmërisht me etiketimet e tilla si kombi 'qytetar' ose kombi 'etnik'. Për më tepër, ne duhet ta bëjmë dallimin midis botëkuptimit nacionalist (edhe nëse i përshkruajnë kombet si entitete organike ose asociacione voluntariste) dhe këtij realiteti: Asimilimi ose integrimi në një komb tjetër është i mundur. Shtrohet pyetja në cilat rrethana. Madje edhe një komb kryesisht 'etnik' do të jetë më i hapur për të huajt herët në procesin e kombformimit sesa më vonë, dhe kombet me identitet kombëtar të kontestuar mund të jenë më të hapura sesa kombet ku përmbajtja kombëtare është fare mirë e definuar. Sa i hapur apo i mbyllur është një komb, është një pyetje empirike, dhe jo diçka që mund të përcaktohet në bazë të një etikete. Pyetja relevante është nëse dallimi midis një kombi qytetar dhe një kombi etnik është një mjet i dobishëm për hulumtim. Me konotacionet e zakonshme unë e gjej dallimin më shumë të turbullt sesa të dobishëm. I zhveshur nga konotacionet si gjithëpërfshirës/përjashtues, voluntarist/jo-voluntarist dhe liberal/autoritar, megjithatë, në këndvështrimin tim do të jetë një mjet shumë më i mirë (Bakke 2000: 12).

Më tutje, sipas Smith, nacionalizmi ka disa lloje ideologjike: religjioz, sekular, konservativ, radikal, imperial, seperatist etj. Megjithëkëtë, të gjitha këto lloje ideologjike shfaqin elemente themelore të përbashkëta dhe janë të vulosura me një shenjë identike të *aktivitetit për kombësinë*[42] dhe, nacionalizmi, përveçse është ideologji, është kulturë publike dhe 'religjion' politik. Është kulturë publike në kuptimin se: "… shtytja e përgjithshme e nacionalizmit është e qartë: kombi është një formë e kulturës publike dhe simbolizmit politik dhe, në fund të fundit, kulturë e politizuar e masave që kërkon t'i mobilizojë qytetarët për ta dashur kombin e tyre, t'i respektojnë ligjet dhe ta mbrojnë atdheun e tyre" (Smith 2008: 35). Është 'religjion' politik, në kuptimin se gjatë vrullit të vet sekular, ngjan më

[42] Smith 2008: 21

shumë me 'religjionin politik' sesa me ideologjitë politike. Në këtë vazhdë, Smith, duke marrë pikënisje në definicionin e sociologut Emile Durkheim për religjionin (veçanërisht për rolin funksional të shenjtërisë dhe ritualeve), konsideron se mund ta kuptojmë më lehtë karakteristikën surrogate religjioze të nacionalizmit, ngaqë kjo karakteristikë është shumë e dukshme, për shembull, gjatë ceremonive përkujtimore për liderët, për të rënët në beteja, që sakrifikuan jetët e tyre për vendin e tyre etj. Dhe në këso çaste mund ta kuptojmë kombin si një 'bashkësi e shenjtë e qytetarëve'.[43] Madje, sipas tij:

> "Ekzistojnë edhe aspekte të tjera që zbulojnë karakterin e religjionit politik surrogat të nacionalizmit. Kohë pas kohe hasim vetë imazhin e një kombi të zgjedhur, një populli unik me një histori dhe fat të veçantë, pasuesit sekularë të besimeve të vjetra religjioze në përzgjedhjen etnike, ose 'popull i zgjedhur'. Këto janë vetë imazhe që mund të gjenden në vende të largëta si Franca dhe Japonia, India dhe Shtetet e Bashkuara. Pastaj ekziston një entuziazëm kuazimesianik i lidhur me themeluesit dhe udhëheqësit e tyre. Në shtetet e reja të Afrikës dhe Azisë, burrat që udhëhoqën kombet e tyre në pavarësi, të tillë si Nehru dhe Sukarno, Nkrumah dhe Kenyatta, fituan pothuajse statusin e shenjtë në atë kohë si profetë dhe shpëtimtarë të popullit të tyre, që çoi në një epokë të re të lirisë, drejtësisë dhe dashurisë. Edhe më të rëndësishme janë besimet e dyfishta në fatin nacional dhe pasardhësit etnikë siç është përshkruar më herët. Këto besime plotësojnë dhe nganjëherë zëvendësojnë besimin religjioz tradicional në një pasjetë, që i transferon në një aeroplan tokësor, me premtimin e pavdekshmërisë kolektive të bartur brenda dhe përmes gjeneratave ende të palindura të kombit" (Smith 2008: 35-36).

Smith sugjeron se, pa marrë parasysh kontrastet në mes llojeve të nacionalizmit, nacionalizmin duhet ta trajtojmë si fenomen i njësuar, pa i harruar variacionet e ndryshme ideologjike të nacionalizmit, dhe konkludon:

> "Në këtë nivel fondamental kombi mund të konsiderohet si një bashkësi e shenjtë e qytetarëve dhe nacionalizmi si një formë e

[43] Po aty: 35

> 'religjionit politik' me shkrimet e veta të shenjta, liturgjitë, shenjtorët dhe ritualet. Megjithëkëtë, nuk ka asgjë monolitike apo statike as për kombet apo nacionalizmat. Sepse, ashtu sikurse religjionet tradicionale që kanë kaluar periodikisht nëpërmes proceseve të ndryshimit në ballafaqim me rrethanat e reja, edhe identitetet kombëtare moderne, zakonisht reinterpretohen nga gjeneratat e mëpasshme, dhe ashtu sikurse religjionet që përmbajnë variante të ndryshme, edhe te nacionalizmat hasim në mite konkurruese të origjinës kombëtare dhe të zhvillimit. Prapëseprapë, fjalët me të cilat Durkheim përmblodhi analizën e tij të religjionit, mund të zbatohen në mënyrë të dobishme edhe për kombet dhe nacionalizmin: *…ka diçka të përjetshme në religjion, e destinuar që të mbijetojnë të gjitha simbolet e veçanta në të cilat mendimi religjioz, suksesshëm e ka mbështjellë vetveten. Nuk mund të ketë shoqëri që nuk ndien nevojën për t'i mbështetur dhe riafirmuar gjatë intervaleve të rregullta ndjenjat kolektive dhe idetë kolektive që përbëjnë unitetin dhe personalitetin e saj.* Prandaj, për aq kohë, themelet e shenjta të kombit vazhdohen dhe materializmi sekular dhe individualizmi nuk e kanë minuar besimin qendror në një bashkësi të historisë dhe të fatit, për aq kohë, nacionalizmi - si ideologji politike, si kulturë publike dhe si religjion politik - është i destinuar të lulëzojë dhe për aq kohë identiteti kombëtar do të vazhdojë të furnizojë një nga gurthemelet bazë të rendit botëror bashkëkohor" (Smith 2008: 146).

Shikuar historikisht, për dallim nga të gjitha ideologjitë, religjioni dhe nacionalizmi e kanë pasur dhe e kanë ndikimin më të madh në kuadër të shoqërisë njerëzore. Ngjashëm sikurse religjioni, edhe nacionalizmi është keqpërdorur gjatë historisë. Prandaj interpretimi konstruktiv i religjionit dhe i nacionalizmit është përgjegjësi morale, intelektuale dhe politike, sepse as religjioni dhe as nacionalizmi nuk janë të vërteta të plota absolute, por në radhë të parë përpjekje për ndërgjegjësim, solidaritet dhe barazi, në kuadër të organizimit të shoqërisë njerëzore. Me fjalë të tjera, librat e shenjtë religjiozë e kanë kontekstin e vet historik dhe dora e njeriut ka interferuar në shkrimin dhe interpretimin e tyre dhe, si të tillë, edhe pse mund të përmbajnë elemente të vërtetës absolute, nuk mund të jenë të vërteta të plota absolute. Gjithashtu, nacionalizmi, edhe pse mund të përmbajë elemente të së vërtetës absolute në kuptimin e vazhdimësisë dhe kultivimit më të gjatë dhe më të shkurtër të

kulturave etnike, nuk është e vërtetë e plotë absolute, në kuptimin se kombet ekzistojnë me vetë ekzistencën e njeriut, ose në kuptimin se kombet kanë ekzistuar në vazhdimësi në kuadër të historisë njerëzore.

Respektimi i religjionit (vlerave dhe ritualeve religjioze), qoftë në mënyrë aktive në kuadër të institucioneve religjioze, qoftë në mënyrë pasive, duke festuar ose duke treguar respekt për festimin e festave të caktuara religjioze (duke e përfshirë harmoninë dhe respektin ndër-religjioz), e inkurajojnë dhe e pasurojnë shoqërinë njerëzore me humanizëm, altruizëm dhe solidaritet. Ndërsa politizimi i religjionit në kuptimin e qëllimit të pronësimit të së vërtetës absolute, rezulton në keqpërdorim të vlerave religjioze dhe shtytjes për konflikt brenda-religjioz dhe në mes religjioneve. Ngjashëm edhe respektimi i nacionalizmit në kuptimin e dashurisë aktive për atdheun, ose respektimi i patriotizmit në kuptimin e dashurisë pasive për atdheun (dhe në kuptimin e barazisë në respekt të ndërsjellë në mes kombeve dhe grupeve etnike), është i domosdoshëm dhe shërben për paqen ndërnjerëzore. Ndërsa politizimi i nacionalizmit në kuptimin e pronësimit të së vërtetës absolute, rezulton në fashizëm, nazizëm dhe racizëm, që nënkupton urrejtjen dhe shtytjen për konflikt brendakombëtar dhe në mes kombeve, duke përfshirë grupet etnike.

Njëkohësisht, qasjet ekstreme ateiste etj. kundër vlerave dhe të drejtave religjioze dhe qasjet ekstreme globaliste etj. kundër vlerave dhe të drejtave të identiteteve nacionale determinojnë urrejtje dhe shtytje për konflikt, sepse religjioni dhe nacionalizimi janë pjesë e rëndësishme dhe e ndjeshme e shoqërisë njerëzore (që nuk kem me çfarë t'i zëvendësojmë), njëkohësisht parakushte drejt organizimit edhe më të barabartë dhe më të drejtë të shoqërisë njerëzore. Prandaj, është e domosdoshme të respektohen vlerat dhe të drejtat e religjioneve dhe vlerat dhe të drejtat e identiteteve nacionale. Dhe, për ta shmangur më shumë keqpërdorimin e këtyre vlerave dhe të të drejtave, duhet të kemi një përkufizim më të qartë të tyre në kuadër të platformës universale për të drejtat dhe liritë e njeriut, duke u

bazuar edhe në një teori liberale të modifikuar, që mëton të gjejë balancën në mes të drejtave individuale dhe të drejtave kulturore siç, përveç të tjerash, argumentohet (nga një këndvështrim i teorisë politike normative), edhe në kreun III të këtij libri.

Kontinuiteti kulturor dhe përsëritja/rishfaqja e etnisë shqiptare

Kritika kryesore, ndaj qasjes etnosimboliste, nënkupton se s'është e lehtë të identifikohet kontinuiteti i lashtë dhe i gjatë historik i etnive deri te kombet moderne. Një ndër kritikuesit e tillë është studiuesi John Breuilly. Në lidhje me këtë, Smith, përveç të tjerash, shkruan:

> "Qartësisht, John Breuilly e ka ngritur një çështje të rëndësishme kur i sfidon etnosimbolistët që t'i sigurojnë lidhjet historike me identitetet etnike dhe bashkësitë e së kaluarës që i postulojnë si bazë për formimin e kombeve pasuese. Është e qartë se ka shumë punë për t'u bërë këtu, por kjo kërkon një konceptim më të gjerë të kanaleve përmes të cilave identitetet e tilla janë të transmetuara dhe të transformuara, dhe lidhjeve që i lidhin me kombet moderne. Vetëm atëherë do të jemi në gjendje ta vlerësojmë thellësinë e lidhjeve që lidhin anëtarët e kombeve dhe pasionet që këto lidhje mund të ngjallin, në këtë detyrë nuk duhet ta lëmë anash dëshminë e dhënë nga preokupimi intensiv nacionalist me 'legjendat heroike' të antikitetit dhe me 'hapësirat poetike' të atdheut. Ato na tregojnë drejtime të cilat zbulojnë themelet religjioze të nacionalizmit dhe shpeshherë statusin e shenjtë të këtij preokupimi" (Smith 2006: 198).

Për etnosimbolistët si Anthony D. Smith, John A. Armstrong dhe John Hutchinson kombi dhe nacionalizmi mund të kuptohen vetëm nëpërmes një analize të identiteteve kolektive që u japin përparësi linjave afatgjata të historisë mbi ngjarjet. Mirëpo, sipas tyre, marrëdhënia në mes të kaluarës, të tashmes

dhe të ardhmes nuk mund të konstituohet vetëm nëpërmes një rruge të vetme, si lidhje kausale, por vetëm nëpërmes llojeve të ndryshme të lidhjeve/marrëdhënieve, në varësi të rrethanave të jashtme dhe resorëve të etnisë. Në këtë vazhdë mund të marrim pikënisje në tri marrëdhënie (kritere) të tilla: *Kontinuitetin kulturor, Përsëritjen/rishfaqjen dhe Riinterpretimin.*[44]

Kontinuiteti kulturor mund të gjendet në elemente të tilla si emri kolektiv, gjuha, kodet, pozita etnike etj. Këto komponente në disa raste mund të vazhdohen edhe nëse bashkësia në të cilën kanë qenë të bashkangjitura këto komponente është zhdukur, siç është shembulli me kulturën punike të kartagjenasve, pesë shekuj pas shkatërrimit total të Kartagjenës nga romakët. Gjithashtu, kontinuiteti kulturor në disa raste mund të sigurojë kornizën/skeletin për ringjalljen e bashkësisë në një formë të re, pas peripecive të shumta dhe transformimeve, siç është rasti i ringjalljes dhe i riidentifikimit të grekëve nëpërmes kontinuitetit të emrave, gjuhës dhe pozitës gjeografike. Kriteri ose marrëdhënia e dytë, përkatësisht përsëritja/rishfaqja e identiteteve kolektive, është më komplekse ngaqë kjo marrëdhënie nuk është vetëm çështje e gjurmimit të identiteteve të veçanta etnike të epokës mesjetare dhe të epokave të tjera më të thella në histori. Por ka si qëllim për të shpjeguar se forma nacionale e identitetit kolektiv-kulturor dhe e bashkësisë është fenomen përsëritës gjatë epokave historike dhe në kontinente të ndryshme, dhe për këtë arsye mund të vazhdohet kjo përsëritje edhe në të ardhmen. Në këtë mënyrë fenomeni komb iu referohet burimeve (pasurisë/rezervave) kulturore të asociacionit human që është potencialisht në dispozicion në të gjitha periudhat e historisë. Edhe pse kjo pikëpamje etnosimboliste e lidhjes në mes të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes i përafrohet pikëpamjes së perenialistëve, megjithëkëtë dallon nga pikëpamja perenialiste, sipas Smith. Sepse, për dallim të pikëpamjes perenialiste, pikëpamja etnosimboliste parasheh "thyerjet historike", në kuptimin e thyerjeve/këputjeve të kontinuitetit

[44] Smith 2008: 83

etnik. Në këtë mënyrë mund të dëshmohet për shfaqjen e kombeve të bazuara në etnitë, në zonat e caktuara në botë, si rezultat i rënieve dhe shpërbërjeve në Lindjen e Afërt, Evropën Mesjetare dhe në Lindjen e Largët. Gjithashtu, në këtë mënyrë mund të dëshmohet kohëzgjatja e etnive të caktuara, për shembull, e armenëve dhe e hebrenjve; duke qenë në periudhën e antikitetit të vonë, bashkësi të ngjashme me një formë nacionale të bashkësive, dhe më pastaj zbehja ose 'humbja' e kësaj forme nacionale, dhe përsëri në epokën moderne, rishfaqja ose ripërvetësimi i formës nacionale.[45]

Smith bën një ndarje në mes *etnive si kategori* dhe *etnive si bashkësi*. Referencë e etnive si kategori janë popullatat e lashta dhe fluide në kuadër të fazës së hershme të historisë. Një popullate të tillë të lashtë dhe fluide i atribuohen vetitë e etnisë më shumë nga "jashtë" ("nga të huajt") sesa nga brenda, nga anëtarët e kësaj popullate. Përndryshe, nuk ka dëshmi të mjaftueshme historike se a kanë poseduar anëtarët e popullatave të tilla të lashta dhe fluide ndonjë ndjenjë kolektive. Por kjo situatë fillon të ndryshojë me shfaqjen e interesimit për gjenealogjitë. Përkatësisht me shfaqjen e interesimit (fillimin e vetëdijesimit) për linjat e prejardhjes së paraardhësve të përbashkët (të lidhur me kujtimin për migrimet, ritualet, simbolet, kultin e përbashkët etj.), dhe fillimisht duke e trashëguar këtë interesim në mënyrë gojore, më vonë edhe nëpërmes kronikave dhe poemave epike. Në këtë vazhdë, sa më shumë që mitet për farefisninë e origjinës etnike dhe prejardhjes janë ndërthurur me kultin dhe ritualet, aq më shumë janë forcuar lidhjet dhe ndjenjat në mes të anëtarëve të grupit, duke e përshkallëzuar veprimtarinë dhe marrëdhëniet e rrjetëzuara dhe të përbashkëta, dhe duke rezultuar në bashkësi etnike[46]: "popullatë me mitet e origjinës së përbashkët, kujtimet e historisë së përbashkët, me një ose më shumë elemente të kulturës së

[45] Po aty: 83-84
[46] Po aty: 108-109

përbashkët, e lidhur me një mëmëdhe dhe një ndjenjë të fortë solidariteti, të paktën në kuadër të elitave" (Smith 2008: 109).

Shikuar nga ky këndvështrim i qasjes etnosimboliste, mund të thuhet se konstituimi historik i disa etnive në Ballkan (për shembull, konstituimi historik i etnisë bosane/boshnjake, malazeze etj.) është, përveç të tjerash, më shumë ose më pak, edhe rezultat i vazhdimësisë së shpërbërjes dhe absorbimit të popullatës ilire. Ndërsa për etninë shqiptare mund të argumentohet se i përmbush të dy kriteret: kontinuitetin kulturor dhe veçanërisht përsëritjen/rishfaqjen etnike gjatë epokave historike, që nga periudha e ilirëve dhe më thellë në histori.

Në lidhje me kontinuitetin e gjatë historik të etnisë shqiptare (si kategori etnike), përveç të tjerëve, studiuesi Edwin Jacques, merr pikënisje në pellazgët parahistorikë. Për ekzistencën e pellazgëve parahistorikë, Jacques bazohet në historianë, gjeografë, poetë e dramaturgë të hershëm (Homerin, Herodotin, Tuqididin, Dionisin e Halikarnasit, Plutarkun, Strabonin, Hesioditin, Eskilin, Sofokliun, Euripidin, Virgjilin etj.), dhe konstaton se termi pellazg, duke qenë term shumë i vjetër, (rrjedhimisht term jo i përshtatshëm për gjurmim historik), ka bërë që shumë studiues të rinj të preferojnë ta zëvendësojnë termin pellazg me termin "parahelen".[47]

Sipas historianit Noel Malcollm, shqipja (përveç greqishtes), është e vetmja gjuhë që ka mbijetuar nga një gjuhë antike e Ballkanit, dhe emrat e përveçëm: toponimet, emrat e njerëzve dhe të fiseve, të ruajtura në mbishkrimet latine ose greke si dhe në veprat e historianëve antikë, përbëjnë prova të vlefshme për lidhjen e shqipes me ilirishten.[48]

Rrjedhimisht, duke marrë pikënisje në pellazgët si kategori etnike, si një popullatë shumë e lashtë dhe fluide, dhe duke u bazuar se greqishtja dhe shqipja janë dy gjuhë të vetme antike të Ballkanit që kanë mbijetuar, mund të argumentohet (bazuar në burime të autorëve të huaj), se shqiptarët (veçanërisht në

[47] Jacques 1995: 53-64
[48] Malcolm 2001: 31-32

aspektin linguistik), janë pasardhës të pellazgëve. Gjithashtu, protogrekët (në kuadër të një ndërveprimi dhe bashkëjetese të hershme me protoshqiptarët), mund të konsiderohen, më shumë ose më pak, pjesë e trashëgimisë së shpërbërjes dhe absorbimit të popullatës së lashtë pellazge. Përveç të tjerëve, historiani i njohur grek Dhimitri Bethanis konsideron se shqiptarët dhe grekët kanë lidhje të vjetër farefisnore. Bethanis merr pikënisje në burimet e historianëve të vjetër grek Tuqididin etj., që dëshmojnë se në luftën e Peloponezit ilirët luftuan përkrah grekëve. Kjo, sipas Bethanis, dëshmon për lidhjen farefisnore në mes të ilirëve dhe grekëve sepse, sipas tij, grekët nuk lejonin që në një luftë civile të ndërhynin barbarët, në cilëndo anë që të ishin rreshtuar, përveçse nëse grekët i konsideronin si 'njerëz të tyre'.[49] Ndërsa Jaqcues, për raportet shumë të lashta në mes të protoshqiptarëve dhe protogrekëve, përveç të tjerash, shkruan:

> "... rreth vitit 2000 p.e.s. një popull i paqytetëruar greqishtfolës depërtoi ngadalë në drejtim të jugut, duke kaluar përmes Danubit në Gadishullin Ballkanik, së bashku me kopetë e tufat e bagëtive. Aty gjetën banorët pellazgë të cilët e kishin zhvilluar tashmë artin e bujqësisë, i panjohur deri atëherë për nomadët. Gjithashtu, ata kishin ndërtuar shtëpi e qytete të fortifikuara e të përhershme dhe kishin mësuar ta përpunonin bronzin. Për njëfarë kohe të sapoardhurit bashkëjetuan me vendasit, duke marrë mënyrën e tyre të jetesës prej bujku, mjeshtërinë dhe qytetërimin e tyre, adhurimin e natyrës dhe hyjnitë pellazge. Nga pikëpamja kulturore ata u zhvilluan më shpejt se pellazgët vendas. Por, kjo kulturë e dy popullsive u errësua nga pushtimi i një dyndjeje të dytë të nomadëve grekë, të fisit luftarak të dorëve, reth vitit 1500 p.e.s. Të sapoardhurit sollën me vete përdorimin e armëve e të veglave të punës prej hekuri, një hap përpara që e tejkalonte bronzin, në një kohë kur hekuri hyri në përdorim të gjerë aty rreth vitit 1100 p.e.s. Por ata sollën aty edhe një periudhë të errët për të gjithë trevën. Jopellazgët po bëheshin gjithnjë e më të vetëdijshëm për identitetin e tyre etnik dhe zunë të përhapeshin në të gjithë hapësirën jugore të gadishullit. Folklori grek e kërkon origjinën e themelimit të Greqisë te Deukalioni mitologjik dhe shoqja e tij Pirra, - dy njerëzit e vetëm që i shpëtuan përmbytjes

[49] Historia e Shqipërisë (Ilirisë) që nga viti 2500 p.e.s, sipas historianit grek, Dhimitri Bethanis: https://www.youtube.com/watch?v=7qWXSwRblKw&feature=youtu.be

> së madhe. Biri i tyre, Heleni, ishte pasardhësi legjendar i racës greke, që daton rreth vitit 800 p.e.s. Prej tij njerëzit e këtij populli morën emrin helenë, kurse atdheu i tyre Hellas. Nga kjo del qartë përse Homeri nuk përmend grekë apo helenë në rrethimin e Trojës, por flet për një numër fisesh pellazge. Duke pasur parasysh përmendjet e shpeshta të këtyre pellazgëve parahelenë nga autorët e lashtë grekë, duket i çuditshëm fakti se shumë historianë të sotëm ose e injorojnë ekzistencën e tyre, ose i futin ata në një thes me grekët! Dijetarët e lashtë nuk bënin gabime të tilla. Autorët e vjetër shprehnin mendimin se grekët u shtuan në numër dhe u fuqizuan, duke i mposhtur kështu pellazgët. Disa nga banorët vendas u dëbuan nga viset e tyre në jug të Ballkanit. Që t'i shpëtonin trysnisë gjithnjë e në rritje, të tjerët u larguan vullnetarisht drejt veriut. Kurse disa u asimiluan nga popullsia dore e greke. Gjatë periudhës së mëvonshme të kolonizmit grek, pellazgë të tjerë të pakënaqur u shpërndanë në të gjithë pellgun e Mesdheut. Pra, në një mënyrë ose në një tjetër, me anë të dëbimit, të shpërnguljes, të asimilimit ose të shpërbërjes, prania pellazge në Greqinë e Vjetër u zvogëlua. Përqendrimi i tyre në trevat e epërme të Gadishullit Ballkanik, veçanërisht në Epir, Maqedoni dhe Iliri, bëri të mundur që ta ruanin identitetin, gjuhën, kulturën dhe traditat pellazge. Një studim i këtyre poemave të hershme epike do të ndihmojë për një përkufizim më të qartë të karakterit të këtij qytetërimi pellazg" (Jacques 1995: 65)

Jaqcues i referohet Herodotit, sipas të cilit, pellazgët flisnin një gjuhë krejtësisht tjetër krahasuar me fqinjët e tyre. Dhe në këtë vazhdë, duke iu referuar studiuesve të tjerë të kohës së mëvonshme për ndërlidhjen e gjuhës shqipe me iliro-pellaz-gjishten (Gotfrid Vilhelm Lajbnic, Hans Erik Tunman, Johan Georg Fon Han, Franc Bop, Gustav Majer, Eduard Shnajder, Holger Pedersen, Kristian Sandfeld-Jensen, Norbert Jokli, Maksimilian Lamberc etj.), konstaton se emrat e njerëzve, të vendeve dhe hyjnive paragreke janë të bazuara në gjuhën pellazge dhe se këta emra mund të shpjegohen vetëm nëpërmes ilirishtes dhe shqipes dhe jo nëpërmes greqishtes ose gjuhëve të tjera. [50] Duke pasur parasysh se Aleksandri i Maqedonisë, Aleksandri I (500-454 p.e.s.) kishte pasur admirim për kulturën greke, grekët i kishin dhënë titullin Filelini ("Miku i Grekëve").

[50] Jacques 1995: 34-38, 54

Sipas Jacques, kjo dëshmon se Aleksandri I nuk ishte grek[51] dhe, përveç të tjerash, shkruan:

> "... Herodoti na tregon se njëherë Aleksandri shkoi në Olimp për të marrë pjesë në garat panhelene. Meqë ishte nga Maqedonia, grekët deshën qe ta përjashtonin nga garat, me pretekstin se në to lejoheshin të merrnin pjesë vetëm grekët e jo barbarët. Mirëpo Aleksandri dëshmoi se ishte pasardhës i Herkulit dhe i mbretërve të Argosit prandaj, pas shumë ngurrimesh, e pranuan. Megjithatë, duket qartë se grekët nuk i konsideronin maqedonasit si bashkë-kombës..." (Jacques: 1995: 98)

Mbreti Filip II i Maqedonisë (359-336 p.e.r.) arriti të bëhet mbret i tri mbretërive pellazge: Maqedonisë, Epirit dhe Ilirisë. Filipi II ishte i martuar me iliren e fisit të molosëve, Olimpian, dhe ishin prindër të Lekës së madh (Aleksandrit III 336-323). Mjeku i oborrit i të atit të Filipit, mbretit Aminta II, ishte Babai i Aristotelit. Para se Aristoteli të shkojë si 17-vjeçar në Athinë që të bëhet student i Platonit, në oborrin mbretëror maqedonas ndihej si në shtëpinë e vet. Kjo, sipas Jacques, ishte një ndër arsyet pse Aristoteli (i cili vetë kishte lindur në Stagira të Maqedonisë, në lindje të Selanikut) u ftua nga Filipi II që të bëhet mësues i djalit të tij, Aleksandrit.[52]

Pas vdekjes së Aleksandrit të madh, Pirroja i Epirit (296-272) arriti t'i afrohej për nga madhështia Aleksandrit të madh, saqë krijoi simpati edhe te maqedonasit të cilët e ftuan që ta sundojë Maqedoninë. Në bazë të gojëdhënave tradicionale, ushtarët e quanin Pirron "Shqiponjë" (për shkak të shkathtësive të spikatura në luftë), ndërsa Pirro i quante ushtarët e vet "Bijtë e Shqiponjës" (Bij të shqipes). Kjo, sipas Jaqcues, ndikoi që të adopotohet ky emër nga shqiptarët dhe ta quajnë veten me këtë emër: "Shqiptarë" ose "Bij të shqipes".[53]

Në këtë vazhdë, rezistenca e gjatë ilire në krye me mbretërit, Agronin, Teutën, Gentin etj., kundër Perandorisë Romake kishte fituar një nam, madje edhe pas nënshtrimit të Ilirisë nga

[51] Po aty: 98
[52] Po aty: 101-105
[53] Po aty: 134-135

Roma.[54] Rrjedhimisht, s'ka qenë rastësi pse Garda Pretoriane rekrutoi shumë ushtarë ilirë:

> "Rritja e trysnisë së gotëve dhe skithëve në kufirin verior përgjatë Danubit, e detyroi Romën që t'i përdorte në mënyrë konstruktive fiset luftarake ilire që i kishte nën sundim. Shumë prej tyre u rekrutuan në legjionet romake, kurse të tjerë u vendosën në koloni përgjatë kufirit verior, me qëllim që të formonin një zonë mbrojtëse. Ushtarët ilirë u treguan aq të zotë saqë shumë prej tyre u zgjodhën për shërbim në Gardën Pretoriane, elita e truprojës romake për perandorin. Një numër i madh i këtyre njerëzve u graduan në rangje të larta dhe u bënë të njohur me emrin ushtarë perandorakë ilirë. Këta bijë të paepur të shqipes ishin pasardhës të Akilit, Filipit, Aleksandrit të Madh dhe Pirros. Nuk ka se si të mos impresionohesh nga numri i madh i këtyre ushtarëve perandorakë dhe të mos mbetesh i mahnitur nga zotësia e shumë prej tyre" (Jacques: 1995: 150).

Sipas Jacques, ilirët dhanë disa ndër figurat e rëndësishme në kuadër të hierarkisë së Perandorisë Romake dhe më vonë bizantine, ndër të tjerë: Deci me origjinë nga Bubalia, në Panoni, në Ilirikun e veriut. Mark Aurel Klaudi me origjinë nga një familje nga Dardania, në Ilirikun lindor. Mark Aurel Probi me origjinë nga Sirmiana, në Panoni, në kufirin verior të Ilirikut. Valer Diokletiani, i lindur në një familje të panjohur dalmate në fshatin e Dokleas, në pellgun e liqenit të Shkodrës (Shkodra për një kohë të gjatë ishte kryeqytet i Ilirisë së lirë). Maksimiani i lindur në Panoni, në skajin verior të Ilirikut, pranë Danubit. Kostandin Klori - Verdhacaku, i lindur në Ilirikun lindor, ishte biri i një fisniku dardan, i quajtur Eutrop. Kostandini i Madh ishte djali i parë i Kostandin Klorit, lindi në Naissus (sot Nish) të Moesisë, në Ilirikun lindor. Julian "Renegati", i njohur si Flavius Claudius Julianus, ishte nipi i Kostandinit të Madh.[55] Më tutje, Jacques radhitë një varg argumentesh që i kanë bindur studiuesit se populli shqiptar dhe gjuha e tij kanë prejardhjen nga ilirët e lashtë:

[54] Po aty: 138-142
[55] Po aty: 150-153

1. Emri kombëtar Albania ka ardhur prej fjalës "Albanoi", një fis ilir që përmendet nga gjeografi Ptoleme i Aleksandrisë rreth vitit 150 e.s.

2. Trevat e Albanoit të atëhershëm e kishin qendrën në Albanopolis midis Durrësit dhe Krujës, zemrës së Shqipërisë së sotme.

3. Në kohët e lashta, në Ballkan jetonin katër popuj të ndryshëm që flisnin gjuhët e tyre: grekët në jug, maqedonasit në qendër, trakasit në lindje dhe ilirët në perëndim. Sot shqipja flitet në po ato treva ku dikur flitej ilirishtja.

4. Ato pak elemente gjuhësore që njihen si të gjuhës ilire, mund të shpjegohen vetëm nëpërmjet shqipes dhe jo gjuhëve të tjera.

5. Një krahasim gjuhësor midis shqipes dhe greqishtes e latinishtes së vjetër vërteton se shqipja si gjuhë ishte formuar më herët se dy gjuhët e tjera të vjetra.

6. Të dhënat arkeologjike e historike dëshmojnë për një vazhdimësi kulturore nga ilirët te shqiptarët. Lidhjet e vazhdueshme me popuj e gjuhë të tjera kanë lënë gjurmët e tyre në fjalorin e shqipes. Ndonëse janë huazuar fjalë të huaja nga greqishtja, latinishtja, sllavishtja e turqishtja, shqipja e ka ruajtur mëvetësinë e saj si gjuhë, sistemi gramatikor i së cilës ka mbetur praktikisht i pandryshuar.

7. Gjuhëtarët vënë në dukje ngjashmëri të shumta teknike midis fjalëve ilire dhe shqipe.

8. Huazimet nga greqishtja dhe latinishtja në gjuhën shqipe pasqyrojnë trysninë politike e kulturore mbi trevat ilire. Studimet gjuhësore tregojnë se shqipja është zhvilluar nga ilirishtja si gjuhë më vete aty midis shek. IV dhe VI e.s. Prandaj, huazimet greke e latine nuk duhet të kenë depërtuar drejtpërdrejt në gjuhën shqipe, por më parë në ilirishte e prej andej në shqipe. Gjuhësia historike dëshmon se këto huazime të greqishtes së lashtë e kanë prejardhjen nga dialekti dorik dhe depërtuan në ilirishte përmes ngulimeve tregtare korintase në Korfuz, përgjatë bregdetit Adriatik dhe qyteteve kufitare. Huazimet latine erdhën më vonë, gjatë pushtimit të gjatë

romak. Këto kontakte me grekët e romakët e vjetër ndodhën në trevat e Ilirisë së Vjetër, duke lënë gjurmët e tyre në ilirishte, të cilat, më vonë, u përcollën në gjuhën shqipe.

9. Toponimet ilire, emërtimet e vjetra ilire të qyteteve, lumenjve dhe maleve, janë ruajtur në gjuhën e sotme shqipe dhe vetëm në shqip. Emrat e fshatrave në Ballkan zakonisht ruheshin vetëm për disa shekuj, pasi në kohë lufte fshatrat shpesh zhdukeshin pa lënë gjurmë. Qytetet jetonin më gjatë, prandaj edhe emrat e tyre janë më të vjetër. Mirëpo lumenjtë, liqenet dhe malet i qëndruan kohës dhe emrat e tyre të vjetër, zakonisht, vazhdojnë të përdoren edhe sot e kësaj dite. Madje edhe banorët e rinj zakonisht adoptonin emrat e vjetër ashtu siç bënë kolonët amerikanë me toponimet e vjetra indiane në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kështu, gjuhëtarët shqiptarë kanë gjetur mbi 300 emra të qyteteve të lashtë, si Shkodra, të lumenjve, si Drini, dhe të maleve, si Tomori, të cilët përmenden nga gjeografët dhe historianët e vjetër grekë e romakë dhe që vazhdojnë të përdoren edhe sot në Shqipëri. Studiuesit vënë në dukje se rregullat e fonetikës historike shpjegojnë çdo ndryshim të fjalëve që ka ndodhur përmes shekujve gjatë kalimit të tyre nga ilirishtja në shqip. Si shembull mund të përmendim kalimet Scupi-Shkup, Scodra-Shkodër, Lissus-Lezha, Durrachium-Durrës, Drinus-Drin, Mathias-Mat. Nuk ka dyshim, pra, që gjuha shqipe ka rrjedhur nga ilirishtja.

10. Emrat e përveçëm ilirë vazhdojnë të përdoren në shqipen e sotme. Shumë emra të tillë ilirë janë ruajtur në epitafet e varreve dhe në mbishkrimet e monedhave. Dikur emrat e njerëzve si, p. sh., të sundimtarëve ilirë, Agron e Teuta, kanë qenë përmendur nga historianët grekë e romakë. Studiuesi shqiptar Mahir Domi pohon se ka identifikuar 800 të tillë.

11. Termat e ndryshëm për faunën në gjuhën shqipe dëshmojnë se ky popull ka jetuar gjatë bregdetit në të njëjtat treva si ilirët e dikurshëm.

12. Në gjuhën shqipe ka edhe fjalë të tjera të cilat shkrimtarët grekë dhe romakë i kanë përcaktuar me kohë si ilire (Jaqcues: 1995: 42-43).

Sipas Jaqcues, pushtimi nga romakët ndikoi që pasardhësit e popullsisë së vjetër pellazge që jetonin në Maqedoni, Epir dhe

Iliri, ta humbin lirinë e tyre të shumëçmuar dhe një pjesë e kësaj popullate protoshqiptare u tkurrë në kështjellat e tyre në viset malore.[56]

Gradualisht (nën sundimin e Perandorisë Romake), proto-shqiptarët (ilirët) u krishtëzuan dhe, pas ndarjes së Perandorisë Romake (në vitin 395 e.s.), ranë nën sundimin e Perandorisë Bizantine. Në periudhën 489-535 ranë nën sundimin e gotëve, e në periudhën 535-861, sërish nën sundimin bizantin. Ndërsa në periudhën 861-1014 ranë nën sundimin e Mbretërisë Bullgare, dhe përsëri nën sundimin bizantin gjatë periudhës 1014-1204, duke përfshirë edhe sundimin norman gjatë periudhës 1081-1204 etj.[57] Në lidhje me kontinuitetin kulturor të shqiptarëve, Jacques konkludon:

> "Gjatë shekujve shumë popuj, dikur të mëdhenj, janë shkatërruar ose asimiluar nga të tjerët, madje edhe janë zhdukur pa lënë gjurmë. Mirëpo ilirët, me zakonet, muzikën, veshjet karakteristike dhe veçanërisht me gjuhën e tyre, i kanë qëndruar kohës në trevat e tyre, ndonëse tashmë të tkurrura, përgjatë bregut perëndimor të Gadishullit Ballkanik. Duke qenë se nuk ka asnjë dëshmi tjetër veçse ta pranojmë vazhdimësinë e tyre të pandërprerë historike, nuk ka pikë dyshimi që shqiptarët e sotëm janë historikisht pasardhës të drejtpërdrejtë të ilirëve, të cilët dikur, në kohën e grekëve e të romakëve të vjetër, kanë jetuar në po këto treva të sotme shqiptare" (Jaqcues 1995: 43).

Rrjedhimisht, shikuar nga këndvështrimi i qasjes etnosimboliste, përkatësisht kriterit të dytë në lidhje me potencialin e përsëritjes/rishfaqjes së etnive, mund të konstatohet se tkurrja e një pjese të protoshqiptarëve (ilirëve) në viset malore, shpëtoi nga procesi i asimilimit të ilirëve si tërësi, dhe e ka ruajtur për disa shekuj "kornizën/skeletin" për përsëritjen/rishfaqjen e etnisë shqiptare në mesjetë, në një formë të re. Përndryshe, parakushtet e kontinuitetit historik të ilirëve krahasuar me parakushtet e kontinuitetit historik të grekëve kanë qenë për dy

[56] Po aty: 142
[57] Po aty: 168-182

arsye më të brishta. Ilirët nuk kanë mundur t'u konkurrojnë në aspektin linguistik grekëve (dhe as romakëve, duke përfshirë edhe perandoritë e mëvonshme), në mënyrë që ta përdorin ilirishten si gjuhë të shkruar, sepse gjuha greke, duke përfshirë edhe gjuhën romake etj., ka qenë gjuhë dominuese.

Gjithashtu, pas ndarjes së Perandorisë Romake, rivalizimi fetar në mes të Kostandinopojës dhe Romës ka ndikuar që protoshqiptarët - ilirët (duke qenë gjeografikisht në mes të këtyre dy qendrave të mëdha politike dhe nën trysninë e të dyjave), të mbesin të brishtë në aspektin fetar dhe, e vetmja mundësi për kontinuitetin e drejtpërdrejtë historik të ilirëve dhe ilirishtes, ka qenë tkurrja e protoshqiptarëve në viset malore.

Edhe Malcolm konsideron se tkurrja e shqiptarëve në viset malore mund të ketë kontribuar për kontinuitet kulturor të shqiptarëve. Në lidhje me këtë, përveç të tjerash, shkruan:

> "… në qoftë se ilirishtja ka mbijetuar në formën e gjuhës shqipe, kjo ka ndodhur vetëm nëpërmjet tkurrjes fizike - tërheqjes dhe izolimit gjë që, s'do mend, ka ngjarë në trojet malore. Ja se pse elementet më të pastra të fjalorit të shqipes janë në malësi. Ato janë fjalë bimësh të lartësive dhe të barinjve. Kjo s'do të thotë se protoshqiptarët nuk kanë çuar kurrë ndonjë far jete tjetër, por si të vetmit që kanë mbijetuar si shqipfolës, ia dolën të mbeten të tillë pikërisht për arsye se për shekuj me radhë bënë një jetë të veçuar dhe të pavarur. Ilirët, të cilët kanë jetuar në rrafshinat bregdetare, u romanizuan, si ata të bregdetit dalmat, ashtu edhe ata të pjesës dërrmuese të trojeve të ish-Jugosllavisë. Në kohën kur sllavët zunë të arrinin në shekullin VI, kishin mbetur vetëm grupe të shpërndarë folësish të gjuhëve të vjetra "barbare" të Ballkanit dhe të gjithë ata ndodheshin në viset malore…" (Malcolm 2001: 35).

Sipas pikëpamjes etnosimboliste, transformimet e etnive, nga etnitë si kategori në etnitë si bashkësi, e kanë forcuar elementin subjektiv të etnive, në kuptimin e ngritjes së vetëdijes për identitetet kolektive të etnive si bashkësi. Së paku, ky transformim ka ndikuar në ngritjen e vetëdijes për identitetet kolektive tek elitat e bashkësive etnike dhe kështu është forcuar

potenciali/mundësia (jodomosdoshmëria) e transformimit të mëvonshëm të bashkësive etnike në kombe.

Është e diskutueshme se cila periudhë historike e karakterizon transformimin e etnisë protoshqiptare nga etnia si kategori (nga një nivel i ulët i vetëdijes për dallimet identitare etnike në mes "nesh" dhe të "tjerëve") në etninë si bashkësi (në një fillimngritje të vetëdijes për dallimet identitare etnike në mes "nesh" dhe të "tjerëve", (së paku në kuadër të elitës së bashkësisë etnike protoshqiptare). Megjithëkëtë, një pikënisje për këtë mund të merret në periudhën historike të fillim-procesit të tkurrjes së një pjese të protoshqiptarëve (ilirëve) në trevat malore (pas pushtimit nga Perandoria Romake). Sepse bashkëjetesa e izoluar në zonat malore për disa shekuj ka mundur ta ruajë jo vetëm gjuhën dhe kujtesën historike për të kaluarën, por edhe të ndikojë gradualisht në vetëdijesimin më të madh për dallimet në mes "nesh" dhe të "tjerëve". Në këtë vazhdë, konsolidimi i familjeve feudale dhe princore shqiptare: Gropajt 1273-1468, Muzakajt 1280-1389, Topiajt 1338-1460, Shpatajt 1358-1431, Balshajt 1360-1421, Kastriotët 1383-1474, Dukagjinët 1393-1479 etj. [58] Dhe veçanërisht periudha e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut kanë ndikuar edhe më shumë për forcimin e vetëdijes etnike protoshqiptare. Në lidhje me këtë, vlen të përmendet një dëshmi si burim primar nga vetë Skënderbeu, përkatësisht korrespondenca/letra që Skënderbeu i shkruan Princit të Tarentit, Johanes Antonius de Ursinis që, përveç të tjerash, i thotë: "... nëse kronikat tona nuk na gënjejnë, ne quhemi epirotë dhe duhet të keni dijeni se në kohë të tjera paraardhësit tanë kaluan në vendin që ju mbani sot dhe patën luftime të mëdha me romakët dhe ne e dimë se në të shumtën e herëve u ndanë me nder sesa me turp..." (Frashëri 2005: 110).

Referimi i Skënderbeut për të kaluarën etnike (respektivisht duke iu referuar implicit Pirros së Epirit, i cili, po ashtu, mund të ketë qenë i vetëdijshëm më pak ose më shumë për identitetin etnik), s'dëshmon për ekzistencën e kombit shqiptar në

[58] Po aty: 187-192, 197-201

periudhën e Skënderbeut sepse kombet janë fenomene moderne. Dhe as nuk dëshmon për nacionalizmin shqiptar në periudhën e Skënderbeut, në kuptimin e doktrinës nacionaliste për dallimin rigjid në mes "nesh" dhe të "tjerëve", sepse nacionalizmi është fenomen modern i fundshekullit XVII dhe fillimshekullit XVIII. Por dëshmon për kujtesën subjektive, dhe vetëdijen për kontinuitetin e lashtë historik të etnisë shqiptare që më vonë, gjatë fillimshekullit XVIII, u bë bazë për kombformimin e shqiptarëve.

Gjithashtu, ndikimin e rëndësishëm për vetëdijesimin e etnisë shqiptare si bashkësi (së paku në kuadër të elitës së bashkësisë etnike shqiptare), e kanë pasur edhe shkronjësit e parë në gjuhën shqipe, që pothuajse të gjithë kryesisht kanë përkthyer tekste religjioze në gjuhën shqipe: Pal Engjëlli (1416-1470), Gjon Buzuku (1499-1577), Pjetër Budi (1566-1622), Frang Bardhi (1606-1643), Pjetër Bogdani (1625-1689) etj. Dhe në përputhje me qasjen teorike të Benedict Andersonit, mund të thuhet se nisma e përkthimit të teksteve religjioze në gjuhën shqipe ishte e inspiruar nga nisma e procesit të përkthimit të teksteve religjioze nga gjuha latine në gjuhët e ashtuquajtura lokale/popullore në Evropë si rezultat i ndërlidhjes në mes të protenstantizmit dhe shpikjes së makinës së shtypit. Ngase më herët, gjatë një periudhe të gjatë të historisë së shqiptarëve (nën Perandorinë Romake, bizantine etj.) nuk ka pasur iniciativë nga prijësit religjiozë shqiptarë të krishterë që të përkthejnë tekste religjioze të krishtera në gjuhën shqipe. Dhe kjo është një ndër arsyet pse gjuha protoshqiptare (ilirishtja) ka mbetur e pashkruar gjatë një periudhe shumë të gjatë historike. Rrjedhimisht, shqiptarët si popull i vjetër në Ballkan, për shkak të mosshkruarjes së gjuhës shqipe gjatë një periudhe të gjatë historike, në kombinim me ndikimin e gjatë fetar dhe rivalitetin fetar në mes të Romës dhe Konstantinopojës, (duke përfshirë, përveç të tjerëve, edhe sundimin e mbretërisë mesjetare serbe), s'kanë arritur të kenë institucion fetar të pavarur. Kjo gjendje fetare e painstitucionalizuar e shqiptarëve është një ndër

shkaqet kryesore, pse një pjesë e shqiptarëve gradualisht u myslimanizuan gjatë sundimit osman.

Shqiptarët në krye me heroin e tyre, Gjergj Kastriotin - Skënderbeu (1405-68), i rezistuan mbi 20 vjet pushtimit osman. Pas pushtimit një pjesë e shqiptarëve u shpërngulën në Itali dhe Sicili, më pastaj edhe në Rumani, Bullgari, Ukrainë etj., (të cilët më vonë, gjatë epokës së nacionalizmit, gjatë shekullit XVIII, e kanë pasur një rol të rëndësishëm për inkurajimin e transformimit të etnisë shqiptare në kombin shqiptar). Madje një pjesë e konsiderueshme e këtyre shqiptarëve të shpërngulur e kanë ruajtur (brez pas brezi) kujtesën historike dhe vazhdimësinë kulturore deri në ditët e sotme.

Pas pushtimit nga Perandoria Osmane gradualisht ndodhi edhe myslimanizimi i një pjese të konsiderueshme të shqiptarëve, ngjashëm siç kishte ndodhur më herët krishtërizimi i shqiptarëve nën Perandorinë Romake dhe pastaj bizantine. Në lidhje me pushtimin dhe myslimanizimin e shqiptarëve nga Perandoria Osmane, ballkanologu norvegjez, Svein Mønnesland, përveç të tjerash, shkruan:

> "Kur u pushtua Kruja në vitin 1478, dhjetë vjet pas vdekjes së Skënderbeut, dhe Durrësi më 1501, shqiptarët ranë nën sundimin turk. Shumë prej tyre u shpërngulën në Itali dhe Sicili. Turqit ishin myslimanë, ndërsa shqiptarët i përkisnin një kulture të lashtë të krishterë, me rrënjë që nga shekulli III. Shqiptarët ishin të ndarë fetarisht, në jug ishin ortodoksë dhe në veri katolikë. Në fillim shqiptarët mbajtën besimin e tyre të krishterë. Në shekullin XV-dhe XVI u zhvillua një lëvizje letrare dhe humaniste në mesin e shqiptarëve katolikë. Literatura ishte e drejtuar kundër islamizimit për ta ruajtur identitetin. Një nga shkrimtarët më të rëndësishëm shqiptarë, Pjetër Bogdani (1632-89), ishte nga Kosova dhe ishte kryepeshkop në Shkup. Në shekullin XVI ndodhi një ndryshim. Një numër i madh i shqiptarëve u konvertuan në islam. Është e diskutueshme se cili ishte shkaku për islamizimin e shqiptarëve. Pjesërisht është shpjeguar se sistemi i taksave kishte ndryshuar, duke e bërë të vështirë për jomyslimanët të përballen me presionin e tatimeve. Por, ka gjasë se turqit e përdorën edhe dhunën, për dallim nga ajo që ishte e zakonshme, ndoshta sepse shqiptarët ishin kryengritës. Arsyeja kryesore ishte se shqiptarët katolikë përbënin

> një rrezik për Perandorinë Osmane si aleatë potencialë me Venedikun. Për këtë arsye, përndjekja më e fortë ishte kundër shqiptarëve katolikë, veçanërisht pasi u rebeluan dhe mbështetën Venedikun gjatë luftërave në fund të shekullit XVI. Disa prej tyre u zhvendosën në Kosovë, ku edhe sot ka grupe të shqiptarëve katolikë (Nëna Terezë, faktikisht Agnes Gonxhe Bojaxhiu, rrjedh nga një familje katolike shqiptare). Disa shqiptarë vazhduan të jenë të krishterë, por në fshehtësi. Jashtë ishin myslimanë, kishin emra myslimanë dhe visheshin me rroba turke, por fshehurazi lejonin pagëzimin e fëmijëve dhe i ndiqnin ritualet krishtere. Në mesin e këtyre "kriptokristianëve" kishte katolikë dhe ortodoksë. Pasi që kalimi në islam u bë një fakt, shumë shqiptarë, të njohur si luftëtarë të mirë, u morën në shërbimin turk si ushtarë dhe zyrtarë. Shumë shqiptarë u vendosën në Stamboll dhe gjetkë në Perandorinë Osmane, ku morën një pozitë të privilegjuar dhe shumë u ngritën në postet më të larta. U zhvillua një shtresë e zyrtarëve dhe oficerëve shqiptarë që u konsideronin më të besuarit dhe më të privilegjuarit e sulltanit". (Mønnesland, 2006: 143-144).

Ngjashëm sikurse nën Perandorinë Romake, dhe më vonë bizantine etj., shqiptarët dhanë disa ndër figurat e rëndësishme në kuadër të Perandorisë Osmane. Përveç të tjerëve, Mehmet Ali Pashën, valiun e Elajetit të Egjiptit dhe themeluesin e Egjiptit modern, dhe shumë figura të tjera, në pozita të larta, deri në postin e kryeministrit (sadriazamit). Sipas historianit Bernard J. Fischer: "… nga të gjithë sadriazemët, rreth tridhjetë prej tyre, ishin shqiptarë".[59]

Në këtë vazhdë shqiptarët kontribuuan, përveç të tjerash, edhe për pavarësinë e Greqisë. Sipas Hobsbawmit: "... malësorët grekë që u ngritën kundër turqve (...) disa nga luftëtarët e tyre më të dalluar nuk ishin helenë, por shqiptarë (suliotë)" (Hobsbawm 2012: 65). Madje autorët serbë, Milorad Bošnjak dhe Slobodan Jakovljević, në librin e tyre "Karagjorgjeviqët, histori e fshehur" (2006), bazuar në burime arkivore, konsiderojnë se Đorđe Petrović Karađorđe (i njohur, gjithashtu, si

[59] Bernard J. Fischer 2014: 28, *Albanian Nationalism And Albanian Independence*: https://www.researchgate.net/publication/307842058_Albanian_Nationalism_and_Albanian_Independence/fulltext/57d1903a08ae6399a38b7ff4/307842058_Albanian_Nationalism_and_Albanian_Independence.pdf?origin=publication_detail

Gjergji i zi, dhe si udhëheqësi i famshëm i kryengritjes së parë serbe kundër Perandorisë Osmane), ka prejardhje etnike shqiptare, përkatësisht nga fisi Kelmend. Këta dy autorë, përveç të tjerash, i referohen letrës së historianit serb Andrija Luburić, dërguar Knjazit (Princit), përkatësisht trashëgimtarit Pavle të Karagjorgjeviqëve - mëkëmbësit mbretëror serb. Letra është e arkivuar në arkiv si dokument (AC-ZAL II/123):

SHKËLQESISË SË TIJ, PRINCIT, TRASHIGIMTARIT PAVLE

Beograd, 14 tetor 1935

Duke gjurmuar origjinën e familjes tuaj mbretërore kam ardhur deri në përfundim se Pjetri, babai i Vozhdit (Đorđe Karađorđević – Gjergji i zi), ka jetuar një kohë në fshatin Zhabren në Sanxhak dhe aty është lindur Vozhdi i pavdekshëm. Themelet e shtëpisë së Pjetrit mund të shihen edhe sot dhe janë interesantë. Në fshat janë të gjithë myslimanë (me fe), kuç dhe kelmendas të islamizuar, fshati numëron rreth 60 shtëpi. Në fshat nuk ka shkollë, as në rrethinën e tij: Prandaj është në nderin tim që t'ju drejtohem Shkëlqesisë Tuaj që të urdhëroni të ndërtohet një shkollë në themelet e shtëpisë së Pjetrit apo ku komisioni ta vendosë. Banorët e këtij fshati i kanë dhënë paraardhësit tuaj të pavdekshëm, Pjetrit, mbrojtjen dhe ndihmën për pavarësimin e Serbisë dhe me respekt mbajnë kujtesën për të parët Tuaj. Me këtë do të ruhej kujtimi për të Parët tuaj si kujtim për Vozhdin e pavdekshëm të Kelmendit të këtij vendi në Sanxhak. Xhaxhai i juaj, Pjetri, ka bërë përgatitje në vitin 1913 për të ndërtuar shtëpinë aty prapë, në të njëjtat përmasa.

Andrija Luburić
(Bošnjak & Jakovljević, 2006: 25)

Rrjedhimisht, rrethanat historike kanë ndikuar që shqiptarët si etni në vazhdimësi të jenë të ekspozuar ndaj fragmentimit fetar, asimilimit dhe absorbimit, dhe në këtë vazhdë të kontribuojnë më shumë për të tjerët sesa për veten. Kjo ka ndikuar që më vonë (gjatë epokës së nacionalizmit/epokës së procesit të kombformimeve), parakushtet socio-politike për kombfor-

mimin e shqiptarëve të jenë më të dobëta, krahasuar me parakushtet socio-politike për kombformimet e popujve të tjerë ballkanikë. Megjithëkëtë, një pjesë e konsiderueshme e shqiptarëve, arritën ta ruajnë kontinuitetin etnolinguistik dhe kujtesën historike, që u përdor si bazament për kombformimin e shqiptarëve. Për këtë arsye, ideologët e nacionalizmit shqiptar i dhanë rëndësi të veçantë gjuhës si faktori më unifikues i shqiptarëve. Në lidhje me këtë, Hobsbawm, shkruan:

> "... shqiptarët, duke jetuar nën ndikimin e kulturave rivale që nga antikiteti klasik dhe të ndarë midis tri apo (nëse e inkludojmë bektashizmin) madje katër religjioneve rivale: islamit, ortodoksisë dhe katolicizmit. Ka qenë e natyrshme për pionierët e nacionalizmit shqiptar të kërkojnë një identitet kulturor shqiptar në gjuhë, meqë religjioni dhe realisht pothuajse çdo gjë tjetër në Shqipëri dukej më shumë ndarëse sesa unifikuese..." (Hobsbawm 2012: 53).

Faza A dhe B e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare

Sipas Smithit, kriteri ose marrëdhënia e tretë dhe finale e ndërlidhjes në mes të etnisë dhe kombit është riinterpretimi. Në kuptimin e një procesi të udhëhequr nga prijësit/elitat e bashkësive etnike, që kërkojnë për t'i rizbuluar historitë e tyre 'autentike', dhe të lidhin këto histori me epokat e supozuara 'të arta' historike të së kaluarës së tyre etnike, në mënyrë që të rigjenerojnë dhe rivendosin 'fatin e lavdisë' së tyre. Siç dëshmojnë shumë shembuj, elitat e kanë arritur këtë, duke selektuar dhe riinterpretuar domethënien e së kaluarës të çdo gjenerate brenda parametrave të kulturës etnike, dhe duke përjashtuar elementet 'joautentike'. Elitat në këtë mënyrë, kanë arritur ta kenë fuqinë për të mobilizuar dhe pajisur masat

popullore me një sens të qëllimit kolektiv, duke iu referuar ndjenjës së përbashkët të bashkësisë 'së tyre'.[60]

Për ta konkretizuar edhe më shumë kriterin e tretë, riinterpretimin, mund të marrim pikënisje në tipologjinë analitike të historianit Mirosllav Hroch (në lidhje me procesin e kombformimeve), të cilit i referohet edhe Smith.[61] Hroch (duke u pozicionuar në mes të etnosimbolistëve dhe modernistëve), pozicionohet pak më afër etnosimbolistëve në kuptimin se, sipas tij, procesi i kombformimeve ka filluar më herët (sesa siç parashohin teoricienët modernistë). Megjithëkëtë, fazën vendimtare për kombformimet e ndërlidh me modernizmin. Dhe krahasuar me teoricienët e tjerë të sipërpërmendur në këtë kapitull, Hroch dallon në tri mënyra në qasjen e tij si studiues i nacionalizmit/kombformimeve. Përderisa teoricienët e tjerë të sipërpërmendur nuk e kanë të kufizuar empiriken, Hroch fokuson në mënyrë eksplicite vetëm në Evropë dhe jo më gjerë, e veçanërisht në procesin e kombformimit të kombeve të vogla (kombeve jodominuese) në Evropë.

Dallimi i dytë (veçanërisht me teoricienët modernistë), është se Hroch nuk e ka pasur si qëllim parësor të ndërtojë ndonjë teori për nacionalizmin/kombformimet. Por në radhë të parë ka fokusuar në rrethanat përcaktuese dhe të favorshme sociale, për përhapjen e suksesshme të ndjenjave patriotike, në kuadër të masave popullore.[62] Megjithëkëtë, duke e pasur parasysh se teoria në shkencat shoqërore përdoret kryesisht në dy mënyra kryesore, mund të thuhet se Hroch nuk është krejtësisht a-teorik në qasjen e tij sepse në një formë të thjeshtësuar, mund të thuhet se njëra mënyrë e përdorimit të teorisë (e inspiruar nga shkencat natyrore) nënkupton testimin e teorisë për të konkluduar se a ka teoria me empiriken përputhje/dallim. Mënyra tjetër e përdorimit të teorisë (e inspiruar nga shkencat humane) nënkupton përdorimin e teorisë (si pikënisje), për të kuptuar

[60] Smith 2008: 84-85
[61] Po aty: 76
[62] Hroch 2000: xi

dhe interpretuar më mirë empiriken gjatë një hulumtimi empirik. Mund të thuhet se Hroch e përdor teorinë më shumë në mënyrën e dytë, të inspiruar nga shkencat humane.

Dallimi i tretë është se Hroch e eviton përdorimin e termit nacionalizëm sepse e konsideron si term jo të frytshëm për gjurmim empirik.[63] Në vend të termit nacionalizëm, parapëlqen më shumë përdorimin e termeve kombformim, identitet nacional, vetëdije nacionale dhe patriotizëm. Në këtë vazhdë Hroch nëpërmes formulimit të një tipologjie krahasimtare analitike për periodizimin e procesit të kombformimeve nëpërmes tri fazave të lëvizjeve kombëtare, fazës a, b dhe c (të kombeve të vogla evropiane, në veçanti të kombeve eurolindore), ka kontribuar për një qasje më të mirë analitike të proceseve të kombformimeve. Sipas tij, këto tri faza të lëvizjeve kombëtare janë të karakterizuara nga periudha e përkushtimit intelektual për kombin (faza a), periudha e agjitacionit patriotik për kombin (faza b), dhe periudha e masivizimit patriotik për kombin (faza c).[64]

Faza e parë (a) e lëvizjeve kombëtare (duke qenë e inspiruar, përveç të tjerash, nga iluminizmi dhe romantizmi), karakterizohet nga një përkushtim i pasionuar i intelektualëve për gjuhën dhe karakterin e veçantë historiko-kulturor të kombit. Në historiografinë shqiptare kjo fazë identifikohet me fillesën e të ashtuquajturës Rilindja Kombëtare Shqiptare, që mund ta quajmë edhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare. Rrjedhimisht, ndikimin e veçantë për fillimprocesin e kombformimit shqiptar në fazën e parë (a), në kuptimin e shfaqjes së idesë kombëtare-shqiptare (si fillesë për transformimin e bashkësisë etnike shqiptare në kombin shqiptar) e kanë pasur ideologët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare: Naum Veqilharxhi (1797-1854), Hasan Tahsini (1811-1884) Jeronim de Rada (1814-1903), Zef Jubani (1818-1880), Thimi Mitko, (1820-1890), Elena Gjika (1828-1888), Konstantin Kristoforidhi (1830-1895) etj.

[63] Po aty: xii
[64] Po aty: 22-23

Pothuajse të gjithë këta ideologë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare jetonin jashtë Shqipërisë dhe ishin të arsimuar dhe të influencuar nga idetë e iluminizmit dhe romantizmit. Naum Veqilharxhi ishte në moshë të mitur kur familja e tij emigroi në Rumani. Jeronim de Rada ishte pasardhës i një familje emigrantësh shqiptarë që kishin emigruar në Itali pas vdekjes së Skënderbeut. Thimi Mitko, emigrant në Egjipt. Elena Gjika, kishte lindur në Konstancë të Romanisë dhe ishte vajzë e një fisniku me origjinë shqiptare. Ndërsa Hasan Tahsini dhe Konstantin Kristoforidhi ishin emigrantë në Stamboll. Veprimtaria e tyre karakterizohet nga zhvillimi i studimeve mbi historinë, gjuhën, duke përfshirë alfabetin, folklorin, letërsinë, artin, botimin e gazetave, themelimin e shoqatave kulturore dhe arsimin - në kuptimin e kërkesave për hapjen e shkollave shqipe, krahas atyre greke, latine etj., në kuadër të Perandorisë Osmane. Qëllimi kryesor i ideologëve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare ishte unifikimi i shqiptarëve në një komb, pa dallim të feve dhe ndarjes administrative të shqiptarëve, në kuadër të Perandorisë Osmane, duke përfshirë edhe reformat ekonomike etj.[65] Në këtë vazhdë kjo veprimtari e fazës së parë (a), që kishte filluar në vitet 1820, u shtua dhe u shndërrua në mënyrë të suksesshme në fazën e dytë (b).

Faza e dytë (b) e lëvizjeve kombëtare është e karakterizuar nga agjitacioni aktiv me adresë të dyfishtë, që nënkupton se lëvizja kombëtare nga njëra anë përpiqet të bindë sa më shumë anëtarë të bashkësisë së vet etnike se "ne" jemi një komb. Edhe pse në këtë periudhë bashkësitë etnike kanë qenë më shumë projekte kombëtare sesa kombe, në kuptimin se vetëm një pjesë e vogël e popullit e ka perceptuar veten anëtar i një kombi. Dhe nga ana tjetër, lëvizja kombëtare i shpall kërkesa në emër të bashkësisë së vet etnike, elitës së huaj, e në rastin e shqiptarëve, Perandorisë Osmane, në veçanti nëpërmes Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878). Ndikimin e veçantë gjatë fazës së dytë (b), të agjitacionit patriotik të lëvizjes kombëtare shqiptare, e kanë

[65] *Historia e popullit shqiptar II* (2002): 98-102, 121-131

pasur: Abdyl Frashëri (1839-1892), Pashko Vasë Shkodrani (1825-1892) dhe shumë të tjerë.

Faza a dhe b janë të ndërlidhura/përmbushëse me njëra-tjetrën, kështu që ndarja në mes të këtyre dy fazave është pjesërisht ndarje analitike. Shembulli më i mirë (në mes të shembujve të tjerë) për ndërlidhjen/përmbushjen e këtyre dy fazave në aspektin e protagonistëve gjatë procesit të komb-formimit shqiptar janë vëllezërit Frashëri (Abdyl, Sami dhe Naim Frashëri), të cilët kanë qenë protagonistë të rëndësishëm gjatë fazës a dhe b të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Megjithëkëtë, sipas Hroch, dallimi në mes këtyre dy fazave nuk është i parëndësishëm, sepse agjitacioni, përkatësisht faza b (që është faza më e rëndësishme për realizimin e një projekti kombëtar), bëhet më e fuqishme po qe se të tjerët para tyre (faza a) kanë kontribuar për një ide/vetëdije të përbashkët kombëtare.[66]

Në rastin e shqiptarëve, roli i rëndësishëm i diasporës shqiptare ka ndikuar që faza b të jetë më e fuqishme. Sipas Malcolm, arbëreshët e Italisë, të influencuar nga rizorxhimento (Rilindja), kanë qenë më radikalët në kuadër të idesë për çlirimin dhe pavarësimin e plotë të shqiptarëve në një shtet shqiptar në Ballkan dhe, në këtë vazhdë, në vitin 1878 në Milano e kanë themeluar "Komitetin italo-shqiptar për çlirimin e shqiptarëve në Lindje". Gjithashtu, qarqet intelektuale-patriotike të diasporës shqiptare në Rumani, Bullgari dhe deri në Egjipt, e kanë pasur një rol të rëndësishëm, e veçanërisht Bashkësia Shqiptare e Stambollit, që ka pasur kontaktin më të drejtpërdrejtë me trevat shqiptare.[67]

Mønnesland konsideron se dy pashallëqet shqiptare që iu kundërvunë Sulltanit gjatë periudhës së fillimviteve 1800 (pashallëku i Shkodrës në veri në krye me Bushatlinjtë, dhe pashallëku i Janinës në jug, në krye me Ali Pashë Tepelenën), edhe pse nuk kanë përfaqësuar lëvizje tipike kombëtare, kanë

[66] Hroch 2000: xv

[67] Malcolm 2001: 227-228

ndikuar që shqiptarët ta shijojnë vetëqeverisjen. Megjithëkëtë, sipas tij, fillesa e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare zuri vend jashtë trojeve shqiptare, veçanërisht (në kuadër të qarqeve intelektuale-patriotike shqiptare) në Bukuresht dhe Stamboll.[68]

Hroch nuk bazohet vetëm në protagonistë (vetëm në elitat e lëvizjeve kombëtare në fazat a, b dhe c), por pothuajse në të njëjtën masë bazohet edhe në strukturë. Sipas tij, procesi i kombformimit nuk është proces që ndodh në një vakum sociopolitik, por është ngushtë i ndërlidhur me modernizimin politiko -ekonomik. Në kuptimin se procesi i kombformimit starton në një kohë krize identiteti dhe vlerash, si pasojë e krizës në regjimin e vjetër.[69] Kjo pikëpamje e Hrochut përputhet edhe me procesin e kombformimit shqiptar, përkatësisht me fazën a dhe b të kombformimit shqiptar. Në kuptimin e reagimit të fuqishëm të shqiptarëve që nga fillimvitet 1830, kundër reformave centralizuese të Perandorisë Osmane, që më pastaj nga viti 1839-1856 dhe 1856-1876 njihen si Reformat e Tanzimatit, duke përfshirë reagimin e fuqishëm të shqiptarëve kundër Traktatit të Shën-Stefanit (1878). Sepse këto reforma në vazhdimësi i shpërfillën të drejtat kombëtare të shqiptarëve, ndërsa ky traktat e vështirësoi shumë perspektivën e përgjithshme politike të shqiptarëve.

Reforma e Tanzimatit fillimisht u ndesh në kundërshtim me të drejtën zakonore të shqiptarëve, të cilët ishin të organizuar në bashkësi fisnore (veçanërisht në Malësi), dhe kultivonin një lloj vetëqeverisjeje të bazuar në traditat e vjetra. Në lidhje me këtë formë organizative të shqiptarëve, Mønnesland shkruan:

> "Shqiptarët ishin të ndarë në dy grupe me dallime të caktuara gjuhësore, *gegët* dhe *toskët.* Toskët banonin në ultësirën e jugut, kryesisht nën pushtetin e pronarëve të mëdhenj të tokave, që ua bënin të vështirë jetesën fshatarëve. Ultësira kontrollohej më lehtë nga autoritetet dhe barra tatimore ishte e rëndë. Gegët banonin në male në veri, si shoqëri klanore dhe fisnore, që ngjante me atë të

[68] Mønnesland 2006: 144-145
[69] Hroch 2000: xiv

> Malit të Zi. Shoqëria klanore shqiptare është mbajtur deri në ditët e sotme. Klani udhëhiqej nga anëtari më i vjetër i gjinisë mashkullore. Një ose më shumë klane përbënin një njësi territoriale të quajtur *bajrak*, e udhëhequr nga një *bajraktar*, që ishte një post i trashëguar. *Bajraku* ishte një njësi vetëqeverisëse e rregulluar mbi bazën e së drejtës zakonore dhe ligjeve të vjetra. Bashkimi i disa *bajraqeve* formonte një fis, të udhëhequr nga një burrë i një familje të mirënjohur. Të gjitha çështjet e rëndësishme u zgjidhnin nga një këshill i të gjithë anëtarëve meshkuj të fisit. Fiset e qeverisnin vetveten, pasi që për autoritetet qendrore ishte e pamundur të ushtronin kontrollin në këto zona malore" (Mønnesland 2006: 144).

Kjo formë organizative e shqiptarëve (edhe pse në ditët e sotme është anakronike), nëpërmes formës së vet vetëqeverisëse, ka qenë shumë e rëndësishme për ruajtjen dhe vazhdimësinë e identitetit etnik të shqiptarëve. Njëkohësisht ka shërbyer edhe si sinonim i lirisë. Sipas Malcolm, që në fillimvitin 1840, një vëzhgues në përpjekjet e tij për të gjetur përgjigje se ç'dëshirojnë shqiptarët, kishte shkruar: "Ata duan t'i gëzojnë po ato privilegje, po atë pavarësi që i gëzojnë trevat e lira të Malësisë" (Malcolm 2001: 226).

Në kuadër të reformës së Tanzimatit filluan të zbatohen rregullat që kishin të bënin me sistemin e ri të taksimit, të shërbimit të detyrueshëm ushtarak, të gjykatave, duke e përfshirë edhe ndryshimin e strukturës administrative. Në vend të shqiptarëve erdhën administratorë dhe nëpunës të tjerë (me përkatësi tjetër etnike) nga rajonet e ndryshme të Perandorisë Osmane. Kjo ndikoi që shqiptarët (të nxitur edhe nga krerët e tyre lokalë, duke përfshirë edhe spahinjtë/përfaqësuesit e feudeve), të reagojnë fuqishëm kundër Perandorisë Osmane, deri në nivelin e kryengritjeve të armatosura.[70] Reforma e Tanzimatit ishte njëkohësisht një përpjekje për luftimin e separatizmit në kuadër të Perandorisë Osmane, e cila ishte dobësuar nga krizat financiare, disfatat e njëpasnjëshme, procesi i shpërbërjes nga brenda etj. Prandaj, si një lloj strategjie për të kufizuar/amortizuar nismat seperatiste, kjo reformë

[70] Bozbora 2002: 132, 141-142

përfshiu edhe të drejtat për komunitetet jomyslimane, që tashmë ishin politizuar edhe me ndikimin e shteteve të fuqishme evropiane.

Forcimi i Rusisë që nga shekulli XVII dhe puqja e interesave të Rusisë dhe Austro-Hungarisë për ta ushtruar hegjemoninë e tyre në Ballkan, që njëkohësisht karakterizohej nga rivaliteti në mes tyre, kishte rritur presionin ndaj Perandorisë Osmane. Madje në vitin 1782 Austro-Hungaria dhe Rusia kishin arritur një marrëveshje të fshehtë për ndarjen e Ballkanit, por realizimin e këtij plani e penguan Anglia dhe Franca. Rivaliteti në mes të Rusisë dhe Austro-Hungarisë përfshiu edhe konkurrencën në mes tyre, për ushtrimin e ndikimit mbi serbët, me të cilët Rusia kishte një relacion më specifik.[71] Në fillimvitet 1800, me mbështetjen e Austro-Hungarisë dhe Rusisë, iu njoh një lloj autonomie Serbisë dhe në këtë vazhdë, Anglia, Franca dhe Rusia mbështetën lëvizjen greke për pavarësi. Strategjia e Perandorisë Osmane me dhënien e drejtave për komunitetet jomyslimane që përfshiu reforma e Tanzimatit (duke u bazuar në të drejtat fetare dhe jo në të drejtat etnike), ishte një përpjekje për të mbajtur brenda Perandorisë Osmane, komunitetet jomyslimane. Por, efekti u tregua të jetë i kundërt sepse kërkesat gjithnjë në rritje nën petkun fetar, të komuniteteve të krishtera (serbëve, bullgarëve etj.), rezultuan në kërkesa nacionale. Në këtë vazhdë, veçanërisht kërkesat (ekspansioniste) të Serbisë, të mbështetura nga Rusia, rezultuan kërcënuese ndaj shqiptarëve.[72]

Për dallim të fqinjëve të tyre, shqiptarët gjendeshin në një situatë krejtësisht të disfavorshme. Nga njëra anë çështja e shqiptarëve nuk ishte futur haptazi në kuadër të diskursit ndërkombëtar, edhe pse (në vazhdën e reformës së Tanzimatit), e tërhoqi vëmendjen e shteteve perëndimore, si një objekt i një konflikti eventual në planin ndërkombëtar. Anglia, duke qenë e brengosur për rritjen e ndikimit të Rusisë, ishte për ruajtjen e

[71] Mønnesland 2006: 100

[72] Bozbora 2002: 119-120, 143

statuskuosë dhe, në këtë vazhdë, duke e marrë parasysh pozitën e veçantë të shqiptarëve (historike, etnike dhe fetare), konsideronte se çështja shqiptare duhej mbajtur në kuadër të Perandorisë Osmane si çështje e brendshme e saj. Nga ana tjetër, Perandoria Osmane pengonte çdo lloj uniteti të shqiptarëve nëpërmes taktikës "përçaj dhe sundo". Zbatimin e kësaj taktike e lehtësonte edhe struktura e brishtë organizative e shqiptarëve (me ndarjet fisnore dhe fetare). Madje edhe krerët lokalë të shqiptarëve, që ishin ngritur kundër reformës së Tanzimatit, i prioritonin më shumë kërkesat për rikthimin e të drejtave fisnore sesa kërkesat për unitetin territorial-kombëtar të shqiptarëve. Perandoria Osmane kishte krijuar përvojë për përdorimin e kësaj taktike ndaj komuniteteve të ndryshme dhe e vazhdoi ndaj shqiptarëve. Kjo ishte edhe arsyeja pse reformistët e Tanzimatit i konsideronin si kërcënim më të madh, intelektualët shqiptarë (se sa krerët lokalë shqiptarë), të cilët nëpërmes veprimtarisë së tyre patriotike, synonin një strukturë të unitetit kombëtar të shqiptarëve. Një ndër preokupimet kryesore të intelektualëve shqiptarë ishte zgjerimi i veprimtarisë patriotike, dhe duke e shfrytëzuar të drejtën për krijimin e shoqatave, që përcaktoi reforma e Tanzimatit, arritën ta zgjerojnë veprimtarinë e tyre edhe më shumë. Madje edhe duke e ushtruar mësimin e fshehtë në gjuhën shqipe, gjë që rezultoi me reagimin e reformistëve të Tanzimatit dhe të patriarkanës ortodokse të Stambollit. Gjithashtu, ndarja fetare në mes të shqiptarëve ishte një pengesë për unitet kombëtar, edhe pse shqiptarët kishin një traditë të bashkëjetesës ndërfetare. Islamizimi masiv i shqiptarëve rezultoi në një integrim më të madh të shqiptarëve (krahasuar me fqinjët e tyre), në kuadër të Perandorisë Osmane. Njëkohësisht, ndikimi i patriarkanës ortodokse të Stambollit mbi shqiptarët ortodoksë të Shqipërisë së jugut, dhe i Italisë, Austrisë dhe Francës mbi shqiptarët katolikë të Shqipërisë së Veriut, i inkurajonin dallimet fetare të shqiptarëve, në drejtimin e ndarjeve politike.[73]

[73] Po aty: 135-136, 142-144

Rrjedhimisht, brenda këtij konteksti historiko-politik dhe social të shqiptarëve duhet vlerësuar postulatin e Pashko Vasë Shkodranit: "Feja e Shqyptarit është Shqyptaria", të shkruar në kuadër të poemës së tij të titulluar "O moj Shqypni e mjera Shqypni" (1880). Në esencë, ky postulat (që pati ndikim të madh), ishte thirrje për unitetin kombëtar dhe harmoninë ndërfetare të shqiptarëve, dhe jo kundër feve si vlerë në vete. Njëkohësisht, ky postulat e përmban një aspekt të nacionalizmit - religjioz, sepse e cilëson edhe shqiptarinë si fe. Prandaj është edhe një ndër shembujt që zbulon karakterin religjioz surrogat të nacionalizmit. Madje, ndoshta, shembulli më tipik dhe sidomos më eksplicit që e vërteton konstatimin e Smithit, se nacionalizmi përveçse është ideologji politike dhe kulturë publike, është edhe religjion politik, dhe se gjatë vrullit të vet sekular, ngjan më shumë me religjionin politik sesa me ideologjitë politike. Duke u bazuar, përveç të tjerash, në ritualet dhe ceremonitë përkujtimore për heronjtë/dëshmorët e kombit, dhe besimin në fatin kombëtar, si besim komplementar me besimin religjioz tradicional e, në rastin e shqiptarëve, si besim komplementar me besimet religjioze tradicionale, dhe në shërbim të harmonisë ndërfetare.

Përcaktimi i të drejtave për komunitetet mbi bazën fetare dhe jo mbi bazën etnike (në kuadër të reformës së Tanzimatit), i diskriminoi shqiptarët veçanërisht në të drejtat për arsimin. Në lidhje me këtë, Mønnesland shkruan: "Kur popujve në Perandorinë Turke iu lejua të organizonin shkollat në gjuhët e tyre në vitin 1839, kjo nuk vlente për shqiptarët sepse ata ishin të fragmentuar fetarisht. Shqiptarët myslimanë konsideroheshin si turq, ata ortodoksë si grekë dhe ata katolikë si 'latinë', që mund të shkonin në shkollat italiane" (Mønnesland 2006: 145).

Marrë parasysh kontekstin socio-politik në të cilin gjendeshin shqiptarët, edhe pse s'u arrit që kërkesat e kryengritësve lokalë shqiptarë (gjatë fillimviteve 1830 e tutje kundër reformave të Tanzimatit), të përbashkohen dhe formulohen në bazë të një programi, dhe të paraqiten në emër të të gjithë popullit shqiptar.

Megjithëkëtë, përveç kërkesave për anulimin e ligjit për shërbimin e detyrueshëm ushtarak, dhe zëvendësimin e funksionarëve osmanë të pushtetit lokal, që s'e dinin gjuhën shqipe, me nëpunës shqiptarë, duke përfshirë kërkesën që të mos paguheshin taksat shtesë etj. Në disa raste, kërkesa e kryengritësve lokalë shqiptarë për një status të veçantë të trojeve shqiptare, përmbante në "embrion" kërkesën për autonomi territoriale-administrative të Shqipërisë. Disa ndër shembujt më tipikë për këtë janë: Kryengritja e udhëhequr nga Tafil Buzi që nisi në Berat në vitin 1834 dhe u përhap në krahinat e Vlorës, të Tepelenës, të Skraparit, të Tomoricës, të Mallakastrës, të Përmetit etj., dhe rezultoi me organizimin e Besëlidhjes së nëntë krahinave të Shqipërisë së Jugut. Kjo Besëlidhje, që njëkohësisht ishte organ qeverisës, kërkoi që mos të zbatohen reformat centralizuese, në krahinat kryengritëse dhe t'u njihet një qeverisje autonome. Pas një qëndrese heroike kryengritja u shtyp, megjithëkëtë kryengritjet nuk u ndalën dhe në vazhdimësi e vështirësuan zbatimin e reformave centralizuese. Në maj 1835 nisi kryengritja në Shkodër në krye me Hamza Kazazin, që më pastaj u udhëhoq nga një këshill i përkohshëm i njohur në literaturë si qeveri provizore. Kësaj kryengritje të shkodranëve iu bashkuan vullnetarë nga Postriba, Gjakova, Peja, Malësia e Mbishkodrës, Ulqini, Podgorica, krahinat e Mirditës, të Matit e të Dibrës dhe, rrjedhimisht, përfshiu pothuajse gjithë Shqipërinë e Veriut. Gjenerali francez, Kybjer, komandant i forcave të Mesdheut, e cilësoi këtë kryengritje si revolucion, në kuptimin e një lëvizje me shtrirje të gjerë për çlirim nga Perandoria Osmane. Ndërsa një nga emisarët francez në Prevezë shkruante se kryengritësit pretendonin një pavarësi nga Perandoria Osmane, të ngjashme me autonominë e Serbisë. Në këtë vazhdë rol të veçantë ka pasur kryengritja e viteve 1843-1844 në krye me Dervish Carën, që filloi në Shkup dhe u zgjerua duke përfshirë Kumanovën, Preshevën, Bujanovcin, Vranjën, Grykën e Kaqanikut, Leskovcin, Pejën, Gjakovën, Prizrenin e deri në Shkodër. Kjo kryengritje përfshiu pothuajse të gjitha trevat shqiptare, nga Manastiri e Ohri në jug

deri në skajet veriore e verilindore të Kosovës, ku kryengritësit vendosën pushtetin e tyre dhe shprehnin hapur pretendimet për autonominë, duke iu referuar shembullit të organizimit të shteteve fqinje (Serbisë etj.). Gjithashtu, kryengritja e vitit 1847 në krye me Zenel Gjolekën, që nisi në Kurvelesh dhe përfshiu Delvinën, gjithë Labërinë, duke u përhapur në trevën e Çamërisë, të Përmetit e veçanërisht të Mallakastrës në krye me Rrapo Hekalin etj. Prapavija e kësaj kryengritje që shënoi ngritjen në një shkallë më të lartë të Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Shqiptarëve ishte organizimi i Kuvendit të Madh Ndërkrahinor të Mesaplikut, në qershor 1847, ku morën pjesë përfaqësues nga krahinat e Shqipërisë, kryesisht të jugut. Edhe këngët popullore që iu kushtuan kësaj kryengritje karakterizohen nga ideja e bashkimit kombëtar. Në njërën nga këto këngë poeti popullor i drejtohet Zenel Gjolekës me fjalët *"sos lëfton për vete, / por për gjithë vilajete"* dhe vë në dukje se udhëheqësi trim nuk lufton *"as për mua, as për ti, / po për gjithë Shqipëri"*. Edhe Sami Frashëri (një ndër ideologët dhe agjitatorët më të spikatur të kombformimit shqiptar) e ka cilësuar këtë kryengritje si kërkesë për bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare në një Shqipëri autonome.[74] Rrjedhimisht, për dallim të kryengritjeve të mëhershme, kryengritjet e shqiptarëve gjatë viteve 1830 e tutje kishin tipare nacionalçlirimtare:

> "Të zhvilluara në kohën kur te shqiptarët ishte formuar tanimë një vetëdije politike e kombëtare, kryengritjet e viteve '30 e '40 nuk mund të mos merrnin tipare të reja nacionalçlirimtare. Dëshmi e kësaj vetëdijeje të shqiptarëve ishte edhe përkrahja që ata u dhanë revolucioneve nacionale në Principatat Rumune dhe në Greqi, në vitet '20, në të cilat dhanë një kontribut të çmuar. Mjaft e gjerë ishte pjesëmarrja e shqiptarëve e kolonisë së Rumanisë dhe jo vetëm e atyre, por edhe e të tjerëve të ardhur nga Shqipëria, e veçanërisht nga trevat e saj jugore, në kryengritje që shpërtheu në principatat rumune në vitin 1821. Disa prej tyre kishin marrë pjesë edhe në revolucionin serb të vitit 1815. Është një fakt i njohur, tanimë se Naum Veqilharxhi, një nga personalitetet më të shquara të Rilindjes

[74] *Historia e popullit shqiptar II*, 2002: 81, 87-88, 89, 92-93, 95, 97

Shqiptare, mori pjesë në kryengritjen e vitit 1821 në Vllahi dhe në Moldavi qysh në fillim të saj, ndihmoi në organizimin e revoltës dhe ishte i pranishëm si komandant ushtarak, gjatë disa veprimeve luftarake që u zhvilluan kundër forcave osmane. Rol të veçantë, si organizator dhe komandant ushtarak, në kryengritjen e vitit 1821 në principatat rumune luajti iluministi tjetër i njohur shqiptar, Konstandin Duka. Shqiptarët përbënin një forcë të rëndësishme luftarake në trupat e eteristëve të komanduar nga princi grek Aleksandër Ipsilanti, si edhe në ato të rumunit Tudor Vladimiresku që luftuan trimërisht në radhët e kryengritësve të drejtuar nga komandantët shqiptarë, Haxhi Prodani e kapiten Mihallaqi. Të shumtë ishin shqiptarët që u vranë në betejat që u zhvilluan gjatë kësaj kryengritje e sidomos në atë të Skulenit, pas së cilës trupat e tyre u hodhën në lumin Pruth. Edhe masakra që ushtria osmane ndërmori në Bukuresht ndaj forcave kryengritëse, në gusht të vitit 1821, ishte drejtuar kundër shqiptarëve që morën pjesë në revoltën kundërosmane. Shqiptarët u bashkuan me kryengritjen e principatave rumune jo si mercenarë, por si luftëtarë që ishin të ndërgjegjshëm se, duke kontribuar në çlirimin e popullit rumun nga sundimtarët osmanë, të cilët mbanin të robëruar gjithë popujt e Ballkanit, do ta jepnin ndihmesën e tyre edhe në çështjen e çlirimit kombëtar të popullit shqiptar. Pikërisht pse vepruan si një forcë e ndërgjegjshme politikisht në aktet e kryengritjes të principatave rumune, shqiptarët përmendën krahas grupeve të tjera etnike që morën pjesë në lëvizje. Edhe frymëzuesit e lëvizjes, eteristët, në thirrjen që ua drejtuan shqiptarëve, grekëve, vllahomoldavëve, bullgarëve, serbëve, maqedonasve etj., qysh në fillim të kryengritjes u kujtonin atyre se kjo luftë bëhej për çlirimin e gjithë popujve të Ballkanit dhe njëherazi të atdheut të tyre, se është atdheu i tyre i robëruar ai që u bën thirrje të ngrihen kundër sundimtarëve të huaj osmanë.

Shqiptarët ishin, gjithashtu, një forcë aktive me rol të veçantë si në përgatitjen e kryengritjes greke të vitit 1821, ashtu edhe në zhvillimin e revolucionit në përgjithësi. Nëse Ali pashë Tepelena me veprimet e tij ushtarake kundër ushtrive osmane u dha dorë eteristëve të shpërthenin kryengritjen në mars të vitit 1821, shqiptarët (arvanitët), krahas grekëve, ishin nismëtarë të kësaj kryengritjeje. Qysh në mars të vitit 1821 u bashkuan me Revolucionin grek fshatra të tëra shqiptare (arvanite) të Atikës. Kryengritësit shqiptarë, të udhëhequr nga fshatari i thjeshtë Melet Vasili nga Atika (i quajtur Haxhimeleti), marshuan në fundin e marsit drejt Athinës, e detyruan garnizonin osman të mbyllet në Akropol dhe çliruan Athinën. Përgjithësisht gjatë fazës së parë të revolucionit

> grek arvanitët, dhe jo vetëm ata, por edhe shqiptarët e trevave të Shqipërisë, duke përfshirë edhe ata myslimanë, u bënë figura qendrore e ngjarjeve dhe e veprimeve luftarake të kryengritësve. Kryengritësit e Peloponezit, grekë e shqiptarë (arvanitë), të komanduar nga Kolokotroni, arritën ta merrnin qytetin e Tripolicës, për çlirimin e të cilit patën luftuar pesë muaj me radhë, vetëm pasi shqiptarët myslimanë hynë në marrëveshje me ta dhe dezertuan në masë nga ushtria osmane. Pati edhe mjaft shqiptarë myslimanë, ndërmjet të cilëve njihen Mustafa Gega, Bajram Lapi, Avdi Gega etj., të cilët jo vetëm dezertuan nga ushtria osmane, por morën pjesë në veprimet luftarake të Revolucionit grek. Është i njohur kontributi i luftëtarëve suliotë, të udhëhequr nga Marko Boçari, të cilët gjatë periudhës së parë të Revolucionit grek mbajtën barrën kryesore të luftës në Greqinë kontinentale. Edhe sundimtari i pashallëkut të Shkodrës, Mustafa pashë Bushatliu, duke kundërshtuar urdhrin e sulltanit, braktisi në vitin 1823 luftimet në Misolongjin e rrethuar, nuk pranoi të marshonte drejt Athinës për ta shtypur kryengritjen dhe u kthye me ushtrinë e tij në Shkodër. Shpërthimi i rrethimit të Misolongjit nga grekët më 1823 u arrit, krahas të tjerave, edhe nga ndihmesa e shqiptarëve që dezertuan në masë nga ushtria osmane. Këto dezertime të shqiptarëve myslimanë nga ushtria do të përsëriteshin edhe në rrethimin e dytë të Misolongjit, në vitin 1825" (Historia e popullit shqiptar II, 2002: 82 - 83).

Me fjalë të tjera, kryengritjet e shqiptarëve që nga fillimvitet 1830 dhe në vazhdimësi, kundër reformave të Tanzimatit (në Shqipërinë jugore dhe veriore, duke përshirë Kosovën dhe vise të tjera të banuara me shqiptarë), dhe veçanërisht ndikimi i veprimtarisë patriotike dhe i retorikës sekulare i intelektualëve shqiptarë (në shërbim të gjuhës, historisë, harmonisë ndërfetare etj.), ishin shpëtimi i Shqipërisë. Në këtë vazhdë veprimtaria dhe rezistenca patriotike e shqiptarëve u shtuan si reagim ndaj vendimeve të Traktatit të Shën-Stefanit dhe të Kongresit të Berlinit (1878). Rrjedhimisht, faza a dhe b e kombformimit shqiptar është gjithashtu e ndërlidhur/përmbushëse me njëra-tjetrën në aspektin strukturor. Në kuptimin e kryengritjeve që nga fillimvitet 1830, dhe në vazhdimësi kundër reformave të Tanzimatit (pothuajse në gjithë territoret ku banonin shqiptarët), deri në prag të Kuvendit të Prizrenit, përkatësisht

Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878), që arriti ta shndërrojë përfundimisht idenë kombëtare shqiptare (të fazës a) në projektin/programin kombëtar shqiptar (të fazës b). Dhe që njëkohësisht ishte shprehje e revoltës kundër vendimeve të traktatit të Shën Stefanit dhe të Kongresit të Berlinit (1878).

Prapavija e Traktatit të Shën Stefanit ishte lufta ruso-turke e vitit 1877. Perandoria Osmane e humbi luftën dhe më 3 mars 1878 u detyrua ta nënshkruajë marrëveshjen me Rusinë. Sipas marrëveshjes, osmanët humbën shumicën e vendeve të Ballkanit të cilat u shndërruan në shtete kombëtare. Shqiptarët nuk ishin të përfshirë në marrëveshje dhe disa nga zonat e banuara me shqiptarë u okupuan nga shtetet e sapoformuara kombëtare në Ballkan (Serbia, Mali i Zi, Bullgaria etj.), ndërsa pjesa tjetër e territorit të banuar me shqiptarë mbeti nën okupimin e Perandorisë Osmane. Në këtë periudhë historike shqiptarët ishin shumicë në katër vilajete nën administrimin e Perandorisë Osmane: Vilajeti i Kosovës, Vilajeti i Shkodrës, Vilajeti i Janines dhe Vilajeti i Manastirit.

Një pjesë domethënëse e intelektualëve shqiptar të cilët kishin themeluar në vitin 1877 "Komitetin Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombit Shqiptar", në krye me Abdyl Frashërin, si reagim kundër Traktatit të Shën Stefanit, u dërguan apele shteteve perëndimore për ta ndaluar copëtimin e trojeve shqiptare. Ky komitet (që përfshinte intelektualë shqiptarë, myslimanë, katolikë dhe ortodoksë), në kombinim me iniciativën e gjeneralit të shquar shqiptar Ali Pashë Gucisë, për ndalimin e aneksimit të territoreve shqiptare, pati ndikim të rëndësishëm për mobilizimin politiko-ushtarak të shqiptarëve. Dhe kulmoi me organizimin e Kuvendit të Prizrenit, përkatësisht Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, më 10 qershor të vitit 1878, në qytetin Prizren, në Kosovë. Për prapavijën e organizimit të këtij kuvendi, Malcollm shkruan:

> Ideja për mbajtjen e një Kuvendi të madh krerësh ose prijësish shqiptarë rikujtonte një traditë të thellë të historisë së shqiptarëve. Siç kemi thënë edhe më sipër, kuvende të këtilla ishin mbajtur në pjesë të ndryshme të Shqipërisë së Veriut që në fillim të shekullit

> XVII. Ekzistonte edhe një traditë e fuqishme e mbajtjes së kuvendeve të fiseve, për shembull, ku merreshin vendime për veprime të përbashkëta ose për ndërprerjen e hakmarrjeve në kohë pushtimesh. Kreu i fuqishëm fisnor, Ali Pashë Gucia, territorin e të cilit ia kishin premtuar Malit të Zi (sipas Traktatit të Shën Stefanit), tashmë kishte formuar një "lidhje" të fiseve vendëse me qëllim që ta kundërshtonte aneksimin; për mendjen e shumicës së krerëve dhe të parisë në Kosovë dhe në Shqipërinë e Veriut. Kuvendi në Prizren ishte, sipas gjasave, një shtrirje e kësaj ideje (Malcolm 2001: 229).

Rrjedhimisht, organizimi i Lidhjes së Prizrenit (ku morën pjesë pothuajse të gjithë delegatët nga të gjitha trojet shqiptare, dhe u udhëhoq formalisht nga Ymer Prizreni), shënon njëkohësisht bashkimin e forcave politiko-ushtarake të shqiptarëve në nivel kombëtar. Përkatësisht, shënon bashkimin e traditës së kryengritjeve lokale dhe regjionale të shqiptarëve deri në një masë me karakter kombëtar (veçanërisht në krye me Tafil Buzin, Hamza Kazazin, Dervish Caren, Zenel Gjolekën, Rrapo Hekalin etj.), tashmë në krye me gjeneralin e shquar Ali Pashë Gucinë etj. Dhe traditës së intelektualëve shqiptarë, me synimin për arritjen e një strukture të unitetit kombëtar të shqiptarëve (veçanërisht në krye me Naum Veqilharxhin, Hasan Tahsinin, Jeronim de Radën, Zef Jubanin, Thimi Mitkon, Elena Gjikën, Konstantin Kristoforidhin etj.), tashmë në krye me intelektualin dhe agjitatorin e shquar kombëtar Abdyl Frashërin etj.

Fillimisht qëllimi me Lidhjen e Prizrenit ishte formimi i një organizate ushtarake për ndalimin e copëtimit të trojeve shqiptare. Por, me ndikimin e Abdyl Frashërit etj., avancoi edhe me kërkesën politike për bashkimin dhe autonominë e vilajeteve shqiptare.[75] Në këtë vazhdë, edhe pse përfaqësuesit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në kuadër të Lidhjes së Prizrenit, karakterizoheshin nga dy rryma politike, progresistët dhe konservatorët, këta të fundit nuk ishin për shkëputjen e plotë sepse, përveç të tjerash, konsideronin se Perandoria Osmane do të mund t'i mbrojë nga rreziku i copëtimit të mëtutjeshëm i

[75] Malcolm 2001: 229-230

territoreve shqiptare nga vendet fqinje. Megjithëkëtë, me ndikimin e progresistëve në krye me Abdyl Frashërin etj., rezultoi kërkesa për bashkimin dhe pavarësimin e katër vilajeteve shqiptare.

Traktati i Shën Stefanit shqetësoi disa ndër fuqitë e mëdha të kohës (Gjermaninë, Austro-Hungarinë, Francën, Italinë, Britaninë e Madhe), sepse e forconte hegjemonin ruse në Ballkan nëpërmes aleatëve të saj (Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë etj.). Për këtë arsye, u organizua një kongres në Berlin në qershor të vitit 1878, për ta rishikuar këtë traktat. Kongresi në Berlin e miratoi një korrigjim në lidhje me territoret shqiptare, megjithëkëtë një pjesë e konsiderueshme e territoreve të banuara me shqiptarë u ndanë.

Përveç të tjerash, Kongresi i Berlinit vendosi që një pjesë e trevës veriperëndimore e vilajetit të Kosovës, duke përfshirë Plavë-Gucin të banuar me shqiptarë, t'ia dorëzojë Malit të Zi. Por rezistenca e shqiptarëve, e nisur nga bajraktari i Hotit të Kujit, Alush Smajl Hoti[76] dhe nën udhëheqjen e Ali Pashë Gucisë, i zmbrapsi forcat malazeze në nëntorin e vitit 1879, dhe në janarin e vitit 1880. Kjo rezistencë e shqiptarëve kundër forcave malazeze, e njohur si lufta e Nokshiqit, ndikoi që fuqitë e mëdha ta ndryshojnë vendimin e tyre dhe, në vend të Plavë-Gucisë, ia dhanë Malit të Zi zonën bregdetare të Ulqinit, gjithashtu e banuar me shqiptarë.[77] Edhe ky aneksim u kundërshtua nga shqiptarët, por fuqitë e mëdha vendosën forcat detare për ta zbatuar/imponuar vendimin e tyre.[78] Vlen të theksohet se rezistenca heroike e luftëtarëve shqiptarë në luftën e Nokshiqit (kryesisht të mobilizuar nga krahina e Plavë-Gucisë dhe krahina e Rugovës), i ka lënë mbresë të fortë edhe udhëheqësit ushtarak të forcave malazeze në këtë luftë, Marko Miljanovit, i cili, në shkrimet e tij të mëvonshme, ka shkruar me admirim për jetën dhe zakonet e shqiptarëve. Në fakt,

[76] Alush Smajl Hoti: Alush Smajli Hoti - YouTube
[77] Malcolm 2001: 230, 232
[78] Mønnesland 2006: 146

Marko Miljanov ka qenë pjesëtar i fisit të Kuçit, që konsiderohet një ndër fiset më të vjetra me shtrirje të gjerë dhe me një vazhdimësi të trashëgimisë iliro-shqiptare. Madje, sipas studiuesit Mehmet Bislimi, pasardhës të fisit Kuçi janë edhe disa ndër heronjtë e shquar shqiptarë nga treva e Drenicës: Ahmet Delia, Azem Bejta, Nebih e Tahir Meha, Shaban, Hamëz dhe Adem Jashari etj., përkatësisht pasardhës të Prekë-Kuçit (Prekaz-Kuçit) dhe të vëllezërve dhe djemve të Prekë-Kuçit në fshatrat Galicë, Ternac, Abri, duke përfshirë fshatin Lutogllavë të Pejës, të cilët e mbajnë me krenari mbiemrin Kuçi.[79] Rrjedhimisht, gjatë zhvillimeve historike një pjesë e shqiptarëve katolikë të fisit Kuçi, duke kaluar në fenë ortodokse, janë asimiluar gradualisht në malazezë, por kanë vazhduar të identifikohen me këtë fis, siç është rasti i Marko Miljanovit. Studiuesi Robert Elsie për Mark Miljanovin, përveç të tjerash, shkruan:

> Marko Miljanov (1833-1901), i njohur në shqip si Mark Milani, ishte një luftëtar malazez, prijës i fisit Kuçi, një figurë e shquar ushtarake dhe shkrimtar. Babai i tij ishte një sllav ortodoks dhe nëna e tij ishte një shqiptare katolike. Libri i tij i botuar pas vdekjes, "Jeta dhe zakonet e shqiptarëve", është magjepsës për pikëpamjet që ai ofron për fiset fqinje malësore të Shqipërisë, me të cilët fisi i tij malazez kishte shumë të përbashkëta.[80]

Mospërfshirja e të drejtave kombëtare të shqiptarëve në kuadër të Traktatit të Shën Stefanit, e sidomos në kuadër të vendimeve të Kongresit të Berlinit, ishte tregues se fuqitë e mëdha të kohës, duke e përfshirë edhe Perandorinë Osmane, do të vazhdojnë (më pak e më shumë), t'i shpërfillin kërkesat kombëtare të shqiptarëve.

Protagonisti kryesor i Lidhjes së Prizrenit, Abdyl Frashëri, duke konsideruar se Perandoria Osmane nuk do t'i ndihmojë

[79]Mehmet Bislimi (2011): *Bislim Luti - Lutfia - një kapitull i veçantë:* AlbaniaPress.com / ShqiperiaPress.com

[80] Robert Elsie (s. a.): *Marko Miljanov: The Life and Customs of the Albanians*: Marko Miljanov: The Life and Customs of the Albanians (albanianhistory.net)

shqiptarët dhe do ta lejojë copëzimin e Shqipërisë, u bënte thirrje shqiptarëve të përpiqeshin për pavarësinë e plotë të Shqipërisë (bashkimin dhe pavarësimin e katër vilajeteve shqiptare). Kjo ndikoi që Perandoria Osmane të dërgojë forca të mëdha ushtarake, dhe në një luftë të pabarabartë, gjatë muajve mars-maj të vitit 1881, i shtypi kryengritësit shqiptarë të Lidhjes së Prizrenit. Në këtë vazhdë, Perandoria Osmane dënoi me dënime të rënda disa prej krerëve kryesorë të Lidhjes së Prizrenit, përveç të tjerëve, udhëheqësin politik të Lidhjes së Prizrenit, Abdyl Frashërin, zëvendëssekretarin e Lidhjes së Prizrenit, Shuaip Agë Spahiun etj.[81] Megjithëkëtë, fryma e Lidhjes së Prizrenit s'u shua, por ndikoi që Lëvizja Kombëtare Shqiptare të riorganizohet, fuqizohet dhe masivizohet edhe më shumë.

Faza C e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare

Faza e tretë c, e lëvizjeve kombëtare, është faza e masave /masivizimit, dhe nënkupton se një shumicë e një populli arrin të ketë një identitet kombëtar. Kjo fazë arrihet konkretisht kur jo domosdoshmërisht i tërë populli, por kur shumica e një populli e formëson vetëdijen se është një komb. Në rastin e shqiptarëve kjo fazë fillon pas Lidhjes së Prizrenit, sepse veprimtaria dhe rezistenca e Lidhjes së Prizrenit (edhe pse u shtyp nga Perandoria Osmane), ndikoi për inkurajimin e masivizimit të ndjenjës kombëtare shqiptare, njëkohësisht shërbeu si inspirim për vazhdimin e përpjekjeve të shqiptarëve drejt pavarësimit të Shqipërisë.

Prandaj jorastësisht historiografia shqiptare i jep një rëndësi të veçantë Lidhjes së Prizrenit, por edhe studiuesit e huaj. Përveç të tjerëve, Mønnesland konsideron se para vitit 1878 shqiptarët nuk kanë qenë të karakterizuar nga një vetëdije e

[81] Malcolm 2001: 235-236

fortë e të qenit komb, por pas vitit 1878 (Lidhjes së Prizrenit) kjo gjë ndryshon radikalisht.[82]

Edhe pas Lidhjes së Prizrenit, Perandoria Osmane vazhdoi t'i refuzojë kërkesat e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për të drejtat kombëtare të popullit shqiptar. Njëkohësisht, vendet fqinje ballkanike (veçanërisht Serbia) në vazhdimësi i rritën apetitet e tyre hegjemoniste për copëtimin dhe aneksimin e territoreve të banuara me shqiptarë. Kjo situatë ndikoi për një mobilizim më masiv të veprimtarisë së Lëvizjes Kombëtare Shqiptare (duke përfshirë edhe qarqet intelektuale-patriotike të shqiptarëve në diasporë) dhe u fuqizua veçanërisht në fundvitet 1890 dhe fillimvitet 1900 si në aspektin politiko-ushtarak, po ashtu edhe në atë kulturor.

Në aspektin politiko-ushtarak rezultoi, përveç të tjerash, me Lidhjen e Pejës (1899), Komitetin për Lirinë e Shqipërisë (1905), Mbledhjen e Taksimit (1912), Kuvendin e Junikut (1912) etj. Lidhja e Pejës ishte, në fakt, një kuvend kombëtar, ku morën pjesë rreth 500 përfaqësues nga pothuajse të gjitha anët e Shqipërisë. U organizua në janar të vitit 1899, në krye me klerikun patriot mysliman Haxhi Zekën, ish-anëtar i këshillit qendror i Lidhjes së Prizrenit. Ky kuvend ishte një vazhdimësi e kërkesave të Lidhjes së Prizrenit për bashkimin e katër vilajeteve shqiptare në një njësi kombëtare shqiptare. Në këtë vazhdë Komiteti për Lirinë e Shqipërisë i themeluar në Manastir në vitin 1905 e pati një ndikim të rëndësishëm për organizimin dhe koordinimin e kryengritjeve të shqiptarëve, në nivel kombëtar:

> Ndonëse kryengritjet popullore me karakter lokal vazhduan, tipari themelor i lëvizjes kombëtare të viteve 1905-1908 ishte fillimi i organizimit të saj në përmasa kombëtare, vendosja e një drejtimi të njëjtë, që realizohej nga komitetet "Për lirinë e Shqipërisë" si dhe krijimi i çetave të armatosura të cilat merreshin me përhapjen e ideve të çlirimit kombëtar dhe me përgatitjen e popullit për kryengritjen e përgjithshme. Komiteti Qendror "Për lirinë e

[82] Mønnesland 2006: 145-146

> Shqipërisë" hartoi edhe Rregulloren e çetave (Udhë-Rrëfenjësi i Trimave, Komiteti i Shqipërisë) ku, krahas programit politik kombëtar, përcaktoheshin edhe rregullat e organizimit nga komitetet e pleqësitë të zgjedhura prej tyre, të "trupave të armatosura" siç quheshin çetat në këtë dokument (*Historia e popullit shqiptar II*, 2002: 321).

Çeta e parë u themelua në prill të vitit 1906, në krye me Bajo Topullin (vëllai i kryengritësit të spikatur të çetave shqiptare të jugut të Shqipërisë, kapedan Çerçiz Topullit), më pastaj u shumëfishua numri i çetave shqiptare, duke përfshirë edhe çetat që kishin qëllimet e njëjta patriotike në Kosovë dhe në viset e tjera të banuara me shqiptarë[83]. Ndërsa Mbledhja e Taksimit, e udhëhequr nga Ismail Qemali, (e mbajtur në lagjen Taksim të Stambollit më 12 janar 1912), dhe pas disa muajsh Kuvendi i Junikut, i udhëhequr nga Hasan Prishtina (që i zhvilloi punimet në fshatin Junik, në veriperëndim të Gjakovës, më 21-25 maj 1912), e patën ndikimin e drejtpërdrejtë për inkurajimin e kryengritjes më të fuqishme të shqiptarëve (që nga periudha e Lidhjes së Prizrenit), kundër Perandorisë Osmane. Kjo kryengritje filloi në pranverën e vitit 1912 në Kosovë dhe u udhëhoq nga disa ndër komandantët e shquar: Isa Boletini, Mehmet Deralla, Bajram Curri, Idriz Seferi etj.

Prapavija konkrete e kësaj kryengritjeje ishin 14 kërkesat e shqiptarëve, të ashtuquajturat "14 pikat" e Hasan Prishtinës, që fillimisht nuk u morën parasysh nga Perandoria Osmane. Hasan Prishtina ishte tashmë një figurë shumë e njohur, duke e marrë parasysh kontributin i tij në kuadër të hapjes së shkollave shqipe dhe fjalimet e tij në Parlamentin e Stambollit, në kuadër të grupit opozitar të kryesuar nga Ismail Qemali. Shumica e këtyre kërkesave ishin në përputhje me kërkesat e Abdyl Frashërit gjatë viteve 1877-1878 për të drejtat kombëtare të shqiptarëve. Ngjashëm sikurse Abdyl Frashëri, Hasan Prishtina ishte një intelektual përparimtar, por i duhej t'i përshtaste kërkesat politike në raport me disa udhëheqës konservatorë

[83] *Historia e Popullit Shqiptar II,* 2002: 321-322

shqiptarë[84] në kuadër të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Kjo kryengritje e fuqishme e shqiptarëve e pranverës së vitit 1912 kundër Perandorisë Osmane i inkurajoi edhe vendet fqinje. Në lidhje me këtë, Malcolm, përveç të tjerash, shkruan:

> "Kjo ishte pika kulminante e të gjitha luftimeve të ndryshme për njohjen kombëtare të shqiptarëve që nga viti 1878. Më në fund ishte arritur pajtimi për formimin e një shteti shqiptar brenda Perandorisë Osmane, në të cilin do të zhvilloheshin me kohë institucionet e kulturës kombëtare si dhe institucionet e tjera kombëtare shqiptare. Por, nuk kishte kohë. Brenda dy muajsh osmanët do të dëbohen nga pothuajse të gjitha territoret e tyre evropiane dhe, ç'është e drejta, vetëm kryengritja shqiptare e vitit 1912 i kishte bindur shtetet e Ballkanit se kishte ardhur koha për një luftë kundërosmane, ndërkohë osmanlinjtë ishin të dobësuar aq shumë saqë lufta u fitua me shpejtësi. Sikundër që ka vënë në dukje gjashtë vjet më pas në memorandumin e tij për shqiptarët, udhëtari dhe politikani anglez Obri Herbert: "Më në fund si Samsoni në Tempullin e Gazës, ata i shembën kolonat e Perandorisë Osmane mbi kokën e tyre. Janë shqiptarët ata të cilët i shpartalluan turqit, e jo serbët, as bullgarët dhe as grekët" (Malcolm 2001: 259).

Në aspektin kulturor, mobilizimi më masiv i veprimtarisë së Lëvizjes Kombëtare Shqiptare rezultoi, përveç të tjerash, me shumëfishimin e numrit të botimit të librave në gjuhën shqipe, duke përfshirë shtypin shqiptar (gazetat dhe të ngjashme), dhe deri në një masë shkollat shqipe. Gjithashtu, me organizimin e Kongresit të Manastirit (14-22 nëntor 1908), në krye me priftin patriot katolik Gjergj Fishta etj., ku u vendos për njësimin e alfabetit të gjuhës shqipe. Në këtë kongres ishin të pranishëm 150 delegatë nga të gjitha anët e Shqipërisë, si dhe nga qarqet e diasporës shqiptare në Rumani, Itali, Greqi, Turqi, Egjipt, Amerikë etj. Në kuadër të kësaj veprimtarie të njësimit të alfabetit të gjuhës shqipe, një kontribut të veçantë ka dhënë familja Qiriazi, përkatësisht Qerasim, Gjergj, Sevasti dhe Parashqevi Qiriazi. Të njëjtin vit prifti patriot ortodoks shqiptar Fan Stilian Noli etj. arritën ta themelojnë kishën autoqefale

[84] Malcolm 2001: 256, 258

ortodokse shqiptare që, gjithashtu, shënoi një hap të rëndësishëm për unifikimin e shqiptarëve.

E gjithë kjo veprimtari politiko-ushtarake dhe kulturore e shqiptarëve pas Lidhjes së Prizrenit ndikoi që Lëvizja Kombëtare Shqiptare të marrë një karakter masiv dhe të ndikojë për fillimprocesin e masivizimit të ndjenjës kombëtare të shqiptarëve në kuadër të fazës c, që arriti pjesërisht të realizohet gjatë një periudhe 30-vjeçare. Përkatësisht që nga periudha e pas Lidhjes së Prizrenit deri në vitin 1912, ku edhe kulmon realizimi i pjesshëm i fazës c, me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912. Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë (me delegatët dhe me ministrat e Qeverisë së Përkohshme nga të gjitha krahinat shqiptare, në krye me Ismail Qemalin, Luigj Gurakuqin, Isa Boletinin etj.)., përfshiu të gjitha trojet shqiptare të banuara me shumicë shqiptare dhe vetëdijesoi (nëse jo të gjithë) shumicën e popullit shqiptar, se i takon një kombi të përbashkët.

Vlen të theksohet se në rastin e shqiptarëve, faza a dhe b, identifikohen edhe me vazhdimësinë e ndërlidhur të krijimtarisë folklorike në lidhje me ngjarjet historike, veçanërisht nëpërmes këngëve të epikes historike që, në fakt, shtohen edhe më shumë gjatë fazës c në kuadër të masivizimit të ndjenjës kombëtare shqiptare:

> Epika historike shqiptare, e krijuar gjatë Rilindjes Kombëtare, në rend kronologjik grupohet në tri etapa: a) Këngët e viteve 1831-1847; b) ato të gjysmës së dytë të shek. XIX, me pikë kulmore ngjarjet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit; c) këngët për ngjarjet që vijojnë deri në shpalljen e pavarësisë. Grupi i parë zë fill me pasqyrimin e njërës prej kryengritjeve të fshatarësisë të trevave të jugut më 1831 (Leskovik, Kolonjë, Përmet, Tepelenë), vijon me veprimet sulmuese kundër administratës së pushtuesit më 1833-1834 (Delvinë, Tepelenë e Berat), me kryengritjen e armatosur të Kosovës (1833), me luftimet për të mos lejuar zbatimin e ligjeve centralizuese më 1844-1845 (Shkodër, Dibër, Çermenikë, Malësi e Gjakovës, Prishtinë etj.), deri te çasti i rëndësishëm i vitit 1847, kur në jug të vendit pati kryengritje popullore të përgjithshme me shumë jehonë kundër administratës osmane. Nëpërmjet këngëve popullore

përcillen skena të tëra, ku pasqyrohet tabloja e gjendjes politike e shoqërore e kohës. Shohim në to kushtrimet popullore, dhënien e besës, ngritjen e gatishmërinë e shtresave të gjera popullore për t'u hedhur në sulme dhe për të sakrifikuar në luftë kundër pushtuesit: "Melesini maja maja, / E rreh topi e kumbaraja…/ Kjo kisha me një kamare, / Nizamët i shojti fare"; Shkodra të vetën e bani, / I erdh hakut Osmanllisë"; "Kurvelesh, krie të ngrini, / Gra e burra armë vini, / Anën e detit të zini, / Se na pllakosi qafiri"; "Kur të çahen kullat tona, / Plot me gjak dirgjet Valbona"; "Shqipëria anembanë / U ngren'e një fjalë thanë: / - Mbretit s'i apëm nizamë". Në këto këngë, krahas figurave shumë të njohura, si Zylyftar Poda, Zenel Gjoleka, Tafil Buzi, Çelo Picari etj., dalin edhe një varg personazhesh të tjera të spikatura në luftime të ndryshme, si Zenel Xhafoja, Balili i Xhixhisë, Sinan Maloja, Labë Duka etj.

Këngët e etapës së dytë gjatë Rilindjes Kombëtare pasqyrojnë jehonën e lëvizjeve të mëtejshme kundër pushtuesve osmanë, por edhe një temë të re, siç ishte ajo e mbrojtjes së tërësisë tokësore të atdheut nga synimet dhe përpjekjet e qarqeve shoviniste fqinje me nxitjen e Fuqive të Mëdha të kohës. Kalojnë nëpërmjet këngëve historike pamje tragjike, si shpërnguljet e shqiptarëve nga Leskovci, Prekupla, Vranja (1877-1878) etj.: "Oh, muhaxhirt, o bre, kah po shkojn-e, / Dru e gur, bre, ç'po vajtojn-e". Gjendja e vështirë për popullin tonë gjatë viteve 1875-1878, e krijuar nga Kriza Lindore, me pikë kulmore Kongresin e Berlinit, përshkallëzoi qëndresën dhe i nxiti shqiptarët ta organizojnë luftën për mbrojtjen e tërësisë tokësore të vendit. Idetë e mëdha të Rilindjes tingëlluan me forcë të veçantë në këngët epike kushtuar Lidhjes së Prizrenit (1878-1881), në të cilat përjetësohet njëkohësisht qëndresa e pashembullt e popullit shqiptar kundër shteteve shoviniste fqinje për mbrojtjen e tërësisë së tokave shqiptare, si dhe lufta e tij për autonominë e vendit kundër ushtrisë osmane të Dervish Pashës. Këngët për Lidhjen Shqiptare shprehin veçoritë dhe idetë e reja të kësaj epoke: formimin e ndërgjegjes kombëtare të popullit shqiptar, karakterin e përgjithshëm mbarëshqiptar të luftës së Lidhjes, idenë e saj të madhe të bashkimit kombëtar të të gjithë shqiptarëve pa dallim feje e krahine. U krijuan atëherë shumë këngë për ngjarjet dhe për personazhet aktive të tyre, të pasuruara me një numër risish ideo-estetike. Mund të përmendet, ndër të tjera, përfshirja në kryengritje e pothuajse të gjitha mjediseve shqiptare, me vetëdijen e plotë se luftohej për t'i mbrojtur interesat e larta të popullit e të atdheut. Në këngët popullore theksohet se në këtë luftë *"ngrihet në këmbë e tanë shqiptaria", "se jena nis m'uba milet (komb)"* etj. Gjerësinë e luftës së Lidhjes dhe veçanërisht pjesëmarrjen në Kuvendin e Gjirokastrës

(1880) të përfaqësuesve të të gjitha viseve shqiptare të Veriut e të Jugut, poeti popullor e jep në këto vargje: *"Kurvelesh e Gegëri, / ç'u mblodhën në Egjëri"*. U krijuan cikle këngësh për ngjarjet sa historike aq edhe dramatike që ndodhën në vitet 1878 deri 1881. Të tilla ishin, midis të tjerash, këngët për mbrojtjen e Plavës e të Gucisë, të Hotit, të Grudës e të Ulqinit. Në të gjitha këto beteja shpërtheu bindshëm forca e qëndresës së vendosur shqiptare, një solidaritet i paparë që shprehte unitetin kombëtar. Kudo shfaqet heroizmi masiv, por veçohen nga këngët edhe trimat e paepur, si Zhuj Selmani e Jakup Feri, Sadik Hamza e Çel Shabani etj.: *"Te bjen dielli e praron hana, / Zhuj Selman nuk ban ma nana"; "Jakup Feri, zok sokolit, / Met shehit në ball' t'llogorit"*.Në të njëjtën kohë, edhe ndaj pushtuesve osmanë u mbajt i njëjti qëndrim sfidues me armë në dorë. Nën udhëheqjen e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit shpërthyen kudo kryengritje të armatosura, qëndresa u bë masive. Vrasja e mareshalit turk Mehmet Ali pashë Maxharit në Gjakovë në shtator të vitit 1878, paralajmëroi që populli shqiptar ishte i vendosur për të ecur në rrugën drejt lirisë. Në këngët kushtuar betejave historike të shqiptarëve në Kosovë kundër ushtrive të Dervish Pashës, pasqyrohet heroizmi dhe guximi i luftëtarëve popullorë kosovarë që u mbërthyen *"fyt më fyt me armikun",* që nuk sprapseshin para ushtrive osmane edhe pse merrnin nga *"shtatë plumba për shtat",* që qëndronin krenarë edhe kur e kishin litarin në grykë si Sef Kosharja: *"Sef Kosharja, trim i fisit, / Hije t'paska maja e lisit. / Hije m'ka, o djemt e mi, / Kam dhanë jetën për Shqipni"*. Spikasin në këngët historike për këtë periudhë personazhe me karakteristika vetjake, por me rrezatim të gjerë kombëtar, si Abdyl Frashëri, Ymer Prizreni, Mic Sokoli, Sef Kosharja, Ali Ibra, Çun Delia etj.: *"Mic Sokoli ban me dorë: / -Besa shok', nuk muj me fole, / Se m'ka ra do gjak në gojë, / Se m'ka ra do gjak në bark, / Shtat' martina i kam në shtat"*.

Ndonëse Lidhja Shqiptare e Prizrenit u thye ushtarakisht, veprimtaritë dhe idetë e saj ngjallën e ruajtën dëshirën dhe shpresën e popullit shqiptar për autonomi e për pavarësi. Ato u bënë shtysë e fuqishme për vazhdimësinë e përpjekjeve të pareshtura deri në arritjen e shpalljes së pavarësisë. Në këngë të ndryshme pasqyrohen njëra pas tjetrës ngjarjet e zhvilluara në Dibër (1881) kundër qeveritarëve turq, kryengritja e malësorëve të Shkodrës (1883), ajo e Kosovës me Sulejman Vokshin e Ali Ibrën në krye kundër Vesel Pashës (1885), luftimet e Dibrës kundër Memduh Pashës (1884), Lidhja e Pejës, luftimet e kosovarëve kundër Çekrez Pashës, përleshjet e shpatarakëve me forcat turke, luftimet e zhvilluara kundër trupave të Shemsi Pashës në Kosovë (1903-1904), kryengritja e Kurbinit dhe e Krujës (1906-1907) etj. Këngët historike pas Lidhjes

së Prizrenit deri në shpalljen e pavarësisë përcjellin frymën liridashëse të popullit shqiptar që gjithmonë u gjend në luftëra me karakter mbrojtës çlirimtarë. Një gjë e tillë shihet në rend kronologjik te këngët që pasqyrojnë ngritjen e çetave të para kombëtare dhe veprimet e tyre të armatosura (1906-1908). Aksionet e tyre konceptohen nga këngëtarë popullorë si pjesë e luftës së përgjithshme për çlirim kombëtar: *"Lule Çerciz Topulli, / Vulose për Shqipëri".* Kënga historike pasqyron gjithashtu artistikisht kryengritjet e gjera kundërosmane në vitet 1910-1912. Janë kënduar kryengritjet dhe luftërat e popullit shqiptar kundër ekspeditave famëkeqe turke të kryesuara nga Shemsi Pasha e veçanërisht nga Shefqet Turgut pasha. Krahas mizorisë së pushtuesit, në këngët e ndryshme spikat heroizmi i luftëtarëve në Kaçanik, Carralevë, Boletin, ngado në Kosovë, në Malësi të Madhe, në Zadrimë, në Mirditë, në Himarë etj. Dalin me madhështinë e tyre figurat e udhëheqësve popullorë, si Idriz Seferi, Dedë Gjo Luli, Mehmet Shpendi, Isa Boletini, Hasan Prishtina, Bajram Curri etj., por edhe dhjetëra e qindra luftëtarë të tjerë në shërbim të lirisë. Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor të vitit 1912, si një kurorëzim i gjithë epokës së Rilindjes, gjeti gjithashtu pasqyrim në këngët popullore. Cikli i këngëve për shpalljen e pavarësisë shpreh fuqishëm vendosmërinë e përfaqësuesve të popullit shqiptar të mbledhur në Kuvendin e Vlorës për ta hedhur poshtë zgjedhën osmane, për ta përmbushur aspiratën shekullore të popullit, për ta bërë Shqipërinë të lirë e të pavarur. Përfaqësuesit e të gjitha krahinave shqiptare, me Ismail Qemalin në krye, shpallin hapur dëshirën dhe vullnetin e kombit shqiptar për të qenë i pavarur: *"Nuk ka vent këtu Turqia, / Ja të vdesim, ja të rrojmë, / Ësht' e jona Shqipëria!"*. (*Historia e popullit shqiptar II*, 2002: 363-365).

Përfundim

Gellner, Anderson, Hobsbawm, Smith dhe Hroch janë disa ndër kontribuuesit më të spikatur në kuadër të studimeve moderne të nacionalizmit. Në veçanti Smith ka qenë më i përkushtuari në këtë drejtim dhe ka kontribuar për një qasje më të nuancuar, tashmë e mirënjohur si qasja etnosimboliste. Smith distancohet nga pikëpamja primordialiste (që i përkufizon kombet si fenomene natyrore) duke e cilësuar si pikëpamje a-historike dhe a-teorike, pajtohet me modernistët se kombet janë fenomene moderne, por jo në kuptimin se kombet moderne janë të konstruktuara nga asgjëja dhe as si rezultat i domosdoshëm i historisë. Gjithashtu, pajtohet me perenialistët se është e mundur të gjenden gjurmët e disa etnive në disa kultura, thellë në histori, por nuk pajtohet se kombet janë fenomene që kanë qenë të pranishme gjatë tërë historisë. Në këtë mënyrë Smith pozicionohet në mes të modernizmit dhe perenializmit, duke u pajtuar se kombet janë fenomene moderne, por duke insistuar se kombet i kanë rrënjët në etnitë paramoderne, në kuptimin transformativ.

Relacioni transformativ nga etnitë në kombe nuk është një domosdoshmëri, sipas Smith, por nënkupton se disa etni i kanë ruajtur dhe zhvilluar me kalimin e kohës identitetet kolektive kulturore, dhe se këto identitete reprezentojnë një lloj kontinuiteti duke u bërë bazë për kombformimet, gjatë epokës së nacionalizmit. Kjo nuk nënkupton se për çdo komb duhet të ketë qenë një etni e mëparshme që i ka shërbyer si bazë e vetme (sepse kombet e tilla janë numerikisht më pak), por kjo nënkupton se kombet janë zhvillime të specializuara e një ose më shumë grupeve të lirshme etnike, dhe se bashkësia etnike ka shërbyer historikisht si modeli dhe baza e shumë kombeve. Kjo, gjithashtu, shpjegon pse etnia është një forcë kaq e fuqishme në botën moderne, dhe pse kaq shumë kombe janë apo kërkojnë për t'u formuar në bazë të etnive dominuese ose së paku përpiqen ta arrijnë atë sens të unifikimit kulturor dhe të intimitetit që etnia e furnizon. Njëkohësisht Smith e precizon

se konstituimi i etnive nuk është i bazuar në linjat e prejardhjes fizike, por në radhë të parë në linjat e afërsisë kulturore, në kuptimin e sendërtimit/mishërimit mbi mitin e prejardhjes së përbashkët, kujtesën historike, simbolet, vlerat etj., dhe kjo përveçse e përcakton strukturën e bashkësive etnike, vlen për çdo komb të krijuar mbi bazën e afërsisë kulturore. Rrjedhimisht, sipas Smith (si përfaqësuesi më i spikatur i qasjes etnosimboliste), shpërfillja dhe mosnjohja e implikimeve të etnisë në raport me kombin, ka qenë pengesë për zhvillimin e studimeve moderne të nacionalizmit.

Gellner dhe Anderson pothuajse aspak nuk i kanë dhënë rëndësi lidhjes në mes të etnive dhe kombeve moderne. Ndërsa Hobsbawm, nëpërmes termit "traditat e shpikura", mëton të ç'vlerësojë këtë lidhje, njëkohësisht nuk arrin të japë një përgjigje të plotë dhe të qartë. Prandaj, mund të shtrojmë dy pyetje kritike në lidhje me qasjen teorike të Hobsbawmit:

Pse gjatë procesit të kombformimeve (nga ana e popullit) ka pasur respons, simpati dhe kuptueshmëri për "traditat e shpikura"? Cila është arsyeja që populli unifikohet rreth këtyre "traditave të shpikura"?

Përgjigjja se dikush i shpikë traditat dhe ato futen automatikisht në përdorim në fillim të procesit të kombformimit, është shpjegim i pamjaftueshëm dhe rrjedhimisht jobindës. Më tutje mund të shtojmë se edhe po qe se e interpretojmë Hobsbawm, se termi i tij "traditat e shpikura", i përfshin pjesërisht që të dyja, fabrikimin dhe konstruktimin (në kuptimin se traditat janë pjesërisht të fabrikuara/false, dhe se traditat gjatë konstruktimit inkludojnë pjesërisht në vete edhe elementet paranacionale), megjithëkëtë nuk e kemi zgjidhur këtë paqartësi, sepse lind një pyetje tjetër që ka të bëjë me intencën/qëllimin dhe drejtimin kausal:

A kanë menduar "shpikësit e traditave" (elitat) t'i shpikin traditat me qëllim për të krijuar një unitet, apo i kanë shpikur traditat që kanë simbolizuar (që janë bazuar në) një unitet prezent?

Nëse qëllimi i shpikjes së traditave ka qenë për të krijuar një unitet, atëherë drejtimi kausal shkon nga "traditat e shpikura" tek uniteti dhe kjo nënkupton se "traditat e shpikura" (kombet) janë të shkëputura krejtësisht nga e kaluara historike paranacionale. Por nëse traditat janë përdorur për të simbolizuar një unitet prezent (ose kanë marrë pikënisje në një unitet prezent), atëherë drejtimi kausal shkon nga uniteti prezent te "traditat e shpikura" dhe kjo nënkupton se "traditat e shpikura" (kombet) nuk janë (krejtësisht) të shkëputura nga e kaluara historike paranacionale.

Sidoqoftë, mund të konkludohet se dallimi kryesor në mes të Hobsbawm dhe Smith, në lidhje me të kaluarën historike (etninë), në relacion me kombformimet, është se, sipas pikëpamjes teorike të Hobsbawmit, e kaluara historike nuk vazhdohet ose nuk trashëgohet, por e kaluara historike funksionon si "material i papërpunuar historik" ose si "material ndërtimi historik", ku elitat kanë mundur t'i përzgjedhin gjërat që iu nevojiten për konstruktimin e kombeve. Ndërsa, sipas pikëpamjes teorike të Smithit, e kaluara historike (etnia) e ka të inkluduar edhe elementin subjektiv, dhe ky element subjektiv ka vazhduar në kuptimin e kontinuitetit transformues, i karakterizuar nga ndërlidhja në mes etnisë dhe kombit.

Në rastin e shqiptarëve bazuar, përveç të tjerash, në historianë, gjeografë, poetë dhe dramaturgë të hershëm dhe në studiuesit e tjerë të kohës së mëvonshme, të cilëve iu referohet studiuesi Edwin Jaqcues, mund të konkludohet se etnia shqiptare (që nga lashtësia) e ka një vazhdimësi të gjatë historiko-kulturore, veçanërisht linguistike. Njëkohësisht, kjo vazhdimësi etnike e shqiptarëve (si kategori etnike dhe si bashkësi etnike) i përmbush kriteret e qasjes etnosimboliste. Përkatësisht kriterin e kontinuitetit kulturor, kriterin e ripërsëritjes/rishfaqjes së identitetit kulturor, dhe kriterin e riinterpretimit gjatë epokës së nacionalizmit (epokës së kombformimeve). Gjithashtu, në rastin e shqiptarëve kriteri i tretë, riinterpretimi, përputhet edhe me skemën a, b, c të Miroslav Hrochut, në lidhje me periodizimin

e procesit të kombformimeve nëpërmes tri fazave të lëvizjeve kombëtare. Rrjedhimisht, Lëvizja Kombëtare Shqiptare, gjatë fazës së parë (a), arriti ta influencojë dhe ta inkurajojë bashkësinë etnike shqiptare me idenë kombëtare shqiptare. Gjatë fazës së dytë (b) arriti ta transformojë idenë kombëtare shqiptare në projektin kombëtar shqiptar, që kulmoi me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878). Dhe gjatë fazës së tretë (c) e transformoi projektin kombëtar shqiptar të Lidhjes së Prizrenit në një lëvizje të masave dhe rrjedhimisht në kombin shqiptar. Shpallja e Shqipërisë shtet i pavarur dhe sovran më 28 nëntor 1912 (e cila shpallje e përfshiu edhe Kosovën me vise), i dha njëkohësisht vulën përbashkuese kombit shqiptar, si në kuptimin e relacionit në mes shqiptarëve (shumicës së tyre) si anëtarë (më pak ose më shumë) të vetëdijesuar se i takojnë një kombi të përbashkët, ashtu edhe në kuptimin e relacionit në mes kombit shqiptar (si njësi kulturore dhe si realitet sociologjik) në raport me kombet e tjera. Me fjalë të tjera, nacionalizmi sekular shqiptar prej fillimviteve 1800 deri në fillimvitet 1900 (përafërsisht 100 vjet) nëpërmes 3 fazave a, b, dhe c e transformoi etninë shqiptare në kombin shqiptar si njësi kulturore të përbërë nga: gjuha si kriter objektiv, historia si kriter "subjektiv" dhe harmonia ndërfetare si vlerë humane dhe kombëtare. Kjo njësi kulturore me këto kritere dhe vlera, prej vitit 1912 e këtej, u bë vetëdije dhe ndërgjegje kombëtare shqiptare.

Për dallim nga vendet fqinje, ku nacionalizmi u ngrit kryesisht mbi bazën religjioze (Serbi, Greqi, Bullgari etj.), nacionalizmi shqiptar, duke qenë më shumë i inspiruar nga idetë kombformuese të shteteve perëndimore, dhe për shkak të rrethanave historike, u ngrit kryesisht mbi bazën e sekularizmit të moderuar, bazuar në histori, gjuhë, dhe harmoninë/respektin ndërfetar. Prandaj, krahasuar me kombet fqinje që janë më të mbyllura, kombi shqiptar është komb më i hapur, në kuptimin e përmbajtjes kombëtare me një nivel më të lartë të voluntarizmit, sepse një fe e caktuar nuk është kriter gjithëpërfshirës dhe përjashtues i të qenit anëtar i kombit shqiptar. Madje si anëtar i kombit shqiptar cilësohen dhe pranohen të gjithë pasardhësit

pellazgë-ilirë-shqiptarë që, për shkak të rrethanave historike, janë detyruar të asimilohen gjuhësisht, por që kanë arritur ta ruajnë kujtesën për të kaluarën dhe trashëgiminë e tyre, dhe që kanë interesim të mësojnë - komunikojnë edhe në gjuhën shqipe. Vlen të theksohet, gjithashtu, se kjo përmbajtje goxha voluntariste kombëtare shqiptare krijon njëkohësisht mundësi për një integrim më të balancuar të minoriteteve etnike në Shqipëri dhe Kosovë si në kuptimin e ruajtjes të identitetit të minoriteteve etnike, dhe sidomos në kuptimin e mundësisë më të lehtë që minoritetet etnike t'i përshtaten majoritetit shqiptar.

KREU II

NACIONALIZMI SHQIPTAR PAS VITIT 1912 (vazhdimi i fazës c)

Hyrje

Në kuadër të literaturës akademike shqiptare në lidhje me nacionalizmin shqiptar, pothuajse aspak s'është zbatuar skema abc e Miroslav Hroch. Ndërsa nga studiuesit e huaj, më e njohura për zbatimin e kësaj skeme në lidhje me nacionalizmin shqiptar është historiania Nathalie Clayer. Gjithashtu, deri në një masë edhe historiani Robert Austin, i cili e zbaton pothuajse arbitrarisht këtë skemë, thotë se shqiptarët kanë qenë ende në fillimet e fazës a në kohën kur u fitua pavarësia e Shqipërisë (1912)[85]. Për dallim nga Austini, Clayer konstaton se faza c ka filluar në Shqipëri në vitet 1920, dhe për shqiptarët jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë (në ish-Jugosllavi), pas vitit 1945, duke u fokusuar: në ngritjen e një rrjeti të shkollave shqiptare, në konkurrencën në mes të shqiptarëve të Kosovës dhe të Maqedonisë me kombet dhe kombësitë të tjera në ish-jugosllavi, dhe në përpjekjet e shqiptarëve për ta transformuar krahinën e Kosovës në Republikën e Kosovës, në kuadër të ish-Federatës Jugosllave. [86] Megjithëkëtë, edhe konstatimi i historianes Clayer nuk mund të konsiderohet krejtësisht i saktë ngaqë faza c, në rastin e shqiptarëve (siç është argumentuar edhe në kreun e parë të këtij libri), fillon pas Lidhjes së Prizrenit (1878-1881) dhe pjesërisht përmbushet deri në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë (1912). Në këtë vazhdë, pas vitit 1912 (e sidomos pas Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore), nga njëra anë, vazhdimësia e përmbushjes së mëtutjeshme e fazës c, për shqiptarët brenda kufijve shtetërorë të Shqipërisë, karakterizohet

[85] Austin, 2004: 239
[86] Clayer, 2009: 137, 648

nga forcimi i institucioneve shtetërore, duke përfshirë sistemin arsimor, standardizimin e gjuhës, shtypin e shkruar, radio-televizionin etj. Veçanërisht, Universiteti i Tiranës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë etj. kanë pasur ndikim të rëndësishëm për masivizimin e ndjenjës kombëtare shqiptare në kuadër të fazës c. Në kuptimin e hulumtimit shkencor kulturor-historik (gjuhës, arkeologjisë etj.), dhe distribuimit të këtyre diturive shkencore nëpërmes sistemit arsimor, shtypit të shkruar etj., madje duke pasur ndikim (deri në një masë) edhe në hapësirën shqiptare jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë. Nga ana tjetër, prej vitit 1912, deri pas Luftës së Dytë Botërore (1945), nuk ka pasur vakum socio-politik sa i përket vazhdimit të masivizimit të ndjenjës kombëtare për shqiptarët jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë (në ish-Jugosllavi), siç lë të kuptohet historiania Clayer, sepse përpjekjet e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për Çlirimin e Kosovës me vise nga Serbia (dhe më pastaj nga Jugosllavia) fillojnë që nga viti 1912, dhe jo vetëm pas vitit 1945. Dhe këto përpjekjeje (që në kohë dhe hapësirë karakterizohen nga rezistenca ushtarake, politike dhe veprimtaria kulturore etj.), kanë ndikuar njëkohësisht për vazhdimësinë e masivizimit të ndjenjës kombëtare të shqiptarëve jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë (në ish-Jugosllavi). Rrjedhimisht në vijim, pas një përmbledhje të shkurtër të prapavijës historiko-politike të Kosovës deri në vitin 1912, në këtë vazhdë do të përqendrohem në ecurinë e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për Çlirimin e Kosovës në periudhën 1912-1999, që njëkohësisht sinonimizon ecurinë e pashkëputur të masivizimit të ndjenjës kombëtare shqiptare në Kosovë në kuadër të fazës c.

Prapavija historiko politike e Kosovës deri në vitin 1912

Shikuar historikisht, historiografia serbe dhe historiografia shqiptare në lidhje me historinë e Kosovës, kryesisht karakterizohen nga mospajtueshmëria për të "drejtën historike mbi Kosovën". Historiografia serbe nuk është e shqetësuar aspak

për periudhën e para pushtimit dhe sundimit serb të Kosovës, sikur të kishte qenë Kosova një trevë krejtësisht e zbrazur dhe e pabanuar para invadimit serb në Kosovë. Me fjalë të tjera, historiografia serbe e legjitimon të drejtën historike serbe mbi Kosovën (duke e konsideruar Kosovën si 'djep të serbëve'), bazuar kryesisht në periudhën e mbretërisë mesjetare serbe nga fundi i shekullit XII deri në vitin 1389. Megjithëkëtë, edhe nëse e pranojmë këtë si kriter për të "drejtën historike serbe mbi Kosovën", rezultojnë implikime të tjera. Për shembull, Bullgaria mund të pretendojë se ka më shumë të "drejtë historike mbi Kosovën", duke u bazuar se e ka sunduar trevën e Kosovës më herët, prej vitit 850 deri në fillim të shekullit XI. Gjithashtu, Turqia mund të pretendojë se ka më shumë të "drejtë historike mbi Kosovën" sesa Serbia sepse Kosova ka qenë në një periudhë më të gjatë nën sundimin e Perandorisë Osmane (1389-1912). Në lidhje me këtë qasje të historiografisë serbe në raport me Kosovën, Malcolm, përveç të tjerash, shkruan:

> "Kosova e mesjetës shpeshherë përmendet në rrethana të përgjithshme si 'djep i serbëve' sikur të kishte qenë zemra e Serbisë që nga fillimi, mirëpo realiteti është krejtësisht ndryshe. Më se 800 vjet e ndajnë arritjen e serbëve në Ballkan në shekullin VII nga pushtimi përfundimtar osman më 1450: nga këta tetë shekuj, Kosova u sundua nga serbët vetëm në dy shekujt e gjysmë të fundit që është më pak se një e treta e tërë periudhës. Khanët apo carët bullgarë e sunduan Kosovën që nga viti 850 deri në fillim të shekullit XI, ndërsa perandorët bizantinë e sunduan Kosovën deri në dekadat e fundit të shekullit XII" (Malcolm 2001: 42).

Historiografia shqiptare, duke u bazuar në vazhdimësinë e lashtë etnike të shqiptarëve, edhe në territorin e Kosovës, si territor i banuar nga popullata ilire, dhe i njohur si territor edhe gjatë sundimit të Perandorisë Romake, me emrin provinca e Dardanisë, nuk i jep rëndësi okupimit, sundimit dhe administrimit të Kosovës nga mbretëria mesjetare bullgare, mbretëria mesjetare serbe, Perandoria Osmane dhe perandoritë e tjera të

mëhershme, por i paraqet shqiptarët si trashëgues të drejtpërdrejtë historikë edhe të trevës së Kosovës.

Edhe studiues të huaj konsiderojnë se treva e Kosovës ka qenë e banuar kryesisht me popullatën shqiptare para se të pushtohet nga dyndja e sllavëve (pa marrë parasysh variacionin demografik të popullatës shqiptare në Kosovë në kohë dhe hapësirë). Përveç të tjerëve, Mønnesland konsideron se dyndja e sllavëve në Kosovë ka shkuar në dëm të shqiptarëve dhe popullatave të tjera ngaqë, sipas tij: "Në thellësinë e Ballkanit sllavët i asimiluan disa popullata, por disa sikurse shqiptarët dhe vllahët u zhvendosën lart në bjeshkë dhe arritën të mbijetojnë" (Mønnesland 2006: 31).

Pas invadimit në Ballkan serbët u organizuan në dy qendra shtetërore gjatë vitit 1000. Njëra qendër ishte Dioclea (Dukla) ose Zeta, Mali i Zi i sotëm, tjetra qendër ishte Rashka, afër Pazarit të Ri të sotëm në Serbi.[87] Malcolm konsideron se Kosova gjatë kësaj periudhe nuk ka qenë brenda qendrës shtetërore të Rashkës që kontrollohej nga serbët ngaqë, sipas tij: "Ekspansioni serb në Kosovë fillon seriozisht vetëm në fund të shekullit XII" (Malcolm 2001: 26). Më tutje, Malcolm konsideron se Beteja e Maricës në vitin 1371 është një datë më e rëndësishme historike sesa Beteja e Kosovës në kuptimin e hapjes së rrugës për pushtimin e përgjithshëm të Perandorisë Osmane në Ballkan dhe se kjo disfatë duhet të ketë pasur ndikim shumë të madh te serbët ngaqë humbën territoret më të rëndësishme të okupuara në Maqedoni.[88]

Për betejën e Kosovës në vitin 1389 ekziston një mospajtueshmëri në mes të historianëve serbë dhe shqiptarë për përbërjen e ushtrisë së udhëhequr nga Lazari. Historiografia serbe nuk i jep fare rëndësi, ose e përmend shumë pak, pjesëmarrjen e shqiptarëve në radhët e forcave ushtarake të Lazarit kundër forcave të Perandorisë Osmane, ndërsa historiografia shqiptare i jep rëndësi pjesëmarrjes së shqiptarëve në këtë

[87] Mønnesland, 2006: 89
[88] Malcolm, 2001: 59

betejë. Gjithashtu, kronikat e hershme osmane të shkruara në shekullin XV dëshmojnë se shqiptarët (por edhe etni të tjera joserbe) kanë marrë pjesë në ushtrinë e Lazarit.[89] Madje disa historianë shqiptarë pretendojnë se personi që kishte arritur të vrasë Sulltan Muratin I, dhe që më vonë (rreth gjysmë shekulli pas betejës së Kosovës) u identifikua me emrin Miloš Obilić (Millosh Kopiliqi) ka qenë nga fshati Kopiliq i Drenicës dhe ka pasur prapavijë etnike shqiptare.

Historiografia serbe pretendon se në vitin 1690, gjatë "shpërnguljes së madhe" nga Kosova, të ashtuquajtur "Velika Seoba" janë shpërngulur rreth 500 000 serbë dhe se para vitit 1690, shqiptarët kanë qenë vetëm një pakicë e parëndësishme në Kosovë. Prapavija e kësaj ngjarjeje ishte sulmi dhe dëbimi i forcave lokale osmane nga zona e Kosovës, nga një ushtri e perandorisë habsburge, në vjeshtën e vitit 1689. Në fillimvitin 1690 forcat osmane detyruan forcat austriake të tërhiqen nga Kosova dhe disa muaj më pas edhe nga shtabi i tyre në Nish dhe nga Beogradi. Bashkë me këto forca austriake ikën nga Kosova për në Hungari një numër i refugjatëve serbë së bashku me patriarkun e Pejës, Arsenije III Crnojević. Duke u bazuar në korrespondencën e patriarkut Arsenije me perandorin Leopold, Malcolm konstaton se numri i kësaj shpërngulje është tepër i stërmadhuar nga historiografia serbe ngaqë patriarku Arsenije nëpërmes një peticioni të dërguar perandorit Leopold, të cilit i kërkon ndihmë për refugjatët e ikur serbë në Hungari, përmend vetëm rreth 30 000 persona të ikur (burra gra dhe fëmijë) dhe, bazuar në një letër tjetër, dërguar trashëgimtarit të Leopoldit, përmend vetëm rreth 40 000 persona.[90] Gjithashtu ky numër i të ikurve nuk ishte vetëm nga Kosova. Në lidhje me këtë, Malcolm, përveç të tjerash, shkruan:

> "Numri më i madh i tyre me siguri duhet të ketë ardhur nga rajoni i Nishit, nga Lugina e Moravës dhe nga rajoni i Beogradit. (Krahasimi midis regjistrave osmane të taksave para dhe gjatë

[89] Po aty: 63
[90] Po aty: 144, 166-167

> periudhës 1688-90 për sanxhakun e Beogradit tregon se popullata jomyslimane atje kishte rënë në shtatë të tetat e numrit). Edhe pjesët e tjera të Serbisë së Mesme duhet t'i kenë kontribuar numrit të refugjatëve, siç tregon përhapja gjeografike e parisë serbe që ishte mbledhur atje në qershorin e vitit 1690, siç dëshmojnë edhe provat e tjera. Prandaj, është vështirë për t'u besuar se një e katërta e numrit të përgjithshëm të refugjatëve kishte ardhur nga Kosova. S'ka dyshim se shumë sish kishin ikur dhe shumë sish, të cilët u orvatën të udhëtonin nga largësitë e mëdha, duhet të kenë vdekur rrugës, disa ndoshta ishin strehuar nëpër kodra e bjeshkë, ashtu siç kishin bërë edhe në kohët e mëparshme të krizave, në mënyrë që herët a vonë të ktheheshin në shtëpitë e tyre. Dhe, ndër ata të cilët arritën deri në Hungari, një pakicë (ndoshta e vogël) përbëhej nga katolikët sllavishtfolës ose nga katolikët shqipfolës, ose nga myslimanë shqipfolës ose edhe nga sllavët myslimanë. Toma Raspasani, duke shkruar, më 1693, për katolikët e Kosovës, thekson se shumica syresh kishin shkuar në një rajon të Budapestit, "ku pjesa dërrmuese kishin vdekur, disa nga uria e të tjerët nga sëmundjet". Raportet ushtarake austriake përmendin "arnautët në shërbimin perandorak" në dhjetorin e vitit 1690 dhe në marsin e vitit 1691, kurse në një dokument të shkurtit të vitit 1693 thuhet se në ishullin e Sant Andresë ndodhej "një numër i madh i rashkasve, ndër të cilët kishte edhe turq (myslimanë)". Këta myslimanë dhe shqiptarë proaustriakë kam përshtypjen se meritojnë një mirënjohje më të madhe nga librat e historisë se deri tashti" (Malcolm 2001: 167-168).

Historiografia serbe nuk merr parasysh migrimet e ngjashme të popullatave të tjera në Ballkan sikurse rasti i serbëve në vitin 1690, veçanërisht tkurrjet, asimilimin dhe migrimet e shqiptarëve gjatë historisë si pasojë e pushtimeve dhe sundimeve që nga antikiteti, përfshirë edhe shpërnguljet e mëvonshme të shqiptarëve (pas vdekjes së Gjergj Kastriotit Skënderbeut), në Itali, Rumani, Bullgari, Ukrainë etj. Në lidhje me eksodin e shqiptarëve pas vdekjes së Skënderbeut (1468), studiuesi Roel Schuyt, përveç të tjerash, shkruan: "Eksodi shqiptar në Itali dhe Rumani në një farë mase mund të krahasohet me *velikaseoba* -

Shpërngulja e Madhe - më 1690" [91]. Gjithashtu, vlen të theksohet se trashëgimia e kishave ortodokse në Kosovë nuk është vetëm trashëgimi serbe, por edhe trashëgimi e shqiptarëve si popullatë autoktone në Kosovë. Dhe, njëkohësisht, duhet të kihet parasysh se kombi shqiptar si tërësi, është komb multifetar, ku një pjesë e konsiderueshme e shqiptarëve kanë përkatësi fetare ortodokse. Prandaj, konflikti i mëvonshëm shqiptarët vs Serbia në periudhën 1878-1999 nuk mund të shkurtohet në një konflikt fetar. Edhe pse, fatkeqësisht, politika shtetërore serbe (që nga hyrja në epokën e nacionalizmit), e ka keqpërdorur në vazhdimësi kishën ortodokse serbe, në kuadër të propagandës stigmatizuese ndaj të tjerëve, veçanërisht ndaj shqiptarëve.

Më 3 mars 1878 u nënshkrua Traktati i Paqes (Traktati i Shën Stefanit), në mes të Rusisë dhe Perandorisë Osmane. Ky traktat nuk i përfshiu shqiptarët dhe parashihte që gati gjysma e territoreve të banuara me shqiptarë t'u jepen shteteve të sapoformuara (Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë etj.), që njëherësh ishin aleate të Rusisë, ose nën ndikimin e saj, ndërsa pjesa tjetër e territoreve të banuara me shqiptarë të mbetej nën sundimin e Perandorisë Osmane. Kjo rritje e hegjemonisë ruse në Ballkan, nëpërmes aleatëve të saj, Serbisë etj., i shqetësoi fuqitë e mëdha (Gjermaninë, Austro-Hungarinë, Francën, Italinë dhe Britaninë e Madhe) dhe rezultoi me organizimin e Kongresit të Berlinit (që u mbajt gjatë muajve qershor-korrik 1878) për ta rishikuar Traktatin e Shën Stefanit.

Gjatë periudhës 1877-'78 forcat serbe dëbuan masivisht shqiptarët nga territoret e tyre indigjene. Deri në fund të vitit 1878 numri i të dëbuarve shqiptarë arriti shifrën e 60 000 refugjatëve të vendosur në Maqedoni dhe 60 000-70 000 refugjatëve të vendosur në Kosovë. Në ndërkohë, në Kongres të Berlinit u vendos që territoret shqiptare të Nishit, Prekuples,

[91] Roel Schuyt: (s. a.): *Greeks, Albanians, Romanians and Vlachs: Antagonism and Symbiosis in the nineteenth century*, page 2: http://cf.hum.uva.nl/natlearn/Balkan/athens_schuyt.html

Kurshumlisë, Vranjës dhe Leskovcit t'i jepen Serbisë, ndërsa Malit të Zi iu dhanë zonat e Tivarit, Podgoricës, Plavë-Gucisë, Rugovës dhe Kollashinit.[92] Kjo periudhë historike shënon edhe pikënisjen e konfliktit shqiptarët vs Serbia jo në kuptimin se ky konflikt ishte një rezultat i natyrshëm i relacionit historik në mes të popullit serb dhe popullit shqiptar, të cilët në të kaluarën pothuajse gjithmonë kanë jetuar në paqe me njëri-tjetrin. Përkundrazi, shkak kryesor për këtë konflikt ishte politika shtetërore serbe e bazuar në projektin *Naçertanje*.

Projekti nacional i shtetit serb *Naçertanje* u përpilua në vitin 1844 nga ministri i Brendshëm i Serbisë, Ilija Grašanin dhe synonte formimin e Serbisë së Madhe që përfshin pjesë të Bosnjë-Hercegovinës, Malin e Zi, Kosovën, Maqedoninë, Shqipërinë veriore dhe pjesë të Kroacisë dhe Bullgarisë. [93] Ngjashëm sikurse projekti fashist i Musolinit (për ribërjen e Perandorisë Romake) dhe projekti nazist i Hitlerit (si shembujt më të spikatur të keqpërdorimit të ideologjisë nacionaliste), edhe projekti i Ilija Grašaninit dhe i pasuesve të tij, u bazua në ribërjen e Perandorisë Mesjetare Serbe të Stefan Dušanit dhe rezultoi me krime, pastrime etnike dhe gjenocid. Me fjalë të tjera, politika e shtetit serb e bazuar në *Naçertanjen* e Ilia Grashaninit dhe pasuesve të tij (Nikola Pašić, Vaso Čubrilović, Aleksandar Ranković, Slobodan Miloshević etj.), ishte shkaku dhe shtytja kryesore për raportet konfliktuoze në mes të Serbisë dhe fqinjëve të saj, e veçanërisht në mes të Serbisë dhe shqiptarëve.

Për dallim të *Naçertanjes*, projekti nacional i Lidhjes Shqiptare i Prizrenit (1878) synonte çlirimin dhe bashkimin e vilajeteve të banuara me shumicë shqiptare në një shtet dhe jo ekspansionin, asimilimin dhe pastrimin etnik të tjerëve. E ngjashme me *Naçertanjen* do të kishte qenë sikur projekti nacional i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit të synonte zgjerimin/ ekspansionin e territoreve shqiptare në përputhje me ish-territoret e dikurshme

[92] Daskalovski, 2003: 19
[93] Roe, 2005: 79

të banuara me ilirë. Me *Naçertanjen* në pikënisje mund të krahasohet projekti ekspansionist grek i ashtuquajtur "Mageli ideja" (Ideja e Madhe), i shpallur nga kryeministri Ioannis Kolettis, para asamblesë kushtetuese në Athinë në vitin 1844. Sipas historianit Richard Clogg, kryeministri Kolettis me këtë rast, përveç të tjerash, kishte deklaruar: "Mbretëria Greke nuk është e tërë Greqia, por vetëm një pjesë, pjesa më e vogël dhe më e varfër. Një vendas nuk është vetëm dikush që jeton brenda kësaj Mbretërie, por edhe ai që jeton në Janinë, në Thesali, në Serres, në Adrianopojë, në Kostandinopojë, në Trabzon, në Kretë, në Samos dhe në çdo tokë të lidhur me historinë greke ose me racën greke..." (Clogg 1992: 48).

Kongresi i Berlinit arriti ta ndalojë vetëm pjesërisht dhe përkohësisht ekspansionin e mëtutjeshëm të politikës shtetërore serbe të mbështetur nga Rusia, që synonte riokupimin e tërësishëm të Kosovës etj. Me vendimet e Kongresit të Berlinit vilajeti i Kosovës dhe territore të tjera të banuara me shqiptarë u ndan dhe Kosova me kufijtë e "tanishëm" mbeti nën sundimin e Perandorisë Osmane. Vazhdimi i sundimit të Perandorisë Osmane edhe për një kohë e pengoi copëtimin e mëtutjeshëm të territoreve të banuara me shqiptarë nga vendet fqinje. Por, njëkohësisht, e vështirësoi perspektivën politike të shqiptarëve sepse Perandoria Osmane në vazhdimësi (që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit më 1878), i kundërshtoi përpjekjet e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për formimin e shtetit shqiptar.

Kërkesat kombëtare të shqiptarëve u shtuan pas revolucionit xhonturk në vitin 1908 ngaqë xhonturqit nëpërmes "osmanizimit" që, në fakt, nënkuptonte nacionalizmin turk, ishin kërcënim për arritjen e deriatëhershme kulturore të shqiptarëve. Njëkohësisht, vendet fqinje me politikat e tyre agresive i shprehnin hapur dëshirat për zgjerimin e territoreve të tyre. Në një situatë të tillë, shqiptarët, për t'u mbrojtur, u ngritën në kryengritjen kundër turqve që filloi në Kosovë në mars të vitit 1910 dhe rezultoi me kryengritjet e tjera, duke përfshirë kryengritjen e pranverës të vitit 1912. Të njëjtin vit, më 8 tetor, shpërtheu kryengritja e popujve ballkanikë (Lufta e Parë

Ballkanike) kundër Perandorisë Osmane. Por vendet fqinje i shpërfillën dhe i sulmuan shqiptarët. Serbia, përveç Kosovës, e okupoi edhe Shqipërinë e mesme me qytetet Tiranë, Durrës, Elbasan, ndërsa Mali i Zi e okupoi Shkodrën. Rrjedhimisht, për shqiptarët tashmë ishte e qartë se plani i vendeve fqinje ishte ndarja e territorit shqiptar, duke përfshirë rrezikun e ndarjes së Shqipërisë përgjatë lumit Shkumbin, nga Serbia dhe Greqia.[94] Në këto rrethana të vështira një pjesë e konsiderueshme e elitës së Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, në krye me Ismail Qemalin, Luigj Gurakuqin, Isa Boletinin etj., e shpallën pavarësinë e Shqipërisë më 28 nëntor 1912, e cila shpallje përfshiu edhe Kosovën:

> Shpallja e Pavarësisë ishte një akt me rëndësi jetike për popullin shqiptar. Ajo, nga njëra anë, mbylli një epokë të tërë luftërash e përpjekjesh shekullore për të hequr qafe zgjedhën e huaj, për ta ruajtur tërësinë territoriale të atdheut e për ta formuar shtetin e lirë kombëtar shqiptar duke kurorëzuar veprën e Rilindjes dhe, nga ana tjetër, hapi një epokë të re, një epokë luftërash e përpjekjesh të tjera për ta mbrojtur pavarësinë e fituar nga rreziqet e jashtme e të brendshme për të siguruar bashkimin kombëtar të gjymtuar rëndë dhe për ta vendosur rendin demokratik. Ngritja e flamurit kombëtar në Vlorë përfaqësonte fitoren e përbashkët të gjitha trevave shqiptare prej Rrafshit të Dukagjinit në veri e deri në Çamëri në jug, prej brigjeve të Adriatikut e të Jonit në perëndim e deri në fushat e Kosovës, të Tetovës, në pellgun e Shkupit, në luginën e Preshevës e të Kumanovës, në lindje. Këto treva, duke marrë pjesë gjallërisht me pushkë e me penë në lëvizjen për çlirimin kombëtar, vunë gurë në themelet e pavarësisë shqiptare, i çimentuan ato me gjakun e bijve më të mirë dhe i hapën rrugën formimit të shtetit shqiptar. Kuvendi i Vlorës e shpalli pavarësinë në emër të të gjithë shqiptarëve, të të gjitha trevave shqiptare, që dërguan përfaqësuesit e tyre në të. Ai e trajtoi Shqipërinë një e të pandarë. Edhe qeveria shqiptare e Ismail Qemalit doli në rrafshin ndërkombëtar si përfaqësuese e gjithë popullsisë shqiptare dhe e të gjitha tokave shqiptare, edhe pse një pjesë e madhe e tyre ishte e pushtuar nga ushtritë e shteteve ballkanike. Edhe deklaratat e notat e protestës, që kjo qeveri u dërgoi shteteve ballkanike e komandave të tyre ushtarake,

[94] Mønnesland, 2006: 148-149

> në të cilat kërkoi largimin e menjëhershëm të forcave të huaja ushtarake nga trojet e pushtuara shqiptare dhe kthimin e tyre Shqipërisë, u bënë në emër të Asamblesë Kombëtare që përfaqësonte të gjitha trojet e banuara nga shqiptarët. Shpallja e autonomisë nga Lidhja e Prizrenit dhe ajo e Pavarësisë nga Kuvendi i Vlorës më 1912 janë dy hallkat themelore në zinxhirin e ngjarjeve të lëvizjes kombëtare, të lidhura organikisht ndërmjet tyre si shprehje e vullnetit popullor dhe si pasojë e drejtpërdrejtë e përfundim logjik i luftës çlirimtare. Por, shpallja e Pavarësisë shqiptare ishte në të njëjtën kohë një etapë më e lartë, e përcaktuar nga zhvillimi progresiv i lëvizjes dhe nga rrethanat ndërkombëtare (Historia e *popullit shqiptar II*, 2002: 511-514).

Situata e re e krijuar në Ballkan, i alarmoi fuqitë e mëdha dhe rezultoi me organizimin e Konferencës së Ambasadorëve në Londër, që filloi punimet në dhjetor të vitit 1912. Në këtë konferencë ishin të pranishëm përfaqësuesit e Britanisë së Madhe, të Austro-Hungarisë, të Gjermanisë, të Italisë, të Francës dhe të Rusisë. Qeveria serbe në krye me Nikola Pašićin synonte që Serbia ta përfshinte Kosovën dhe pjesën më të madhe të Shqipërisë së veriut deri në det. Austro-Hungaria, me të cilën pajtohej edhe Italia, ishte kundër që Serbia të bëhet një fuqi e Adriatikut. Këtij kundërshtimi të Austro-Hungarisë i dha përkrahje edhe Britania e Madhe. Në fakt, në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, Austro-Hungaria ishte pro-themelimit të një shteti shqiptar, ku përfshiheshin të gjitha territoret e banuara me shqiptarë. Por, ky qëndrim u kundërshtua nga Franca e veçanërisht nga Rusia, pastaj vazhdoi një pazarllëk me territoret e banuara me shqiptarë.[95] Për rezultatin e konferencës së ambasadorëve në Londër, Mønnesland, përveç të tjerash, shkruan:

> "Në dhjetor 1912 fuqitë e mëdha filluan një konferencë të ambasadorëve në Londër. Rusia mbështeste kërkesat e Serbisë dhe Malit të Zi për t'i aneksuar territoret shqiptare, ndërsa Austria dhe Italia ishin për krijimin e një shteti shqiptar. Britania e Madhe dhe Gjermania ishin neutrale. Fillimisht konferenca rezultoi pro

[95] Malcolm, 2001: 266-267

> autonomisë shqiptare brenda Perandorisë Osmane, por pasi që turqit humbën Maqedoninë, konferenca rezultoi pro krijimit të një shteti të pavarur shqiptar, në korrik 1913. Parashihej që Shqipëria të bëhej një monarki kushtetuese nën mbrojtjen e fuqive të mëdha. Fuqitë e mëdha refuzuan ta njihnin qeverinë e Qemalit, e emëruan një komitet të veçantë të kontrollit si autoritet suprem. Qemali u detyrua të largohet nga vendi. Çështja e kufijve krijoi probleme të mëdha. Krijimi i një shteti shqiptar nuk u përshtatej shteteve të tjera të Ballkanit që kishin plane t'i aneksojnë zonat shqiptare. Për Serbinë ishte e rëndësishme për ta marrë bregdetin shqiptar, por nuk e arriti këtë. Fuqitë e Mëdha e detyruan Malin e Zi të tërhiqet nga Shkodra. Gjëja më e rëndësishme për fuqitë e mëdha ishte për ta parandaluar hyrjen e Serbisë në det dhe ishin më pak të shqetësuar se a duhej kufijtë shtetërorë të përcaktohen në bazë të kufijve etnikë. Serbia me kokëfortësi insistonte për "të drejtën e saj historike" mbi Kosovën dhe pas presionit rus, fuqitë e mëdha lejuan që Kosova të ndahet në mes të Serbisë dhe Malit të Zi. Madje Serbia mori edhe zonat e banuara me popullsi shqiptare në Maqedoni dhe Malit të Zi iu lejua t'i mbajë zonat shqiptare. Rrjedhimisht shteti i ri nuk ishte identik me territorin etnik shqiptar. Zona të mëdha të banuara me shqiptarë nuk u përfshinë në shtetin e ri. Sipas regjistrimeve popullore turke, në vitin 1910 kanë qenë rreth 742 000 shqiptarë në vilajetin e Kosovës, rreth 60 % e popullsisë. Fuqitë e mëdha emëruan një kapiten gjerman mbret të Shqipërisë (Princ Vidi), por qëndroi vetëm për gjashtë muaj. Kushtet ishin pothuajse kaotike në shtetin e ri, që kurrë nuk pati kohë ta marrë veten në periudhën e para shpërthimit të Luftës së Parë Botërore (Mønnesland 2006: 149).

Rrjedhimisht, në Konferencën e Ambasadorëve në Londër u bë copëtimi i dytë i territoreve të banuara me shqiptarë (pas copëtimit të parë në Kongresin e Berlinit). Tashmë pothuajse gjysma e territoreve të banuara me shqiptarë (Kosova me vise dhe Çamëria), mbetën nën pushtimin e vendeve fqinje (Serbisë, Greqisë etj.). Ndërsa me insistimin e Austro-Hungarisë dhe Italisë u arrit të pavarësohet vetëm gjysma e territoreve të banuara me shqiptarë, e ashtuquajtura Shqipëria Londineze. Me fjalë të tjera, fuqitë e mëdha perëndimore nuk munden t'i rezistojnë ekspansionit të mëtutjeshëm serb të ndihmuar nga Rusia dhe kjo rezultoi me ndarjen e kombit shqiptar në dysh, ku pothuajse gjysma e kombit shqiptar mbeti nën okupimin e

vendeve fqinje si një rast unik në kontinentin evropian. Ky gjymtim i Shqipërisë konsiderohej si një kompromis i domosdoshëm për ta arritur paqen evropiane në mes të fuqive të mëdha. Drejtuesi i Konferencës së Ambasadorëve në Londër (njëherësh ministër i Jashtëm i Britanisë së Madhe), Edward Grey, gjatë raportimit të tij më 12.08.1913, në parlamentin britanik u shpreh: "Duhet mbajtur në mend se në bërjen e kësaj marrëveshje, rëndësi kryesore pati ruajtja e mirëkuptimit mes vetë fuqive të mëdha, e nëse marrëveshja mbi Shqipërinë e arrin këtë, atëherë ka bërë punën më të rëndësishme në interes të paqes në Evropë".[96]

Pa u mbushur një vjet nga ky raportim i Edward Greyit, shpërtheu Lufta e Parë Botërore dhe e prishi paqen evropiane dhe më gjerë. Njëkohësisht u vu në pikëpyetje pavarësia e Shqipërisë. Nga njëra anë, Fuqitë e Mëdha, tashmë si pjesëtare të luftës, e ndryshuan qasjen e tyre ndaj Shqipërisë. Madje edhe Edward Grey konsideronte se me futjen e fuqive të mëdha në luftë u humbën garancitë nënshkruese ndërkombëtare për Shqipërinë. Në këtë vazhdë pothuajse të gjitha përfaqësitë diplomatike të Fuqive të Mëdha u tërhoqën nga Shqipëria, duke përfshirë edhe tërheqjen e Princ Vidit (i cili vazhdoi formalisht të konsiderohet mbret i Shqipërisë deri më 31 janar 1925, kur Shqipëria u shpall Republikë). Nga ana tjetër, shtetet fqinje ballkanike (Serbia etj.) vazhduan qëndrimet e njëjta (duke mos hequr dorë nga ambiciet e tyre për aneksimin e mëtutjeshëm të territoreve shqiptare), ndërsa Lëvizja Kombëtare Shqiptare u dobësua dukshëm gjatë kësaj periudhe, duke u fragmentuar skajshmërisht, përveç të tjerash, edhe me ndikimin e interesave të vendeve fqinje etj. Megjithëkëtë, shumica e elitës e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare i mbante ende shpresat në Austrinë, edhe pse tashmë Austria nuk e kishte krejtësisht qëndrimin e qartë ndaj Shqipërisë. Futja e trupave austriake në Shqipëri gjatë

[96] Raportimi i Edward Greyt në parlamentin britanik më 12 gusht 1913: https://api.parliament.uk/historic-hansard/commons/1913/aug/12/war-in-balkans-statement-by-sir-edward

luftës ishte mirëpritur, madje një kuvend kombëtar i shqiptarëve që zgjodhi një 'komision nismëtar' dhe që rezultoi me krijimin e një kongresi kombëtar synonte, përveç të tjerash, rikthimin e Princ Vidit në Shqipëri, ndërsa austriakët synonin rivendosjen e një autonomie për Shqipërinë nën kontrollin e Austrisë.[97]

Më 10 mars 1917 qeveria austriake u përcaktua pro një autonomie për Shqipërinë nën mbrojtjen austriake. Kjo rezultoi me protesta nga ana e shqiptarëve, që tashmë konsideronin se reduktimi i Shqipërisë në autonomi e kërcënonte perspektivën e pavarësisë së ligjshme të Shqipërisë. Por të njëjtin vit revolucioni bolshevik në Rusi (që, përveç të tjerash, ndikoi për tërheqjen e Rusisë nga lufta, në nëntor të vitit 1917), dhe veçanërisht hyrja e ShBA-së në luftë, ndikuan për një të ardhme më të mirë të pavarësisë së Shqipërisë.[98] Në lidhje me këtë, historiania Nicola Guy, përveç të tjerash, shkruan:

> "Roger Mac Ginty ka nënvizuar se në rastin e nacionalizmave të shteteve të vogla në Evropën Perëndimore, hyrja e Shteteve të Bashkuara në luftë dhe veprimet e bolshevikëve kanë pasur një ndikim të rëndësishëm. Këto ide mund të gjejnë zbatim në rastin e çështjes shqiptare. Hyrja e amerikanëve në luftë ndikoi së tepërmi mbi lulëzimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Nismat më të rëndësishme lindën në Shtetet e Bashkuara, veçanërisht brenda 'Vatrës' (Shoqata Shqiptaro-Amerikane). Fillimisht, gjatë luftës 'Vatra' kishte mbështetur Austrinë, por hyrja në luftë e Shteteve të Bashkuara në krah të Aleatëve bënte të domosdoshme një ndryshim në besnikërinë e saj. 'Vatra' përqafoi dhe mbështeti sidomos idealet dhe institucionet politike liberale amerikane, me besim në parimet e Wilsonit rreth vetëvendosjes. Anëtarët e saj mendonin se një qëndrim i tillë do të ishte mjaft dobiprurës për kauzën shqiptare për sa i përket rimarrjes së atyre territoreve (Kosovë, Çamëri, Hot, Grudë etj.) të mohuara atyre më 1913-n" (Guy 2012: 176).

Këto ndryshime në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare e përmirësuan perspektivën e pavarësisë së Shqipërisë Londineze.

[97] Guy, 2012: 80, 151, 155-157, 162, 181-182
[98] Po aty: 163, 174-175

Në këtë vazhdë organizimi i Kongresit të Lushnjës, më 21-31 janar të vitit 1920 (ku u miratua akti kushtetues për pavarësinë e plotë të vendit etj.), dhe anëtarësimi në Lidhjen e Popujve më 17 dhjetor 1920, i forcuan themelet e Shqipërisë Londineze. Por pritjet e shqiptarëve, duke përfshirë "Vatrën" (Shoqatën Shqiptaro-Amerikane) në krye me Fan Nolin etj., për t'i kthyer territoret e banuara me shqiptarë (Kosovën me vise), në kuadër të kufijve të Shqipërisë Londineze (bazuar në parimet e Wilsonit për vetëvendosje), nuk u realizuan. Megjithëkëtë, duke e marrë parasysh situatën e vështirë politike të shqiptarëve që nga Traktati i Shën Stefanit (1878), realizimi dhe stabilizimi i gjysmës së shtetit shqiptar (Shqipërisë Londineze) ishte një arritje e shqiptarëve. Gjithashtu, përpjekjet e shqiptarëve për çlirimin e Kosovës me vise dhe bashkim kombëtar nuk u ndalën.

Lëvizja Kombëtare Shqiptare për çlirimin e Kosovës me vise pas vitit 1912

Gjatë luftës së parë ballkanike (së cilës i parapriu kryengritja e fuqishme e shqiptarëve e pranverës së vitit 1912, kundër Perandorisë Osmane), Serbia e shfrytëzoi situatën për ta okupuar Kosovën (duke përfshirë viset e banuara me shqiptarë në Maqedoni etj.). Historiografia serbe e paraqet këtë pushtim të Kosovës si "çlirim", ndërsa historiografia shqiptare si "pushtim". Sipas Malcolmit: "Kosova mbeti territor i Perandorisë Osmane deri kur u pushtua nga forcat serbe në vitin 1912. Serbët do të thonë çliruar por, edhe sipas llogaritjes së tyre, popullsia serbe-ortodokse ka qenë më pak se 25 %. Popullsia shumicë ishte shqiptare dhe nuk e mirëpriti sundimin serb, kështu që "pushtuar" rezulton të jetë fjalë e drejtë".[99]

[99]The Guardian (2008): *Is Kosovo Serbia? We ask a historian, Noel Malcolm*: https://amp.theguardian.com/world/2008/feb/26/kosovo.serbia

Pavarësisht prej rrethanave të vështira në fundvitin 1912, shqiptarët në Kosovë në krye me dhe të inspiruar nga udhëheqësit e tyre politiko-ushtarakë (Hasan Prishtina, Isa Boletini, Idriz Seferi, Bajram Curri etj.), rezistuan kundër pushtimit serb të Kosovës por, për shkak të luftës së pabarabartë, nuk mundën ta ndalojnë hyrjen e trupave serbe në Kosovë. Megjithëkëtë, kjo rezistencë e shënoi një pikënisje të rëndësishme për inkurajimin e vazhdimësisë së Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për Çlirimin e Kosovës me vise pas vitit 1912, që fillimisht u identifikua me Lëvizjen Kaçake.

Veçanërisht, krimet dhe dhuna e forcave serbe ndaj popullatës shqiptare, gjatë dhe pas pushtimit të Kosovës, ndikuan për rebelimin e shqiptarëve. Në lidhje me këto krime dhe dhunën ndaj shqiptarëve (gjatë luftërave ballkanike, deri në Luftën e Parë Botërore), Mønnesland, përveç të tjerash, shkruan:

> "Serbët perceptuan luftërat ballkanike si një 'çlirim' i 'Serbisë së Vjetër'. Kosova shihej si 'tokë e shenjtë' e Serbisë dhe shqiptarët shiheshin si një element i huaj. Më parë serbët kanë qenë të ngacmuar. Në periudhën 1878-1898 rreth 60 000 serbë kanë ikur nga Kosova. Gjatë luftërave ballkanike, ushtria serbe, bullgare dhe greke ishin brutale ndaj myslimanëve, duke shkatërruar dhe vrarë, me qëllimin për t'i pastruar zonat e fituara nga elementi i huaj sa më shpejt që ishte e mundur nëpërmes shfarosjeve, asimilimit (konvertimit të detyruar) ose dëbimit. Ushtarët serbë bën masakra kundër popullsisë shqiptare. Llogaritet se 12-25 000 shqiptarë u vranë. Pas luftërave ballkanike, Serbia përjetoi për herë të parë se shteti përfshinte një popullsi të konsiderueshme joserbe. Popullsia e madhe shqiptare në Kosovë dhe në Maqedoninë perëndimore përbënte një problem. Serbët nuk mund të prisnin që shqiptarët do të emigrojnë ashtu siç kishin bërë në Serbinë Jugore gjatë aneksimit të zonës Vranjë - Pirot në vitin 1878, kur një popullsi e madhe shqiptare kishte ikur dhe shkuar më tej në jug në zonat e kontrolluara nga osmanët. Për këtë arsye politika serbe ishte për asimilimin e shqiptarëve. Serbia ndërmori një propagandë të fortë, që në njërën anë paraqiste shqiptarët si inferiorë, një lloj subhuman, primitiv, të egër, pothuajse kafshë. Por, nga ana tjetër, shqiptarët 'në të vërtetë' ishin serbë. Historianët serbë u përpoqën të tregojnë se shqiptarët nuk kanë jetuar në Kosovë në kohët e kaluara. Shqiptarët duhej të jenë serbë që ishin 'albanizuar'. Në shtator të

> vitit 1913 shqiptarët bën kryengritjen në Kosovë dhe u përpoqën për të krijuar një qeveri të përkohshme në Dibër, por kryengritja u godit brutalisht. Autoritetet serbe futën një regjim të rreptë policor. Emigrantët serbë dhe malazias filluan të vendosen në Kosovë duke u dhënë shteti tokë. Një nga disa pak serbë, të cilët protestonin kundër masave të ashpra, ishte udhëheqësi socialist Dimitrije Tucović, i cili doli vendosmërisht kundër 'politikës pushtuese të borgjezisë serbe'. Ai e konsideronte pushtimin serb të Kosovës si një luftë klasike koloniale, si një përpjekje për ta 'kryer vrasjen me paramendim ndaj një kombi të tërë'. Tucović ishte pro një federate socialiste të Ballkanit dhe nuk e përkrahte pavarësinë e Shqipërisë, por ai kishte frikë se politika serbe do të krijojë një urrejtje të tillë, që bashkëpunimi në mes të shqiptarëve dhe serbëve do të ishte i pamundur në të ardhmen. Periudha deri në gusht të vitit 1914, kur Lufta e Parë Botërore shpërtheu, ishte shumë e shkurtër që Serbia ta arrijë ndikimin e vet, veçanërisht në raport me popullatën shqiptare. Të gjitha çështjet e rëndësishme nacionale ishin të pazgjidhura. Ky do të jetë shkaku i problemeve të mëdha më pastaj" (Mønnesland 2006: 150).

Përveç reagimit të guximshëm të Dimitrije Tucovićit kundër krimeve ndaj shqiptarëve, pati reagime edhe nga të tjerë që kishin pasur rastin ta përcjellin situatën nga afër. Lev Trocki, i cili gjatë kësaj periudhe ishte korrespondent nga Vjena i gazetës ukrainase "Kievskaia Mysl", ishte tmerruar nga barbarizmat e forcave serbe. Ndërsa publicisti Leo Frojndlih, në bazë të dëshmive të mbledhura, e botoi librin "Golgota Shqiptare" më 1913. Gjithashtu, studiuesja Edith Durham ka shkruar në kujtimet e saj për këto barbarizma ndaj shqiptarëve. Në fundvitin 1913 në shtypin evropian përmendej shifra e 20 000 shqiptarëve të vrarë dhe në vitin 1914, Komisioni Ndërkombëtar i Hetimeve për Luftërat Ballkanike (i Fondacionit Amerikan Karnegi) e publikoi raportin në të cilin vërtetohej dhuna sistematike ndaj shqiptarëve, me qëllim të pastrimit etnik.[100]

Gjatë Luftës së Parë Botërore pjesa veriore e Kosovës u okupua nga Austro-Hungaria, ndërsa pjesa jugore nga Bullgaria. Duke e marrë parasysh mbështetjen e mëhershme të Austro-

[100] Malcolm, 2001: 264-265

Hungarisë për pavarësimin e Shqipërisë Londineze, shumica e shqiptarëve të Kosovës dhe prijësit e tyre (Hasan Prishtina etj.) i mirëpritën dhe i mbështetën trupat austriake. Në kontrast me sundimin në zonën bullgare, autoritetet austriake u lejuan të drejta shqiptarëve. Përveç të tjerash, i emëruan në pushtetin lokal dhe ua lejuan përdorimin e gjuhës shqipe në vend të punës dhe, gjithashtu, ndihmuan hapjen e shkollave në gjuhën shqipe etj.[101]

Pas Luftës së Parë Botërore, më 1 dhjetor 1918, u themelua Mbretëria serbo-kroato-sllovene, e njohur edhe me emrin Mbretëria Jugosllave, nga viti 1929. Prapavija e themelimit të Jugosllavisë, në kuptimin e bashkimit të sllavëve të jugut në një shtet, bazohej në dy ide konkurruese, njëra serbe dhe tjetra kroate. Përderisa Ilija Grašanini dhe pasuesit e tij, në vazhdimësi konsideronin se në një shtet të tillë, serbët duhet të kenë një ndikim kulturor dhe politik mbizotërues. Kryepeshkopi kroat Josip Juraj Strosmayer (1815-1905) etj., konsideronin se një shtet i tillë duhej të bazohej në barazinë kombëtare.[102] Strosmayer ishte i inspiruar nga themeluesi i Lëvizjes Ilire, shkrimtari kroat Ljudevit Gaj (1809-1872), që aspironte unionin kulturor për të gjithë sllavët e jugut, nën ombrellën e 'Ilirianizmit'. Mirëpo, Strosmayer e zëvendësoi termin 'Ilirian' me atë 'Jugosllav' që, sipas tij, ishte term më i përshtatshëm për këtë qëllim.[103] Megjithëkëtë, barazia kombëtare në Jugosllavi nuk u arrit kurrë për shkak të politikës hegjemoniste serbe e bazuar në projektin e Ilija Grašaninit (*Naçertanjen*), si pararendës i rëndësishëm i koncepteve të mëvonshme jugosllave. Në lidhje me këtë, studiuesi Viktor Meier shprehet: "Padyshim politika serbe gjatë gjithë dekadave deri në rënien e Jugosllavisë së parë në vitin 1941 ka ndjekur më shumë dhe më pak linjat e skicuara nga Grašanini" (Meier 1999: 45). Ky konstatim vlen edhe për periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore, sepse Jugosllavia që

[101] Po aty: 271-272
[102] Lukic & Lynch, 1996: 58-59
[103] Bellamy, 2003: 44

nga themelimi me qendër Beogradin, dhe deri me shthurjen e saj të tërësishme, funksionoi si Serbosllavi, që nënkupton dominimin, diskriminimin dhe shtypjen nga politika hegjemoniste serbe ndaj popujve të tjerë e veçanërisht ndaj shqiptarëve në ish-Jugosllavi.

Kosova u bë dhunshëm pjesë e Mbretërisë serbo-kroato-sllovene (Jugosllavisë) në vitin 1918. Regjimet e Beogradit vazhduan shtypjen ndaj shqiptarëve, duke përfshirë vazhdimin e programeve të kolonizimit dhe konfiskimin e tokës së fshatarëve shqiptarë me qëllim për ta nxitur edhe më shumë shpërnguljen e shqiptarëve. Kjo shtypje ndaj shqiptarëve përfshiu edhe diskriminimin gjuhësor. Edhe pse Jugosllavia, me nënshkrimin kundër vullnetit të vet, në vitin 1919 të Traktatit për Mbrojtjen e Pakicave, premtoi lejimin e shkollimit fillor në gjuhët e minoriteteve në Jugosllavi, që dallonin gjuhësisht nga gjuha zyrtare (serbokroate). Megjithëkëtë, në praktikë shqiptarëve nuk iu respektua e drejta e gjuhës as në nivelin e minoriteteve, sikurse minoritetit gjerman, hungarez, çek, turk dhe rus në Jugosllavi. Në këtë vazhdë, regjimi i Beogradit mbyllte shkollat shqipe që ishin hapur gjatë pushtimit austriak, duke përfshirë ndalimin e shitjes së publikimeve në gjuhën shqipe dhe, rrjedhimisht, aty nga viti 1930 nuk kishte shkolla shqipe në tërë Kosovën, përpos disa shkollave krejtësisht të fshehta.[104]

Si reaksion kundër kësaj shtypje ndaj shqiptarëve u shtua rezistenca e Lëvizjes Kaçake, e mbështetur dhe e orientuar politikisht nga Komiteti për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës, i njohur edhe si Komiteti i Kosovës, i themeluar në nëntor të vitit 1918. Ky komitet udhëhiqej nga Hoxhë Kadri Prishtina, Bedri Pejani, Hysni Curri, Sali Nivica, Bajram Curri, Beqir Vokshi, Elez Isufi etj. Pjesë e udhëheqjes e këtij komiteti ishte edhe Hasan Prishtina, i cili me prapavijën e tij patriotike dhe përgatitjen intelektuale e kishte një ndikim të veçantë. Qëllim kryesor i Komitetit të Kosovës ishte bashkimi i rajoneve të Kosovës me vise (Kumanovës, Tetovës, Gostivarit, Shkupit,

[104] Malcolm, 2001: 278, 280

Preshevës, Kaçanikut, Ferizajt, Gjilanit, Prishtinës, Vushtrrisë, Mitrovicës, Jeni Pazarit, Rozhajës, Pejës, Rugovës, Plavë-Gucisë, Gjakovës, Prizrenit etj.) me Shqipërinë Londineze. Përveç veprimtarisë politiko-diplomatike, Komiteti i Kosovës arriti t'i organizojë degët e veta edhe në rajonet e Kosovës me vise dhe mbante lidhje të drejtpërdrejta me disa ndër udhëheqësit më të spikatur të grupeve kaçake.

Grupet më të dalluara kaçake që kanë vepruar deri në vitin 1924 dhe disa deri në vitin 1928 ishin: Grupi i Drenicës në krye me Azem dhe Shotë Galicen, Mehmet Delinë etj. Grupi i Rugovës-Pejës, në krye me Sali Ramën, Ker Sadrinë, Gjon Tarancën, Demush Rrahmanin etj. Grupi i Istogut në krye me Beqir Rexhën, Ramë Alinë, Ramadan Shabanin etj. Grupi i Rahovecit në krye me Sadik Ramën, Malush Miriqin, Met Imerin etj. Grupi i Gjakovës në krye me Zefin e Vogël, Ramë Binakun, Niman Ferizin etj. Grupi i Prizrenit në krye me Sali Shabanin, Mark Matejën, Deli Azemin etj. Grupi i Vuçitërnës në krye me Mehmet Konjuhin, Azem Gjakjen, Beqë Ramë Pantinën etj. Grupi i Shalës së Bajgorës në krye me Habit Lubëçit-Mengjiqin e shumë të tjerë. Grupi i Llapit në krye me Ramë Vllasen, Osman Pollaten, Hysë Popoven etj. Grupi i rrethit të Prishtinës në krye me Ilaz Reqakun, Adem Reqakun, Ibush e Esat Vuçiternalinë etj. Grupi i Karadakut, Kumanovë-Gjilan, në krye me Gjel Gurin, Lot Vakun, Ali Nekushtakun etj. Grupi i rrethit të Ferizajt në krye me Ymer Devedakun, Rexhep Berishën, Bislim Tahirin etj. Gjithashtu, ndikim të rëndësishëm në kuadër të udhëheqjes së rezistencës kaçake në Kosovë kanë pasur Sadik Rama i Gjurgjevikut, Ramadan Shabani i Kijevës, Ali Ukë Draga i Izbicës etj. Ndërsa në viset e Kosovës, në Plavë dhe Guci, në Jeni Pazar dhe Rozhajë, në Kërçovë etj., grupet kaçake udhëhiqeshin nga Mulla Agan Koja, Hysen Boshkoviqi, Jusuf Mehoniqi, Kalosh Dani-Zajazi etj.[105] Për Lëvizjen Kaçake dhe rolin e Komitetit të Kosovës, Malcolm, përveç të tjerash, shkruan:

[105] Rushiti, 2016: 105-108

> "Disa shqiptarë i kishin rrokur armët kundër pushtetit serb që në çastin e parë të rivendosjes së sundimit serb. Së këndejmi, ekzistenca e vazhdueshme e kryengritjes së armatosur në këtë rajon u dha shkas ose justifikim autoriteteve serbe, që të zbatonin shumë metoda drakoniane. Nuk do harruar edhe faktin se një numër i konsiderueshëm shqiptarësh të rëndomtë bashkëpunonin me autoritetet serbe dhe punonin në administratën lokale, edhe disa ndër ta, si rrjedhim, ishin në shënjestër të kryengritësve. Kryengritësit, të cilëve të dyja palëve u referoheshin si kaçakë, në komunikatat zyrtare të Beogradit quheshin thjesht "banditë", të cilët vidhnin dhe plaçkitnin. S'ka dyshim se pati edhe ndonjë rast krimi herë pas here bërë nga kaçakët, kurse disa qerime hesapesh për hakmarrje, po ashtu plekseshin me veprimtarinë e tyre. Megjithatë, në tërësi është më se e qartë se lëvizja kaçake ishte një dukuri politike, drejtuar kundër sundimit serb dhe, si e tillë, gjithashtu është e qartë se politika antishqiptare, si e qeverisë, ashtu edhe e pushtetit lokal (përfshirë tërë programin e kolonizimit), ishte një shtytje e fuqishme e kryengritjes... (...) Shumica e udhëheqësve politikë të Kosovës të kohës së luftës tashmë ishin larguar nga territori i Kosovës, një grup i tyre, nën udhëheqjen e Hasan Prishtinës, u mblodh në Shkodër në nëntorin e vitit 1918 dhe e formoi Komitetin për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës, i njohur më mirë si Komiteti i Kosovës. Hasan Prishtina po bënte përpjekje aktive për të ndikuar në qeverinë amerikane për ta përfshirë Kosovën në shtetin e ri të Shqipërisë, kurse në shkurtin e po atij viti Komiteti Kosovar dërgoi një letër proteste Konferencës së Paqes, në Paris, për shkak të vrasjeve të shqiptarëve në Kosovë... (...) Ç'është e vërteta, Komiteti i Kosovës pjesën më të madhe të energjisë ia kushtoi përkrahjes, deri në një shkallë edhe udhëheqjes së Lëvizjes Kaçake brenda Kosovës. Në fillim të vitit 1919, ky komitet përgatiti një varg rregullash të përgjithshme të lëvizjes, duke filluar me këto dy pika: "1: asnjë kryengritës nuk bën t'i lëndojë serbët vendës, por vetëm ata të cilët rrokin armët kundër shqiptarëve; 2: asnjë kryengritës nuk bën të djegë ndonjë shtëpi apo të rrënojë ndonjë kishë" (Malcolm 2001: 283-285).

Paralelisht me rezistencën kaçake, përpjekjet e shqiptarëve për të arritur të drejtat e tyre, karakterizoheshin edhe nga format e tjera të veprimtarisë/rezistencës. Në dhjetor të vitit 1919 u themelua partia legale Xhemijeti (Bashkimi) me qëllimin për t'i përfaqësuar interesat e shqiptarëve myslimanë të Kosovës dhe

të Maqedonisë. Dhe gjatë zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese të vitit 1920, arriti të ketë përfaqësuesit/deputetët e vet, në Parlamentin e Mbretërisë serbo-kroate-sllovene. Në këtë vazhdë, përfaqësuesit e kësaj partie kërkuan, përveç të tjerash, lejimin për hapjen e shkollave shqipe dhe ndalimin e programit të kolonizimit. Por, përveçse këto kërkesa të vazhdueshme nuk u plotësuan, pasuan edhe arrestimet. Në janar të vitit 1925 u burgos përfaqësuesi më i shquar, Ferat Draga, dhe aktivistë të tjerë të dalluar të kësaj partie. Kjo ndikoi që kjo parti (duke përfshirë edhe përçarjet e brendshme) të shthuret.[106] Megjithëkëtë, ish-strukturat e kësaj partie dhe subjekte të tjera e vazhduan veprimtarinë e tyre. Në lidhje me këtë, Malcom, përveç të tjerash, shkruan:

> "Pos këtij angazhimi publik në politikën jugosllave i cili, duhet të theksohet, nuk arriti pothuajse asgjë për shqiptarë të Kosovës, pati edhe veprimtari të tjera më individuale në jetën kulturore. Megjithëse publikimet bëheshin vetëm në turqishte dhe në serbishte, Xhemijeti nxiti themelimin e shkollave private nëpër shtëpi, ku nxënësit mësonin në gjuhën shqipe. Disa anëtarë të Xhemijetit e vazhduan këtë veprimtari edhe pas shthurjes së partisë, ndërkaq po shtohej synimi i shqiptarëve të shtresave të mesme që fëmijët e tyre t'i dërgonin në shkolla në Shqipëri. Ekzistonin edhe klube të ndryshme sportive, grupe të rinjsh dhe organizata bamirëse në Kosovë që merreshin ilegalisht me veprimtari arsimore dhe kulturore. Kështu, më 1920, një grup ilegal i quajtur "Agimi" filloi të sillte dhe të përhapte libra shqipe nga Shqipëria. Një organizatë e cila luajti një rol të rëndësishëm ishte edhe Kisha Katolike, e cila përkujdesej kryesisht për besimtarët shqipfolës. Ajo e përkrahu një shoqëri në Pejë, e cila në fillim ishte e njohur me emrin "Drini i Bardhë", e cila më pas u bë legale, si një shoqatë fetare dhe bamirëse me emrin "Shoqata e Shën Katerinës". Prifti shqiptar Shtjefën Gjeçovi, një entuziast i letërsisë dhe i kulturës shqiptare (komentet e të cilit për Kanunin e Lekë Dukagjinit u botuan më parë në vazhdime, ndërsa më vonë edhe të përmbledhura në një libër), u emërua në një famulli të Kosovës Perëndimore më 1926 dhe u bë një anëtar aktiv i kësaj shoqate. Veprimtaria e tij, përfshirë edhe mbajtjen e katekizmit në gjuhën

[106] Malcolm, 2001: 281-283

> shqipe, shkaktoi pakënaqësinë e zyrtarëve lokalë serbë, kështu që më 1929 atë e vranë" (Malcolm 2001: 283).

Programet kolonizuese të filluara me dekretligjin e muajit shkurt 1914 u forcuan veçanërisht pas vitit 1918 dhe zgjatën deri në Luftën e Dytë Botërore me qëllimin që t'u vështirësohet jeta shqiptarëve dhe të detyrohen të shpërngulen. Megjithëkëtë, një numër i konsiderueshëm i intelektualëve serbë nuk ishin të kënaqur me përmasat e procesit të kolonizimit, duke e cilësuar si jo mjaft të fortë shtypjen ndaj shqiptarëve në mënyrë që të ndikojë në një ikje më masive të shqiptarëve nga Kosova. Një debat i tillë ndodhi në vitet 1937-'39 në mesin e anëtarëve të klubit kulturor serb në Beograd[107] :

> "Një ndër anëtarët më të shquar të këtij klubi ishte Vaso Čubrilović, një ish-anëtar i 'Mlada Bosna', një grupi terroristësh të rinj, që e kishte përgatitur atentatin kundër arqidukës Franc Ferdinand më 1914; tashti ai ishte një historian i nderuar në Universitetin e Beogradit. Kontributi i tij në këtë debat mori formën e një punimi të gjatë politik, të cilin ai ia paraqiti qeverisë jugosllave më 1937. Duke qenë i vetëdijshëm për mungesat e programit të kolonizimit, ai shkruante: "Në qoftë se supozojmë se zhvendosja graduale e shqiptarëve në kolonizimin tonë të vazhdueshëm është joefikase, atëherë ne na mbetet vetëm një rrugëdalje: që t'i shpërngulim ata në përmasa të mëdha". Siç theksonte ai: "Në një kohë kur Gjermania mund të dëbojë dhjetëra-mijëra çifutë... largimi i disa qindra-mijëra shqiptarëve, s'do të shkaktojë shpërthimin e luftës botërore". Prandaj Čubrilovići propozonte një sërë metodash për t'i shtrënguar shqiptarët që të shpërnguleshin" (Mallcolm 2001: 295-296).

Projekti i Čubrilovićit ka pasur ndikim të madh në qeverinë jugosllave. Pas një sërë bisedimesh, në vitin 1938 rezultoi marrëveshja në mes të qeverisë jugosllave dhe turke. Kjo marrëveshje nënkuptonte pranimin në Turqi të 40 000 familjeve shqiptare (me një çmim prej 500 funtesh turke për familje), që nënkuptonte rreth 400 000 shqiptarë, sepse në këtë periudhë familjet shqiptare në fshatrat e Kosovës përbëheshin nga tri

[107] Po aty: 290-291, 295

breza me nga mbi 10 anëtarë të familjes. Por Lufta e Dytë Botërore e pamundësoi realizimin e kësaj marrëveshjeje. Megjithëkëtë, në periudhën në mes të dy luftërave botërore ka pasur emigrim të madh nga Kosova, ku disa mijëra shqiptarë u shpërngulën në Shqipëri dhe disa dhjeta-mijëra shqiptarë në Turqi.[108] Malcolm konstaton se "mund të supozojmë se numri i shqiptarëve dhe i myslimanëve të tjerë të shpërngulur nga Kosova, gjatë tërë periudhës 1918-'41, ishte diku ndërmjet 90 000 dhe 150 000" (Malcolm 2001: 298). Ndërsa Mønnesland, në lidhje me politikën shtypëse të regjimit të Beogradit ndaj shqiptarëve, në mes të dy luftërave botërore, përveç të tjerash, shkruan:

> Për serbët shqiptarët ishin një element i huaj dhe iu ekspozuan një terrori në shkallë të gjerë dhe serbizimit. U organizua një kolonializim masiv serb i Kosovës. Pjesërisht toka iu mor shqiptarëve pa kompensim dhe përmes masave të tilla i detyronin të emigronin, posaçërisht në Turqi. Alternativë e emigrimit ishte kryengritja e armatosur. Grupet guerile shqiptare, të quajtura kaçake, kishin mbështetje të madhe në popullatë. Udhëheqësi më i famshëm ishte Azem Bejta (1889-1924), i cili udhëhoqi kryengritjen në pjesët qendrore të Kosovës. Ai u bëri thirrje shqiptarëve të mos paguanin taksat dhe ta refuzonin shërbimin ushtarak për sa kohë që nuk iu njihen të drejtat e tyre. Vetëm kur pushteti i Zogut u kthye në Shqipëri me ndihmën e Beogradit, e ndaloi mbështetjen, madje iu kundërvu kryengritësve shqiptarë dhe situata u bë më e qetë. Por politika në mes të dy luftërave botërore ndikoi që shqiptarët e Kosovës të zhvillojnë një qëndrim të fortë antiserb dhe antijugosllav" (Mønnesland 2006: 184).

Gjatë periudhës në mes të dy luftërave botërore, lëvizjet kombëtare në shumë vende të botës u indoktrinuan ideologjikisht nga komunizmi, fashizmi, nazizmi etj. Ky indoktrinim ideologjik te shqiptarët u bë më i dukshëm gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Fashizmi dhe nazizmi (që ishin shfaqur si "ideologji" gjatë pjesës së parë të shekullit 19) patën konsekuenca të dhimbshme,

[108] Po aty: 296-297

veçanërisht gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në këtë vazhdë u keqpërdor edhe zbatimi i idesë komuniste. Ngjashëm sikurse prapavija e hershme e demokracisë, edhe prapavija ideore e komunizmit bazohet në idetë e hershme. Madje këto dy prapavija i kanë karakterizuar edhe dy revolucionet e mëdha. Nga njëra anë revolucionin politik anglez (1688) me ideologun e vet më të spikatur John Locke dhe, nga ana tjetër, revolucionin socio-politik francez (1789) me ideologun e vet më të spikatur, Jean-Jacques Rousseau. Filozofi francez Didie Zhylia, me të drejtë e ndërlidh idenë komuniste me një periudhë shumë të hershme historike, përkatësisht me Platonin:

> "Idenë e një sistemi të tillë të jetës komunitare e gjejmë në 'Republika' e Platonit. Ai shfaqet përsëri si ideal në kohën e Rilindjes, në shkrimet e Tomas Morusit, 'Utopia' dhe Karnpanelës, 'Qyteti i diellit'. Grashys Babëfi është i pari që e paraqet komunizmin jo si një ide filozofike, por si një program politik në 'Shoqëria e të barabartëve'. Pas përvojave 'asosiacioniste' të Ovenit në Angli, të Kabetit në Francë dhe më pas të Sen - Simonit dhe të Furiesë, doktrina e Marksit dhe e Engelsit pati një jehonë shumë të madhe: ata qenë të parët që propaganduan bashkimin jo vetëm të të mirave të konsumit, por edhe të mirave prodhuese..." (Zhylia 1994: 205).

Pavarësisht prej përpjekjeve edhe të teoricienëve të tjerë, nuk u arrit që ideologjia komuniste të mirëndërtohet krejtësisht as teorikisht dhe rrjedhimisht nuk ishte e mundur të zbatohet si duhet në praktikë. Në këtë vazhdë ndodhi revolucioni bolshevik në Rusi (1917) dhe, përveç të tjerash, krijoi implikime të mëdha politike, veçanërisht me ardhjen e Stalinit në pushtet në vitin 1924, ngaqë u bë edhe një inspirim i madh për spektrin e majtë politik në Evropën perëndimore. Një pjesë e lëvizjeve ekstreme majtiste dëshironin ta implementonin sistemin e njëjtë politik që u implementua në Rusi, madje në disa raste dëshironin që vendet e tyre të bëhen edhe pjesë e sistemit politik rus. Shtetet perëndimore arritën t'i dobësojnë lëvizjet ekstreme majtiste, edhe pse nuk ishte e lehtë, madje në disa shtete pati edhe luftëra qytetare. Në këtë vazhdë idetë komunitare në disa shtete evropiane ku kishte traditë më të fortë demokratike, u kultivuan

në kuadër të partive socialiste/ social-demokrate dhe arritën të bashkëjetojnë me partitë liberale, partitë konservatore etj., në kuadër të demokracive parlamentare, ndërsa në disa shtete të tjera, kryesisht në Evropën Lindore dhe më tutje, idetë komunitare përvetuan (veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore) në sisteme diktatoriale dhe autoritare. Me fjalë të tjera, siç u keqpërdorën (gjatë periudhave të caktuara historike), religjionet, nacionalizmi, demokracia etj., ngjashëm u keqpërdor edhe komunizmi.

Në rastin e shqiptarëve indoktrinimi ideologjik në kuadër të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore karakterizohet kryesisht nga dallimi në mes të katër rrymave politike: bashkëpunëtorët e nazifashistëve, ballistët, zogistët dhe komunistët. Megjithëkëtë, vlen të theksohet se ky dallim ka qenë më shumë strategjik sesa ideologjik. Në kuptimin se të gjitha këto rryma politike në kuadër të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare kishin synim parësor çlirimin dhe bashkimin kombëtar të shqiptarëve dhe kryesisht dallonin në kalkulimet e tyre strategjike për mundësinë e arritjes së këtij synimi.

Bashkëpunëtorët e forcave italiane dhe gjermane në Kosovë, (gjatë Luftës së Dytë Botërore), nuk e kishin si motiv parësor simpatinë ndaj fashizmit dhe nazizmit, por i konsideronin forcat italiane-gjermane, si një mundësi për t'u çliruar në kuadër të shthurjes së Jugosllavisë-Monarkiste. Gjithashtu, forcat okupuese italiane-gjermane treguan mirëkuptim për përpjekjet e shqiptarëve për ta ribashkuar Kosovën me Shqipërinë. Në bazë të dekreteve të tetorit 1941 dhe të shkurtit 1942, u vendos që të gjithë banorët e Kosovës së pushtuar nga Italia, të bëheshin shtetas shqiptarë. Në këtë vazhdë u ndihmua përhapja e arsimit në gjuhën shqipe dhe u hapën rreth 173 shkolla fillore shqipe në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore.[109] Një pjesë e kolonistëve serbë dhe malazezë që më herët kishin marrë tokat e shqiptarëve u detyruan nga presioni i shqiptarëve të ikin nga Kosova, ndërsa serbët dhe malazezët që konsideroheshin

[109] Po aty: 304, 308

banorë tradicionalë dhe fqinjë të shqiptarëve në Kosovë, në përgjithësi nuk patën presion nga shqiptarët të ikin.[110]

Ballistët, përkatësisht pjesëtarët e organizatës Balli Kombëtar, që u themelua në fund të vitit 1942 ishte, në fakt, një trashëgimi e opozitës së vjetër kundër mbretit Zog, me një program politik republikan, antifeudal, i së majtës së qendrës, që pasqyronte pikëpamjet e përkrahësve të Fan S. Nolit, kundërshtarit politik të mbretit Zog. Balli Kombëtar përfshinte kërkesat tradicionale kombëtare shqiptare për krijimin e një "territori etnik shqiptar" dhe kishte një autoritet të madh kombëtar sepse udhëhiqej nga Mithat Frashëri, i biri i Abdyl Frashërit (udhëheqësit shpirtëror të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit).[111] Ndërsa zogistët, përkatësisht mbështetësit e mbretit Zog (i cili emigroi jashtë shtetit, në fillim të Luftës së Dytë Botërore), u mobilizuan në kuadër të Partisë së Legalitetit.

Komunistët shqiptarë, të cilët themeluan partinë komuniste të Shqipërisë, në fund të vitit 1941 ishin të përcaktuar të luftonin kundër forcave okupuese italiane-gjermane, ndërsa zgjidhjen e çështjes kombëtare të shqiptarëve (bashkimin kombëtar të shqiptarëve) e shihnin në përputhje me qëndrimin leninist për të drejtën e vetëvendosjes së popujve.

Sipas Malcolmit, gjatë Luftës së Dytë Botërore edhe në Serbi shumë nëpunës dhe zyrtarë vazhduan të punonin për regjimin e ri të forcave okupuese. Shkaku pse numri i shqiptarëve që bashkëpunonin me forcat okupuese ishte më i lartë në Kosovë, kishte të bënte se shqiptarët i shihnin forcat okupuese (së paku potencialisht) si çlirimtare nga okupimi i mëhershëm jugosllav. Rrjedhimisht, numri i shqiptarëve të Kosovës në partinë komuniste ishte i vogël, edhe pse grupet e para të shqiptarëve partizanë të Kosovës u formuan në shtatorin e vitit 1942 dhe në fillim të vitit 1943, përkatësisht aradhet "Zenel Hajdini" dhe "Emin Duraku". Por pasi që partia komuniste jugosllave

[110] Robert Elsie, 2012: *Kosovo and the Bar Tragedy of March 1945,* page 2: http://www.elsie.de/pdf/articles/A2012BarTragedy.pdf
[111] Malcolm, 2001: 315

taktikisht, i bëri disa lëshime ndaj nacionalizmit shqiptar, u rrit numri i komunistëve shqiptarë. Kjo rezultoi edhe në një deklaratë të fuqishme zyrtare të lëshuar nga Partia Komuniste në Shqipëri, në dhjetor të vitit 1943, ku kërkohej vetëvendosja edhe në kuptimin e shkëputjes për Kosovën. Kjo pati ndikim për mobilizimin e shqiptarëve në lëvizjen komuniste dhe, në këtë vazhdë, kërkesat e shqiptarëve u konkretizuan në mbledhjen e mbajtur në fshatin Bujan në Shqipëri, ku dy komitetet lokale të partisë komuniste jugosllave në Kosovë miratuan një rezolutë.[112] Në fragmentin kryesor të rezolutës thuhet:

> "Kosova dhe Metohia është një rajon me shumicën e popullatës shqiptare e cila tashti, si edhe gjithmonë në të kaluarën, dëshiron të bashkohet me Shqipërinë. Mënyra e vetme për bashkimin e shqiptarëve të Kosovës e të Metohisë me Shqipërinë është lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë kundër okupatorëve dhe shërbëtorëve të tyre, sepse e vetmja mënyrë me të cilën mund të arrihet liria është në qoftë se të gjithë popujt, duke përfshirë edhe shqiptarët, kanë mundësinë për të vendosur për fatin e tyre, me të drejtën për vetëvendosje, deri në ndarje" (Malcolm 2001: 320-321).

Gjatë kësaj mbledhjeje delegatët ishin pajtuar që ta ngritin një komitet për tërë Kosovën, dhe rezoluta e Bujanit mbeti politikë zyrtare e këtij komiteti.[113] Paraprakisht, në fillim të muajit gusht 1943 në fshatin Mukje në Shqipëri u arrit një marrëveshje e rëndësishme në mes të komunistëve dhe ballistëve shqiptarë që, përveç të tjerash, nënkuptonte bashkimin në një front të përbashkët kundër okupatorëve nazifashistë dhe bashkimin e shqiptarëve në një shtet, bazuar në parimin e Kartës së Atlantikut për vetëvendosjen e popujve. Kjo ishte një arritje e madhe por, fatkeqësisht, dështoi për shkak të shumë faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Përveç të tjerash, ballistët nuk u treguan të organizuar dhe të përkushtuar mjaftueshëm në luftën kundër okupatorëve nazifashistë. Ndërsa komunistët shqiptarë në krye me Enver Hoxhën ishin të ekspozuar gjithnjë e më

[112] Po aty: 309, 313, 320
[113] Po aty: 320-321

shumë ndaj presionit, ndikimit dhe deri në një masë kontrollit të partisë komuniste jugosllave. Mosarritja e bashkëpunimit në mes të komunistëve dhe ballistëve dhe rrymave të tjera politike të shqiptarëve (gjatë Luftës së Dytë Botërore), e politizoi, njëkohësisht e dobësoi fuqinë e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare (si faktorë i brendshëm) për mundësinë e çlirimit të Kosovës nga Serbia. Në këtë vazhdë shqiptarëve në Kosovë nuk iu lejua referendumi i bazuar në rezolutën e Bujanit dhe Kosova u riokupua formalisht nga Jugosllavia. Në lidhje me këtë, Malcolm, përveç të tjerash, shkruan:

> "Në marsin e vitit 1944 Tito shkroi se Vojvodina dhe rajonet e tjera të ngjashme 'do të gëzojnë një autonomi më të gjerë, kurse çështja se cilës njësi federale do t'i bashkohen ato, do të varet nga vetë popullata nëpërmjet përfaqësuesve të tyre atëherë kur për këtë çështje do të vendoset përfundimisht pas luftës'. (Termi 'përfaqësues' në këtë rast ishte një fjalë e volitshme nëpërmjet së së cilës çdo lloj koncepti për vetëvendosjen popullore mund të neutralizohej: të vetmit përfaqësues që kishin peshë ishin përfaqësuesit komunistë të cilët e zbatonin dëshirën e partisë së tyre). Gjatë vitit 1944 dhe në fillim të vitit 1945 u zhvilluan bisedime ndërmjet disa krerëve komunistë së cilës njësi federale duhet t'i bashkohej Kosova: si Mali i Zi, ashtu edhe Maqedonia, paraqitën kërkesat e tyre, por ideja mbisunduese ishte gjithmonë që Kosova të bashkohej me Serbinë. Në një fazë të fundit të këtyre debateve, në shkurt të vitit 1945, një ndër këshilltarët më të ngushtë të Titos, Eduard Kardel, pati shtruar një mendim interesant, duke përkrahur këtë ide: 'Zgjidhja më e mirë', tha ai në një mbledhje të Komitetit Qendror, "do të ishte që Kosova të bashkohet me Shqipërinë, por meqë as faktorët e huaj, as faktori i brendshëm, nuk e përkrahin këtë, ajo duhet të mbetet një provincë kompakte në kuadër të Serbisë. Si rrjedhojë, në prill të vitit 1945 dy delegatë të Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës (Dushan Mugosha dhe Mehmet Hoxha) morën pjesë në Kuvendin Nacional Çlirimtar Antifashist të Serbisë. Por kërkesa formale u shty deri në mbledhjen e Këshillit Krahinor Popullor të Kosovës. Kjo mbledhje u bë pikërisht në fillim të korrikut, me ç'rast një nga pikat e rendit të ditës ishte "Projektrezoluta për aneksimin e Kosovë e Metohisë në Serbinë Federale". Anëtarëve të pazgjedhur të këtij trupi, të cilët përfaqësonin vetëm 2 250 anëtarë të Partisë Komuniste në Kosovë, me qëllim ua rikujtuan se në Kosovë kishte më shumë se 50 000 trupa, të gatshëm t'i mbronin frytet e luftës.

> Por kjo s'ishte e nevojshme ngaqë vetëm 33, nga 142 anëtarët e Këshillit, ishin shqiptarë. Rezoluta u miratua me aklamacion, pa asnjë votim dhe pa asnjë fjalim" (Malcolm 2001: 328-329).

Rezistenca antikomuniste pas Luftës së Dytë Botërore në Jugosllavi zgjati më së shumti në Kosovë. Madje gjatë përfundimit të Luftës së Dytë Botërore edhe një ndër komandantët partizanë më me ndikim, Shaban Polluzha, i cili kishte përafërsisht 8 000 luftëtarë dhe të cilit konsiderohet se iu bashkuan edhe rreth 20 000 luftëtarë[114], rezistuan kundër ripushtimit të Kosovës. Shaban Polluzha, përveçse ishte një ndër udhëheqësit më me ndikim në Kosovë, me përvojë luftarake që nga Lufta e Parë Botërore, gëzonte respekt të madh edhe në viset e Kosovës (Pazar të ri etj.) sepse gjatë Luftës së Dytë Botërore, së bashku me disa udhëheqës të tjerë lokalë të Kosovës (Miftar Bajraktari, Mulla Ilaz Broja, Bajraktari i Rugovës - Sak Fazlia, Sali Rama, Mulla Zekë Bërdyna etj.), mobilizuan dhe udhëhoqën një numër të konsiderueshëm të ushtarëve vullnetarë nga Kosova për mbrojtjen e shqiptarëve në viset e Kosovës (Pazar të ri etj.). Kjo ishte një përgjigje ndaj kërkesës për ndihmë nga shqiptarët në Pazar të ri, në krye me Haqif Blytën, Ahmet Dacen, Bahri Abdurrahmanin etj., të cilët gjatë Luftës së Dytë Botërore u ballafaquan me sulmet dhe masakrat e çetnikëve serbë ndaj popullatës shqiptare, me qëllim të pastrimit etnik të popullatës shqiptare nga Pazari i ri dhe nga viset e tjera të Kosovës.

Pushteti komunist jugosllav synonte të shmangte çdo lloj rezistence të fuqishme antijugosllave në Kosovë, duke ndërmarrë edhe fushatën për mobilizimin e shqiptarëve. Në dhjetor 1944, rreth 30 000 deri 50 000 ushtarë shqiptarë u rekrutuan me arsyetimin për t'u vendosur në front për nevojat e forcave të armatosura Jugosllave në Serbi, Vojvodinë, Bosnje-Hercegovinë, Kroaci dhe Slloveni. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre ushtarëve shqiptarë u keqtrajtuan dhe u vranë nga komunistët,

[114] Malcolm, 2001: 324 -325

siç është rasti i tragjedisë së Tivarit[115], e njohur si masakra e Tivarit.

Dy udhëheqësit kryesorë komunistë në Kosovë dhe Shqipëri, Fadil Hoxha dhe Enver Hoxha, duke qenë nën presionin e partisë komuniste jugosllave, dhe rrethanave real-politike në përgjithësi, iu kundërvunë rezistencës antikomuniste në Kosovë. Ngjashëm sikurse më herët Ahmet Zogu (pas Luftës së Parë Botërore), i cili, duke qenë nën presionin e Qeverisë së Beogradit, dhe rrethanave real-politike në përgjithësi, iu kundërvu veprimtarisë së Lëvizjes Kaçake në Kosovë dhe rivalëve të tij politikë: Hasan Prishtinës, Fan Nolit, Bajram Currit etj. Megjithëkëtë, rezistenca e komunistëve shqiptarë kundër nazifashistëve gjatë Luftës së Dytë Botërore e ka pasur rëndësinë e vet, në kuptimin që të mos etiketohet e gjithë Lëvizja Kombëtare Shqiptare si bashkëpunëtore e nazifashistëve, siç ishte tendenca propagandistike e vendeve fqinje me qëllimin për ta justifikuar copëtimin e mëtutjeshëm të territoreve shqiptare, sepse ekzistonte rreziku për copëtimin eventual edhe të "Shqipërisë Londineze" nga vendet fqinje. Shembull tipik është qasja e politikës shoviniste greke ndaj shqiptarëve në Çamëri (në vazhdën e shtypjes dhe pastrimit etnik ndaj tyre, prej vitit 1913) që kulmoi me gjenocid ndaj tyre gjatë Luftës së Dytë Botërore (1943-1944), duke i akuzuar si "bashkëpunëtorë të nazifashistëve". Sot e kësaj dite çështja çame rëndon në marrëdhëniet në mes të Shqipërisë dhe Greqisë. Për çështjen çame studiuesit James Pettifer dhe Miranda Vickers, përveç të tjerash, shkruajnë: "… ruajtja e trashëgimisë më të gjerë shoqërore dhe historike e Çamërisë ndërthuret me problemin politik dhe juridik të drejtësisë për pronarët e pasurive çame dhe kërkesat për kompensim nga familjet e prekura nga gjenocidi i Zervas në vitet 1943-44 dhe orvatjet e mëparshme të spastrimit

[115]Robert Elsie: *Kosovo and the Bar Tragedy of March 1945,* 2012: 3, 4 http://www.elsie.de/pdf/articles/A2012BarTragedy.pdf

etnik". [116] Prandaj, mund të konstatohet se rezistenca e komunistëve shqiptarë në Shqipëri dhe në Kosovë me vise (gjatë Luftës së Dytë Botërore), e ka shmangur mundësinë e copëtimit të mëtutjeshëm të Shqipërisë Londineze dhe të spastrimit të tërësishëm etnik të shqiptarëve në Kosovë me vise.

Edhe pse Kosova mbeti nën pushtimin e Jugosllavisë, pas Luftës së Dytë Botërore, vazhdimësia e rezistencës së Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për çlirimin e Kosovës me vise, në periudhën 1912-1945, duke përfshirë veprimtarinë kulturore dhe shkollat në gjuhën shqipe gjatë periudhës së Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, (përfshirë edhe shkollat e fshehta në gjuhën shqipe, në periudhën në mes të dy luftërave botërore) etj., ndikuan për vazhdimësinë e masivizimit të ndjenjës kombëtare shqiptare në Kosovë me vise, në kuadër të fazës c.

Mosrespektimi i rezolutës së Bujanit dhe vrasjet dhe masakrat ndaj shqiptarëve gjatë përfundimit të Luftës së Dytë Botërore e forcuan edhe më shumë qëndrimin antiserb dhe antijugosllav të shqiptarëve. Njëkohësisht, ndikuan për vazhdimin e përpjekjeve për çlirimin e shqiptarëve në Kosovë me vise (çlirimin e shqiptarëve në Jugosllavinë Federale), pas Luftës së Dytë Botërore.

Lëvizja Kombëtare Shqiptare për çlirimin e Kosovës me vise pas Luftës së Dytë Botërore

Pas Luftës së Dytë Botërore regjimi i Beogradit filloi zbatimin e një qasje të re armiqësore shumëdimensionale ndaj shqiptarëve në Kosovë dhe ndaj shqiptarëve në viset e Kosovës, përkatësisht shqiptarëve jashtë kufijve të tkurrur dhe administrativë të

[116] James Pettifer & Miranda Vickers: *The challenge to preserve the cham heritage* 2005:236 https://www.professorjamespettifer.com/uploads/files/pdf/The%20challenge%20to%20preserve%20the%20cham%20heritage.pdf

Kosovës, të mbetur pjesërisht brenda kufijve të Republikës së Serbisë, pjesërisht brenda kufijve të Republikës së Maqedonisë dhe, pjesërisht, brenda kufijve të Republikës së Malit të Zi.

Nënkryetari i Jugosllavisë, numri dy pas Titos, njëkohësisht ministër i Brendshëm i Jugosllavisë dhe shef i Shërbimit të Sigurisë Shtetërore (Uprava Državne Bezbednosti - UDB), Aleksandar Ranković, nëpërmes masave represive kishte mbjell frikë në tërë Jugosllavinë, veçanërisht i dhunshëm ishte ndaj shqiptarëve, duke pasur qëllim shpërnguljen e tyre nga Jugosllavia. Në këtë vazhdë përdoreshin edhe metoda të tjera shtesë për t'i manipuluar dhe shpërngulur më lehtë shqiptarët, duke përfshirë edhe pabarazinë e madhe strukturore etnike. Në lidhje me këtë, Malcolm, përveç të tjerash, shkruan:

> "Mbi autoritetet e Kosovës regjimi i Beogradit ushtronte një presion të fuqishëm, më 1951, për të inkurajuar sa më tepër këtë proces dhe për t'i shpallur turqit pakicë kombëtare, si dhe për të hapur shkolla të reja në gjuhën turke. Deri-diku ky mund të ketë qenë vetëm një zbatim i parimit 'përçaj dhe sundo'. Mirëpo, më 1953, kur Jugosllavia nënshkroi traktatin e ri, si me Turqinë, ashtu edhe me Greqinë, duke bërë të mundur shpërnguljen në përmasa të mëdha të 'turqve' jugosllavë në Turqi, u bë e qartë se ishte fjala për një politikë të përgatitur kaherë, e cila synonte shpërnguljen e plotë të një numri sa më të madh shqiptarësh. Mbrojtësi i flakët i një politike të këtillë, në periudhën e paraluftës, Vaso Qubriloviqi, kishte bërë një kthesë të madhe në karrierën e tij, duke u shndërruar nga një nacionalist serb, në një këshilltar komunist, me ç'rast i kishte paraqitur udhëheqjes komuniste jugosllave, në nëntorin e vitit 1944, një raport tjetër ku propozonte që 'zgjidhja e vetme korrekte për çështjen e pakicave për ne është shpërngulja e tyre'. Më 1953 filloi shpërngulja e përmasave të mëdha. Sipas disa raporteve, 13 000 'turq' braktisën Jugosllavinë dhe u shpërngulën për në Turqi. Vlerësohet se mes viteve 1945 dhe 1966, përafërsisht 246 000 veta emigruan në Turqi nga mbarë Jugosllavia. Mbase më shumë se gjysma e kësaj shifre të përgjithshme ishte nga Maqedonia (ku numri i 'turqve' kishte arritur një numër rekord dhe ishte shtuar nga 95 940, më 1948, në 203 000, më 1953). Disa nga ata që braktisën vendlindjen mund të kenë qenë edhe sllavë myslimanë, kurse disa të tjerë mund të kenë qenë me të vërtetë turq etnikë. Për Kosovën nuk ka shënime të hollësishme, ndonëse numri i

> përgjithshëm prej 100 000 të shpërngulurve nga Kosova gjatë tërë asaj periudhe, ndoshta nuk është një supozim i paarsyeshëm. Vitet '50 dhe fillimvitet '60 nga këndvështrimi shqiptar përbëjnë periudhën më të keqe të tërë sundimit të Titos. Vazhdoi një pabarazi e madhe etnike: serbët dhe malazezët, të cilët përbënin 27 % të popullatës së Kosovës sipas regjistrimit të vitit 1953, përbënin 50 % të anëtarësisë së partisë dhe 68 % të 'administratës dhe të posteve udhëheqëse'. Në fabrika dhe në uzina, ata përbënin 50 % të punëtorëve (Malcom 2001: 336-337).

Ky presion dhe diskriminim ndaj shqiptarëve ndikoi njëkohësisht për rimobilizimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për Çlirimin e Kosovës me vise, që kryesisht karakterizohet nga tri rrymat politike: *revolucionarët, institucionalistët dhe akademikët.* Kjo ndarje tipologjike nuk nënkupton se këto tri rryma politike nuk kanë pasur edhe karakteristika të tjera që i dallojnë. Njëkohësisht, nuk nënkupton se nuk kanë pasur asnjë karakteristikë të përbashkët sepse në kuadër të tri këtyre rrymave politike ka pasur (më pak dhe më shumë) edhe personalitete që mund të cilësohen edhe si intelektuale etj., pavarësisht prej dallimeve kryesore, si revolucionarë, institucionalistë dhe akademikë. Në vijim, duke marrë pikënisje në këtë ndarje tipologjike, mëtoj ta konkretizoj rolin e këtyre tri rrymave politike në kuadër të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për Çlirimin e Kosovës me vise, që njëkohësisht sinonimizon vazhdimësinë e masivizimit të ndjenjës kombëtare shqiptare në Kosovë me vise, në kuadër të fazës c.

Revolucionarët identifikohen me vazhdimësinë e rezistencës aktive të shqiptarëve për çlirimin e Kosovës me vise pas vitit 1912, duke përfshirë rezistencën e shqiptarëve kundër ripushtimit të Kosovës (gjatë përfundimit të Luftës së Dytë Botërore), veçanërisht me veprimtarinë revolucionare të grupeve klandestine të pas Luftës së Dytë Botërore. Disa ndër inkurajuesit kryesorë të kësaj veprimtarie kanë qenë: Halim Spahiu, Ajet Gërguri, Selman Riza, Imer Berisha, Marie Shllaku, Gjon Serreqi, Frati Bernard Llupi, Mulla Idriz Gjilani, Ramadan Hoxha (Mulla Ramë Govori), Hysen Tërpeza, Katarina Josipi,

Xheladin Hana, Hyrie Hana, Nexhat Agolli, Rifat Latif Berisha, Njazi Maloku, Aziz Spahiu, Muhamed Brovina, Metush Krasniqi, Kadri Halimi, Ali Aliu, Mehmetriza Murtezani, Adem Demaçi, Ahmet Haxhiu, Zeqir Gërvalla, Azem Beqiri, Abdyl Lahu, Ilmi Rakovica, Fazli Graiçevci, Shaban Shala, Rexhep Elmazi, Ramadan Shala, Kadri Osmani, Arif Seferi, Rafi Halili, Regjep Gali Balidemaj, Teki Dervishi, Isa Kastrati, Nezir Ibish Gashi etj.

Kjo veprimtari e grupeve klandestine rezultoi edhe me organizimin e demonstratave të vitit 1968, ku ra dëshmor Murat Mehmeti dhe u plagosën dhjetëra të tjerë. Demonstratat u iniciuan nga një grup i studentëve në Prishtinë në krye me Osman Dumoshin etj. që, në fakt, ishin celulë e të rinjve në kuadër të një grupi më të madh klandestin të themeluar në vitin 1963, në krye me Adem Demaçin.[117] Konkretisht, demonstratat filluan në Prizren më 6 tetor 1968, në krye me Isa Demajn dhe bashkëveprimtarët e tij., i cili ishte koordinues i grupit të Prizrenit me grupin e studentëve të Prishtinës[118], dhe vazhduan në qytete të tjera, me kërkesat kryesore: "Duam vetëvendosje gjer në shkëputje", "Duam republikë", "Duam kushtetutë" "Duam universitet" etj. Këto demonstrata e kanë pasur një ndikim të tërthortë edhe në kuadër të një procesi politik që kishte filluar në udhëheqjen jugosllave në vitin 1966 dhe që rezultoi me kushtetutën e re jugosllave të vitit 1974.

Shkaku fillestar i këtij procesi ishte Aleksandar Ranković, i cili me postet e tij të larta në udhëheqjen jugosllave dhe me qasjen e tij neostaliniste ishte bërë shumë i pushtetshëm. Për këtë arsye ishte caktuar një komision hetues i kryesuar nga politikani maqedonas Crvenkovski, për ta hetuar veprimtarinë e UDB-së dhe, në këtë vazhdë, Tito, më 1 korrik 1966, thirri

[117] Adil Pireva (2014): *Osman Dumoshi, kryeorganizator i demonstratave të '68-s*: http://illyriapress.com/osman-dumoshi-kryeorganizator-demonstratave-te-68-es/

[118] Zymer Ujkan Neziri (2016): *Isa Demaj është figurë emblematike e brezit '68 të republikës*: https://www.radiokosovaelire.com/zymer-ujkan-neziri-isa-demaj-eshte-figure-emblematike-e-brezit-68-te-republikes/

mbledhjen plenare (të katërt plenare) në Brione, (në ishullin personal të tij për pushime). Gjatë kësaj mbledhje Tito, përveç të tjerash, përkrahu krahun liberal dhe i akuzoi unitaristët, duke i cilësuar kërcënim për shtetin. Veprimtaria e UDB-së u akuzua për abuzime, përkatësisht për terrorizimin e popullit dhe për përgjimin e Titos, që rezultoi edhe me mënjanimin e Rankovićit nga të gjitha pozitat e larta udhëheqëse.[119] Në lidhje me efektet e këtij procesi dhe demonstratat e vitit 1968, Mønnesland, përveç të tjerash, shkruan:

> Pas luftës shqiptarët kanë qenë të ekspozuar ndaj shtypjes më shumë se çdo kombësi tjetër. Pas rënies së Rankovićit shqiptarët për herë të parë fituan një lloj lirie të caktuar. Edhe pse disa nga nacionalistët serbë protestonin sepse ishin kundër ndalesës së dominimit serb, dhe i akuzonin shqiptarët për 'irredentizëm' dhe 'separatizëm', procesi i reformave nuk ndalej. Në nëntor 1968 shpërthyen demonstratat e fuqishme kundër regjimit serb në Kosovë. Një u vra dhe 37 u plagosën. Demonstruesit kërkuan që Kosova të ketë statusin e republikës. Demonstratat u kundërshtuan nga partia komuniste, ndërsa udhëheqësit e demonstratave u dënuan me burgim të gjatë. Megjithëkëtë, po në atë vit u miratuan ndryshimet kushtetuese që e bën Kosovën një "krahinë autonome socialiste" (tani emri serb Metohija, u hoq nga përdorimi, siç kishin kërkuar shqiptarët). Avancimi i statusit të Kosovës dhe Vojvodinës në 'krahina autonome socialiste', iu dha të drejtë t'i kenë kushtetutat dhe parlamentet e veta dhe të drejtat më të mëdha të vetëqeverisjes ekonomike. Periudha prej 1968 deri më 1980 u karakterizua gjithnjë e më shumë nga prosperiteti kulturor. Në vitin 1969 u themelua universiteti i pavarur në Prishtinë, i dominuar nga studentët dhe mësimdhënësit shqiptarë. Shqiptarëve të Kosovës iu lejua të kenë kontakt me bashkëkombësit e tyre në Shqipëri, për shembull tekstet shkollore të botuara në Tiranë, përdoreshin në shkolla dhe universitete. Kjo ishte krejtësisht e natyrshme për shqiptarët e Kosovës meqë e ndienin se kombi shqiptar ishte një, me gjuhë të njëjtë dhe kulturë të përbashkët. (Mønnesland 2006: 223).

[119] Mønnesland, 2006: 222

Rrjedhimisht, periudha gjatë fundviteve ’60 dhe fillimviteve ’70 karakterizohet nga një përparim kulturor-politik në Kosovë, përveç të tjerash: lejimi i përdorimit të flamurit kombëtar (1968), themelimi i Universitetit të Prishtinës (1969), njësimi i gjuhës letrare shqipe në Tiranë në vitin 1972, ku të pranishëm ishin edhe delegatët shqiptarë jashtë Shqipërisë Londineze (Kosova etj.) dhe kulmoi me Kushtetutën e Kosovës në vitin 1974, që përcaktoi Kosovën si element konstituiv në kuadër të federatës jugosllave.

Institucionalistët identifikohen me udhëheqjen institucionale të shqiptarëve në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore. Përkatësisht me Partinë Komuniste të Kosovës, e njohur më pastaj me emrin Lidhja Komuniste e Kosovës, dhe me institucionet politike të Kosovës: Kuvendin e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës; Kryesinë e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës; Këshillin e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës; Këshillin Ekzekutiv të Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës etj. Disa nga këta udhëheqës institucionalistë, duke qenë të shqetësuar vetëm për karrierën e tyre në kuadër të institucioneve udhëheqëse (duke përfshirë edhe institucionet udhëheqëse federative jugosllave), nuk kanë dhënë ndonjë kontribut për të ardhmen politike të Kosovës. Përkundrazi, shpeshherë kanë qenë të dëmshëm, duke iu nënshtruar krejtësisht qasjes shtypëse dhe diskriminuese të politikës serbo-jugosllave ndaj shqiptarëve në Kosovë dhe ndaj shqiptarëve në viset e Kosovës. Ndërsa një pjesë tjetër e konsiderueshme e udhëheqësve institucionalistë: Fadil Hoxha, Imer Pula, Veli Deva, Xhavit Nimani, Rezak Shala, Iljaz Kurteshi, Rexhai Surroi, Mahmut Bakalli etj., përveç të tjerash, e kanë dhënë kontributin e tyre në kuadër të procesit politik që rezultoi edhe me Kushtetutën e Kosovës në vitin 1974. Megjithëkëtë, gjatë këtij procesi dhe, në vazhdimësi, përkushtimi i kësaj pjese të institucionalistëve ka qenë i karakterizuar nga një rezistencë pasive, në kuptimin se nuk kanë qenë proaktivë në kuadër të përpjekjeve për transformimin e Krahinës së Kosovës në Republikën e Kosovës, edhe pse kishte pengesa reale për këtë

transformim. Në lidhje me këtë, Malcolm rendit "tri pengesa" kryesore që e pamundësuan Kosovën të avancohet në Republikë në vitin 1974. Pengesa e parë ishte teorike, e bazuar në doktrinën komuniste të zhvilluar në Bashkimin Sovjetik që, në fakt, ishte edhe gurthemel i federatës jugosllave dhe nënkuptonte se republikat ishin entitete për "kombet" dhe jo për "kombësitë". Ky kriter teorik s'respektohej plotësisht. Për shembull, popullata rumanishtfolëse e Moldavisë që kufizohej me Rumaninë e kishte republikën e vet në kuadër të Bashkimit Sovjetik. Pengesa e dytë praktike nënkuptonte se Kosova si republikë formale do të mund t'i bashkohet Shqipërisë. Pengesa e tretë politike nënkuptonte se avancimi i Kosovës në republikë formale do të krijonte indinjatë të madhe te serbët në Serbi dhe te serbët në Kosovë.[120]

Akademikët identifikohen me veprimtarinë në kuadër të institucioneve shkencore të Kosovës: Institutin Albanologjik (1967); Entin e Historisë (1967), që më pastaj evoluoi në Institutin e Historisë së Kosovës; Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës (1975), dhe veçanërisht me Universitetin e Prishtinës. Disa ndër drejtuesit kryesorë dhe me ndikim të kësaj veprimtarie kanë qenë: Fehmi Agani, Idriz Ajeti, Rexhep Qosja, Ali Hadri, Esad Mekuli, Dervish Rozhaja, Gazmend Zajmi, Ejup Statovci, Anton Çeta, Mark Krasniqi, Ibrahim Rugova, Zekeria Cana, Ukshin Hoti, Nexhat Daci, Muhamedin Kullashi, Gani Bobi, Pajazit Nushi, Ismet Gusia, Agim Vinca, Ali Podrimja, Esat Stavileci, Edi Shukriu, Rexhep Ismajli etj. Kjo elitë akademike nuk arriti gjatë viteve '70-'80 të determinojë figura sikurse Haveli, Valenca, Sakharov etj., dhe (me ndonjë përjashtim), deri në fillimvitet '90 nuk karakterizohet nga përpjekjet e veçanta për transformimin e Krahinës së Kosovës në Republikën e Kosovës. Megjithëkëtë, elita akademike e Kosovës në përgjithësi, e ka dhënë, përveç të tjerash, një kontribut të rëndësishëm në kuadër të veprimtarisë shkencore dhe ngritjes së sistemit të lartë arsimor në Kosovë,

[120] Malcolm, 2001: 341-343

duke përfshirë edhe kontributin e pedagogëve nga Shqipëria, që vinin gjatë viteve '70 për të ligjëruar në Universitetin e Prishtinës.

Vlen të theksohet se fillimet e themelimit të institucioneve shkencore në Kosovë, pas Luftës së Dytë Botërore, datojnë që nga viti 1946, kur u krijua sektori për gjuhë, folklor dhe histori.[121] Në këtë kontekst vlen të përmendet edhe kontributi i veteranëve Ilhami Nimani, Selman Riza, Mehdi Bardhi, Ali Rexha etj. të cilët udhëhoqën Institutin Albanologjik të Prishtinës në periudhën 1953-1955, edhe pse ky Institut u mbyll nga regjimi serb në vitin 1955,[122] dhe u rihap në vitin 1967 në krye me Fehmi Aganin. Gjithashtu, gazetarët veteranë, Shemsi Mehmeti, Sedat Dida, Mustafë Shala, Haki Hoxha, Gjeto Leka etj. kontribuuan, përveç të tjerash, për ngritjen e kuadrove të reja të gazetarisë në Kosovë.[123]

Përparimi kulturor-politik i shqiptarëve gjatë fundviteve '60 dhe fillimviteve '70, duke përfshirë Kushtetutën e Kosovës në vitin 1974, ishte një e arritur e madhe. Por, njëkohësisht, nuk ishte ndonjë garanci e zgjidhjes së çështjes shqiptare në Jugosllavi sepse Kosova nuk kishte evoluar në një republikë formale që do të mund t'u garantohej një siguri politike shqiptarëve në Jugosllavi, edhe pas vdekjes së Titos, i cili prioritet parësor kishte pushtetin dhe stabilitetin politik dhe jo të ardhmen politike të shqiptarëve në Jugosllavi. Madje edhe përafrimi i Titos me Enver Hoxhën ishte strategjik. Malcolm konstaton se pajtimi i Jugosllavisë me Shqipërinë kishte të bënte se Tito ishte frikësuar paraprakisht nga pushtimi i Çekosllovakisë nga Bashkimi Sovjetik dhe kishte nevojë për të gjitha shtetet antiruse në Ballkan. Shqipëria në këtë periudhë kohore i kishte të prishura marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik dhe nuk

[121] *30 vjet të Institutit të Historisë në Prishtinë* (1967-1997), Instituti i Historisë - Prishtinë, 1998: 9

[122] *Tridhjetë vjet të Institutit Albanologjik* (1967-1977), Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1997: 13-14

[123] Kultplus (2019): *Këta janë veteranët e gazetarisë kosovare:* https://www.kultplus.com/arti-pamor/keta-jane-veteranet-e-gazetarise-kosovare/

merrte subvencione nga sovjetikët. Rrjedhimisht, në fillimvitin 1969 rezultuan marrëveshjet tregtare në mes të Jugosllavisë dhe Shqipërisë dhe, pas disa muajsh, edhe marrëveshja në bazë të së cilës erdhën (gjatë fillimviteve '70), rreth 200 profesorë nga Shqipëria për të ligjëruar në Universitetin e Prishtinës, duke përfshirë përdorimin e teksteve të botuara në Shqipëri.[124]

Për dallim të institucionalistëve dhe akademikëve, revolucionarët përkatësisht veprimtarët e grupeve klandestine ishin idealistë. Ideali për bashkim kombëtar dhe përvojat e hidhura historike të popullit shqiptar në Jugosllavi, para, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore ishin motivacioni i tyre kryesor në përpjekjet për të transformuar Krahinën e Kosovës në Republikën e Kosovës, si një hap i domosdoshëm për sigurinë politike të shqiptarëve në Kosovë (që do të shërbente edhe për sigurinë politike të shqiptarëve në viset e Kosovës), njëkohësisht si një parakusht për bashkimin kombëtar të shqiptarëve në të ardhmen. Për këtë arsye, veprimtarët e grupeve klandestine s'u magjepsën shumë nga ndryshimet politike që solli Kushtetuta jugosllave e vitit 1974 sepse këto ndryshime nuk e zgjidhnin çështjen politike të shqiptarëve në Jugosllavi. Madje në kuadër të këtyre ndryshimeve pozitive të barazisë etnike, rezultuan edhe biefektet negative sepse shqiptarëve u imponohej dhe u mundësohej më së shumti mobilizimi në radhët e partisë. Sipas Malcolmit, "... pabarazia e përgjithshme në punësimin publik asnjëherë nuk u përmirësua: më 1980 llogaritej se çdo i pesti serb kishte rrogë shtetërore, kurse çdo i njëmbëdhjeti shqiptar merrte rrogë shtetërore. Aty ku shqiptarët bënë përparimin më të madh ishte hyrja e tyre në radhët e partisë dhe të administratës lokale" (Malcolm 2001: 340). Rrjedhimisht, rekrutimi masiv i shqiptarëve në lidhjen komuniste, dhe privilegjet e pozitave partiake dhe burokratike, përveç anës pozitive, bartnin me vete imponimin, presionin dhe indoktrinimin, në kuptimin e lojalitetit dhe servilitetit ndaj Jugosllavisë dhe titizmit. Në këtë vazhdë rezultoi strategjia "përçaj dhe sundo" nga shërbimi i

[124] Malcolm, 2001: 339

sigurisë shtetërore jugosllave, i dominuar nga Serbia (UDB), që nëpërmes privilegjeve, shantazheve dhe presioneve, përdorte një pjesë të shqiptarëve, për ta luftuar veprimtarinë revolucionare të grupeve klandestine.

Veprimtaria revolucionare e grupeve klandestine, edhe pse kishte pësuar goditje, pas demonstratave të vitit 1968 (burgosje dhe tortura të pjesëtarëve të vet), u fuqizua gjatë viteve '70, veçanërisht me themelimin e Grupit Revolucionar të Kosovës (GRK), dhe grupeve të tjera klandestine më të vogla. Kjo veprimtari e grupeve klandestine, duke përfshirë tashmë edhe shtypin klandestin që disa nga këto grupe klandestine arritën ta botonin dhe ta shpërndanin ("Zëri i Kosovës" etj.), u bë një ndër faktorët kryesor për shpërthimin e demonstratave të vitit 1981, me kërkesën kryesore: "Republikë, Kushtetutë, ja me hatër ja me luftë".

Demonstratat e vitit 1981 filluan në mënyrë spontane më 11 mars në Mensën e Studentëve të Universitetit të Prishtinës, kur studenti Abdullah Tahiri e përmbysi tavolinën si shprehje e pakënaqësisë dhe revoltës studentore. Fillimisht, demonstruesit shprehën kërkesat sociale, më pastaj edhe politike me kërkesën "Kosova Republikë". Këto demonstrata ishin më masive sesa demonstratat e vitit 1968 dhe ndikuan, përveç të tjerash, për fillimprocesin e shembjes së themeleve të Jugosllavisë. Edhe reagimi i pushtetit serb ndaj demonstratave të vitit 1981 ishte shumë më brutal sesa ndaj demonstratave të vitit 1968. Forcat policore plagosën qindra demonstrues, ndërsa dëshmorë ranë: Naser Hajrizi, Asllan Pireva, Xhelal Maliqi, Salih Abazi, Salih Zeka, Ruzhdi Hyseni, Rizah Matoshi, Sherif Frangu, Tahir dhe Nebih Meha, Nesimi Dervishdana, Salih Maloku, Afrim Abazi, Ibrahim Krasniqi etj. Iniciatorët e këtyre demonstratave (duke përfshirë dy zëdhënësit kryesorë, Ali Lajçin dhe Hydajet Hysenin), u dënuan me burgime të rënda.

Udhëheqësit politikë shqiptarë të institucioneve të Krahinës së Kosovës në krye me Fadil Hoxhën, Mahmut Bakallin, Azem Vllasin etj., edhe pse kishin një përvojë politike më të madhe, nuk u treguan mjaftueshëm të guximshëm dhe politikisht

kreativë për ndonjë lloj koordinimi me iniciatorët e demonstratave të vitit 1981 në lidhje me kërkesën për "Republikën e Kosovës", si një kërkesë e drejtë në kuadër të barazisë së popujve në Jugosllavinë federale. Së paku, nuk morën një qëndrim politiko-diplomatik, që në parim të jenë pro kërkesës për "Republikën e Kosovës" dhe, njëkohësisht, kundër mënyrës së shtrimit të kësaj kërkese nëpërmes demonstratave etj. Në këtë vazhdë, për demonstratat e vitit 1981, pati edhe konspiracione në kuptimin se ishin të orkestruara nga qarqet e shërbimit sekret serb, rus etj., për ta kthyer në regres fuqinë politike të shqiptarëve në Kosovë që e kishin fituar në bazë të Kushtetutës së vitit 1974. Në fakt, ky ishte dhe mbeti një konspiracion dhe vlerësim antihistorik. Sepse demonstratat e vitit 1981 ishin një vazhdimësi historike e rebelimit të shqiptarëve kundër regjimeve shtypëse të Beogradit dhe përpjekjeve për çlirimin e Kosovës nga Serbia që nga viti 1912, duke përfshirë demonstratat e vitit 1968, veçanërisht ishin të ndikuara nga veprimtaria dhe shtypi i grupeve revolucionare klandestine. Me fjalë të tjera, një pjesë domethënëse e shoqërisë studentore e Universitetit të Prishtinës ishte ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë nga veprimtaria dhe shtypi i grupeve revolucionare klandestine. Këto demonstrata ishin rezultat i kontekstit të përgjithshëm socio-politik në Kosovë. Në lidhje me këtë, Mønnesland, përveç të tjerash, shkruan:

> "Mund të duket i çuditshëm rebelimi i shqiptarëve në një kohë kur kishin arritur të kenë më shumë të drejta se ndonjëherë më parë. Por 'periudha e lulëzimit' në vitet '70 ndikoi në ngritjen e vetëdijes kombëtare, sidomos në mesin e të rinjve që pashmangshëm rezultoi me rritjen e kërkesave politike. Pse Kosova nuk duhet të ketë status republike kur ka më shumë banorë sesa në Mal të Zi apo në Slloveni? Gjithashtu, për pakënaqësinë ndikonte që Kosova kishte mbetur ende zona më e varfër në vend" (Mønnesland 2006: 239).

Përndryshe, edhe çdo lloj elementi i komplotit eventual nuk ka mundur të dezorientojë qëllimin e shqiptarëve të Kosovës me demonstratat e vitit 1981 sepse organizimi i grupeve klan-

destine kishte evoluar politikisht, veçanërisht udhëheqësit e Grupit Revolucionar të Kosovës, Hydajet Hyseni etj., të cilët arritën të orientojnë politikisht demonstratat nëpërmes fjalimeve dhe shkrimeve, duke argumentuar, përveç të tjerash, se Kosova përmbush kushtet që t'i njihet statusi i Republikës në kuadër të barazisë së popujve në federatën jugosllave. Në këtë kuadër, një kontribut të rëndësishëm ka dhënë simboli i guximit akademik, politologu Ukshin Hoti, i cili, në një mbledhje në Universitetin e Prishtinës më 19 nëntor 1981, argumentoi nga një këndvështrim shkencor-politologjik, për të mirat që sjell "Republika e Kosovës" duke përfshirë edhe sforcimin e stabilitetit politik në rajon. Për Ukshin Hotin kërkesa për republikë gjatë demonstratave të vitit 1981 ishte njëkohësisht një pikënisje e procesit demokratik nga brenda (demokraci autentike) në Kosovë. Në librin e tij *Filozofia politike e çështjes shqiptare* (1995), përveç të tjerash, konstaton se: "Demokracinë në Kosovë nuk e lindën të tjerët e as nuk u lind për qejfin e tyre. Ishte e ndërlidhur me proceset demokratike të Evropës dhe me synimet e tilla të njerëzimit. Demokracia në Kosovë u vetëlind në vitin 1981, do të rritet vetë, së bashku, e barabartë dhe e ndërlidhur me të tjerat" (Hoti 1995: 76). Madje mund të konstatohet se demonstratat masive të vitit 1981, ku u përfshin pothuajse të gjitha shtresat shoqërore të shqiptarëve të Kosovës, ishin njëkohësisht një referendum popullor i shqiptarëve të Kosovës, në kuptimin e shpalljes së parë të Republikës së Kosovës.

Supozohet se edhe Shqipëria Londineze mund të ketë pasur një ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në lidhje me inicimin e demonstratave të vitit 1981, veçanërisht profesorët që vinin në Kosovë për të ligjëruar në Universitetin e Prishtinës gjatë viteve '70. Por, nuk ka dëshmi dhe informacion të mjaftueshëm që e vërteton këtë supozim. Megjithëkëtë, pas shpërthimit të demonstratave të vitit 1981, pushteti në Shqipërinë Londineze vendosi t'i përkrahë publikisht kërkesat e demonstruesve shqiptarë në Kosovë, në kuadër të kësaj përkrahjeje përpiqej ta kontrollonte veprimtarinë revolucionare të grupeve

klandestine të shqiptarëve në Jugosllavi, me "përgjegjësinë e kalkulimit real-politik" që kishte si pushtet/shtet. Ndërsa veprimtarët e grupeve klandestine, për shkaqe patriotike dhe idealit për bashkim kombëtar, ishin lojalë ndaj vendit amë (Shqipërisë Londineze), pavarësisht sistemit politik. Këtë më se miri e pasqyron një intervistë e Jusuf Gërvallës (një ndër intelektualët dhe veprimtarët më me ndikim në kuadër të veprimtarisë revolucionare të grupeve klandestine të shqiptarëve në Jugosllavi), e realizuar para demonstratave të vitit 1981, përkatësisht në vitin 1980, dhe e publikuar më 20 janar 1982 në gazetën gjermane "Tagische Zeitung", veçanërisht dy përgjigjet e tij:

> ***"Por cili është qëllimi i Lëvizjes Çlirimtare?***
>
> *Jusuf Gërvalla: Qëllimi jo vetëm i Lëvizjes Çlirimtare, por edhe i të gjitha forcave përparimtare, është shkëputje nga Jugosllavia dhe Bashkimi me Shqipërinë amë!*
>
> ***A arsyetohet kjo vetëm me përkatësi nacionale apo ka edhe aspekte shoqërore e politike. A do ta kërkonit ju bashkimin pavarësisht se në Shqipëri mbretëron sistemi radikal komunist, radikal demokratik ose një sistem i së drejtës?***
>
> *Jusuf Gërvalla: Pavarësisht nga çfarëdo sistemi!"*[125]

Në periudhën e viteve '80-'90 u dënuan me burgime të rënda mijëra shqiptarë për "veprimtari armiqësore kundër Jugosllavisë". Konsiderohet se rreth 80 % e të burgosurve politikë në ish-Jugosllavi kanë qenë shqiptarë, ndaj të cilëve u përdorën tortura të rënda, ku kishte edhe raste të vrasjeve gjatë torturave. Gjithashtu, në ushtrinë jugosllave u burgosën qindra dhe u vranë dhjetëra ushtarë shqiptarë për "veprimtari armiqësore

[125] Intervistë e Jusuf Gërvallës botuar në gazetën gjermane "Tagische Zeitung":https://m.gazetaexpress.com/arkiva/interviste-e-jusuf-gervalles-botuar-ne-gazeten-gjermane-tages-zeitung-131866/?arch_tb=temphttps://rajonipress.com/interviste-e-jusuf-gervalles-botuar-ne-gazeten-gjermane-tagische-zeitung/

kundër Jugosllavisë". Versioni zyrtar i regjimit të Beogradit për këto vrasje ishte se ushtarët shqiptarë "bënin vetëvrasje". Edhe para vitit 1981 ka pasur raste të vrasjeve të ushtarëve shqiptarë në ushtrinë jugosllave, por pas vitit 1981 numri i këtyre rasteve shpeshtohet. Sipas studiuesit Qazim Berisha, numri dhe emrat e verifikuar të ushtarëve shqiptarë të vrarë në ushtrinë jugosllave, vetëm në periudhën 1981-1991, është:

1. Besim (Xhemë) Bajraktari, nga Juniku i Deçanit; 2. Sami (Ali) Gashi nga Prishtina; 3. Asllan (Ukë) Gashi nga Suhareka; 4. Halil (Habib) Hajrullahu nga Banulla e Lipjanit; 5. Shaban (Sadik) Prushi nga Zylfaj e Gjakovës; 6. Qerim (Abdurrahman) Aliu nga Kumanova; 7. Nazmi (Avdullah) Muja nga Gradica e Drenasit; 8. Latif (Mehmet) Zeqiri nga Kaçanolli i Mitrovicës; 9. Rasim (Ramadan) Zeka nga Metergovci i Podujevës; 10. Halil (Halim) Binaku nga Gllareva e Drenasit; 11. Shefqet (Avdyl) Prekazi nga Prekazi i Drenasit; 12. Yzeir (Rrustem) Sadiku nga Rahovica e Preshevës; 13. Sami (Shani) Krasniqi nga Buçe e Sharrit; 14. Ismet (Muharrem) Bojku nga Deçani; 15. Hasan (Telat) Sezairi nga Gostivari; 16. Mustafë (Ramadan) Hoxha nga Bellanica e Suharekës; 17. Adem (Binak) Osmanaj nga Turbohovci i Istogut; 18. Mustafë (Arif) Pantina nga Gllareva e Klinës; 19. Enver (Selman) Elezi nga Shkupi; 20. Murat (Muharrem) Isufi nga Haraçina e Shkupit; 21. Naser (Shaqir) Gashi nga Kopiliqi i Poshtëm i Skenderajt; 22. Agron (Haxhi) Ferizi nga Kodralia e Deçanit; 23. Beqir Sahiti nga Stublla e Vitisë; 24. Ejup (Fejzë) Sahiti nga Papazi i Ferizajt; 25. Mujë (Rexhep) Maqaj nga fshati Bregu i Zi i Lipjanit; 26. Rexhep (Ismet) Blakaj nga Jabllanica e Pejes; 27. Enver Hasi nga Poroj i Tetovës; 28. Inajet (Fuad) Istrefi nga Veleshta e Strugës; 29. Erdogan (Alajdin) Morina nga Prizreni; 30. Mustafë (Mumin) Ramadani nga Bozofci i Tetovës; 31. Aziz (Sadik) Kelmendi nga Karaçica e Lipjanit në vendbanim në Arbanë të Prizrenit; 32. Qani (Muharrem) Shabani nga Rahoveci; 33. Ramush Shala nga Rufci i Lipjanit; 34. Tafil (Zahir) Hyseni nga Lumbardhi (Velikoreka) i Podujevës; 35. Abedin (Selman) Bala nga Korrotica e Drenasit; 36. Fadil (Xhafer) Gashi nga Doberdoli i Podujevës; 37. Haki (Rexhep) Shatri nga Tomoci i Istogut; 38. Fadil (Selim) Berdynaj nga Radavci i Pejës; 39. Sami (Daut) Shabani nga Zaskoku i Ferizajt; 40. Raif (Adem) Isufi nga Kotorri i Skenderajt; 41. Besim (Hashim) Fazliu nga Prishtina; 42. Bedri (Nimon) Bajgora nga Vushtrria; 43. Ibrahim (Isuf) Kastrati nga Turjaka e Rahovecit; 44. Miftar (Sylë) Tali nga Babaj i Bokës së

Gjakovës; 45. Naser (Xhafer) Gashi nga Orrobërda e Istogut; 46. Naim (Ramadan) Ajgeri; 47. Osman (Hajdar) Ismajli nga Gërbavci i Medvegjes; 48. Afrim (Muhamet) Lushtaku nga Prekazi i Skenderajt; 49. Qamil (Ramadan) Thaçi nga Demjani i Gjakovës; 50. Enver (Shaban) Ramadani nga Broja e Skenderajt; 51. Xhavit (Alush) Berisha nga Prugoci i Prishtinës; 52. Isuf Krasniqi nga Gllobar i Drenasit; 53. Halim (Shaqir) Lita nga Klina; 54. Jetullah (Haxhi) Desku nga Siçeva e Klinës; 55. Hamit (Jahë) Haxhiu nga Batusha e Gjakovës; 56. Enver (Salih) Maksutaj nga Orrebërda e Istogut; 57. Xhevdet (Hajredin) Aruçi nga Rezalla e Skenderajt; 58. Izet (Sadri) Bushi nga Pusteniku i Kaçanikut; 59. Vahedin (Xhemshit) Hajrizi nga Kuklibegu i Dragashit; 60. Rrustem Bejta nga Prekazi i Skenderajt; 61. Fatmir (Adem) Tafaj nga Grejkoci i Suharekës; 62. Zenun Lushaj nga Gjonaj i Hasit të Prizrenit; 63. Agim (Salih) Gllareva nga Vërboci i Drenasit; 64. Setar (Mustafë) Ramadani nga Osek Hilë i Gjakovës; 65. Ali (Nazif) Sahiti nga Komogllava e Ferizajt; 66. Fahrush (Emrush) Emini nga Zhitija e Vitisë; 67. Tahir (Azem) Gashi nga Verbovci i Drenasit; 68. Afrim (Bahtir) Hyseni nga Lumbardhi i Podujevës; 69. Ali (Sinan) Rrustemi nga Rezniku i Vushtrrisë; 70. Florim (Adem) Kosumi nga Tuxheci i Kamenicës; 71. Haki (Din) Morina nga Gllareva e Klinës; 72. Lulzim (Faik) Rexhepi nga Zabeli i Epërm i Drenasit; 73. Muhamet (Raif) Biçkaj nga Hogoshti i Kamenicës; 74. Muharrem (Mehmet) Robeli nga Laqiçi i Kamenicës; 75. Mumin (Hafiz) Shkodra nga Sadovina e Çerkezve të Vitisë; 76. Rexhep (Zijadin) Ahmeti nga Dobratini i Podujevës; 77. Samedin (Fazli) Krasniqi nga Tërpeza e Drenasit; 78. Selmon (Shpend) Metaj nga Shushica e Istogut; 79. Raif (J.) Miftari nga Medvegja; 80. Fatmir (Nezir) Krasniqi nga Prishtina; 81. Rexhep (Zijadin) Ahmeti nga Tërpeza e Drenasit; 82. Sefer (Mustafë) Ramadani nga Osek Hilë i Gjakovës; 83. Skender (D) Kryeziu nga Capari i Prizrenit; 84. Ejup (S) Bedrolli nga Çallapeku i Lipjanit; 85. Burim (Sherif) Behrami nga Mitrovica; 86. Ejup (Esat) Gashi nga Bardhi i Madh i Fushë-Kosovës; 87. Vesel (D) Duraku nga Demjani i Gjakovës; 88. Ali (Nazif) Sahiti nga Komogllava e Ferizajt; 89. Rasim (R) Istrefi nga Kovaçica e Mitrovicës; 90. Xhevdet (Z) Musliukaj nga Mitrovica; 91. Afrim Zylfiu nga Kumanova; 92. Elez Halipi nga Vrapçishta e Gostivarit; 93. Fadil Salihu nga Livoqi i Poshtëm i Gjilanit; 94. Halim Gashi nga Akllapi i Lipjanit; 95. Ilaz Fazliu nga Polatica e Tetovës; 96. Ilmi Popaj nga Bellacërka e Rahovecit; 97. Mirsad Çekiç nga Peja; 98. Muharrem Muharremi nga Fshati i Vjetër i Ferizajt; 99. Nexhmedin Osmani…; 100. Numan Rexhepi nga Tetova; 101. Shaip Behrami nga Pakashtica e Podujevës; 102.

> Sherif Kashtanjeva nga Nerodimja e Ferizajt; 103. Shukri Kelani nga Prishtina; 104. Xhevdet Pomak nga Brodi i Dragashit; 105. Xhiman Alia nga Skrobishta e Prizrenit; 106. Abedin (Sabit) Krasniqi nga Bardhi i Vogël i Fushë-Kosovës; 107. Gëzim (Sefer) Hasan nga Strofci i Vushtrrisë; 108. Sefer (Bislim) Çukovci nga Cërnilla e Ferizajt.[126]

Gjatë fillimviteve '80 filloi gradualisht edhe zhbërja politike e elitës institucionaliste të shqiptarëve të Kosovës. Pas demonstratave të vitit 1981, dy nga udhëheqësit institucionalistë më me ndikim në Kosovë, Mahmut Bakalli dhe Fadil Hoxha, dhanë "dorëheqje", ndërsa pasardhësit e tyre më me ndikim që kishin mbetur, ishin Azem Vllasi dhe Kaqusha Jashari.

Në fundvitet '80 situata e përgjithshme në Kosovë u përkeqësua edhe më shumë si rezultat i ardhjes në pushtet në Serbi, e neofashistit Slobodan Milošević, i cili shumë shpejt i inicioi përgatitjet për suprimimin e autonomisë së Kosovës. Si reaksion kundër inicimit për suprimimin e autonomisë së Kosovës, rezultuan protestat e shqiptarëve në fundvitin 1988 dhe u fuqizuan në fillimvitin 1989, veçanërisht nëpërmes grevës së minatorëve më 20-28 shkurt dhe të studentëve 19-29 shkurt.

Në muajin shkurt 1989, një grup i intelektualëve shqiptarë inicioi nënshkrimin e një Apeli kundër suprimimit të autonomisë së Kosovës i cili u nënshkrua nga 215 intelektualë shqiptarë ku, përveç të tjerash, apelohej të mos prekeshin parimet themelore të Kushtetutës së vitit 1974.[127] Më 23 mars të vitit 1989, nën rrethimin policor e ushtarak të Kuvendit të Kosovës, u imponua suprimimi i autonomisë së Kosovës. Një pjesë e delegatëve shqiptarë të Kuvendit të Kosovës (si pjesë e establishmentit të elitës institucionaliste të Kosovës), pavarësisht prej presionit, e kundërshtuan hapur ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës: Riza Lluka, Melihate Tërmkolli, Shkëlzen Gusinja, Ukë Bytyqi, Sadik Zuka, Remzi Hasani, Menduh Shoshi, Bajram Buçani,

[126] Qazim Berisha (2020): *Vrasjet e ushtarëve shqiptarë në Armatën Jugosllave 1981-1991*: https://fjala.info/vrasjet-e-ushtareve-shqipare-ne-armaten-jugosllave-1981-1991/).

[127] Cana, 2001: 125-134

Mehdi Uka, Avdi Berisha[128] etj. Të njëjtin vit, me urdhër të Milošević-it, u arrestua edhe Azem Vllasi për "veprimtari kundërrevolucionare".

Suprimimi i Autonomisë së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës ngjalli indinjatë të madhe te shqiptarët, gjë që rezultoi edhe me demonstrata dhe protesta masive gjatë periudhës 1989-1990. Gjatë këtyre demonstratave, përveç burgosjeve dhe persekutimeve, u vranë dhjetëra shqiptarë nga forcat policore dhe ushtarake të Miloševićit. Sipas veprimtarit dhe ish-deputetit të Kuvendit të Kosovës, Emrush Xhemajlit, numri dhe emrat e verifikuar të shqiptarëve të vrarë, vetëm gjatë demonstratave1989-1990 është:

> 1. Ismet Krasniqi nga Grashtica, Prishtinë; 2. Nesimi Elshani nga Nagavci, Rahovec; 3. Bedri Sokoli nga Lluga, Podujevë; 4. Elfete Humolli nga Lupçi i Poshtëm, Podujevë; 5. Agron Fetahu nga Celina, Rahovec; 6. Hilmi Krasniqi nga Hoça e Vogël, Rahovec; 7. Halim Hoti nga Krusha e Madhe, Rahovec; 8. Mehmet Ejupi nga Sekiraça, Podujevë; 9. Agim Rashiti nga Dragashi, Prizren; 10. Agim Kukleci nga Isniqi, Deçan; 11. Basri Ibrahimi nga Smira, Viti; 12. Gjymshit Ahmet Badallaj nga Zhuri, Prizren; 13. Gjylbear Izet Badallaj nga Zhuri, Prizren; 14. Bali Badallaj nga Zhuri, Prizren; 15. Xhemshit Badallaj nga Zhuri, Prizren; 16. Naim Qemajli nga Zhuri, Prizren; 17. Fatmir Hoxha nga Zhuri, Prizren; 18. Haki Pavataj nga Deçani; 19. Zyle Gashi, Prishtinë; 20. Mujë Berisha nga Mazniku, Deçan; 21. Ismet Qorraj nga Carrabregu, Deçan; 22. Xhafer Qorraj nga Carrabregu, Deçan; 23. Selman Haxhosaj nga Pobërxha, Deçan; 24. Musa Gashi nga Peçani, Suharekë; 25. Mirvete Avdiu nga Muzeqina, Shtime; 26. Mustafë Veselaj nga Peçani, Suharekë; 27. Hilmi Jashar Kajtazi nga Vitaku; 28. Bedri Sergjonaj nga Klladonica; 29. Behram Saniçi nga Roshani Mitrovicë; 30. Hakif Bislimi nga Koshtova e Vllahisë, Mitrovicë; 31. Sali Hadërgjonaj nga Vokshi, Deçan; 32. Selat Berisha nga Barileva, Prishtinë; 33. Ismet Krasniqi nga Grashtica, Prishtinë; 34. Muharrem Kabashi nga Dushanova, Prizren; 35. Idriz Rrahmani, Gjilan; 36. Rrahman Demaj, Skenderaj; 37. Bedri Hasanaj,

[128] Telegrafi.com (2014): *Kujtesë: 25 vjet nga suprimimi i dhunshëm i autonomisë së Kosovës*:https://telegrafi.com/kujtese-25-vite-nga-suprimimi-i-dhunshem-i-autonomise-se-kosoves-fotovideo/

Mitrovicë; 38. Sevdat Xhafolli, Prishtinë; 39. Shukrije Obërtinca nga Dobri Dubi, Prishtinë; 40. Nufret Gashi, Suharekë; 41. Muhamet Imeri nga Dushanova, Prizren; 42. Ibrahim Krasniqi, Prishtinë; 43. Ismet Curraj nga Carrabregu, Deçan; 44. Xhafer Curraj nga Carrabregu, Deçan; 45. Muhamet Bytyçi nga Dushanova, Prizren; 46. Bujar Haxhimusa, Mitrovicë; 47. Riza Smajli, Gjilan; 48. Betim Shala nga Nasheci, Prizren; 49. Beqir Shimaniqi nga Roshani, Mitrovicë; 50. Ramadan Zeqiri nga Kopiliçi i Epërm; 51. Istref Gashi, Suharekë; 52. Sakip Bislimi nga Koshtova e Vllahisë, Mitrovicë; 53. Afrim Bytyçi nga Dushanova, Prizren; 54. Rrahman Sopa nga Kaçaniku; 55. Shefki Sejdiu nga Ferizaj; 56. Shaip Bytyçi nga Dushanova, Prizren; 57. Ali Ajeti nga Sveçla - Podujevë, i vrarë në Mitrovicë; 58. Xhemajl Krasniqi, demonstrues i burgosur, i vrarë në burg; 59. Fatmir Hazir Ukaj, Pejë; 60. Agron Ukë Gashi nga Celina, Rahovec; 61. Hilmi Rexhep Krasniqi nga Hoça e Vogël; 62. Halim Malush Hoti nga Krusha e Vogël, Rahovec; 63. Nazim Qemal Elshani nga Nagavci; 64. Reshat Ymeri nga Gjilani; 65. Rexhep Aliu nga Ferizaj; 66. Bekim Ruzhdi Sejdiu nga Koshare, Ferizaj; 67. Meliot Kryeziu, Suharekë; 68. Hysni Abdullah Mazrreku nga Bubaveci, Malishevë; 69. Ali Din Kryeziu nga Bubaveci, Malishevë; 70. Rexhep Selman Aliu nga Bubaveci, Malishevë; 71. Sadik Malaj nga Stanovci i Poshtëm, Vushtrri; 72. Sadri Maksuti nga Stanovci i Poshtëm, Vushtrri; 73. Xhevat Hoxha, Gjakovë; 74. Fatmir Kërleshi, Gjakovë; 75. Qamil Morina, Logjë, Pejë; 76. Fadil Nazmi Talla, Podujevë; 77. Ragip Brahim Hasanmetaj, Strellc, Deçan; 78. Islam Morina nga Topanica, Kamenicë; 79. Sylë Hazir Ukëmetaj, Strellc i Epërm, Deçan; 80. Nuhi Azemi nga Prelezi i Jerlive, Ferizaj; 81. Xhevdet Breznica nga Magura, Lipjan; 82. Enver Morina nga Çikatova e Vjetër, Drenas; 83. Sahit Shala nga Krajkova, Drenas; 84. Gani Daci nga Nabërgjani, Pejë; 85. Ali Hysevukaj, Pejë; 86. Ali Isë Zuka, Pejë; 87. Nazmi Tefiku, Dubravë, Kaçanik; 88. Sadri Shoshi, Istog; 89. Samedin Bylykbashi, Prishtinë; 90. Agron Fetahu, Rahovec; 91. Milazim Karaxha, Çikatovë, Drenas; 92. Smajl Lladrovci, Gllanasellë, Drenas; 93. Xhavit Lladrovci, Gllanasellë, Drenas; 94. Shani Morina, Drenas; 95. Bahtijar Gashi, Prizren; 96. Sylë Ukë Haxhaj, Carrabreg, Deçan; 97. Haziz Shora, Kaçanik; 98. Milot Kryeziu, Suharekë; 99. Qazim Shoshi, Kashicë, Istog; 100. Ali Tafa, Shtime; 101. Vehbi Shesholli, Zveçan, Mitrovicë; 102. Rasim Sheqer Mulliqi, Beleg, Deçan; 103. Osman Vokshi, Pejë;

104. Osë Muqaj, Podujevë; 105. Ragip Hasanmetaj, Strellc i Epërm, Deçan.[129]

Kjo situatë e rëndë politike në Kosovë koincidoi me shembjen e murit të Berlinit që, përveç të tjerash, ndikoi për ndryshimet e mëdha politike gjithandej në shtetet autoritare dhe diktatoriale, duke përfshirë edhe Jugosllavinë. Në këtë vazhdë rezultoi pluralizmi politik në Jugosllavi dhe pjesa dërrmuese e elitës akademike e Kosovës më 23 dhjetor 1989 themeluan Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK), në krye me kryetarin e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, Ibrahim Rugova. Për strategjinë politike të simbolit të rezistencës paqësore të Kosovës, Ibrahim Rugova, dhe për gjendjen politike në Kosovë në fillimvitet '90, Malcolm, përveç të tjerash, shkruan:

> "Politika themelore e ndjekur nga Rugova në LDK që nga viti 1990 ka pasur tri aspekte: së pari, për ta penguar revoltën e dhunshme; së dyti, për ta 'ndërkombëtarizuar' problemin e Kosovës, që do të thotë për t'i kërkuar format e ndryshme të ndërhyrjes politike ndërkombëtare (duke filluar me ndërmjetësimin diplomatik e deri te vënia e protektoratit të Kombeve të Bashkuara mbi Kosovën); dhe, së treti, për ta mohuar sistematikisht legjitimmitetin e pushtetit serb, duke i bojkotuar zgjedhjet dhe regjistrimet dhe duke krijuar së paku konturet e një aparati shtetëror të 'Republikës së Kosovës'. Synimi i parë nga këto të tria ka qenë i suksesshëm deri në një farë mase, gjë që vështirë se mund të përfytyrohej nga kush njeh traditën luftarake të shqiptarëve dhe historinë e tyre të gjatë të kryengritjeve të armatosura. Synimi i dytë i dha mundësinë Rugovës që të bënte një numër të madh vizitash nëpër kryeqytete të huaja, por me këtë u arrit pak si, p. sh., miratimi i disa rezolutave nga disa forume, siç janë Kombet e Bashkuara dhe Parlamenti Evropian. Si qëllimi i dytë i politikës, ashtu edhe qëllimi i tretë, kontestojnë tok një ide e cila ende njihet si parim nga fuqitë më të mëdha të Perëndimit se statusi i Kosovës është vetëm një çështje e brendshme e Serbisë. Me formimin e institucioneve të një republike të ndarë, shqiptarët e Kosovës ishin angazhuar në një strategji politike që fillon me kushtin "sikur të ishte". Të sillesh sikur Kosova nuk ishte pjesë e

[129] Emrush Xhemajli (2009): *Në ligjin për dëshmorët dhe familjet e tyre të përfshihen edhe të rënët para fillimit të luftës së UÇK-së.* Konferencë shtypi e deputetit Emrush Xhemajli, kryetar i LPK-së (beepworld.de)

Serbisë, do të dukej, me një fjalë, një shtirje e thjeshtë, mirëpo në qoftë se kjo strategji do të vazhdojë me vendosmëri për një kohë mjaft të gjatë, atëherë qeveritë e jashtme do të jenë të detyruara, më në fund, të pranojnë se i kishin besuar një fantazie, kur kishin vazhduar ta trajtonin Kosovën pjesë përbërëse e shtetit të Serbisë. Pyetja që u shtrohej shqiptarëve, së këndejmi, ishte: edhe sa do të jenë në gjendje të durojnë dhe sa duhet të vuajnë ndërkohë? Të shkruash një analizë të mirëfilltë për shkeljen e të drejtave të njeriut nga të cilat vuajnë shqiptarët e Kosovës që nga viti 1990, do të nevojiteshin edhe një sërë kapitujsh të gjatë. Është shkatërruar çdo aspekt i jetesës në Kosovë. Duke zbatuar një kombinim masash të jashtëzakonshme, dekretesh dhe ligjesh administrative që autorizonin përjashtimin e çdokujt nga puna, i cili kishte marrë pjesë në ndonjë protestë njëditëshe, autoritetet serbe dëbuan shumicën dërrmuese të gjithë shqiptarëve që kishin qenë në punë shtetërore. U përjashtuan nga puna edhe shumica e mjekëve dhe e personelit tjetër shëndetësor shqiptarë nga spitalet; ndërsa numri i vdekjeve nga sëmundja e fruthit dhe e polios, filloi të shtohet meqë njëherësh po binte edhe numri i shqiptarëve të vaksinuar. Më 1990, përafërsisht 6 000 arsimtarë u dëbuan nga puna për shkak të pjesëmarrjes në protesta, kurse të tjerët u përjashtuan nga puna, kur refuzuan t'i pranonin planprogramet e reja serbe që eliminonin mësimin e letërsisë dhe të historisë shqiptare. Në disa vende arsimtarëve shqiptarë iu lejua t'i vazhdonin mësimet (pa paga) në ndërtesat shkollore, megjithatë ndaj tyre u zbatua një segregacion i ashpër fizik, me ç'rast, fjala vjen, u ndanë banjat dhe nevojtoret e veçanta për fëmijët shqiptarë dhe të tjerat për fëmijët serbë - u ndanë pajisjet ose inventari, madje në një rast u hoqën xhamat e dritareve nga klasa. Si për shëndetësinë, ashtu edhe për arsimin, shqiptarët organizuan sistemin e tyre "paralel" të klinikave dhe shkollave, në përgjithësi nëpër shtëpitë private; mjekët dhe arsimtarët paguhen nga "Republika" (në të vërtetë nga LDK-ja), nga taksat e 3-përqindëshit që paguhet vullnetarisht nga diaspora. Në këtë mënyrë, është siguruar mësimi për 400 000 nxënës, mirëpo arsimtarët dhe organizatorët shpeshherë u nënshtrohen arrestimeve, kërcënimeve dhe rrahjeve nga policia serbe. Arrestimet arbitrare dhe dhuna policore u shndërruan në rutinë. Ligji serb i lejon arrestimet dhe dënimin e menjëhershëm deri në dy muaj burgim të secilit që ka bërë "një delikt verbal", siç është fyerja e "ndjenjave patriotike" të qytetarëve serbë. Ai lejon, po ashtu, procedurën e njohur si "bisedë informative", në saje të së cilës njeriu mund të thirret në stacion policor dhe të merret në pyetje tri ditë me radhë: më 1994, 15 000 veta në Kosovë u morën në pyetje në këtë mënyrë, zakonisht pa u

> thënë se cila ishte arsyeja... Ligji serb, natyrisht, nuk lejon rrahjen e njerëzve të arrestuar nga policia, mirëpo shumë dëshmi të gjalla ekzistojnë për rrahjet jashtëzakonisht barbare të shqiptarëve me shkopinj gome, me përdorimin e shokut elektrik në gjenitale etj. Në Kosovë, po ashtu, shkelen shumë shpesh edhe ligjet zyrtare për bastisjen legjitime të shtëpive të banorëve: shtëpitë bastisen shpesh pa kurrfarë arsyetimi dhe me atë rast policia konfiskon (vjedh) mallrat dhe paratë. Vetëm më 1994 Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Liritë Qytetare në Kosovë ka shënuar 2 157 sulme fizike kundër qytetarëve nga policia, 3 553 bastisje shtëpish private dhe 2 963 arrestime arbitrare" (Malcolm 2001: 363-365).

Pikënisja konkrete dhe themelimi i UÇK-së

Diaspora shqiptare në përgjithësi dhe emigracioni politik shqiptar në veçanti e kanë pasur një rol shumë të rëndësishëm në kuadër të proceseve për kombformimin, dhe faktorizimin politik të shqiptarëve në Ballkan. Megjithëkëtë, politizimi i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore i ka pasur pasojat e veta edhe në emigracion sepse deri në vitet '70 elita e emigracionit politik shqiptar ka qenë kryesisht e shqetësuar me ndonjë përjashtim (Hysen Tërpeza, Tahir Kerrnaja, Sami Repishti, Ihsan Toptani etj.), vetëm me veprimtarinë kundër regjimit diktatorial të Enver Hoxhës dhe jo me ndonjë veprimtari konkrete për çlirimin e Kosovës me vise.

Pas demonstratave të vitit 1981 regjimi i Beogradit i vuri në shënjestër edhe veprimtarët e grupeve klandestine, në kuadër të emigracionit politik shqiptar, të cilët organizonin demonstrata dhe protesta në disa qendra të shteteve perëndimore, me qëllim të sensibilizimit të opinionit ndërkombëtar për shtypjen e shqiptarëve në Jugosllavi dhe për kërkesën "Kosova Republikë", si kërkesë për barazi të shqiptarëve me popujt e tjerë në kuadër të Federatës Jugosllave. Kjo konsiderohej një kërcënim për imazhin e Jugosllavisë e veçanërisht të Serbisë në lidhje me çështjen e Kosovës ngaqë regjimi i Beogradit bënte përpjekje të vazhdueshme të paraqiste dhe ta ruante imazhin e rrejshëm të

Jugosllavisë në kuadër të arenës ndërkombëtare. Përveç të tjerash, Jugosllavia, edhe pse ishte nënshkruese e Deklaratës së Helsinkit (1975), ku në mesin 10 parimeve të kësaj deklarate përfshihej edhe parimi për respektimin e të drejtave të njeriut, nuk e respektonte fare në praktikë këtë parim. Prandaj nismat e veprimtarëve shqiptarë në diasporë për prishjen e imazhit të rrejshëm të Jugosllavisë ndikuan që shërbimi i sigurisë shtetërore jugosllave (UDB), të përpiqet të përçajë, të frikësojë dhe ta dobësojë sa më shumë veprimtarinë e emigracionit politik shqiptar, madje edhe nëpërmes organizimit të atentateve. Më 14 prill 1981 në Frankfurt të Gjermanisë u plagos rënd veprimtari Rasim Zenelaj, ndërsa më 10 tetor 1981 në Bruksel të Belgjikës u vra veprimtari Vehbi Ibrahimi (që të dy veprimtarë të grupit Besëlidhja Kombëtare Shqiptare, në krye me Emin Fazliun).

Me fjalë të tjera, veprimtaria revolucionare e grupeve klandestine për çlirimin e shqiptarëve në Jugosllavi (pas Luftës së Dytë Botërore), si brenda vendit (në trojet e banuara me shqiptarë në ish-Jugosllavi), ashtu edhe jashtë vendit që nga vitet '70 (në kuadër të emigracionit politik shqiptar), për shkak të rrethanave të vështira për veprim, ka pasur vështirësi të përbashkohet formalisht në një organizatë me strukturë të qëndrueshme politike. Në këtë vazhdë, ndikimin vendimtar për përafrimin e një pjese domethënëse të grupeve revolucionare në kuadër të një organizate me strukturë të qëndrueshme politike e kanë pasur veprimtarët me ndikim të veçantë dhe me përvojë të veçantë, Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, etj., të cilët para demonstratave të vitit 1981 u kishin shpëtuar arrestimeve në Kosovë dhe kishin emigruar në Zvicër dhe Gjermani. Rrjedhimisht, inicimi në diasporë (në vigjilje të demonstratave të vitit 1981), për themelimin e organizatës Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK-së), në krye me Jusuf Gërvallën, Kadri Zekën, Bardhosh Gërvallën, Ibrahim Kelmendin etj., (tre të parët u ekzekutuan në një atentat të UDB-së, në Shtutgard të Gjermanisë, më 17 janar të vitit 1982), dhe inkurajimi i veprimtarisë së LPK-së në Kosovë, në krye me Rexhep Malën, Nuhi Berishën etj., (të cilët

ranë heroikisht më 12 janar të vitit 1984 në Prishtinë, në një përballje të armatosur e të pabarabartë nën rrethimin e forcave policore), është një pikënisje konkrete e fillesës së organizimit të rezistencës së armatosur në Kosovë që më pas rezultoi me UÇK-në.

Formalizimi i themelimit të LPK-së, e njohur nga viti 1982 si Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi (LRShJ), nga viti 1985 e njohur si Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK), dhe nga viti 1993 e njohur si Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK), është i bazuar edhe në platformën "Teza rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës" e lëshuar në qarkullim në qershor 1981, nga Hydajet Hyseni, Mehmet Hajrizi, Nezir Myrtaj etj. Dhe, bazuar në takimin e 17 shkurtit 1982 në mes të përfaqësuesve të dy grupeve klandestine, Sabri Novosellës dhe Abdullah Prapashticës, me Konsullin e Shqipërisë në Turqi, Bujar Hoxhën, (përndryshe i biri i Hoxhë Kadri Prishtinës - kryetar i Komitetit për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës). Ndërsa më 15 maj 1982 udhëheqjes së LPK-së iu bashkëngjit Xhafer Shatri[130], i cili përfaqësonte grupin më të fuqishëm klandestin në Kosovë gjatë viteve '70 (Grupi Revolucionar i Kosovës, i njohur edhe si Grupi Marksist Leninist i Kosovës).

Në këtë vazhdë, nga njëra anë, Dega e LPK-së brenda vendit (në trojet e banuara me shqiptarë në ish-Jugosllavi) e vazhdoi veprimtarinë çlirimtare gjatë viteve '80-'90 pavarësisht prej rrethanave të vështira për veprim. Gjatë kësaj periudhe strukturat e regjimit të Beogradit në Kosovë me vise, burgosën, torturuan dhe vranë veprimtarë dhe simpatizantë të LPK-së. Në kuadër të kësaj veprimtarie, gjatë viteve '80-'90 u vranë nën rrethim dhe përballje të armatosur e të pabarabartë me forcat policore, u dënuan me burgje të rënda, dhe vdiqën si pasojë e torturave, edhe disa ndër drejtuesit dhe veprimtarët më të spikatur të veprimtarisë klandestine dhe të Degës së LPK-së brenda vendit,

[130] Emrush Xhemajli (2002): *Lëvizja Popullore e Kosovës 1982-2002*: http://lpk-kosova.com/historiku.html

përveç të tjerëve: Bajram Bahtiri, Zijah Shemsiu, Kadri Osmani, Enver Topalli, Xhavit Haziri, Fehmi Lladrovci, Metush Krasniqi, Ahmet Haxhiu, Arif Seferi, Ali Ajeti, Afrim Zhitia, Fahri Fazliu, Fadil Vata, Bejadin Hallaqi, Xhemaijli Berisha, Xhemail Blakaj, Tahir Lush Berisha, Hasan Ramadani, Mehë Ramë Uka, Xhevat Qerimi, Besim Latifi, Skender Munolli, Hysen Zogiani, Shaban Shala, Nazmi Hoxha, Hysen Gega, Xhabir Morina etj. Kjo vazhdimësi e veprimtarisë brenda vendit, ka qenë jetike për mundësinë e organizimit të kryengritjes së armatosur në Kosovë në fund-vitet '90. Në kuadër të këtyre zhvillimeve, një rol shumë të rëndësishëm ka pasur simboli i guximit akademik, Ukshin Hoti, i cili, (përveçse me bashkëveprimtarët, Halil Alidemaj etj., e kanë përkrahur hapur kërkesën për Republikën e Kosovës, gjatë demonstratave të vitit 1981), ka qenë një inkurajues i madh për veprimtarët e LPK-së.

Nga ana tjetër, Dega e LPK-së jashtë vendit (në kuadër të emigracionit politik shqiptar), e ka ndihmuar në vazhdimësi organizimin dhe riorganizimin (pas goditjeve) të Degës së LPK-së brenda vendit dhe e ka pasur një rol të rëndësishëm për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës sepse në vazhdimësi organizoi demonstrata dhe protesta në qendrat e shteteve perëndimore, duke apeluar për ndaljen e shtypjes dhe diskriminimit të shqiptarëve në Jugosllavi, duke insistuar për kërkesën "Kosova Republikë" (si një kërkesë e drejtë për barazinë në mes të popujve në kuadër të federatës jugosllave) dhe duke e ushtruar njëkohësisht veprimtarinë lobiste dhe të diplomacisë joformale. Në këtë drejtim, një kontribut të veçantë e kanë dhënë edhe disa struktura lobiste dhe të diplomacisë joformale të ish-emigracionit politik shqiptar, të themeluara para shembjes së murit të Berlinit: Organizata Rinia Shqiptare-Kosovare në Botën e Lirë në Nju-Jork (1970), Komiteti i Kosovës për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut në Belgjikë (1983), Komiteti i Kosovës për Informimin e Opinionit Botëror në Zvicër (1985), Grupi për Ballkanin i Komitetit Norvegjez të Helsinkit në kuadër të Federatës Ndërkombëtare

të Helsinkit (1988) që bashkëpunonte drejtpërdrejt me LPK-në, Shoqata Migjeni në Slloveni (1989), Liga Qytetare Shqiptaro-Amerikane (1989) etj. Kjo veprimtari lobiste dhe e diplomacisë joformale ndikoi, përveç të tjerash, për sensibilizimin e çështjes së Kosovës në kuadër të kancelarive diplomatike të shteteve perëndimore dhe në kuadër të "Procesit të Helsinkit" (si një proces shumë i rëndësishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare në mes të Lindjes dhe Perëndimit, që rezultoi me fitoren e shteteve perëndimore).

LPK-ja ishte e vetmja organizatë e fuqishme politike e shqiptarëve në ish-Jugosllavi dhe në diasporë që në programin e vet nuk e përjashtonte kryengritjen e armatosur si mjet të fundit për çlirimin e shqiptarëve në Jugosllavi (pasi që të gjitha mjetet e tjera politiko-diplomatike të konsumohen). Pas themelimit të LPK-së, në vitin 1982, katër mbledhjet e përgjithshme të kësaj organizate që janë mbajtur në vitin 1987, 1989, 1991, 1993 dhe kështillat e përgjithshëm që kanë rezultuar nga këto mbledhje të përgjithshme, si organi më i lartë udhëheqës i LPK-së, e kanë ruajtur kontinuitetin organizativ për mundësinë e kryengritjes së armatosur në Kosovë, pas konferencës së Dejtonit.

Mbledhja e Parë e Përgjithshme e LPK-së është mbajtur në korrik 1987 në Zvicër, nën organizimin e Degës së LPK-së jashtë vendit, ku të pranishëm ishin edhe delegatët/përfaqësuesit e Degës së LPK-së brenda vendit. Kjo mbledhje kontribuoi, përveç të tjerash, për riorganizimin e LPK-së në kuptimin e zgjerimit të radhëve si në Kosovë ashtu edhe në diasporë, ku pothuajse në të gjitha shtetet e Evropës perëndimore u themeluan degët e LPK-së (këshillat popullore të LPK-së). Edhe në ShBA Klubi Kombëtar "Jusuf Gërvalla" me seli në Nju-Jork funksionoi për një kohë si degë e LPK-së, me nëndegët në Detroit, Chicago, Dallas etj., në krye me: Rrok Nikçin, Ahmet Zherkën, Gjeto Sinishtajn, Kolë Gojçin, Gjokë Martinin, Gjergj Kalajn, Ndue Camajn, Rexhep Vuçetajn, Ramiz Llapatincën, Shpend Haxhajn, Bruno Selimajn, Naim Balidemajn, Gjergj Dedvukajn, Prelë Camajn, Pjetër Berishën, Pjetër Shkrelin,

Nikollë Berishajn, Ismail Gjonbalajn, Zefë Kalajn, Gjyste Kalajn, Prena Camajn, Kumrije Selimajn, Gjyste Ivezajn, Nurije Rugovën, Gazmend Lleshin, Agim Gashin, Ajet Shkupin, Ali Popovën, Shefqet Matin, Rexhep Dedushajn, Rrok Dedvukajn,[131] Din Egriun, Esad Gjonbalajn etj.

Programi i LPK-së për herë të parë u aprovua në Mbledhjen e Parë të Përgjithshme dhe u botua në organin e LPK-së "Zëri i Kosovës", nr. 7, 1987. Në botimin e dytë të programit të LPK-së, në dhjetor 1989 (në gjuhën shqipe, frënge, gjermane dhe kroate), u përfshinë edhe ndryshimet që u bënë në Mbledhjen e Dytë të Përgjithshme të LPK-së[132], e cila u mbajt në tetor 1989 në Zvicër, nën organizimin e Degës së LPK-së, jashtë vendit, ku të pranishëm ishin edhe delegatët/përfaqësuesit e Degës së LPK-së brenda vendit. Në nenin III të këtij programi, përveç të tjerash, thuhet:

> "Krahas përpjekjeve për Republikën, Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës organizon edhe rezistencën në çdo ndërmarrje, fshat, shkollë, lagje e fakultet për mbrojtjen e të drejtave kombëtare, politike, ekonomike dhe shoqërore të klasës punëtore, fshatarësisë, rinisë, gruas, inteligjencies etj., i kundërvihet plaçkitjes së pasurive të Kosovës dhe mbron kulturën materiale dhe shpirtërore të popullit tonë. Për realizimin e kërkesave dhe qëllimeve të veta LPRK do t'i përdorë të gjitha format e luftës demokratike-paqësore dhe revolucionare, do t'i kombinojë dhe do t'i zëvendësojë ato në përputhje me kërkesat e situatës, taktikës dhe strategjisë së saj. Në veprimtarinë e saj LPRK i jep përparësi organizimit dhe veprim-

[131] Shkruan: Qazim Doda, Nju-Jork: *Rrok Nikçi ishte kelmendasi që vlente më shumë se qeveritë e dy shteteve tona*: https://www.google.no/amp/s/qazimdoda.wordpress.com/2015/11/20/rrok-nikci-ishte-kelmendasi-qe-vlente-me-shume-se-qeverite-e-dy-shteteve-tona/amp/Intervistë me Ramiz Llapatincën, ish-drejtues i Klubit Kombëtar "Jusuf Gërvalla" në Nju-Jork, botuar në librin *Shqiptarët e Amerikës:* http://illyriapress.com/na-la-ramiz-llapatinca-atdhetari-piktori-i-urti-e-i-palodhuri/Intervistë me Shpend Haxhaj – Hoti, dhënë AA Vision "*Me shqiptarët e Amerikës"* :https://www.google.no/amp/plavaeguciasot.com/interviste-me-shpend-haxhaj-hoti-dhene-aa-vision-me-shqiptaret-e-amerikes/amp/Intervistë me veprimtarin Gazmend Lleshi dhënë AA Vision "*Me shqiptarët e Amerikës*: https://www.facebook.com/watch/?v=2385085775117207

[132] Programi i Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës (1989): 2

> tarisë ilegale. Por, krahas kësaj, LPRK do t'i shfrytëzojë të gjitha format e mundshme të luftës legale. Jashtë shtetit LPRK i organizon dhe mobilizon mërgimtarët. LPRK është kundër reformizimit dhe legalizimit borgjez, njëkohësisht kundërshton pikëpamjet e metodat anarkiste e terroriste të luftës të cilat dëmtojnë rëndë dhe e kompromet ojnë çështjen tonë të drejtë. LPRK lufton përpjekjet e armikut që me anë të fesë, hakmarrjes dhe vëllavrasjes tenton ta përçajë popullin tonë" (Programi i Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës 1989: 20-21).

Në të njëjtin vit (1989) u formua një sektor ushtarak në kuadër të LPK-së.[133] Rrjedhimisht, organizimi i Mbledhjes së Dytë të Përgjithshme të LPK-së në vitin 1989 kontribuoi edhe për legjitimimin e këtij sektori që kishte për detyrë parapërgatitjen e kryengritjes së armatosur në Kosovë. Në kuptimin e futjes më të madhe të armatimit në Kosovë dhe krijimin e kushteve për kryerjen e aksioneve të mundshme guerile, si opsion i fundit për çlirimin e shqiptarëve në Jugosllavi.

Në Mbledhjen e Tretë të Përgjithshme të LPK-së, mbajtur në tetor të vitit 1991 në fshatin Ujmir në Kosovë (në shtëpinë e veprimtarit Sadri Shala), u mor vendimi që të themelohet një forcë e armatosur në Kosovë.[134] Ndërsa në Mbledhjen e Katërt të Përgjithshme të LPK-së, mbajtur në korrik të vitit 1993 në Prishtinë (në shtëpinë e veprimtarit Fatmir Brajshori), u mor vendimi për nismën e kryengritjes së armatosur dhe u bënë ndryshimet e mëtutjeshme programore të LPK-së, ku në nenin III, përveç të tjerash, thuhet: "Për arritjen e aspiratave kombëtare LPK do t'i përdorë të gjitha mjetet e luftës çlirimtare: demokratike, paqësore dhe politike dhe të rezistencës së armatosur. LPK, si mjet për arritjen e qëllimit, parasheh luftën e armatosur për çlirimin e Kosovës".[135] Në bazë të këtyre vendimeve filloi shndërrimi i këshillave të LPK-së në Kosovë në njësi të

[133] Emrush Xhemajli (2002): *Lëvizja Popullore e Kosovës 1982-2002*: http://lpk-kosova.com/historiku.html

[134] Emisioni "Rasti V - VI", pjesa 1 dhe 2, mysafir: Ibish Neziri etj (2019): https://www.youtube.com/watch?v=RBW2PLxy9K4 dhe https://www.youtube.com/watch?v=JGS8QgABPSw&feature=youtu.be

[135] *Zëri i Kosovës*, nr. 15, 15 shtator 1993, programi i LPK-së, f. 4

armatosura. Gjatë kësaj periudhe udhëheqës emblematikë të LPK-së në Kosovë kanë qenë Ahmet Haxhiu, Xhavit Haziri dhe Bejadin Hallaqi, të cilët, së bashku me disa veprimtarë të tjerë, u arrestuan nga shërbimi sekret serb menjëherë pas Mbledhjes së Katërt të Përgjithshme të LPK-së (1993).

Meqë Dega e LPK-së brenda vendit, e veçanërisht udhëheqja e saj goditej në vazhdimësi (me burgosje, tortura dhe vrasje), Dega e LPK-së jashtë vendit (në kuadër të emigracionit politik shqiptar) kishte kompetencat që në situata të caktuara të merrte përgjegjësinë për udhëheqjen e përgjithshme të organizatës. Kjo bartje e kompetencave ndodhi konkretisht pas Mbledhjes së Katërt të Përgjithshme të LPK-së (1993) sepse shërbimi sekret serb (në kuadër të arrestimeve), kishte arritur ta arrestojë edhe udhëheqjen qendrore të LPK-së në Kosovë. Disa nga veprimtarët që u shpëtuan arrestimeve në Kosovë emigruan jashtë vendit, ndërsa një pjesë e veprimtarëve që tashmë vepronin në kuadër të njësive të armatosura në krye me Adem, Hamzë dhe Shaban Jasharin, Zahir Pajazitin, Edmond Hoxhën, Hakif Zejnullahun, Luan Haradinajn, Adrian Krasniqin etj. mbetën të rezistojnë në Kosovë.

Gjatë viteve '90 LPK, dega jashtë vendit, operonte me tre sektorë të rëndësishëm: sektorin e organizimit politik të drejtuar nga Fazli Veliu, Muhamet Kelmendi etj., sektorin e lidhëmbajtjes të drejtuar nga Emrush Xhemajli, Rexhë Ibërdemaj, Adem Grabovci, Gafurr Elshani; dhe sektorin e rëndësisë së veçantë të drejtuar nga Xhavit Haliti, Ali Ahmeti, Azem Syla), duke e përfshirë fondin "Vendlindja Thërret" nga viti 1993, i kryesuar nga Jashar Salihu.[136] Ndërsa si sektor për lobizëm dhe diplomaci ka shërbyer Sektori/Grupi për Ballkanin si pjesë zyrtare e Komitetit Norvegjez të Helsinkit, i themeluar në vitin 1988, në koordinim në mes të Nufri Lekajt, Ibrahim Kelmendit, Xhavit Halitit, e veçanërisht me ndihmën e fuqishme të mikes norvegjeze Berit Backer etj. Ky sektor për

[136] Emrush Xhemajli (2002): *Lëvizja Popullore e Kosovës 1982-2002*: http://lpk-kosova.com/historiku.html

disa vjet ka shërbyer si sektor lobist dhe diplomatik i LPK-së, duke pasur një ndikim të rëndësishëm për ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës në kuadër të Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit etj.[137] Më pastaj, me zhvillimin e ngjarjeve, veprimtaria diplomatike e LPK-së evoluoi, veçanërisht në fundvitet '90, me formimin e Sektorit/Grupit të përfaqësuesve të UÇK-së për marrëdhënie me jashtë, në krye me Bardhyl Mahmutin, Sabri Kiçmarin, Ramadan Avdiun etj.,[138] të cilët më herët, gjatë fundviteve '80, kanë qenë bashkëpunëtorë të udhëheqësve emblematikë të LPK-së në Kosovë, Afrim Zhitisë, Fahri Fazliut etj. Dhe si sektor i propagandës, shërbeu në vazhdimësi që nga fillimvitet '80 redaksia e "Zërit të Kosovës" (e drejtuar nga Skënder Durmishi, Xhafer Shatri, Mustafë Xhemajli, Avni Dehari, Beqir Beqa, Bislim Elshani, Adnan Asllani etj.). Në kuadër të sektorit të propagandës gjatë viteve '80 (me angazhimin e veçantë të veprimtarëve të LPK-së, Mustafë Xhemajli, Ismet Rashiti, Ibrahim Xhemajli etj.), u ngrehën tetë radio lokale në gjuhën shqipe në diasporë.[139] Përveç të tjerash, më 5 maj 1986 kishte filluar transmetimi i radioemisionit të parë "Zëri i Kosovës", në Malme (Suedi), që jepej në kuadër të Shoqatës "Kosova" në gjuhën shqipe, me stafin: Imi Egriu - redaktor, Fitore Sherolli, Shpetime Fida, Sazan Egriu e Haxhi Haxija - folës; Xhemajl Duraku, Musli Fida dhe Sherif Gjonbalaj - instruktorë teknikë.[140] Në vitin 1994 u konsoliduan grupet e gazetarëve të "Zërit të Kosovës" në Prishtinë dhe Tiranë (Nezir Myrtaj, Nuhi Paçarizi, Merxhan Avdyli, Besim Zymberi, Shaban Sinani dhe Naim Zoto).[141]

[137] Kelmendi 2012: 174-175, shih edhe Lekaj 2014: 65-66, 68, 79-81

[138] Kiçmari 2017: 30

[139] Emrush Xhemajli (2002): *Lëvizja Popullore e Kosovës 1982-2002*: http://lpk-kosova.com/historiku.html

[140] Imi Egriu (2011): *Ju flet Radio Zëri i Kosovës*: http://zerikosoves.com/ju-flet-radio-zeri-i-kosoves/

[141] Emrush Xhemajli (2002): *Lëvizja Popullore e Kosovës 1982-2002*: http://lpk-kosova.com/historiku.html

Gjatë viteve 1993-1995 pjesë të këshillave të LPK-së në Kosovë dhe në Maqedoni u shndërruan në njësi të armatosura (në krye me Adem Jasharin, Sahit Jasharin, Durmish Gashin, Halil Çadrakun, Selim Gashin, Xheladin Gashin, Sokol Bashotën, Ragip Shalën, Rexhep Selimin, Mujë Krasniqin, Isa Krasniqin, Asllan Pantinen, Skender Rexhepin, Fadil Nimanin, Rexhep Bislimin, Qerim Kelmendin, Adrian Krasniqin, Gursel Sylejmanin, Beqir Limanin, Xhemajl Jasharin, Ismet Sylejmanin, Shaqir Shaqirin, Jonuz Musliun etj.), dhe me insistimin e tyre, kryesia e LPK-së, dega jashtë vendit, mori vendim për fillimin e lëshimit të komunikatave. Më 17.11.1994 u lëshua komunikata e parë ushtarake dhe u mor vendimi që organizimi i ri ushtarak të quhet (emërtohet) Ushtria Çlirimtare e Kosovës - UÇK.[142] Në këtë vazhdë, një fraksion "radikal" i LPK-së, Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK), iu bashkëngjit UÇK-së.

Rrjedhimisht, datë e themelimit formal të UÇK-së konsiderohet data e komunikatës së parë ushtarake e lëshuar më 17.11.1994, ku u mor vendimi nga kryesia e LPK-së (dega jashtë vendit), që organizimi i ri ushtarak të quhet Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) që, në fakt, bazohej në vendimet e Mbledhjes së Tretë dhe të Katërt të Përgjithshme të LPK-së për themelimin e forcës së armatosur dhe për fillimin e kryengritjes së armatosur në Kosovë, në krye me udhëheqësit emblematikë të LPK-së në Kosovë: Ahmet Haxhiun, Xhavit Hazirin dhe Bejadin Hallaqin. Dhe në ndërlidhjen e këtyre vendimeve me shndërrimin e këshillave popullore të LPK-së në Kosovë, në njësi të armatosura në krye me komandantët emblematikë të UÇK-së, Adem Jasharin, Zahir Pajazitin, Edmond Hoxhën, Hakif Zejnullahun, Luan Haradinajn, Adrian Krasniqin etj., jo se grupe të armatosura nuk kishte edhe më herët para vitit 1994. Për shembull, grupi gueril i quajtur Fronti për Rezistencë dhe Bashkim Kombëtar (FRBK) ishte

[142] Po aty

themeluar në Gjakovë në vitin 1990[143] dhe pas vitit 1994, disa pjesëtarë të këtij grupi iu bashkëngjiten UÇK-së. Në fakt, grupi gueril i Prekazit në krye me Adem Jasharin ishte aktiv pandërprerë që nga viti 1991.[144] Edhe më herët, gjatë viteve '80, ka pasur veprimtari të grupeve guerile (në kuadër LPK-së) që kanë shërbyer si pikënisje konkrete për përgatitjen, inkurajimin dhe organizimin e kryengritjes së armatosur në Kosovë, siç janë shembujt e grupeve guerile, "Partia e luftës" (1983), "Qeta e Llapit" (1989) etj. Madje mund të thuhet se të gjithë çlirimtarët në përpjekjet e tyre për çlirimin e Kosovës me vise, ndër vite (nga viti 1912, të frymëzuar nga Hasan Prishtina, Isa Boletini, Idriz Seferi, Bajram Curri etj.), janë UÇK. Por data e formimit formal të UÇK-së konsiderohet data e komunikatës së parë ushtarake të UÇK-së (më 17. 11. 1994), pas mbledhjes së kryesisë së LPK-së. Në kuptimin e unifikimit të grupeve të armatosura nën siglën e UÇK-së, të koordinuara, të mbështetura politikisht dhe me logjistikë etj., nga LPK-ja. Me fjalë të tjera, sikurse unifikimi i grupeve revolucionare klandestine më herët, në vitin 1982, nën siglën e LPK-së, ashtu u unifikuan edhe grupet e armatosura më vonë, në vitin 1994, nën siglën e UÇK-së.

Faktorizimi i UÇK-së

Faktorizimi politik dhe ushtarak i UÇK-së, në kuptimin e shtrirjes së idesë te masat popullore për domosdoshmërinë dhe fuqizimin e kryengritjes së armatosur, ballafaqohej me shumë pengesa në Kosovë dhe në diasporën shqiptare. Një ndër

[143] Besim Muhadri (2010): *Fronti i Rezistencës dhe i Bashkimit Kombëtar u themelua si një organizatë politiko-ushtarake* http://www.zemrashqiptare.net/news/14320 /besim-muhadri-fronti-i-rezistences-dhe-i-bashkimit-kombetar-u-themelua-si-nje-organizate-politiko-ushtarake.html?skeyword=a

[144] Gazeta Express (2020): *Rezistenca heroike e familjes Jashari nga viti 1991 deri më 1998*: https://www.google.no/amp/s/www.gazetaexpress.com/rezistenca-heroi ke-e-familjes-jashari-nga-viti-1991-deri-ne-1998/amp/

pengesat ishte mos ndryshimi në vazhdimësi i strategjisë politike të LDK-së (edhe pas vitit 1995), në kuptimin se një ndër aspektet kryesore të politikës së LDK-së ishte pengimi i revoltës së dhunshme. LDK-ja që nga themelimi kishte arritur të marrë një hov të shpejtë mobilizues dhe kishte ndikim të madh te masat popullore.

Për hovin e mobilizimit në kuadër të LDK-së ndikuan një sërë ndodhish dhe aktivitetesh politiko-shoqërore në Kosovë dhe jashtë Kosovës, përveç të tjerash: gjatë demonstratave të vitit 1989-1990 (si reaksion kundër suprimimit të autonomisë së Kosovës), ranë dhjetëra dëshmorë. Më 2 nëntor 1989 ranë heroikisht në Prishtinë dy udhëheqësit kryesorë të LPK-së, Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu, nën rrethim dhe përballje të armatosur e të pabarabartë me forcat policore. Më 2 shkurt 1990 filloi aktivitetin aksioni për pajtimin e gjaqeve dhe ngatërresave, i iniciuar nga disa veprimtarë të LPK-së (Jashar Salihu, Nurie Zeka, Naser Veliu, Ibish Neziri, Adem Grabovci, Hava Shala, Myrvete Dreshaj, Lulzim Etemaj, Ibrahim Dreshaj etj.) dhe u udhëhoq nga profesor Anton Qeta etj., duke evoluar në një mobilizim dhe solidaritet gjithëpopullor.

Idealistja dhe mikja e madhe e shqiptarëve, socialantropologia norvegjeze Berit Backer, njëkohësisht studiuese e kulturës shqiptare dhe veprimtare e shquar në kuadër të "Procesit të Helsinkit", e ka dhënë një kontribut të pakrahasueshëm "nga të huajt" për Kosovën gjatë viteve '80 dhe fillimviteve '90, veçanërisht pasi që kishte filluar bashkëpunimin me LPK-në në vitin 1987. Përkatësisht gjatë një periudhe historike kur Kosovës i mungonte përkrahja e "të huajve" dhe sidomos kur Kosova kishte më së shumti nevojë që zërat e ekspertëve "të huaj dhe të pavarur" t'i informojnë, dhe veçanërisht të bindin kancelaritë politiko-diplomatike të shteteve perëndimore, për shkeljen e të drejtave të njeriut në Kosovë, përveç të tjerash, në shtator 1989 (para shembjes së murit të Berlinit), së bashku me bashkëpunëtorin e saj, Kristoffer Gjøtterud, e udhëhoqi delegacionin e ekspertëve të Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit dhe Helsinki Watch - Amerikan për në Kosovë, për

ta vëzhguar situatën e të drejtave të njeriut.[145] Në këtë vazhdë, duke e marrë parasysh se një ndër pikat kyçe të veprimtarisë në kuadër të "Procesit të Helsinkit" ishte edhe inkurajimi dhe promovimi i forcave opozitare nën regjimet shtypëse, menjëherë pas themelimit të LDK-së e organizoi, me bashkëpunëtorë, vizitën e parë të delegacionit të Kosovës në krye me Ibrahim Rugovën, me qeveritarët norvegjezë në Norvegji dhe, në këtë kuadër, nëpërmes kontakteve të saj, ka lobuar që t'i hapen dyert udhëheqësit të Lëvizjes Paqësore të Kosovës, Ibrahim Rugovës, nga politikanët perëndimorë, me qëllim të faktorizimit të Kosovës në bashkëveprimin ndërkombëtar. Gjithashtu, ka qenë iniciatore dhe e ka ndihmuar themelimin e Komitetit të Helsinkit në Kosovë, më pastaj edhe në Shqipëri, duke përfshirë themelimin e OJQ-së së parë në Shqipëri, si bërthamën e parë nga jashtë për të Drejtat e Njeriut dhe Demokratizim në Shqipëri[146] dhe ka ndihmuar që Shqipëria të përfaqësohet në takimin e ekspertëve të Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (KSBE-së). Ndërsa Kristofer Gjøtterud (fizikan dhe veprimtar i mirënjohur norvegjez i Drejtave të Njeriut), krahas përkushtimit të tij për hebrenjtë në Bashkimin Sovjetik, që nga fillimvitet '70 (veçanërisht i përkushtuar për shkencëtarët hebrenj, të cilëve iu vështirësohej dhe ndalohej udhëtimi jashtë Bashkimit Sovjetik), iu përkushtua edhe çështjes së shqiptarëve të Kosovës nga fundvitet '80. Ka qenë një personalitet i nderuar dhe me ndikim, përveç të tjerash, kryetar i Komitetit për Hebrenjtë e Bashkimit Sovjetik që nga viti 1982 [147] dhe anëtar i Grupit të Helsinkit të Moskës (Moscow Helsinki Group)[148] i themeluar në vitin 1976, nga veprimtarët e mirënjohur rus, për të drejtat e

[145]Kenneth Anderson: *Yugoslavia: Crisis in Kosovo*, International Helsinki Federation and Human Rights Watch, New York, 1990: i

[146] Ann Christine Eek: *Berita - the Norwegian Friend of the Albanians,* parathënie në librin Behind the Stone Walls…, 2003: 12-14

[147] Norsk Biografisk Leksikon; Kristoffer Gjøtterud (2009): https://nbl.snl.no /Kristoffer_Gjøtterud

[148] Kristoffer Gjøtterud: En åpen horisont: https://www.apollon.uio.no/ portretter/1995/horisont.html

njeriut, përkatësisht fizikani dhe nobelisti Andrej Sakharov, historiania Ljudmila Aleksejeva, fizikani Jurij Orlov etj., të cilët më pastaj u përballën me represion të ashpër nga regjimi totalitar rus (arrestime, burgosje dhe internime të brendshme). Veprimtaria e Grupit të Helsinkit të Moskës u shpërbë në vitin 1982, por u ringjall prapë pas shembjes së murit të Berlinit (1989). Kristofer Gjøtterud, me ndikimin që kishte në kuadër të "Procesit të Helsinkit", e mbështeti në vitin 1989 veprimtarinë e Komitetit Norvegjez të Helsinkit për Kosovën. Madje edhe formalisht, në cilësinë e nënkryetarit të këtij komiteti, ku paraprakisht ishte themeluar një sektor i veçantë në shërbim të çështjes së Kosovës, i emëruar Grupi për Ballkanin i Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

Kongresmeni shqiptaro-amerikan Joseph Dioguardi, i inkurajuar dhe i mbështetur nga komuniteti shqiptaro-amerikanë në ShBA, në qershor të vitit 1986 e paraqiti në dhomën e përfaqësuesve Rezolutën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut për shqiptarët në Jugosllavi, ndërsa miku i tij, senatori Bob Dole, e paraqiti të njëjtën rezolutë në senat. Zyrtarët serbë angazhuan sponsorët rusë dhe grekë që të lobojnë kundër kësaj rezolute në Kongresin Amerikan. Megjithëkëtë, një version i zgjeruar i kësaj rezolute u riparaqit në qershor 1987 në Kongresin Amerikan, nga Dioguardi dhe Dol, dhe pati efekt edhe më të madh. Në këtë vazhdë u shtua veprimtaria lobiste për Kosovën, e shqiptaro-amerikanëve në ShBA. Në janar 1989 u themelua Liga Qytetare Shqiptaro-Amerikane në krye me Dioguardin, i cili, pavarësisht prej pengesave, arriti të udhëtojë në Kosovë në nëntor 1989, për ta parë nga afër gjendjen e rëndë socio-politike. Në shkurt 1990 udhëtoi sërish për në Kosovë me stafin për të Drejtat e Njeriut të Kongresit Amerikan, në krye me Tom Lantos dhe John Porter. Ndërsa në prill 1990, me bashkëpunëtorë, arriti ta organizojë vizitën e parë të delegacionit të Kosovës në krye me Ibrahim Rugovën në Kongresin

Amerikan.[149] E gjithë kjo veprimtari në krye me Dioguardin u mbështet fuqishëm nga i tërë komuniteti shqiptaro-amerikan në ShBA, në koordinim me disa ndër veprimtarët e shquar shqiptaro-amerikanë: Vëllezrit Ramadan dhe Xhim Xhema, Gjeto Sinishtaj, Shyqëri Ismailaj, Shaban Gjonbalaj, Gjergj Kalaj[150], Rexhë Xhakli, Bruno Selimaj dhe shumë të tjerë. Vlen të theksohet se gjatë periudhës së viteve 1989-1990 një pjesë e veprimtarëve me ndikim të madh, kundër shkeljes së drejtave të njeriut në botë, që ishin edhe aktivistë kundër antisemitizmit, si Kristoffer Gjøtterud etj., dhe të tjerë me prejardhje hebraike, si kongresistët amerikanë Tom Lantos, Eliot Engjel etj., filluan ta asociojnë urrejtjen e Millošević-it ndaj shqiptarëve me antisemitizmin. Rrjedhimisht,empatia dhe interesimi i tyre për t'i ndihmuar shqiptarët shtohej gjithnjë e më shumë dhe, njëkohësisht, gërshetohej me mirënjohjen e tyre ndaj shqiptarëve të cilët gjatë Luftës së Dytë Botërore ishin pothuajse i vetmi komb në Evropë që kishin mbrojtur hebrenjtë, duke u ofruar mbështetje dhe strehim.

Pas këtyre vizitave të para dhe historike në shtetet perëndimore, të delegacioneve të Kosovës në krye me udhëheqësin karizmatik të Lëvizjes Paqësore të Kosovës, Ibrahim Rugovën, filloi një shtim i lidhjeve diplomatike të Kosovës me shtetet perëndimore dhe kjo ndikoi në ngritjen edhe më të madhe të popullaritetit të Ibrahim Rugovës në Kosovë. Si reagim ndaj kësaj veprimtarie të suksesshme lobiste dhe të diplomacisë joformale të emigracionit politik shqiptar në krye me Berit Backerin, Joseph Dioguardin etj., regjimi i Beogradit ndërmori disa veprime. Në

[149] The albanian american civic league: "*changing histori for twenty five years*": https://www.aacl.com/our-25-year-history

[150] Dashnor Kaloçi (2018) "*Letra sekrete e ambasadorit shqiptar në OKB: Kongresmenit DioGuardi ia financoi fushatën vëllai i Xhemës…..*": https://gazetamapo.al/letra-sekrete-e-ambasadorit-shqiptar-ne-okb-kongresmenit-dioguardi-ia-financoi-fushaten-vellai-i-xhemes-qe-njihet-si-psikopat/

fillimvitin 1990 iu ndalua hyrja në Jugosllavi Berit Backerit[151] dhe në korrik 1990, Joseph Dioguardit.[152] Në ndërkohë, më 25 shkurt 1990, shërbimi sekret jugosllav vrau në Bruksel Enver Hadrin, (kryetar i Komitetit të Kosovës për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut me seli në Belgjikë), i cili me bashkëpunëtorë kishte arritur të krijojë kontakte të drejtpërdrejta me parlamentarë evropianë, duke raportuar për shkeljen e të Drejtave të Njeriut në Kosovë.[153]

Qëllimi i regjimit të Beogradit me veprimet e tilla ishte ta frikësojë dhe dekurajojë veprimtarinë lobiste dhe të diplomacisë joformale të emigracionit politik shqiptar. Por kjo tashmë ishte e kotë ngaqë veprimtaria diplomatike për Kosovën në krye me Ibrahim Rugovën etj. nuk kishte të ndalur dhe, gjithashtu, veprimtaria për të drejtat e njeriut për Kosovën nuk kishte të ndalur ngaqë, në fundvitin 1989, ishte iniciuar themelimi i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë, i cili u udhëhoq fillimisht nga Bajram Kelmendi, Zekeria Cana, Zenun Qelaj etj., pastaj u shtua veprimtaria e këtij këshilli nën udhëheqjen e simbolit të rezistencës kombëtare dhe të drejtave të njeriut, Adem Demaçi. Ndërsa në prill 1990, Gazmend Pula, Veton Surroi dhe Shkëlzen Maliqi e themeluan Komitetin Kosovar të Helsinkit nën udhëheqjen e Gazmend Pulës (kryetar), Ekrem Beqirit (nënkryetar), Agni Dikës (sekretar) dhe anëtarëve, Shkëlzen Maliqi, Veton Surroi, Arbër Xhaferi, Drita Mekuli, Muhamedin Kullashi etj. Në fakt, themelimi i Këshillit për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut dhe i Komitetit Kosovar të Helsinkit (duke përfshirë themelimin e Shoqatës Bamirëse të Kosovës "Nëna Terezë" (1990) dhe organizatës për të drejtat e grave dhe grupeve të margjinalizuara,

---

[151] Ann Christine Eek: *Berita - the NorwegianFriendof the Albanians,* parathënie në librin: Behind the Stone Walls…: 2003: 13

[152] The albanian american civic league: "*changing history for twenty five years*": https://www.aacl.com/our-25-year-history

[153] Die Morina (2016): *Kosovo Dissident's Serbian Assassins Given Life Sentences:* https://balkaninsight.com/2016/11/24/kosovo-dissident-s-serbian-assassins-jailed-for-life-11-24-2016/

"Motrat Qiriazi" (1990) etj., përveçse e përbënin bërthamën e Shoqërisë Civile në Kosovë, njëkohësisht ndikuan (sidomos fillimisht) edhe për afirmimin dhe për përkrahjen e rezistencës paqësore në Kosovë në krye me Ibrahim Rugovën.

Në kuadër të këtyre zhvillimeve, ambasadori i ShBA-së në Beograd, Warren Zimmermann, e vizitoi Prishtinën në muajin prill 1990 dhe u takua me Ibrahim Rugovën, Milazim Krasniqin - bashkëthemelues i LDK-së etj.[154] Ky ishte takimi i parë në mes të Rugovës dhe Zimmermannit, i cili ishte personalitet me ndikim të madh edhe në kuadër të "Procesit të Helsinkit" ngaqë paraprakisht (1986-1989) kishte udhëhequr delegacionin e SHBA-së në Konferencën për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (KSBE), si një arenë e konferencave ndërkombëtare në mes të Lindjes dhe Perëndimit, e bazuar në Deklaratën e Helsinkit (1975) që, më vonë, në vitin 1995, u institucionalizua në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

Të njëjtin vit, më 1990, në sesionin e 45-të të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork, kryetari i Shqipërisë, Ramiz Alia, në fjalimin e tij, përveç të tjerash, apeloi për dënimin e dhunës së regjimit të Beogradit ndaj shqiptarëve në Jugosllavi.[155] Në këtë vazhdë edhe pasardhësi i tij, Sali Berisha, në takimin e parë me presidentin amerikan George Bush, në qershor 1992, kërkoi që ShBA-ja të ndihmojë në ndalimin e dhunës ndaj shqiptarëve në Jugosllavi.[156]

Në muajt prill-maj 1990 LPK-ja organizoi nënshkrimin e një peticioni drejtuar Kuvendit të Kosovës që ta shpallë Republikën e Kosovës. Në këtë vazhdë, vendosi bashkëpunimin me bashkësinë e sindikatave të pavarura të Kosovës që u themelua në qershor

[154] Lajmi net (2015): *Milazim Krasniqi zbulon bisedat brenda takimit Zimmermann - Rugova*: https://lajmi.net/milazim-krasniqi-zbulon-bisedat-brenda-takimit-zimmermann-rugova/

[155] Fjalimi i Ramiz Alisë në vitin 1990 në Asamblenë e OKB-së në Nju-Jork: https://www.youtube.com/watch?v=00A3bb_mh54&feature=youtu.be

[156] Albanian President Sali Berisha meeting President George Bush, June 1992: https://www.youtube.com/watch?v=1M11iRWQGiY&feature=youtu.be

1990 në krye me Hajrullah Goranin.[157] Më 2 korrik 1990 delegatët shqiptarë të legjislaturës së re të Kuvendit të Kosovës, që filloi punën më 4 dhjetor 1989, morën vendimin e guximshëm dhe shpallën Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës. Shpallja e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës ndodhi te hyrja e ndërtesës së Kuvendit sepse delegatët nuk u lejuan të hyjnë në ndërtesën e Kuvendit që ishte e rrethuar nga forca të shumta të policisë, njësisë speciale dhe të ushtrisë serbe. Deklaratën e lexoi Muharrem Shabani, e cila ishte e nënshkruar nga të gjithë delegatët shqiptarë të legjislaturës së re të Kuvendit të Kosovës. Rreth dy muaj më pas, përkatësisht më 7 shtator 1990, në sallën e Shtëpisë së Kulturës në Kaçanik, në mbledhjen e drejtuar nga Iliaz Ramajli, ku ishin të pranishëm pothuajse të gjithë delegatët shqiptarë të Kuvendit të Kosovës, u miratua edhe Kushtetuta e Kosovës (Kushtetuta e Kaçanikut), që ishte përpiluar paraprakisht nga akademikët Gazmend Zajmi, Ejup Statovci etj. Në këtë vazhdë disa pjesëtarë të ish-strukturave udhëheqëse institucionaliste të Kosovës, por edhe disa pjesëtarë të mirënjohur të ish-veprimtarisë revolucionare klandestine (kryesisht ish të burgosur politikë), iu bashkuan strukturave udhëheqëse të LDK-së. Gjithashtu, me pluralizmin politik në Jugosllavi, përveç LDK-së, u themeluan edhe disa parti të tjera të shqiptarëve në Kosovë (Partia Shqiptare Demokristiane, Partia Liberale, Partia Fshatare, Partia Socialdemokrate, Partia Republikane, Parlamenti Rinor që, në fakt, ishte bërthama e Partisë Parlamentare etj.), dhe u organizuan në kuadër të një këshilli koordinues të udhëhequr nga LDK-ja, në krye me Ibrahim Rugovën.

Këshilli koordinues i partive politike të Kosovës (i përbërë nga Ibrahim Rugova, Fehmi Agani, Ali Aliu, Ramush Tahiri, Veton Surroi, Shkëlzen Maliqi, Reshat Nurboja etj.), e emëroi një komision qendror për organizimin dhe mbajtjen e referendumit popullor (i përbërë nga Fehmi Agani, Fatmir Sejdiu,

[157] Emrush Xhemajli (2002): *Lëvizja Popullore e Kosovës 1982-2002*: http://lpk-kosova.com/historiku.html

Rifat Blaku, Hivzi Islami, Ramush Tahiri, Ejup Statofci, Ismet Salihu etj.). Pavarësisht prej rrethanave të vështira, referendumi u mbajt më 26 -30 shtator 1991, ku mbi 90 % të shqiptarëve të Kosovës votuan pro pavarësisë së Kosovës dhe rrjedhimisht e legjitimuan Deklaratën e 2 korrikut dhe Kushtetutën e 7 shtatorit. Gjithashtu, më 24 maj 1992 u mbajtën zgjedhjet e para parlamentare[158] dhe presidenciale në Kosovë, të cilat i fitoi Lidhja Demokratike e Kosovës dhe kryetari i saj Ibrahim Rugova u zgjodh president. Paraprakisht, më 19 tetor 1991, ishte themeluar Qeveria e Kosovës në Egzil, në krye me Bujar Bukoshin, që fillimisht u vendos në Lubjanë të Sllovenisë dhe më pastaj nga viti 1992 në Bon të Gjermanisë. Deri në këtë periudhë kohore ishin themeluar edhe degët e LDK-së në shtetet perëndimore dhe koordinoheshin nga një qendër në Gjermani në krye me Hafiz Gagicën.

Paralelisht me këto zhvillime, represioni ndaj shqiptarëve gjatë fillimviteve '90 ndikoi që të ketë edhe iniciativa pothuajse publike për organizimin e kryengritjes së armatosur kundër regjimit neofashist të Millošević-it. Me këtë qëllim, një grup i shqiptarëve nga Kosova kishte shkuar për stërvitje ushtarake në Shqipëri në vitin 1991, ndërsa me shpërthimin e luftës në Kroaci dhe Bosnje, disa ushtarakë shqiptarë të ish-Armatës Jugosllave etj. kishin iniciuar ngritjen e një fronti të përbashkët që do t'i përfshinte shqiptarët me palët e tjera në luftë kundër regjimit neofashist të Millošević-it. Këtyre iniciativave (që shumë shpejt u dekonspiruan) nuk iu kushtua ndonjë interesim dhe mbështetje e veçantë nga udhëheqësit e politikës paqësore të Kosovës, përkatësisht kryesia e LDK-së.

Në vitin 1993 ministri i Informatave i Qeverisë së Kosovës në Egzil, me seli në Gjenevë, Xhafer Shatri, i paraqet një projekt-propozim kryeministrit të Kosovës në Egzil, Bujar Bukoshit dhe presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugovës, për përgatitjen e

[158] Rifat Blaku (2016): *Referendumi i parë shqiptar në Kosovë u mbajt në mënyrë dinjitoze*: https://www.kosova-sot.info/opinione/140682/referendumi-i-pare-shqiptar-ne-kosove-u-mbajt-ne-menyre-dinjitoze/

një force të armatosur. Në kuptimin e përgatitjes (jashtë kufirit të Kosovës), të disa formacioneve ushtarake që do të ishin të gatshme t'i dalin në mbrojtje popullit të Kosovës. Por, as ky projektpropozim s'ishte përkrahur.[159] Megjithëkëtë, ndikimi i Lëvizjes Paqësore në krye me Ibrahim Rugovën, për ta penguar revoltën e dhunshme të shqiptarëve, në masë të madhe ishte i logjikshëm politikisht deri në përfundimin e konferencës së Dejtonit. Por, çuditërisht, as para, veçanërisht pas Konferencës së Dejtonit, nuk u sinkronizua ndonjë lloj strategjie e përbashkët (plan B për çlirimin e Kosovës), në mes të LDK-së (duke përfshirë Qeverinë e Kosovës në Egzil) dhe LPK-së, sepse mospërfshirja e çështjes së Kosovës në konferencën e Dejtonit ishte njëkohësisht dështim i politikës paqësore. Në lidhje me këtë, Malcolm shkruan:

> "Fundi i luftës në Bosnjë nuk e solli edhe përfundimin e krizës në Kosovë. Ky fakt ishte vetëm një goditje për prestigjin e Rugovës. Ai, në të vërtetë, për katër vjet me radhë e kishte bindur popullin e vet se duhet të ketë durim derisa bashkësia ndërkombëtare të impononte një zgjidhje përfundimtare për ish-Jugosllavinë, në të cilën do të respektoheshin edhe interesat e tyre. Mirëpo, zgjidhja e paraqitur nga amerikanët në Dejton të Ohajos në nëntorin e vitit 1995, i la shqiptarët e Kosovës pikërisht aty ku ishin. E vetmja përkrahje në favor të Kosovës ishte një pajtim nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara se 'muri i jashtëm' i sanksioneve kundër Serbisë (duke përfshirë edhe mohimin e të drejtës për pjesëmarrje në Fondin Monetar Ndërkombëtar), do të mbetej derisa Beogradi ta përmirësonte gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Përndryshe, Marrëveshja e Dejtonit në përgjithësi ndikoi në konsolidimin e sundimit të Millošević-it në Serbi: diplomatët e Perëndimit deklaruan haptazi se ata i ishin atij mirënjohës për përpjekjet e tij "për vendosjen e paqes" dhe se e konsideronin atë si një forcë konstruktive në rajon, largimi i të cilit mund të shpinte në një destabilizim" (Malcolm 2001: 368-369).

[159] Intervistë televizive e Xhafer Shatrit më 08.09.2020: Telashet e Kosovës - Xhafer Shatri, DESKU, 08.09.2020 - YouTube

Rrjedhimisht, ngjashëm sikurse udhëheqja politike shqiptare e institucioneve të Krahinës së Kosovës në krye me Fadil Hoxhën etj. që u konsumua, duke konsideruar se të drejtat politike të bazuara në Kushtetutën jugosllave të vitit 1974, e kishin zgjidhur çështjen politike të Kosovës në Jugosllavi, edhe politika e LDK-së, në krye me Ibrahim Rugovën etj., u konsumua duke konsideruar (edhe pas Konferencës së Dejtonit) se çështja politike e Kosovës zgjidhet vetëm me metoda paqësore. Një ndër protagonistët e proceseve politike në Kosovë gjatë viteve '90 dhe më pas, Blerim Shala, në pasthënien e librit të Bardh Hamzajt, *Rrëfimi për luftën dhe lirinë: dialog me komandantin Ramush Haradinaj* (1999), përveç të tjerash, shkruan:

> "Kurrë Serbia nuk do ta braktisë Kosovën. Kurrë Perëndimi nuk do të intervenojë ushtarakisht në Kosovë. Kurrë Kosova nuk do të bëhet e lirë dhe e pavarur. Ishin këto qëndrime politike të cilat ishin lidhur si gur rreth qafës së secilit shqiptar në vitet e nëntëdhjeta. Ideja e pavarësisë, e cila ishte zyrtarizuar në vitin 1990-1991, me vendimet e Kuvendit të Kosovës dhe me votën e qytetarëve në Referendum, në të nëntëdhjetat, u bë një fjalë goje, një llomotitje, një mburojë për ta mbajtur monopolin e një pushteti të rremë që ndërtohej pra mbi prononcimin verbal në dobi të shtetit të Kosovës. Në vete, secili prej nesh, druante që për të gjallët tanë nuk do të përjetonim asnjë ditë të vetme, asnjë çast të vetëm në liri. Robëria dukej si kob i përjetshëm. Në këtë skenë fati dhe politike, gjithçka u përmbys, me të paraqitur të disa dhjetëra vetave, të cilët kishin atë bindjen e moçme shqiptare se nuk mund të ketë liri pa luftë dhe se nuk mund të ketë pavarësi pa flijim. Mbase nuk e kanë ditur në fillim se çka është lufta, se me kë në të vërtetë kapeshin fyt për fyti, se ç'gjë mund të dalë nga gjithë kjo rrëmujë, por e dinin mirë, tepër mirë, se të gjitha iluzionet ishin sosur, se afati i përdorimit të fjalëve përulëse kishte kaluar, se vdekja për liri kishte shumë më tepër vlerë sesa jeta nën Serbi". (Hamzaj 1999: 179).

Megjithëkëtë, duhet të kihet parasysh se UÇK-ja ishte parësisht rezultat i përpjekjeve të pandërprera të rezistencës aktive të shqiptarëve për çlirimin e Kosovës me vise dhe Bashkim Kombëtar prej vitit 1912 (dhe jo vetëm rezultat i një

individi ose një grupi të përbërë qoftë nga dhjetë vetë ose nga dhjetëra vetë), dhe shërbeu si katalizatori kryesor për çlirimin e Kosovës. Gjithashtu, duhet të kihet parasysh se Lëvizja Paqësore, në krye me akademikun urtak me përgjegjësi të madhe politike, të ndikuar nga poststrukturalizmi francez, dhe fituesin e çmimit Sakharov, Ibrahim Rugovën, e ka pasur rolin kryesor për shmangien e luftës në fillimvitet '90 në mes të popullit shqiptar të Kosovës dhe regjimit neofashist të Milloševićit. Përndryshe, ka pasur gjasa të mëdha që gjenocidi me përmasa aq të mëdha që ndodhi në Bosnjë, të ndodhte me përmasa edhe më të mëdha në Kosovë. Gjithashtu, strategjia paqësore e Rugovës kontribuoi për ruajtjen e stabilitetit në Ballkan sepse (për dallim të Kroacisë dhe Bosnjës) shpërthimi i luftës në Kosovë kishte potencialin ta zgjeronte luftën përtej territoreve të ish-Jugosllavisë. Fatkeqësisht, shtetarët perëndimorë që nga fillimi i konfliktit të armatosur në Jugosllavi (në fillimvitet '90) u treguan të ç'koordinuar për ndërmarrjen e hapave konkretë dhe efektivë për ta ndaluar/ndëshkuar dhunën e regjimit neofashist të Milloševićit në Kosovë. Në këtë vazhdë, edhe gjatë konferencës së Dejtonit, e shpërfillën dhe e injoruan Ibrahim Rugovën, duke mos e inkuadruar si një protagonist të rëndësishëm për zgjidhjen e krizës politike në Jugosllavi. Me fjalë të tjera, shtetet perëndimore, edhe pse kishin keqardhje më shumë dhe më pak për situatën e rëndë të shqiptarëve në Kosovë, nuk ishin në gjendje ta shpërblejnë politikën paqësore të Kosovës që sakrifikonte me vite në kurriz të shqiptarëve për zgjidhje politike paqësore dhe për ruajtjen e stabilitetit në Ballkan.

Konferenca e Dejtonit i humbi të gjitha shpresat se shqiptarët mund të çliroheshin vetëm me politikën paqësore. Megjithëkëtë, sikurse në vitet 1988-1990, ndikimi i grevave të minatorëve dhe i përpjekjeve politike të institucionalistëve në krye me Azem Vllasin, Kaqusha Jasharin etj., duke e përfshirë një numër të caktuar të delegatëve shqiptarë të Kuvendit të Kosovës, e veçanërisht rënia e dhjetëra dëshmorëve në demonstrata (kundër nismës dhe suprimimit të dhunshëm të autonomisë së Kosovës)

si faktor i brendshëm dhe shembja e murit të Berlinit, si faktor i jashtëm, që e patën ndikimin e vet, për t'i dhënë legjitimitet ndërkombëtar Lëvizjes Paqësore të Kosovës (LDK-së).

Gjithashtu, politika e Lëvizjes Paqësore (para Konferencës së Dejtonit) si faktor i brendshëm dhe gjenocidi në Bosnjë si faktor i jashtëm (që preku thellë ndërgjegjen e shteteve perëndimore), e patën ndikimin e vet, që t'i japin legjitimitet ndërkombëtar luftës së mëvonshme të UÇK-së, në kuptimin se shqiptarët e Kosovës në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare kishin provuar me vite ta zgjidhin problemin e Kosovës pa luftë, por ishin refuzuar nga Millosheviçi dhe se shtetet perëndimore nuk mund të toleronin të ndodhte në Kosovë e njëjta përmasë gjenocidiale që kishte ndodhur në Bosnjë. Veçanërisht duke e marrë parasysh edhe faktorin gjeopolitik ngaqë një konflikt i armatosur në Kosovë (për dallim të Bosnjës) e kishte potencialin e zgjerimit të luftës përtej kufijve të Jugosllavisë.

Në lidhje me kontekstin politik në Kosovë pas konferencës së Dejtonit, Mønnesland shkruan:

> "Në vitet 1996-'97 filluan të shfaqen informatat për forcat e armatosura guerile shqiptare. Deri në këtë kohë shqiptarët shumë kënd e befasuan, duke mos iu përgjigjur dhunës me mjete të dhunshme. Fillimisht ishin grupe të shpërndara dhe jo mirë të organizuara të cilat e quanin veten Ushtria Çlirimtare e Kosovës - UÇK. Zona kryesore e tyre ishte rajoni kodrinor i Drenicës në perëndim të Prishtinës. Presidenti Rugova u distancua nga këto grupe dhe për një kohë mohoi se ato ekzistonin. Ndërsa veprimtari i të drejtave të njeriut, Adem Demaçi, e mbështeste UÇK-në dhe dëshironte të shërbente si zëdhënës i tyre" (Mønnesland 2006: 357).

Pas Konferencës së Dejtonit (dhe çlirimit të Kroacisë me forcat e veta, në vitin 1995), u shtuan aksionet e armatosura të UÇK-së. Në këtë vazhdë edhe UÇK-ja pësoi goditje të njëpas-njëshme, e veçanërisht në vitin 1997. Përveçse u arrestua koordinatori i UÇK-së në Kosovë, Nait Hasani etj., u vranë edhe disa ndër drejtuesit më të spikatur ushtarakë të UÇK-së, Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha, Hakif Zejnullahu, Luan Haradinaj, Adrian Krasniqi etj. Të njëjtin vit ndodhi edhe vrasja e gazetarit Ali Ukaj, i cili konsiderohej si një zëdhënës i UÇK-së.

Me vendim të LPK-së (degës jashtë vendit), në pranverën e vitit 1997 u nisën për në Prishtinë disa veprimtarë të LPK-së, me përgjegjës Habib Elshanin. Ky grup kishte për detyrë të punonte me studentë dhe në bashkëpunim me dr. Muhamet Mehmetin.[160] Më 1 tetor 1997 rektori i Universitetit të Prishtinës, Ejup Statovci, së bashku me përfaqësuesit e Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës (Albin Kurti, Bujar Dugolli, Muhamet Mavraj, Driton Lajçi, Ilir Dugolli etj.), e organizuan demonstratën e fuqishme studentore për të drejta në arsim, që njëkohësisht nënkuptonte një lloj mbështetje për UÇK-në. Në këtë vazhdë, përfaqësuesit e LPK-së në shtetet perëndimore i shtuan përpjekjet e tyre që ta sensibilizojnë diasporën shqiptare për domosdoshmërinë e përkrahjes së UÇK-së. Përveç të tjerash, më 9 nëntor 1997, përfaqësuesit e LPK-së në Gjermani, Fehmi Lladrovci etj., mbajtën konferencë publike me bashkatdhetarë.[161]

Më 28 nëntor 1997, në Llaushë të Drenicës, gjatë varrimit të mësuesit Halit Gecaj, i vrarë nga forcat e policisë serbe, në praninë e qindra njerëzve, tre ushtarë të UÇK-së dolën haptas para të pranishmëve dhe thanë se UÇK-ja ekziston.[162] Më 9 dhjetor 1997, një përfaqësues i LPK-së në Skandinavi, deklaroi publikisht për radiotelevizionin norvegjez (NRK), se UÇK-ja ekziston dhe se shqiptarët në diasporë kanë filluar mobilizimin për të mbështetur financiarisht dhe ushtarakisht UÇK-në.[163] Në fund të vitit 1997 kryesia e LPK-së, e aprovoi stemën e UÇK-së, e dizajnuar nga veprimtari i LPK-së, Adnan Asllani.[164] Më 22 shkurt 1998, në Zyrën Amerikane në Prishtinë, Adem Demaçi

[160] Emrush Xhemajli (2002): *Lëvizja Popullore e Kosovës 1982-2002*: http://lpk-kosova.com/historiku.html

[161] Fehmi Lladrovci 9 nëntor 1997, mbledhje e LPK-së në Köln, Gjermani: https://youtu.be/2HjxmeBvONE

[162] Dalja e UÇK-së në skenë, 28 nëntor 1997: https://www.youtube.com/watch?v=MiMm5MaaIb8&feature=youtu.be

[163] Gazeta Bujku (10 dhjetor 1997): *Mjetet skandinave të informimit rreth ekzistimit dhe aksioneve të UÇK-së.*

[164] Zëri (2014): *Preshevari që bëri stemën e UÇK-së*: https://zeri.info/aktuale/8711/preshevari-qe-beri-stemen-e-uck-se/

takoi të dërguarin special të ShBA-së për Ballkanin, Robert Gelbart, i cili paraprakisht e kishte cilësuar UÇK-në organizatë "terroriste". Sipas biografit të Adem Demaçit, Shkëlzen Gashi, në këtë takim: "Demaçit i kërkohet ta mbështesë tezën se UÇK-ja është organizatë terroriste. Ai jo veç kundërshton, por pohon me këmbëngulësi se UÇK-ja është organizatë çlirimtare" (Gashi 2010: 132). Megjithëkëtë, pavarësisht prej vështirësive të mëdha, rezistenca e armatosur dhe heroike e UÇK-së vazhdoi dhe u zgjerua në të gjitha zonat e Kosovës, në krye me udhëheqësit ushtarakë të UÇK-së, tashmë heronjtë: Adem Jashari, Shkëlzen Haradinaj, Ilir Konushevci, Bahri Fazliu, Agron Rrahmani, Mujë Krasniqi, Remzi Ademaj, Xhevat Berisha, Qerim Kelmendi, Selman Lajçi etj., dhe njëkohësisht vazhduan me këmbëngulësi edhe përpjekjet politiko-diplomatike të UÇK-së.

Dy ndodhitë e mëdha

Në këtë vazhdimësi, dy ndodhi të mëdha e bën ndryshimin e madh për faktorizimin e UÇK-së. Ndodhia e parë është e ngjashme me rënien heroike në krye të detyrës të prijësve emblematikë të LPK-së, Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës, Bardhosh Gërvallës, Rexhep Malës, Nuhi Berishës etj., në një periudhë kyçe historike (pas demonstratave të vitit 1981), që ndikoi për një inkurajim dhe mobilizim të fuqishëm në kuadër të LPK-së. Ngjashëm, në një periudhë kyçe historike, rënia heroike në mars të vitit 1998, e prijësit emblematik të UÇK-së, Adem Jasharit, dhe 57 anëtarëve të familjes së tij, (ku u masakruan 58 persona nga ana e regjimit neofashist të Millošević), ndikoi për një mobilizim të fuqishëm në kuadër të UÇK-së.

Njëkohësisht vlen të potencohet se nuk është qëllimi të mbivlerësohet roli i individit (Adem Jasharit etj.), dhe të nënvlerësohet roli i LPK-UÇK-së si strukturë (ose anasjelltas), dhe as të shpërfillen rrethanat e përgjithshme politike në Kosovë dhe jashtë Kosovës në vitin 1998, sepse ka pasur raste të ngjashme

(edhe pse jo krejtësisht identike) sikurse rasti i familjes Jashari, por rrethanat kanë qenë pothuajse krejtësisht ndryshe. Për shembull, rezistenca dhe rënia nën rrethim e bashkëfshatarit të Adem Jasharit, Tahir Mehës me bashkëfamiljarë në vitin 1981, gjatë një përballje të armatosur dhe të pabarabartë me forcat policore dhe ushtarake serbo-jugosllave, nuk e ka pasur efektin e njëjtë sikurse rezistenca dhe rënia e Adem Jasharit me bashkëfamiljarë në vitin 1998, kryesisht për dy arsye. Së pari, veprimtaria e grupeve revolucionare klandestine të shqiptarëve në Jugosllavi, prej pas Luftës së Dytë Botërore e deri në vitin 1981, nuk kishte arritur të përbashkohet në një organizatë me strukturë të qëndrueshme politiko-ushtarake, siç arriti më pastaj në periudhën 1982-1994 në kuadër të LPK-UÇK-së, në vazhdën e përgatitjes, organizimit, mbështetjes dhe mobilizimit të kryengritjes së armatosur. Me fjalë të tjera, duhet të kihet parasysh se Tahir Meha nuk ka qenë i organizuar sikurse Adem Jashari, në kuptimin e të qenit i ndërlidhur me një organizatë politiko-ushtarake sikurse LPK-UÇK, ku individi dhe struktura në ndërveprim mund të prodhojnë efekte më të mëdha, drejt një synimi të përbashkët. Së dyti, rrethanat e përgjithshme politike në Kosovë dhe jashtë Kosovës në vitin 1981 kanë qenë krejtësisht të disfavorshme për mbështetjen dhe mobilizimin e kryengritjes së armatosur në Kosovë, krahasuar me rrethanat në vitin 1998. Kjo mund të ndërlidhet edhe me debatin klasik dhe të ndërlikuar në kuadër të sociologjisë dhe në kuadër të drejtimeve të tjera të shkencave shoqërore (politologjisë etj.) dhe të shkencave humane (historisë etj.). Në lidhje me pyetjen se kujt duhet t'i jepet më shumë rëndësi, individit apo strukturës /rrethanave për t'i kuptuar/shpjeguar fenomenet shoqërore, në fakt, i ngjan pyetjes se kush u krijua e para, pula apo veza?

Disa sociologë, duke u bazuar në metodologjizmin individualist (që asociohet me sociologun gjerman Max Weber), konsiderojnë se fenomenet shoqërore mund t'i kuptojmë/shpjegojmë më mirë duke marrë pikënisje në individin, sepse shoqëria është shuma e individëve. Disa të tjerë, duke u bazuar në metodologjizmin kolektivist (që asociohet me sociologun

francez Emile Durkheim), konsiderojnë se shoqëria është diçka më shumë sesa shuma e individëve dhe, për t'i kuptuar/shpjeguar më mirë fenomenet shoqërore, duhet marrë pikënisje në grupe, strukturë, rrethana. Ndërsa një pjesë e sociologëve kanë një qasje më të balancuar ngaqë konsiderojnë se individi dhe struktura ndikojnë në njëri-tjetrin, në kuptimin se ekziston një ndërveprim në mes individit dhe strukturës/rrethanave. Rrjedhimisht, efektin e madh të ndodhisë së flijimit të Adem Jasharit me bashkëfamiljarë mund ta kuptojmë/shpjegojmë më mirë në kuadër të një konteksti më të gjerë. Përkatësisht si efekt i madh (fenomen shoqëror), i një ndërveprimi në mes individëve (Adem Jasharit me bashkëfamiljarë) të përkushtuar për sakrificë altruiste kombëtare në shërbim të çlirimit të Kosovës, dhe LPK-UÇK-së si strukturë parapërgatitëse dhe mbështetëse ushtarako-politike e kryengritjes së armatosur, në shërbim të çlirimit të Kosovës, duke përfshirë edhe rrethanat e përgjithshme politike në Kosovë dhe jashtë Kosovës në vitin 1998.

Menjëherë pas sakrificës dhe rënies heroike të familjes Jashari, LPK - dega jashtë vendit (duke e marrë parasysh domosdoshmërinë për mobilizimin dhe fuqizimin e mëtutjeshëm të UÇK-së), organizoi shkuarjen në Kosovë të një pjese të udhëheqjes, veprimtarëve dhe përkrahësve me përvojë të LPK-së, përveç të tjerëve: Fehmi Lladrovci, Xhevë Krasniqi Lladrovici, Ismet Jashari, Ahmet Kaçiku, Agim Bajrami, Sejdi Sejdiu, Skënder Çeku, Xhemajl Fetahu, Fatmir Limaj, Ramush Haradinaj, Sami Lushtaku, Shukri Buja, Nasim Haradinaj, Hashim Thaçi, Emrush Xhemajli, Gafurr Elshani, Abdyl Mushkolaj, Kadri Veseli, Nazmi Brahimaj, Azem Syla, Adem Grabovci, Avdi Muja, Imri Ilazi, Sabri Kiçmari, Selim Krasniqi, Metush Zenuni, Agron Gërvalla, Demir Demiri, Cenë Aliçkaj, Muharrem Dina[165], Haxhi Hoti, Sadik Halitjaha, Reshat Salihaj, Ujkan Nikçi, Shani Berisha, Zafir Berisha, Jashar Aliu, Blerim Muriqi

[165] Emrush Xhemajli (2002): *Lëvizja Popullore e Kosovës 1982-2002*: http://lpk-kosova.com/historiku.html

etj. Gjithashtu, disa nga veprimtarët me përvojë të LPK-së, të degës jashtë vendit, Abedin Rexha, Ilaz Kodra etj., kishin shkuar më herët në Kosovë (në korrik të vitit 1997) për të ndihmuar në zgjerimin dhe konsolidimin e UÇK-së. Në këtë vazhdë, UÇK-së iu bashkëngjiten edhe profesionistët, përkatësisht ushtarakët e parë: Agim Qela, Bekim Berisha, Agim Ramadani, Ekrem Rexha, Tahir Sinani, Xhelal Hajda, Bislim Zyrapi, Naim Maloku, Sali Veseli, Rifat Sylejmani etj. Gjithashtu, edhe mjekët: Shpëtim Robaj, Lec Gradica, Hafir Shala, Izet Hima, Igballe Oshlani, Vesel Elezi, Blerim Dema, Fahredin Hoti, Masar Radoniqi, Faton Huma, Nuredin Zejnullahu, Xhevat Gashi etj.

Edhe përpara sulmit dhe masakrës ndaj familjes Jashari dhe më pas, forcat ushtarake dhe policore serbe bën masakra të njëpasnjëshme gjatë sulmeve arbitrare ndaj popullatës civile shqiptare, me qëllimin për ta dekurajuar mbështetjen ndaj UÇK-së. Siç është rasti i 28 shkurtit 1998, në fshatrat Likoshan dhe Qirez u vranë dhe u masakruan nga forcat serbe, 24 civilë shqiptarë nga familjet Ahmeti, Rexhepi, Behrami, Nebihu, Xheli, Sejdiu, Rama dhe Fazliu[166], e vetëm në familjen Ahmeti u masakruan 11 persona.[167] Në këtë vazhdë në fshatin Abri të Epërme forcat serbe masakruan 23 anëtarë të familjes Deliu, në mesin e tyre gra, fëmijë e pleq, nga mosha gjashtë muajsh deri në 94 vjeç[168], dhe shumë raste të tjera të ngjashme, gjatë tërë periudhës së luftës.

Më 24 mars 1998 forcat serbe rrethuan fshatin Gllogjan në Dukagjin dhe bën një sulm (të ngjashëm sikurse ndaj familjes Jashari), ndaj familjes Haradinaj, e cila tashmë ishte vigjilente për mundësinë e ndonjë sulmi të papritur. Sulmi ndodhi më 24

[166] Klan Kosova (2018): Kujtohet beteja e Likoshanit dhe Qirezit: https://klankosova.tv/kujtohet-beteja-e-likoshanit-dhe-qirezit-1/

[167] Kultplus (2020): *20 vjet nga beteja e Likoshanit dhe Qirezit*: https://www.kultplus.com/trashegimia/20-vjet-nga-beteja-e-likoshanit-dhe-qirezit/

[168] Gazeta Mapo (2019): *Masakra e Abrisë së Epërme, u vranë 23 anëtarë të familjes Deliu:* https://gazetamapo.al/masakra-e-abrise-se-eperme-u-vrane-23-anetare-te-familjes-deliu

mars 1998 dhe familja Haradinaj me bashkëluftëtarë bëri rezistencë të suksesshme që ndikoi t'i zmbrapsë forcat serbe. Kjo rezistencë heroike në krye me komandantin Ramush Haradinaj, ku ranë dëshmorë Him Haradinaj dhe Gazmend e Agron Mehmetaj, i inkurajoi mijëra shqiptarë të tjerë në rajonin e Dukagjinit, t'i bashkëngjiten UÇK-së.[169] Në kuadër të luftës së lavdishme të UÇK-së ka edhe mjaft shembuj të tjerë, ku nga disa anëtarë të një familje rezistuan dhe ranë dëshmorë, siç janë shembujt e Ismet, Muharrem dhe Nazim Asllanit nga fshati Prapashticë; Mark, Prend, Kolë dhe Memë Lleshit nga fshati Vraniq; Mentor, Menderes e Menhend Dervishajt nga qyteti Istog; Gursel e Bajram Sylejmanit nga qyteti Ferizaj etj.

Pas shkuarjes në Kosovë, në mars të 1998-s, të një numri të konsiderueshëm të pjesëtarëve të LPK-së (degës jashtë vendit), pjesa tjetër e mbetur e udhëheqjes, veprimtarëve dhe përkrahësve me përvojë të LPK-së (degës jashtë vendit) u bë mbështetja kryesore politike, diplomatike, financiare e logjistike për UÇK-në nga jashtë territorit të luftimeve: Bedri Islami, Fazli Veliu, Ali Ahmeti, Xhavit Haliti, Raif Gashi, Sejdi Gega, Refik Hamiti, Jashar Salihu, Bardhyl Mahmuti, Rexhë Ibërdema, Sahit Krasniqi, Hasan Ukëhaxha, Murat Jashari, Shefit Xhaferi, Ibrahim Kelmendi, Xhavit Hoxha, Salih Bicku, Xhavit Bajraktari, Agush Buja, Musa Demiri, Halil Selimi, Ramiz Lladrovci, Gafurr Zendeli, Rexhep Halimi, Muharrem Elshani, Afrim Emini, Sahadete Zhitia, Selam Bajrami, Pleurat Sejdiu, Begzat Gashi[170], Ramadan Avdiu, Shaban Muja, Ali Reshani, Sabit Veseli, Xhevat Bislimi, Fatmir Brajshori, Kadri Rexhaj, Mehmet Bislimi, Sheradin Berisha, Haki Morina, Ibish Neziri, Nufri Lekaj, Ibrahim Xhemajli, Lulëzim Etemaj, Rifat Muriqi, Sadri Ramabaja, Xhemajl Duraku etj. Në këtë vazhdë, UÇK-ja u mbështet edhe nga një pjesë e veprimtarëve të LDK-së në

[169] Lajmi.net (2020): *22 vjet nga Epopeja e Dukagjinit*: https://lajmi.net/22-vjet-nga-epopeja-e-dukagjinit/

[170] Emrush Xhemajli (2002): *Lëvizja Popullore e Kosovës 1982-2002*: http://lpk-kosova.com/historiku.html

diasporë siç është shembulli i afaristit dhe veprimtarit të njohur të LDK-së në diasporë, Fatmir Zymberaj, i cili më pastaj u emërua drejtor i Fondit të UÇK-së (Fondit Vendlindja Thërret). Gjithashtu, edhe nga afaristë të tjerë shqiptarë në diasporë, Hetem Ramadani etj., veçanërisht në ShBA: Dino Asanaj, Bruno Selimaj, Dino Erbeli, Ekrem Bardha, Florin Krasniqi, Harry Bajraktari dhe shumë të tjerë.

Në muajin mars 1998 u paraqit "publikisht", në një intervistë, drejtuesi i sektorit të rëndësisë së veçantë të LPK-së, Xhavit Haliti etj.[171] Kjo intervistë e ka rëndësinë e vet sepse për herë të parë zyrtarisht për mediat paraqitet personi i autorizuar nga LPK, i cilësuar si personi kryesor i UÇK-së (sidomos deri në këtë kohë). Sektori i rëndësisë së veçantë në kuadër të LPK-së (që kishte për detyrë ta organizojë dhe koordinojë kryengritjen e armatosur në Kosovë), që nga fillimi ishte më i pavarur krahasuar me sektorët e tjerë të LPK-së dhe, pas vitit 1998, u vetëpavarësua edhe më shumë ngaqë paraprakisht ishte shndërruar në Shtabin Qendror të UÇK-së dhe më pastaj në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së. Mënyra e këtij transferimi është konsideruar anashkalim i vet organizatës (LPK-së), që de jure ishte pjesë e saj por, de facto, vepronte si strukturë e re paralele. Veçanërisht u konsiderua si anashkalim, pozicionimi i Hashim Thaçit (pa autorizimin e duhur të LPK-së) në pozitën e drejtorit të Drejtorisë Politike të UÇK-së, i cili gradualisht, sidomos gjatë Konferencës së Rambujesë, e akumuloi pushtetin politik brenda UÇK-së - LPK-së. Ndoshta kjo kishte të bënte pjesërisht edhe me vetë aspektin organizativ si "fenomen universal". Studiuesi Robert Michels, në studimin e tij të famshëm *Partitë politike: Një studim sociologjik i tendencave oligarkike të demokracisë moderne* (1911), konstaton se të gjitha organizatat pashmangshmërisht rezultojnë në "ligjin e hekurt të oligarkisë". Në kuptimin se me zhvillimin e një organizate,

[171] Intervista e parë publike e përfaqësuesve të sektorit të rëndësisë së veçantë, Xhavit Halitit, Azem Sylës etj.: https://youtu.be/q58Oujsu-Dshttps://www.facebook.com/ShqipChannel/videos/338922393384692/

një grup personash, duke kontrolluar resorët, linjat e informacionit etj., dalëngadalë e akumulojnë pushtetin në kuadër të organizatës. Madje sipas kësaj teorie ("ligji i hekurt i oligarkisë"), edhe në kuadër të organizatave me intenca të njëmendta demokratike dhe me dëshirat për ndarje të duhur të pushtetit, dalëngadalë rezultojnë një "grup personash" që akumulojnë pushtetin brenda organizatës. Megjithëkëtë, kjo teori (që shpeshherë cilësohet si pothuajse i vetmi "ligj" në kuadër të shkencave shoqërore), është modifikuar nga studiues të tjerë të mëvonshëm.

Sidoqoftë, vlen të precizohet se Hashim Thaçi nuk ka qenë një ndër themeluesit emblematik të UÇK-së sepse gjatë periudhës kur janë marrë vendimet më të rëndësishme të LPK-së për themelimin e UÇK-së, udhëheqja qendrore e LPK-së në Kosovë (e degës brenda vendit) ka qenë e identifikuar me udhëheqësit emblematikë Afrim Zhitia, Fahri Fazliu, Ahmet Haxhiu, Xhavit Haziri dhe Bejadin Hallaqin, si udhëheqje me kontinuitet pas rënies heroike të udhëheqësve emblematikë të LPK-së në Kosovë në fillimvitet '80, Rexhep Malës, Nuhi Berishës etj. Me fjalë të tjera, gjatë kësaj periudhe, përveç të tjerash, Mbledhja e Dytë e Përgjithshme e LPK-së (1989) i ka dhënë legjitimitet formimit të sektorit ushtarak në kuadër të LPK-së, me detyrën për parapërgatitjen e kryengritjes së armatosur në Kosovë. Mbledhja e Tretë e Përgjithshme e LPK-së (1991) i ka dhënë legjitimitet vendimit për themelimin e forcës së armatosur në Kosovë, dhe Mbledhja e Katërt e Përgjithshme e LPK-së (1993) i ka dhënë legjitimitet vendimit për fillimin e kryengritjes së armatosur në Kosovë, duke rezultuar me shndërrimin e këshillave popullore të LPK-së në Kosovë në njësi të armatosura. Njëkohësisht vlen të precizohet se Hashim Thaçi nuk ka qenë një ndër komandantët e parë dhe emblematik të UÇK-së sikurse Adem, Hamzë dhe Shaban Jashari, Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha, Hakif Zejnullahu, Luan Haradinaj, Adrian Krasniqi etj., që i kanë prirë në vazhdimësi (pa ndërprerje) shndërrimit të këshillave popullore të LPK-së në Kosovë, në njësi të armatosura. Gjithashtu, pasi që

ka emigruar nga Kosova në vitin 1993, Hashim Thaçi nuk ka qenë pjesë e kryesisë së LPK-së në emigracion (degës jashtë vendit), kur kjo kryesi (në përbërje nga Fazli Veliu, Muhamet Kelmendi, Emrush Xhemajli, Ali Ahmeti, Xhavit Haliti dhe Gafurr Elshani), ka vendosur nëpërmes komunikatës së parë ushtarake më 17.11.1994, që njësitet e armatosura në Kosovë të emërtohen: Ushtria Çlirimtare e Kosovës - UÇK. Dhe nuk ka qenë i autorizuar nga LPK, si shef i sektorit të rëndësisë së veçantë sikurse Xhavit Haliti, dhe as i emëruar si anëtar i këtij sektori, sikurse Azem Syla, Ali Ahmeti dhe Jashar Salihu. Madje nuk ka qenë as kryekordinatori i UÇK-së, me veprimtari të pashkëputur në Kosovë, sikurse Nait Hasani, e as kryeprotagonisti i shfaqjes së parë publike të UÇK-së në Kosovë më 28 nëntor 1997 sikurse Rexhep Selimi. Por, pa dyshim, Hashim Thaçi ka qenë një ndër veprimtarët e dalluar të LPK-së - UÇK-së prej se është rekrutuar në LPK në vitin 1989 nga veprimtarët e spikatur të LPK-së, Sabit dhe Kadri Veseli. Dhe, përveç të tjerash, e ka dhënë kontributin e tij, si pjesëmarrës i mbledhjes së Tretë dhe të Katërt të Përgjithshme të LPK-së. Duke përfshirë edhe kontributin e tij në kuadër të Unionit Studentor të Prishtinës (gjatë fillimviteve '90), edhe pse nuk ka arritur të afirmohet si ndonjë lider premtues i gjeneratës së re, në fakt, prej që ka emigruar në vitin 1993, ka qenë nën monitorim të Xhavit Halitit, deri në Konferencën e Rambujesë, dhe vetëm pas sakrificës altruiste të Adem Jasharit me bashkëfamiljarë në mars 1998, ka arritur të marrë një pozitë udhëheqëse, përkatësisht të drejtorit të Drejtorisë Politike të UÇK-së, domethënë i pjesës politike të Shtabit të Përgjithshëm, e jo si përfaqësues i përgjithshëm politik i UÇK-së. Ky vetemërim i bërë në mënyrë të njëanshme dhe me leje të Xhavit Halitit, i ka anashkaluar organet e tjera udhëheqëse të LPK-së. Dhe konsiderohet se këtë pozitë politike të UÇK-së do të duhej të kishte një personalitet me kredibilitet të fortë politik brenda LPK-së, e jo Hashim Thaçi i cili deri me emërimin e tij në këtë post nuk ka qenë një figurë e afirmuar dhe as një ndër udhëheqësit kryesor të LPK-së. Sepse nuk ka qenë as një ndër

themeluesit e LPK-së në vitin 1982, në krye me prijësit emblematikë Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka etj., e as pjesë e udhëheqjes qendrore të LPK-së në Kosovë ose emigracion, madje pas daljes në emeigracion, asnjëherë nuk ka qenë anëtar i rregullt i këshillit të përgjithshëm të LPK-së si organi më i lartë udhëheqës i LPK-së.

Me zgjedhjen e Bedri Islamit kryetar i LPK-së në vitin 1998, u arrit të bëhej menaxhimi më i mirë i mundshëm (marrë parasysh rrethanat), duke shmangur përçarjen brenda LPK-së: në mes të sektorit të rëndësisë së veçantë (tashmë Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së) dhe udhëheqjes së LPK-së, respektivisht Këshillit të Përgjithshëm të LPK-së, thellimi i përçarjes do të kishte efekt fatal për luftën çlirimtare. Në vazhdën e faktorizimit të UÇK-së, përveç të tjerash, më 15 qershor 1998 u paraqit me një deklaratë të guximshme në lajmet për Kosovën në Televizionin shqiptar, zëdhënësi i UÇK-së brenda vendit, Jakup Krasniqi.[172] Më 24 qershor 1998 në Junik të Kosovës ndodhi një takim (që pati efekt të madh në mediat ndërkombëtare), në mes të disa ushtarëve të UÇK-së, në krye me Hajdin Abazin dhe të dërguarin special të ShBA-së për Ballkanin, Richard Holbrooke, i cili, në ndërkohë, ishte emëruar në postin që kishte më parë, Robert Gelbart.[173] Më 29 qershor 1998 u realizua një takim i rëndësishëm në mes të zëdhënësit të UÇK-së jashtë vendit, Bardhyl Mahmutit dhe Richard Holbrooke, në Forumin Ndërkombëtar të Crans-Montanas në Zvicër.[174] Ndërsa më 2 korrik 1998, gazeta e mirënjohur zvicerane "Le Temps", botoi deklaratën e Xhafer Shatrit (në cilësinë e ministrit të Informatave të Qeverisë së Kosovës në

[172] Paraqitja e parë publike e zëdhënësit të UÇK-së, Jakup Krasniqit etj.: https://youtu.be/qDbQg2sS9ac

[173] Takimi më 24 qershor 1998, në Junik të Kosovës, i përfaqësuesve të UÇK-së, në krye me Hajdin Abazin, me të dërguarin special të ShBA-së për Ballkanin, Richard Holbrooke: https://youtu.be/qzMxZKu2KWQ

[174] Takimi më 29 qershor 1998 në Forumin Ndërkombëtar të Crans-Montanas, i përfaqësuesve të UÇK-së, në krye me Bardhyl Mahmutin, me të dërguarin special të ShBA-së për Ballkanin, Richard Holbrooke: http://www.zemrashqiptare.net /news/19040/ina-interviste-me-bardhyl-mahmutin.html

Egzil, me seli në Gjenevë), i cili kishte kontakte të drejtpërdrejta në OKB, ku thuhej:

> "E konfirmoj gjithashtu dhe qartas, se lindja e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës (UÇK) është rezultat logjik i terrorit serb që po zgjat që 17 vjet dhe i një indiference të padurueshme të bashkësisë ndërkombëtare për fatin tonë. Po përpiqem t'i bind të gjithë se anëtarët e kësaj organizate (UÇK-së) nuk janë terroristë, por njerëz që po sakrifikohen për popullin e tyre. Është e njohur botërisht se në një mënyrë apo në një tjetër ministri që nga vjeshta e vitit 1997 mbron publikisht idenë se pas kaq vitesh të përpjekjeve pacifiste që nuk dhanë fryte, lufta e armatosur është bërë e domosdoshme për çështjen e Kosovës".[175]

Shtabi i përgjithshëm i UÇK-së, për shkak të shumë faktorëve dhe shpejtësisë së zhvillimit të ngjarjeve, nuk arriti ta organizojë në nivel të duhur strukturën ushtarake të UÇK-së. Përveç të tjerash, nuk u arrit (që të tejkalohet krejtësisht tradita e organizimit kaçak të rezistencës) që komandantët të transferohen (nga vendlindjet/vendbanimet e tyre) në vende të tjera në Kosovë. Gjithashtu, udhëheqja kryesore e UÇK-së karakterizohej nga një lloj provincializmi sepse, përveç zëdhënësit (Jakup Krasniqit) dhe komandantit të përgjithshëm (Azem Sylës) që, në fakt, ishin figura të njohura në nivel të Kosovës (si veprimtarë që nga vitet '70 në kuadër të Grupit Revolucionar të Kosovës), edhe të tjerë në udhëheqje të UÇK-së (të panjohur deri në këtë kohë), ishin kryesisht nga zona e Drenicës, duke përfshirë drejtorin politik pranë Shtabit të Përgjithshëm (Hashim Thaçin) etj. Megjithëkëtë, ndodhia e dytë e zbehi elementin provincialist e të udhëhequrit politik të UÇK-së etj.

Ndodhia e dytë është, gjithashtu, e ngjashme me ndodhin para shumë dekadash në kuadër të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për çlirimin e Kosovës me vise. Sikurse idealisti dhe intelektuali Hasan Prishtina që e pati një rol shumë të

[175] Gazeta zvicerane Le Temps: *Genève: un attentat vise le très discret Ministère kosovar de l'information"*, 2 korrik 1998: https://www.letemps.ch/suisse/geneve-un-attentat-vise-tres-discret-ministere-kosovar-linformation

rëndësishëm për orientimin politik të Lëvizjes Kaçake, duke i dhënë dimension të gjerë kombëtar (antiprovincialist).

Ngjashëm, një rol shumë të rëndësishëm për mobilizimin edhe më të madh të UÇK-së në nivel kombëtar e pati simboli i rezistencës kombëtare dhe i drejtave të njeriut, Adem Demaçi, i cili (me insistim të Xhavit Halitit etj.), më 13 gusht 1998 e mori përgjegjësinë dhe u emërua përfaqësues i përgjithshëm politik i UÇK-së me seli në Prishtinë, i mbështetur edhe nga sekretari i UÇK-së, Albin Kurti etj. Me fjalë të tjera, ky emërim e pati një efekt të jashtëzakonshëm në mobilizimin e mëtejmë të popullit në mbështetje të UÇK-së sepse e tejkaloi një të "metë" të UÇK-së, në kuptimin se deri në këtë kohë udhëheqja kryesore e UÇK-së identifikohej pothuajse vetëm me një rajon (Drenicën) dhe pothuajse vetëm me një organizatë (LPK-në). Ndërsa me përfaqësimin e përgjithshëm politik me seli në Prishtinë, në krye me Adem Demaçin (dhe liderin premtues të gjeneratës së re, Albin Kurtin), UÇK-ja filloi të identifikohej me tërë Kosovën dhe shqiptarinë. Gjithashtu, ky emërim e pati efektin e duhur te faktori ndërkombëtar ngaqë lufta e UÇK-së filloi të identifikohet drejtpërdrejt me sakrificën e Adem Demaçit, veçanërisht si personalitet i mirënjohur ndërkombëtarisht (përveç të tjerash, edhe me çmimin Sakharov) në fushën e të drejtave të njeriut. Ndërsa diaspora shqiptare në përgjithësi dhe përfaqësuesit e UÇK-së në diasporë në veçanti: Bardhyl Mahmuti, Sabri Kiçmari, Jashar Salihu, Ramadan Avdiu, Agush Buja, Bilall Sherifi, Rexhë Ibërdemaj, Xhevat Bislimi, Nufri Lekaj, Dino Asanaj, Mujë Rugova, Pleurat Sejdiu etj., (kryesisht veprimtarë të LPK-së, të mirëshkolluar në universitetet prestigjioze perëndimore dhe të emëruar nga Drejtoria Politike e UÇK-së, kryesia e LPK-së, dhe nga përfaqësuesi i përgjithshëm politik i UÇK-së, Adem Demaçi), e kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm për faktorizimin politiko-diplomatik të UÇK-së sepse në vazhdimësi nëpërmes deklaratave dhe debateve në mediat e shkruara dhe televizive perëndimore, insistuan se UÇK-ja është organizatë çlirimtare me karakter kombëtar sekular dhe legjitime si mjet i fundit për arritjen e çlirimit të Kosovës nga

regjimi neofashist i Milloševićit. Për këtë insistuan dhe argumentuan edhe gjatë takimeve të drejtpërdrejta, por edhe nëpërmes apeleve publike bërë diplomatëve me ndikim të veçantë në diplomacinë amerikane dhe evropiane, përveç të tjerëve: Ministres së Jashtme të ShBA-së, Madeline Albright, duke përfshirë: të dërguarin special të ShBA-së për Ballkanin, Richard Holbrooke; ministrit të Punëve të Jashtme të Britanisë, Robin Cook; ministrit të Punëve të Jashtme të Austrisë, Wolfgang Schüssel (gjatë kësaj periudhe Austria ishte udhëheqëse e radhës së BE-së); ministrit të Punëve të Jashtme të Norvegjisë, Knut Vollebæk i cili gjatë luftës në Kosovë ishte udhëheqës i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe, gjithashtu, ministrave të jashtëm të Gjermanisë dhe Francës, Joschka Fischer dhe Hubert Vedrine etj. Kjo kishte rëndësi të veçantë për UÇK-në sepse propaganda e regjimit serb përpiqej, përveç të tjerash, ta paraqesë UÇK-në në arenën ndërkombëtare si një organizatë fundamentaliste fetare dhe si organizatë terroriste. Gjithashtu, edhe një numër i caktuar i intelektualëve, akademikëve dhe aktivistëve të shoqërisë civile në Kosovë, në krye me Rexhep Qosen, Hydajet Hysenin, Veton Surroin etj., dhe në diasporë në krye me Ismail Kadarenë, Shenasi Ramën, Ilir Zherkën, Daut Dautin, Muhamedin Kullashin, Reshat Sahitajn, Sadik Tolajn etj., e kanë dhënë kontributin e tyre për faktorizimin politiko-diplomatik të UÇK-së, veçanërisht qeveria dhe diplomacia formale e Shqipërisë Londineze etj.

Pas përshkallëzimit të luftës dhe krizës humanitare në Kosovë, UÇK-ja u forcua edhe më shumë, duke u përkrahur nga atdhetarët me ndikim, pa marrë parasysh subjektet politike shqiptare që u takonin, edhe nga diaspora (Sali Çekaj, Abaz Thaçi, Ahmet Krasniqi, Tahir Zemaj etj.). Madje mobilizimi në kuadër të UÇK-së përfshiu edhe mobilizimin ushtarak nga vendet e largëta (ShBA-ja etj.) siç është shembulli i Batalionit Atlantiku etj. Për historikun e lavdishëm të këtij mobilizimi ushtarak ka shkruar bashkëpjesëmarrësi i këtij batalioni, Uk Lushi, në librin e tij *Shqiptaro-amerikanët e UÇK-së: kronikë e*

Batalionit Atlantiku (2009). Shembull i veçantë i sakrificës nga ky batalion janë vëllezërit Ylli, Agroni dhe Mehmet Bytyqi, të cilët gjatë një misioni humanitar për t'i shpëtuar fqinjët e tyre romë, u burgosën nga forcat serbe dhe më pastaj u ekzekutuan. Kjo njëkohësisht vërteton se UÇK-ja nuk ishte kundër pakicave (minoriteteve).

Me fjalë të tjera, diaspora shqiptare në përgjithësi, e veçanërisht veprimtaria e emigracionit politik shqiptar në vitet '70, sidomos në vitet '80 dhe '90, e ka pasur një rol pothuajse qendror për parapërgatitjen, themelimin dhe mbështetjen financiare, politike, diplomatike dhe ushtarake të UÇK-së. Duke e përfshirë edhe financimin e sistemit paralel në Kosovë në vitet '90, përkatësisht financimin e sektorit të arsimit, kulturës, sportit, shëndetësisë dhe administratën e LDK-së. Bartësit kryesorë të veprimtarisë së emigracionit politik shqiptar në vitet '70 dhe sidomos në vitet '80 kanë qenë kryesisht të përndjekurit politik që u kishin shpëtuar arrestimeve dhe ish të burgosurit politikë që rrezikoheshin përsëri të arrestoheshin dhe të dënoheshin në Jugosllavi (përfshirë deri në një masë edhe bashkëfamiljarët lojalë të tyre që persekutoheshin në Jugosllavi dhe detyroheshin të emigronin), të cilëve në shumtën e rasteve u njihej statusi i refugjatit në shtetet perëndimore, në bazë të Konventës për Refugjatët, artikullit 1a.[176] Edhe një pjesë e emigrantëve-shqiptarë me kontrata të punës gjatë viteve '70 dhe '80 e kanë mbështetur në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, veprimtarinë e emigracionit politik shqiptar. Në këtë vazhdë (me përkeqësimin e përgjithshëm të situatës politike në Jugosllavi), emigracioni politik shqiptar u masivizua nga valët e refugjatëve shqiptarë që detyroheshin të emigronin nga Kosova gjatë viteve '90, të cilëve kryesisht (përpos rasteve më të veçanta), u njihej statusi i refugjatit bazuar në Konventën për Refugjatët, artikullin 33, parimin non-refoulment. Përkatësisht, bazuar në parimin (e moskthimit) që ua ndalon shteteve

[176] Convention and protocol relating to the status of refugees, f. 14 : https://www.unhcr.org/3b66c2aa10

kthimin e refugjatëve, edhe kur refugjatët nuk i përmbushin krejtësisht kriteret e definuara në artikullin 1a, por që rrezikohen po qe se kthehen në vendlindjet e tyre dhe, rrjedhimisht, i përmbushin kriteret e artikullit 33 të Konventës për Refugjatët, [177] të ashtuquajturit refugjatë de-facto ose refugjatë me status b.

Gjithashtu vlen të theksohet se një pjesë e intelektualëve dhe aktivistëve të huaj, me profile të ndryshme profesionale, kanë ndikuar në mënyra të ndryshme që t'i bindin shtetet perëndimore për ta ndalur dhunën dhe krimet e regjimit të Millosheviçit në Kosovë gjatë periudhës së luftës 1998-1999. Përveç të tjerëve: Joseph Dio Guard, Bernard-Henry Levy, James Pettifer, Tim Judah, David Loyn, Christane Amanpour, Adelheid Feilcke-Tiemann, Antoine Garapon, Yves Laplace, Maria Fuglevaag Warsinski, Pål Refsdal, Erik Fosse, Ann Christine Eek, Gro Holm, Ulmar Qvick, Nils Henrik Hogge, Tue Magnussen, Anders Wesman etj. Një ndikimin të veçantë në këtë drejtim e ka pasur ambasadori i OSBE-së, William Walker, i cili, përveç të tjerash, masakrën e Reçakut më 15 janar 1999 e cilësoi publikisht si masakër dhe krim kundër njerëzimit.[178]

Pas përpjekjeve që nga qershori i vitit 1998, në janar 1999 u themeluan në Kosovë institucionet informative të UÇK-së, radio Kosova e Lirë dhe agjencia e lajmeve "Kosovapress". Themelimi i këtyre institucioneve informative ishte iniciuar nga shtabi i përgjithshëm i UÇK-së, (Jakup Krasniqi, Shaban Shala, Ramë Buja, Kadri Veseli etj.)., dhe u arrit të realizohej me kontributin e dhënë në mënyra të ndryshme nga: Ahmet Qeriqi, Nezir Myrtaj, Mentor Hoxha, Basri Beka, Shaqir Shaqiri, Islam Berisha, Bajram Jashari, Bekim Haxhiu, Blerim Peja, Xhevdet Gashi, Musa Jashari, Isë Krasniqi, Hilmi Ramadani, Nusret Pllana, Martin Çuni, Rizah Asllan Berisha, Berat Luzha, Xhevdet Gashi, Enver Tefik Gashi, Rizah Berisha,

[177] Po aty: 30

[178] Kosovo: Investigation Into Racak Killings (2015): https://mail.google.com /mail/u/0/?pc=no-ha-emea-no-bk#inbox/FMfcgxwGCkmVvGVSXhHXNpnZfNKGZwZB?projector=1

Milaim Berisha, Elez Durmishi, Ismet Sopi, Fadil Berisha, Nuri Bega, Ismet Behxheti, Rauf Dhomi, Efraim Kastrati etj.[179]

Për bashkësinë ndërkombëtare (paralelisht me faktorizimin e UÇK-së) ishte me rëndësi që UÇK-ja (veçanërisht udhëheqja e UÇK-së) të vihej nën kontroll dhe në këtë kuadër të kihet kontroll edhe mbi negociatat që po përgatiteshin. Sipas studiuesit Mark Weller, "që nga pranvera (1998) forcat serbe kishin nisur një ofensivë të rëndësishme, duke e zhvendosur UÇK-në nga disa zona për të cilat thoshte se i kontrollonte. Thuhej se ky veprim nuk ishte kundërshtuar ndërkombëtarisht sepse qëllimi ishte të evitohej që UÇK-ja të kishte një rol dominues në negociatat që po vinin" (Weller 2009: 158). E tëra rezultoi me inicimin e organizimit të Konferencës së Rambujesë në Francë në fillimvitin 1999.

Udhëheqja politike e UÇK-së u sfidua shumë nga dokumenti i propozuar për negociata në Konferencën e Rambujesë ngaqë nuk mund të pranonte zgjidhje për Kosovën në kuadër të Serbisë. Në pikënisje, ky dokument garantonte sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës Federative Jugosllave (RFJ-së) de facto të Serbisë, mbi Kosovën, dhe parashihte një autonomi për Kosovën që nuk ishte në nivel as me autonominë që kishte Kosova në bazë të Kushtetutës të vitit 1974. Megjithëkëtë, udhëheqja e UÇK-së, duke e përfshirë edhe përfaqësuesin e përgjithshëm politik të UÇK-së, Adem Demaçin, ishte e gatshme të bëjë kompromise, por vetëm në kuptimin e një zgjidhje që hapte një perspektivë të sigurt politike për Kosovën. Në lidhje me këtë, autori i librit biografik për Adem Demaçin, Shkëlzen Gashi, shkruan:

> "Në fund të nëntorit 1998 Demaçi paralajmëron se çfarëdo përpjekjeje që në çfarëdo mënyre synon me e lanë Kosovën koloni të Serbisë a të Jugosllavisë është krejt e papranueshme. Porse pranon që UÇK-ja mund ta bëjë një kompromis: Kosova të jetë

[179] Radio-Kosova e Lirë (2016): *Një histori autentike e informimit në luftë e në liri*. https://www.radiokosovaelire.com/radio-kosova-e-lire-nje-histori-autentike-e-informimit-ne-lufte-e-ne-liri/

> republikë në kuadër të mbetjes jugosllave - bashkë me Serbinë dhe Malin e Zi - veçse me garancinë e SHBA-së dhe të BE-së që, pas skadimit të një afati trevjeçar, kjo republikë ta gëzojë të drejtën për vetëvendosje" (Gashi 2010: 150).

Pas insistimit të bashkësisë ndërkombëtare, platforma e paraqitur për negocimin e statusit të përkohshëm të Kosovës fillimisht u pranua nga LDK në krye me Ibrahim Rugovën, më pastaj edhe nga një pjesë e përfaqësuesve të UÇK-së në krye me Hashim Thaçin. Ndërsa përfaqësuesi i përgjithshëm politik i UÇK-së, Adem Demaçi, sekretari i përgjithshëm i UÇK-së, Albin Kurti, duke e përfshirë komandantin e përgjithshëm të UÇK-së (të emëruar nga Adem Demaçi), Sylejman Selimin etj., e refuzuan platformën negociuese. Në fakt, ky refuzim shërbeu si presion konstruktiv ndaj delegacionit shqiptar të Kosovës në Rambuje. Në kuptimin që të mos pranohet ndonjë zgjidhje pa asnjë perspektivë politike për Kosovën, dhe njëkohësisht ndikoi në mënyrë të tërthortë për forcimin e pozicionit negociues të delegacionit shqiptar të Kosovës në Rambuje. Madje edhe Madeline Albright, në librin e saj *Madam Secretary: a memoir*, i botuar për herë të parë në vitin 2003, përveç të tjerash, shkruan se Demaçi ishte: "një prej atyre që i bënin presion Thaçit ta ruante qëndrimin më të ashpër të mundshëm" (Albright 2005: 501). Gjithashtu, Thaçit i bëhej presion edhe nga disa veprimtarë të LPK-së (dega jashtë vendit), por edhe nga disa komandantë të zonave të UÇK-së në Kosovë. Në këtë vazhdë, vetëm pasi që u premtua se zgjidhja finale për Kosovën do të bazohet në "vullnetin e popullit", delegacioni i shqiptarëve të Kosovës, që u kryesua nga Hashim Thaçi, pas më shumë dhe më pak hezitimeve gjatë procesit negociator, e pranoi propozimin për Marrëveshjen e Rambujesë dhe e nënshkroi më 18 mars 1999 në Paris të Francës. Rrjedhimisht, gjëja shpresëdhënëse për perspektivën politike të Kosovës ishte se kapitulli 8, pika 3 e marrëveshjes, përcaktoi se zgjidhja finale për Kosovën, përveç të tjerash, do të bazohet në "vullnetin e

populit"[180], edhe pse shprehja "vullneti i popullit" nuk ishte e konkretizuar.

Milloševići e refuzoi këtë marrëveshje sepse nuk pranoi (siç parashihte kjo marrëveshje) stacionimin e trupave paqeruajtëse të udhëhequra nga NATO dhe se kjo marrëveshje pas tre vjetësh parashihte një lloj referendumi për Kosovën.[181] Si pasojë e refuzimit dhe vazhdimit të krimeve ndaj popullatës shqiptare në Kosovë, regjimi neofashist i Milloševićit u ndëshkua me sulmet ajrore ushtarake të NATO-s që nisën më 24 mars 1999.

Në ndërkohë, UÇK-ja u përforcua edhe më shumë me kuadër profesional në krye me Agim Çekun, i cili e la pozitën ushtarake aktive si gjeneral i armatës kroate dhe iu bashkëngjit UÇK-së në cilësinë e shefit të shtabit të përgjithshëm të UÇK-së. Kjo periudhë përkon me ndërhyrjen e NATO-s dhe me konsolidimin profesional të UÇK-së si partnere e NATO-s deri në përfundimin e luftës. Paraprakisht nga Kroacia iu kishte bashkëngjitur UÇK-së, ushtaraku i shkathtë Bekim Berisha - Abeja, i cili përveç tjerash kishte iniciuar formimin e njësisë elite të UÇK-së, "Tigrat e Zi". Në kuadër të këtij profesionalizimi ushtarak të UÇK-së, kontribut të çmuar dhanë edhe ushtarakët nga Shqipëria Londineze: Tahir Sinani, Indrit Cara, Dilaver Goxhaj, Adem Shehi, Bardhyl Tahiri etj. Duke përfshirë edhe ushtarak të tjerë shqiptarë (me prapavijë profesionale ushtarake nga ish-jugosllavia) të cilët dëshmuan profesionalizmin e tyre ushtarak, veçanërisht në betejën e Koshares, si njëra ndër betejat më heroike dhe më të suksesshme të UÇK-së.

Në vazhdën e intervenimit të NATO-s, nga këndvështrime të ndryshme (politike, ushtarake dhe morale), pati kritika ndaj mënyrës së këtij intervenimi. Në lidhje me këtë, Mønnesland, shkruan:

[180] Rambouillet Accords: Interim Agreement for Peace and Selv-Government in Kosovo 1999, p. 85: https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/990123_RambouilletAccord.pdf

[181] Mønnesland 2006: 359

> "Kritikët në Perëndim konsideronin se NATO e kishte të pamundshme ta arrinte qëllimin pa i futur trupat tokësore. Ekspertët ushtarakë shpjegonin se trupat tokësore ishin të domosdoshme për të kontrolluar një territor. Disa, gjithashtu, konsideronin se ishte e pamoralshme të luftohej pa i ekspozuar për humbje trupat vetjake. Por politikanët perëndimorë u zmbrapsën nga mendimi për të futur trupat tokësore të cilat do të kishin edhe humbje. Megjithëkëtë, rezultoi se trupat tokësore nuk qenë të domosdoshme për t'u arritur presioni politik" (Mønnesland 2006: 361).

NATO, vetëm me intervenimet ushtarake ajrore që zgjatën 78 ditë, pa futjen e trupave tokësore, nuk mundi ta mbrojë popullatën civile në Kosovë. Gjatë kësaj periudhe forcat serbe vranë rreth 12 mijë shqiptarë të Kosovës, dhunuan mijëra femra, shkatërruan dhjetëra mijëra shtëpi dhe deportuan rreth një milion shqiptarë nga Kosova. Me fjalë të tjera, intervenimi i NATO-s në Kosovë nuk ndodhi sikurse intervenimi për çlirimin e Kuvajtit në vitet 1990-'91 nga aleatët perëndimorë të cilët përdorën trupat tokësore. Tri pasojat kryesore të mungesës së ndërhyrjes tokësore janë viktimat shqiptare, kompromisi për Rezolutën 1244 dhe nisma e ndarjes së Mitrovicës.

Madje vetë gjenerali Wesley K. Clark e pranon në njëfarë mënyre se sikur të kishin filluar që në fillim përgatitjet për intervenim tokësor do të shpëtoheshin shumë njerëz të pafajshëm. Në librin e tij *Waging Modern War* (2001), përveç të tjerash, shkruan: "Planifikimi dhe përgatitjet për ndërhyrje tokësore ishin në proces aty nga fundi i fushatës ajrore dhe unë jam i bindur se kjo, në veçanti, e shtyu Miloševićin të dorëzohet" (Clark 2001: 429). Në fakt, përgjegjësinë kryesore për mungesën, së paku të një strategjie të armatosjes për vetëmbrojtje të popullatës civile shqiptare në Kosovë nga regjimi i Millošević (gjatë intervenimit të NATO-s), e kishte elita politike shqiptare sepse, fatkeqësisht, mungoi një koordinim i duhur paraprak për përgatitjen për luftë (sidomos pas konferencës së Dejtonit), në mes të LDK-së, Qeverisë së Kosovës në Egzil, dhe LPK-së, duke i përfshirë edhe pushtetarët në Shqipërinë Londineze.

Nëse mund të fajësohen më shumë rrethanat politike -

ndërkombëtare (se sa elita politike shqiptare), për mosarritjen e duhur të koordinimit politik gjatë Luftës së Dytë Botërore, në mes nga njëra anë Fadil Hoxha, Enver Hoxha etj. dhe, nga ana tjetër, Shaban Polluzha, Mithat Frashëri etj., duke përfshirë mosarritjen e koordinimit të duhur politik pas Luftës së Parë Botërore, në mes nga njëra anë Ceno Beg Kryeziut, Ahmet Zogu etj. dhe, nga ana tjetër, Hasan Prishtina, Fan Noli etj. Pas shembjes së murit të Berlinit (1989) mund të fajësohet më shumë elita politike shqiptare për mosarritjen e koordinimit të duhur politik në kuadër të përpjekjeve për çlirimin e Kosovës, sepse pas vitit 1989 rrethanat politike ndërkombëtare kanë qenë në vazhdimësi më të favorshme për shqiptarët, krahasuar me të kaluarën.

Pas gjithë tragjedisë që ndodhi në Kosovë gjatë vitit 1998-1999, dhe duke marrë parasysh se Marrëveshja e Rambujesë mund të cilësohej moralisht e pavlefshme, edhe juridikisht e pavlefshme, duke u bazuar në klauzolën *rebus sic stantibus* të së drejtës ndërkombëtare, ku parashihet se një marrëveshje humb vlefshmërinë mbasi të jenë ndryshuar radikalisht rrethanat nën të cilat ajo është nënshkruar.[182] Fatkeqësisht, liderët shqiptarë të Kosovës vazhduan me divergjenca në mes tyre edhe gjatë dhe sidomos pas Konferencës së Rambujesë, duke mos i shfrytëzuar si duhet çastet historike. Kjo pati konsekuenca të shumta më pastaj, përveç të tjerash: vonesa e pavarësimit të Kosovës, trazirat e marsit në vitin 2004, mungesa e forcimit të shtetit ligjor etj.

Në ndërkohë Milloševići (i cili paraprakisht kishte kalkuluar se sa më shumë që zgjasin sulmet ajrore aq më shumë rriteshin gjasat të përçahen shtetet anëtare të NATO-s), gjatë dorëzimit të tij e shfrytëzoj marrëveshjen Ahtisaari - Çernomyrdin:

[182] Clausula rebus sic stantibus in internationals conventions (internacional agreements or treaties): Vienna Conventionon the law of treaties (with annex). Concluded at Viennaon 23 May 1969, article 62: https://www.law.cornell.edu /wex/rebus_sic_stantibushttps://treaties.un.org/doc/publication/unts/volume %201155/volume-1155-i-18232-english.pdf

"Marrëveshja Ahtisaari - Çernomyrdin, e cila u pranua nga Beogradi në fillim të qershorit, dallonte nga marrëveshja e Rambujesë, edhe pse shumë nga pikat kryesore ishin të njëjta. Për Milloševićin, i cili duhej t'ia shiste marrëveshjen popullit të tij si një fitore, ishte më e rëndësishmja që tani OKB-ja rezultoi si një autoritet suprem dhe se trupat paqeruajtëse nuk ishin në emërtim trupa të NATO-s. E rëndësishme ishte, gjithashtu, se marrëveshja e re nuk përmendte asgjë lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës, tranzicionin kalimtar trevjeçar ose referendumin. Një parakusht për zbatimin e marrëveshjes ishte rekomandimi i Këshillit të Sigurimit i OKB-së, që grupi G-8 i vendeve më të rëndësishme të industrializuara ta hartojë draftrezolutën ku mori pjesë edhe Rusia (Kina abstenoi nga votimi). Kur gjithashtu Serbia plotësoi kërkesën e NATO-s për ta filluar tërheqjen e trupave të veta nga Kosova, NATO i ndërpreu sulmet ajrore. Tërheqja serbe nga Kosova ndodhi siç ishte planifikuar dhe në mënyrë të rregullt. U bë paqe në Jugosllavi, por detyrat që pritnin ishin enorme. Marshimi i trupave të NATO-s në Kosovë shkoi pa probleme të mëdha dhe ushtarët u pritën si shpëtimtarë nga shqiptarët e entuziazmuar. Por roli i rusëve ishte i paqartë, dhe nëpërmjet një manovre befasuese rusët arritën t'i vejnë mbroth NATO-s dhe të vendosin disa qindra burra në aeroport, të cilët u përshëndetën me mirëseardhje nga serbët. Për NATO-n ishte e rëndësishme të ketë një bashkëpunim me Rusinë pa e ndarë Kosovën në një sektor shqiptar dhe serb. Një problem tjetër për NATO-n ishte marrëdhënia me UÇK-në, që e konsideronin veten si ustallarë legjitimë të Kosovës së lirë. Menjëherë pas Rambujesë, UÇK-ja formoi një "qeveri" me liderin e UÇK-së, Hashim Thaçi, kryeministër. Tani UÇK-ja dëshironte të merrte përsipër administrimin e krahinës. Por, sipas marrëveshjes, UÇK-ja duhej të çarmatosej. Në këtë vazhdë pasuan shfaqje konfliktesh në mes të UÇK-së dhe NATO-s dhe në mes fraksioneve të ndryshme të shqiptarëve. UÇK-ja ishte në opozitë të ashpër ndaj udhëheqësit të moderuar të shqiptarëve të Kosovës, Ibrahim Rugova, i cili gjatë sulmeve të NATO-s u mbajt në arrest shtëpiak nga serbët dhe u shfaq në televizionin serb në "negociatat" me Milloševićin" (Mønnesland 2006: 362-363).

Përfundim

Shqiptarët si etni e kanë një vazhdimësi të gjatë edhe në trevën e Kosovës me vise, pavarësisht prej ndryshimeve demografike në kohë dhe hapësirë (tkurrjes, shpërnguljeve) të shqiptarëve, të shkaktuara nga pushtimi dhe sundimi romak, bizantin, bullgar, serb, otoman etj.

Hyrja në epokën e nacionalizmit (epokën e kombformimeve) gjatë fundshekullit XVII dhe fillimshekullit XVIII ndikoi për fillimprocesin e kombformimeve edhe në zonën e Ballkanit, ku ideologjia nacionaliste u keqpërdor deri në ekstrem, veçanërisht pas marrëveshjes Ruso - Turke të vitit 1878 (Traktatit të Shën Stefanit). Në këtë vazhdë, procesi i krijimit të shteteve kombëtare në zonën e Ballkanit dhe më gjerë rezultoi me konsekuenca të dhimbshme (krime, spastrime etnike dhe persekutime) ndaj shqiptarëve, armenëve, kurdëve etj. Konsekuenca të ngjashme (të shkaktuara nga keqpërdorimi i ideologjisë nacionaliste) u përsëritën gjatë Luftës së Dytë Botërore ndaj hebrenjve, romëve etj. dhe gjatë zhbërjes së Jugosllavisë federale në vitet '90 ndaj boshnjakëve, shqiptarëve etj.

Si në shumë raste të tjera në botë, edhe në rastin e shqiptarëve Lëvizja Kombëtare nuk ka qenë tërësisht politikisht homogjene që nga Lidhja e Prizrenit (1878), e veçanërisht pas vitit 1912. Megjithëkëtë, rrymat e ndryshme politike në kuadër të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare pas vitit 1912 kanë qenë më shumë rezultat i kalkulimeve strategjike (sesa i indoktrinimeve ideologjike), me përpjekjet e gërshetuara kryesisht të rezistencës aktive dhe pasive, dhe me një synim kryesor dhe të përbashkët për çlirimin e Kosovës me vise drejt Bashkimit Kombëtar.

Rezistenca aktive, kundër pushtimit dhe sundimit serb të Kosovës që nga Lufta e Parë Ballkanike 1912, identifikohet, përveç të tjerash, me: Lëvizjen Kaçake, Komitetin për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës, rezistencën kundër ripushtimit serb të Kosovës (gjatë përfundimit të Luftës së Dytë Botërore) dhe me grupet revolucionare klandestine të pas Luftës së Dytë Botërore që rezultuan me themelimin e Lëvizjes Popullore të

Kosovës - LPK (1982) dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - UÇK (1994). Me fjalë të tjera, rezistenca aktive e shqiptarëve, pavarësisht prej rrethanave realpolitike në kohë dhe hapësirë, ka qenë në vazhdimësi e karakterizuar nga idealizmi, përkushtimi dhe sakrificat për çlirimin e pjesëve të okupuara të kombit shqiptar jashtë Shqipërisë Londineze dhe për bashkimin e shqiptarëve në një shtet (federatë/konfederatë), bazuar në idealin kombëtar të Lidhjes së Prizrenit. Në këtë kuptim, rezistenca aktive e shqiptarëve për çlirimin e Kosovës me vise dhe bashkim kombëtar e ka një vazhdimësi të pashkëputur prej vitit 1912 si në aspektin strukturor, ku gjatë goditjeve të ndryshme që ka marrë në kohë dhe hapësirë, ka arritur të riorganizohet në mënyra të ndryshme dhe, si në aspektin e individit, duke qenë e inkurajuar nga personalitetet me ndikim të jashtëzakonshëm kombëtar, që nga Hasan Prishtina e deri te Adem Demaçi dhe Adem Jashari.

Rezistenca pasive e shqiptarëve, në kuptimin e "politikës si art i së mundshmes", identifikohet kryesisht (pas Luftës së Parë Botërore), me Partinë Legale Shqiptare, Bashkimi (Xhemijeti) në kuadër të Jugosllavisë Monarkiste, në krye me Ferat Dragën etj. Ndërsa pas Luftës së Dytë Botërore, identifikohet me udhëheqjen politike shqiptare të institucioneve të Krahinës së Kosovës në Jugosllavinë Federaliste, në krye me Fadil Hoxhën etj. Pas shembjes së murit të Berlinit (1989) identifikohet me Lidhjen Demokratike të Kosovës, në krye me Ibrahim Rugovën etj. Edhe (në kuadër më të gjerë politik-kombëtar), udhëheqja politike e Shqipërisë Londineze, pas Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, në krye me Ahmet Zogun dhe Enver Hoxhën, ka qenë e karakterizuar nga "politika si art i së mundshmes" dhe në këtë vazhdë edhe qasja politike e udhëheqësve të mëpasshëm (me disa ndryshime në rrethanat e reja, pas shembjes së murit të Berlinit), në krye me Ramiz Alinë, Sali Berishën, Fatos Nanon etj.

Shikuar historikisht, vazhdimësia e rezistencës pasive (në Kosovë, por edhe në nivel kombëtar, duke përfshirë Shqipërinë Londineze), ka shërbyer, përveç të tjerash, t'i amortizojë

goditjet e regjimeve të Beogradit etj., që qëllim final kishin të gjejnë "shkas" dhe "justifikim" për zhdukjen dhe dëbimin e tërësishëm të shqiptarëve nga Kosova dhe më gjerë, dhe për aneksimin e mëtutjeshëm të territoreve shqiptare. Ndërsa vazhdimësia e rezistencës aktive e shqiptarëve ka shërbyer si katalizatori kryesor për çlirimin e Kosovës dhe në këtë vazhdë ka ndikuar për inkurajimin e procesit për realizimin e të drejtave kombëtare të shqiptarëve në Maqedoni dhe në vise të tjera të banuara me shqiptarë në ish-Jugosllavi. Rrjedhimisht, rezistenca aktive dhe pasive e shqiptarëve për çlirimin e Kosovës me vise, (përkundër sfidave, dobësive dhe divergjencave), ka qenë në masë të madhe komplementare si në kuptimin për vazhdimësinë e masivizimit të ndjenjës kombëtare të shqiptarëve në Kosovë me vise, në kuadër të fazës c, në periudhën 1912-1999, dhe si në kuptimin për çlirimin e Kosovës, duke kulmuar me luftën legjitime dhe të lavdishme të UÇK-së.

Mobilizimi dhe mbështetja shumëdimensionale – gjithëkombëtare, e luftës legjitime të UÇK-së, kundër regjimit neofashist të Millosheviçit në vitet 1998-99, ishte një rikonfirmim i vullnetit kombëtar të shqiptarëve (të shprehur nëpërmes Lidhjes së Prizrenit në vitin 1878, veçanërisht nëpërmes shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912), se kombi shqiptar është një njësi kulturore dhe një realitet sociologjik i pandashëm, pa marrë parasysh hapësirat politike ku jetojnë shqiptarët në Ballkan. Njëkohësisht, ky ishte një konfirmim, se masivizimi i ndjenjës kombëtare gjithëshqiptare kishte arritur pikën kulmore në kuadër të fazës c. Në këtë vazhdë, UÇK-ja arriti që çështjen e Kosovës (që kishte mbetur çështje e pazgjidhur prej vitit 1912) ta imponojë për zgjidhje në kuadër të agjendës ndërkombëtare, dhe me sakrificën e heronjve, dëshmorëve dhe viktimave të luftës, shërbeu si katalizatori kryesor për çlirimin e Kosovës. Duke e përfshirë mbështetjen e shtetit shqiptar (Shqipërisë Londineze) dhe rolin vendimtar të intervenimit ushtarak ajror të NATO-s, në krye me ShBA-në dhe Britaninë e Madhe (përfshirë të gjitha shtetet anëtare të NATO-s), të cilëve shqiptarët u janë përjetësisht mirënjohës. Pas çlirimit të

Kosovës në vitin 1999, Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) e mori përgjegjësinë për ta organizuar bashkësinë politike në Kosovë në mes të shqiptarëve, serbëve dhe të tjerëve.

Krejt në fund vlen të theksohet se prej filleve të epokës së nacionalizmit (të fundshekullit XVII dhe fillimshekullit XVIII) nuk ka pasur konflikt në mes të popullit shqiptar dhe popullit turk, por përpjekje të vazhdueshme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për arritjen e të drejtave kombëtare dhe çlirimin e shqiptarëve nga sundimi i Perandorisë Osmane, që rezultoi me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912. Në këtë vazhdë nuk ka pasur konflikt as në mes të popullit shqiptar dhe popullit serb pas okupimit të Kosovës nga shteti serb në vitin 1912, por ka pasur përpjekje të vazhdueshme të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për çlirimin e shqiptarëve në Kosovë me vise, nga regjimet shtypëse të Beogradit. Dhe këto përpjekjeje të vazhdueshme të shqiptarëve prej vitit 1912 kulmuan me luftën legjitime të UÇK-së dhe, rrjedhimisht, me çlirimin e Kosovës (1999). Prandaj me të drejtë, studiuesi për Ballkanin, Tim Judah, konstaton: "Ushtria Çlirimtare e Kosovës duhet të renditet si një nga lëvizjet guerile më të suksesshme në historinë moderne" (Judah 2000: 61).

KREU III

MODELET PËR ORGANIZIMIN E BASHKËSIVE POLITIKE NË MES TË MAJORITETIT DHE MINORITETEVE DHE ORGANIZIMI I BASHKËSISË POLITIKE NË KOSOVË

Hyrje

Me fillesën e epokës së nacionalizmit dhe veçanërisht pas revolucionit francez (që nuk ishte vetëm revolucion socio-politik, por edhe revolucion nacional), rezultoi fuqishëm parimi i sovranitetit të popullit si parim për legjitimitetin e shtetit/kombit. Në këtë vazhdë parimi i sovranitetit të popullit barti me vete implikime praktike sepse shtetet nuk ishin tërësisht homogjene, përveç ndonjë shembulli të izoluar. Me fjalë të tjera, shtetet, duke përfshirë edhe zonat (nën sundimin e perandorive të ndryshme), që pretendonin të bëheshin shtete, ishin në të shumtën e rasteve të përbëra nga majoriteti dhe minoritetet, dhe u shfaq domosdoshmëria për një politikë ndaj minoriteteve.

Shikuar nga këndvështrimi teorik, mund të përkufizojmë tri modele kryesore për organizimin e bashkësive politike në mes të majoritetit dhe minoriteteve: *modeli qytetar, modeli kulturor dhe modeli multikulturor*. Këto modele teorike veç e veç nuk e përshkruajnë krejtësisht realitetin empirik të një kombi, megjithëkëtë shërbejnë për ta kuptuar më thellë kombin si fenomen shoqëror si në aspektin e diskutimit normativ, në kuptimin se si duhet të jetë përmbajtja kombëtare etj., ashtu edhe në aspektin deskriptiv, në kuptimin e përshkrimit sa më objektiv të kombit (përmbajtjes kombëtare) si fenomen shoqëror. Për shembull, nëpërmes operacionalizimit të këtyre modeleve teorike mund të përshkruhet/matet një komb i caktuar (ose në mënyrë krahasimtare, kombet e caktuara) se sa është komb qytetar, sa është komb kulturor dhe sa është komb multikulturor. Cili nga këto modele teorike e mbulon më

shumë empirinë komplekse të një kombi, varion prej kombit në komb. Por, në përgjithësi, mund të thuhet se këto modele teorike për kombet janë të pranishme së bashku pothuajse te çdo komb, por duke variuar në kohë e hapësirë dhe në kualitet dhe kuantitet. Studime dhe analiza të tilla kryesisht kanë për qëllim avancimin epistemologjik për ontologjinë e fenomenit komb, përveç të tjerash, për të fituar dituri më të mëdha për mundësitë e të organizuarit/ri-organizuarit më të duhur të bashkësive politike.

Në këtë kapitull do të përqendrohem fillimisht në shtjellimin e këtyre tre modeleve teorike, veçanërisht të modelit multikulturor për ta bërë më të kapshme qasjen e OKB-së për organizimin e bashkësisë politike në Kosovë. Një pjesë e këtij kapitulli bazohet pjesërisht në një punim timin të mëhershëm të titulluar: *Përkatësia etnike dhe bashkësia politike, ndikimi i bashkësisë ndërkombëtare në organizimin e bashkësisë politike në Kosovë*.

Modeli qytetar dhe modeli kulturor

Pikënisje e modelit qytetar për organizimin e bashkësive politike është, në radhë të parë, mirënjohja e identitetit qytetar. Autoritetet shtetërore përpiqen t'i bashkojnë të gjithë qytetarët në një komb, brenda kufijve të shtetit. Një qasje e tillë është e bazuar në individin dhe parasheh barazinë formale për të gjithë qytetarët si individë në sferën publike, pavarësisht prej përkatësisë së tyre etnike etj. Me fjalë të tjera, anëtarët e grupeve minoritare i kanë të drejtat e barabarta me anëtarët e grupit majoritar si individë, por nuk kanë të drejta grupore si minoritete. Ky model është në linjë me parimin klasik liberal të mbështetur në iluminizmin, modernizmin dhe lirinë individuale, që në vazhdimësi e ka konsideruar asimilimin si formë të integrimit, drejt shoqërive kozmopolite. Në këtë vazhdë, liberalët (ngjashëm sikurse socialistët), konfliktet etnike i kanë konsideruar kryesisht si rezultat i varfërisë, diskriminimit dhe mungesës së të drejtave, duke mbetur me

shpresën se kur të zhduken këto shkaqe do të zhduken edhe konfliktet etnike. Kjo mënyrë e të menduarit e karakterizon edhe mendimtarin e madh socio-liberal John Rawls, në përpjekjet e tij për etablimin e një teorie të përgjithshme të drejtësisë. Në fakt, me veprën e tij të mirënjohur ndërkombëtarisht *Një teori e drejtësisë*, e botuar për herë të parë në vitin 1971, ka arritur t'ia kthejë teorisë politike aspektin normativ që i ka munguar për një kohë, në kuptimin e vazhdimësisë së traditës me kontratat teorike që nga mendimtarët me ndikim të madh si John Locke, Jean-Jacques Rousseau, Charles Montesquieu, John Stuart Mill etj. Në vazhdën e kësaj tradite, Rawls, për t'i legjitimuar parimet e drejtësisë, merr pikënisje në një kontratë hipotetike që nënkupton se palët/aktorët gjenden në "një pozicion origjinal", përkatësisht në një pozicion negociues paraprak dhe, duke qenë të pozicionuar prapa të ashtuquajturës "vellos së injorancës", nuk janë në dijeni për rolin dhe interesat që faktikisht do t'i kenë në shoqëri. Kjo, sipas perspektivës teorike të Rawlsit, e krijon bazamentin e drejtësisë ngaqë palët/aktorët, pavarësisht prej perceptimeve dhe interesave të ndryshme në jetën reale, kanë mundësi racionalisht dhe paanëshmërisht të pajtohen për parimet e drejta në lidhje me politikën, ekonominë dhe shoqërinë si tërësi. Sepse "ata (palët/aktorët) gjithashtu detyrohen ta marrin parasysh faktin se parimet që zgjedhin duhet të duken të arsyeshme për të tjerët, veçanërisht për pasardhësit e tyre, të drejtat e të cilëve do të ndikohen nga kjo thellësisht" (Rawls 1999: 134). Rawls është veçanërisht i shqetësuar me parimet që menaxhojnë drejt aspektet socio-ekonomike dhe lirinë individuale, ndërsa për aspektet kulturore-fetare (etnitetin, fenë etj.), konsideron se duhet lënë në sferën private në kuadër të shtetit neutral, që konsiderohet i nevojshëm për ta mbrojtur autonominë individuale për të gjithë qytetarët si individë. Rrjedhimisht, sipas kësaj qasjeje, vetëm identiteti i përbashkët qytetar është politikisht i rëndësishëm dhe konsiderohet si një zgjidhje e 'drejtë' për organizimin e bashkësisë politike. Në kuptimin se vetëm një identitet i përbashkët qytetar mund ta shmangë

politizimin e identiteteve të tjera kulturore të individëve (që u përkasin grupeve të ndryshme kulturore) dhe që nuk e kanë një perceptim të njëjtë për të "mirën e përbashkët". Kjo është edhe arsyeja pse Rawls sugjeron se në mes të drejtës dhe të mirës, duhet dhënë prioritet të drejtës[183].

Pikënisje e modelit kulturor për organizimin e bashkësive politike është parësisht mirënjohja e identitetit kulturor. Për autoritetet shtetërore, përmbajta e identitetit kombëtar janë gjuha, historia, religjioni etj., të majoritetit. Pragu për integrimin e minoriteteve etnike varion: mund të jetë i ulët, për shembull, një person me prapavijë etnike minoritare të flasë rrjedhshëm gjuhën e majoritetit, ose pragu mund të jetë i lartë, për shembull, një person me prapavijë etnike minoritare duhet të jetë gjenerata e katërt e paraardhësve të tij që kanë jetuar në një shtet, që të mund të perceptohet si pjesë e bashkësisë kombëtare e atij shteti. Ky model është në linjë me idenë e komunitarizmit që parësisht bazohet në bashkësi. Për prapavijën e komunitarizmit mund të merret pikënisje në kritikën e Aristotelit ndaj teorive të Platonit për shtetin ideal, ose në kritikën e Hegelit ndaj etikës formaliste dhe universale të Kantit. Por, si teori e veçantë politike, komunitarizimi u zhvillua gjatë viteve '70-'80, në krye me Alasdair Mac Intyre, Marta Nussbaum, Michael Sandel, Charles Taylor, Michael Waltzer etj., si një reaksion ndaj pikëpamjeve të John Rawlsit, të publikuara në librin e tij: *Një teori e drejtësisë* (1971). Në lidhje me këtë, filozofja Nancy Fraser bën një ndarje në mes traditës që e lidhim me Kantin dhe Rawlsin, e karakterizuar nga një teori deontologjike e bazuar në vlerat e barazisë dhe lirisë që përfaqëson politikën e rishpërndarjes (politics of redistribution). Dhe traditës nga Hegeli te komunitaristët, që i jep rëndësi 'jetës së mirë' dhe mirënjohjes së identitetit (politics of re cognition).[184] Vlen të theksohet se teoricienët komunitaristë janë një grup heterogjen në kuptimin politik, të karakterizuar

[183] Rawls 1999: 396

[184] Fraser 2003: 26-30

që nga simpatitë socialdemokrate (Taylor, Nussbaum etj.), deri te konservatizmi me orientim katolik (MacIntyre etj.) e, gjithashtu, deri në një masë, janë grup heterogjen edhe në kuptimin filozofik. Dhe arsyeja kryesore pse identifikohen/ grupohen, sidomos shikuar nga jashtë, si komunitaristë (community: bashkësi ose shoqëri), është se i japin rëndësi të veçantë bashkësisë shoqëroro-kulturore për formësimin e individit. Dhe në këtë vazhdë janë kryesisht të bashkuar në tri pika në kuadër të kritikës së tyre ndaj liberalizmit. Në radhë të parë në aspektin ontologjik, qasjen "atomiste" të liberalistëve, që e percepton individin si një atom të lirë dhe të izoluar, e konsiderojnë qasje të gabueshme në kuptimin antropologjik ngaqë, sipas tyre, individi nuk ekziston në mënyrë të pavarur nga bashkësia. Së dyti, nuk pajtohen me mendimin e liberalëve se parimet e liberalizmit bazohen në një themel neutral, racional dhe me vlefshmëri universale. Përkundrazi, sipas komunitaristëve, këto parime të liberalizmit janë të kushtëzuara kulturalisht dhe produkt i rrethanave historike. Dhe, së treti, përderisa liberalët prioritojnë të drejtën para të mirës, në kuptimin e një kornize neutrale për të drejtat dhe liritë që i jep mundësi individit të zgjidhë lirshëm, komunitaristët konsiderojnë se parimet për drejtësinë nuk mund të formësohen në mënyrë të pavarur nga perceptimi për të mirën. Rrjedhimisht, kritika komunitariste ndaj pikënisjes së pastër të modelit qytetar për organizimin e bashkësive politike, e bazuar në teorinë liberale, nënkupton se liberalët i shpërfillin rrethanat ku zhvillohet autonomia individuale, dhe se shteti neutral që është i bazuar në identitetin qytetar e redukton ndjenjën e bashkësisë. Me fjalë të tjera, komunitaristët konsiderojnë se lojaliteti ndaj shtetit do të jetë më i vogël po qe se nuk ekziston ndonjë formë e "jetës së përbashkët" që konsiderohet si e "mirë e përbashkët" dhe, sipas tyre, njësia themelore e shoqërisë është parësisht bashkësia, dhe jo individi autonom.

Edhe pse shtetet moderne janë kulturalisht diverse, shumica e teoricienëve bashkëkohorë liberalë, duke qenë të prirë nga mendimi se shtetet janë unikombëtare (shteti-komb), e konside-

rojnë diversitetin kulturor si variacion i perceptimit të njerëzve për të 'mirën' ose si rezultat i migrimit, përkatësisht si diversitet filozofik, fetar dhe etnik, brenda një kulture të vetme unikombëtare të bazuar në një gjuhë të përbashkët. Prandaj, nuk e mirënjohin dhe nuk e diskutojnë ekzistencën e shtetit multikombëtar, që përfshinë brenda vetes minoritetet kombëtare (minoritetet me kontinuitet historiko-territorialo-gjuhësor) dhe nuk i mbështesin kërkesat e minoriteteve kombëtare për vetëqeverisje. Gjithashtu, disa komunitaristë, pavarësisht prej angazhimit të tyre për 'bashkësinë' dhe 'dallimësinë', janë treguar të ngurrueshëm t'i mirënjohin kërkesat e minoriteteve kombëtare për vetëqeverisje. Këndvështrimi i tyre ndaj minoriteteve kombëtare është i ngjashëm me këndvështrimin që kanë ndaj grupeve etnike (emigrantëve) dhe lëvizjeve të reja shoqërore që, sipas tyre, janë forma të bashkësisë dhe dallimësisë, që mund dhe duhet të akomodohen nëpërmes të drejtave specifike në kuadër të shoqërisë si tërësi.[185]

Shikuar historikisht, përderisa modeli kulturor i organizimit të bashkësive politike, më shumë ose me pak, ka rezultuar me segregimin e minoriteteve, modeli qytetar ka rezultuar më shumë ose më pak me asimilimin e minoriteteve. Tradicionalisht, referencë e modelit kulturor ka qenë kombi gjerman, mirëpo ky konstatim është më shumë një kategori historike duke e marrë parasysh se në kohën që po jetojmë, kombi gjerman përmban njëkohësisht në vete shumë elemente të kombit qytetar. Referencë e modelit të kombit qytetar, i quajtur edhe modeli politik i kombit, ka qenë tradicionalisht kombi francez, megjithëkëtë kombi francez nuk ka mundur të krijojë neutralitet të plotë ndaj cilësive të veta etno-kulturore si grup kulturor dominant/shtetformues (cilësitë e kombit kulturor). Kombi francez tradicionalisht ka qenë përfshirës duke njohur dhe garantuar barazi formale në hapësirën publike për të gjithë qytetarët si individë, njëkohësisht duke mos njohur në hapësirën publike identitetin kulturor: etninë dhe gjuhën e

[185] Kymlicka 1995: 128-129

individëve që i përkasin një grupi kulturor-joshtetformues. Kjo do të thotë se shumica franceze (grupi dominues/shtetformues) ka të drejtën ekskluzive të shfaqjes etno-kulturore dhe gjuhësore në hapësirën publike. Po ashtu, ka pritjet e veta që qytetarët që i takojnë një grupi kulturor joshtetformues të kenë sjellje franceze në jetën publike, (njohuri për kodet e kulturës franceze, të komunikohet në gjuhën frënge në vendet publike: punë etj.).

Një ndër shembujt e hershëm në lidhje me këtë qasje franceze është edhe deklarata e Clermont-Tonnerre në asamblenë franceze që në vitin 1790, përkatësisht shprehja e tij: "Hebreut si individ ne i japim gjithçka, hebreut si hebre asgjë" (Smith 2008: 41). Kjo formë e organizimit të bashkësisë politike franceze konsiderohet nga njëra anë si asimiluese ndaj individëve me identitet kulturor që i përkasin grupit apo grupeve joshtetformuese. Nga ana tjetër, kjo konsiderohet si një domosdoshmëri e organizimit politik për ta mbajtur shoqërinë/shtetin të bashkuar, që të mos fragmentohet mbi bazën e identiteteve kulturore dhe të mos rezultojë me segregimin e minoriteteve.

Rrjedhimisht, kombin në rrafshin empirik nuk mund ta përkufizojmë thjesht vetëm në kuptimin politik, bazuar vetëm në shtetësi/qytetari ose, thjesht, vetëm në kuptimin juridik, për shembull, bazuar vetëm në të qenit anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB-së). Dhe as vetëm në kuptimin kulturor/etnik, qoftë në variantin e moderuar (bazuar vetëm në gjuhën dhe bashkësinë historiko-kulturore), ose në variantin radikal (bazuar vetëm në popullin në kuptimin biologjik). Madje varianti radikal në rrafshin empirik për kombet konsiderohet si i paqenë, në veçanti në shtetet perëndimore. Në mënyrë metaforike mund të konkludohet se në rrafshin empirik modeli i kombit qytetar dhe modeli i kombit kulturor janë si vëllezërit siamezë, në veçanti te shtetet unitare. Prandaj një pikënisje objektive është se nuk ka shtete kombëtare neutrale sepse çdo shtet është i formuar nga një grup kulturor shtetformues. Pra, nga një grup kulturor që dominon dhe kontrollon pushtetin, gjuhën dhe simbolet shtetërore (kjo vlen

në veçanti për shtetet unitare). Në këtë vazhdë, modeli i tretë në vijim, përkatësisht multikulturalizmi si projekt politik, është një përpjekje për të gjetur një balancë në mes të drejtave individuale dhe grupore në kuadër të organizimit/riorganizimit të bashkësive politike.

Modeli multikulturor

Në kuadër të teorisë normative politike, Will Kymlicka konsiderohet përfaqësuesi më i spikatur i multikulturalizmit si projekt politik. Veçanërisht bazuar në librin e tij *Shtetësia multikulturore* (1995), në bazë të cilit është mirënjohur me çmimin 'Macpherson Prize' nga asociacioni kanadez i shkencës politike dhe me çmimin 'Bunche Award' nga asociacioni amerikan i shkencës politike. Gjatë argumentimit të tij në këtë libër, fillimisht merr pikënisje në padrejtësitë historike që u janë bërë minoriteteve kulturore. Në kuptimin e përpjekjeve të majoriteteve kulturore për arritjen e homogjenizimit kulturor të bashkësive politike gjatë historisë, që kanë rezultuar me politika dhe konsekuenca të ndryshme ndaj minoriteteve kulturore, përveç të tjerash, me eliminimin e tyre fizik, dëbimin (pastrimin etnik) dhe gjenocidin. Në disa raste me asimilim të dhunshëm dhe detyrim për ta pranuar gjuhën, religjionin dhe zakonet e majoritetit. Dhe në raste të tjera, duke i trajtuar si banorë të huaj, në kuptimin e segregimit fizik, diskriminimit ekonomik, dhe duke ua mohuar të drejtat politike. Paralelisht me këtë, ka pasur përpjekje për t'i mbrojtur minoritetet kulturore dhe për ta shmangur konfliktin në mes të majoritetit dhe minoriteteve, por kanë qenë përpjekje të kufizuara. Për shembull, traktati në mes të Gjermanisë dhe Polonisë për të drejtat e minoriteteve, që nëpërmes Lidhjes së Kombeve mori karakter multilateral, ka qenë një përpjekje, por e pamjaftueshme, ngaqë mbrojtja nga shtypja dhe diskriminimi u sigurohej faktikisht vetëm minoriteteve që kishin afër vendet amë. Gjithashtu, traktatet e tilla janë përdorur nga shtetet e fuqishme për të pushtuar ose

ndërhyrë në shtetet më të dobëta. Në këtë mënyrë, nazistët gjermanë justifikuan pushtimin e Polonisë dhe të Çekosllovakisë me arsyetimin se këto vende po shkelnin të drejtat e minoritetit gjerman.[186]

Pas Luftës së Dytë Botërore, pavarësisht prej sfidave, është shpresuar duke marrë pikënisje në teorinë liberale, se një përkufizim i ri i të drejtave të njeriut do ta zgjidhë çështjen e minoriteteve. Në kuptimin se në vend se t'u jepen të drejta të veçanta, minoritetet do të mbrohen në mënyrë të tërthortë duke ua garantuar të gjithë individëve të drejtat bazike civile dhe politike, pavarësisht përkatësisë etnike etj. Madje, sipas Kymlickas, kjo formë e të menduarit ka ndikuar që të mos përkufizohen hapur në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, të drejtat për minoritetet kombëtare dhe etnike. Gjithashtu, është shpresuar se tradita e gjatë e mbrojtjes së minoriteteve religjioze, e krijuar me ndarjen në mes të shtetit dhe kishës (pas konfliktit në të kaluarën në mes të katolikëve dhe protestantëve), dhe e garantimit të lirisë individuale për ushtrimin e religjionit për të gjithë, do të mund të zbatohet edhe për minoritetet kombëtare dhe etnike. Rrjedhimisht, është shpresuar se edhe identiteti etnik (sikurse identiteti religjioz) është diçka që njerëzit duhet të jenë të lirë ta shprehin në jetën e tyre private, por që nuk është shqetësim i shtetit. Në kuptimin se shteti nuk duhet as ta kundërshtojë dhe as ta inkurajojë lirinë e njerëzve për t'i shprehur lidhjet e tyre të veçanta kulturore. Dhe se në këtë mënyrë, anëtarët e minoriteteve kombëtare dhe etnike janë të mbrojtur nga diskriminimi si individë dhe janë të lirë të përpiqen të mbajnë çfarëdo pjese të trashëgimisë së tyre etnike, por përpjekjet e tyre janë thjesht private. Kjo ndarje në mes të shtetit dhe etnicitetit nënkupton parandalimin e çdo njohje ligjore ose qeveritare të grupeve etnike, përkatësisht parandalon çdo përdorim të kritereve etnike për shpërndarjen e të drejtave, resorëve dhe detyrave. Në këtë kuadër, edhe pse shumë liberalë, veçanërisht të spektrit të majtë, janë përpjekur

[186] Po aty: 2

të krijojnë mekanizma kundër diskriminimit, nëpërmes politikave të 'aksionit afirmativ' për grupet racore të pafavorizuara, si një masë që është e nevojshme të lëvizet drejt 'një shoqërie të verbër ndaj ngjyrave'. Megjithëkëtë, nuk e kanë braktisur idealin e ndarjes në mes të shtetit dhe etnicitetit sepse përpjekjet e tyre kundër diskriminimit nënkuptojnë vetëm masa të përkohshme - përmirësuese, dhe jo masa permanente. Edhe në bazë të Konventës së OKB-së, për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial, parashihet miratimi i programeve të aksionit afirmativ, por vetëm kur ka karakter të përkohshëm - përmirësues. Ndërsa një pjesë e liberalëve, veçanërisht të spektrit të djathtë, kanë qenë në vazhdimësi kundër edhe ndaj politikave të aksionit afirmativ, duke i cilësuar si kontraproduktive, në kuptimin se e përkeqësojnë problemin që synojnë ta zgjidhin, duke i bërë njerëzit më të vetëdijshëm për diferencat grupore dhe më të indinjuar ndaj grupeve të tjera. Qëndrimi i përbashkët i shumicës së liberalëve të pas Luftës së Dytë Botërore, pavarësisht prej spektrit politik të djathtë ose të majtë, është se vazhdimisht e kanë kundërshtuar idenë se minoriteteve kombëtare dhe etnike duhet t'u jepet një identitet permanent politik ose një status kushtetues.[187]

Përveç kritikës së tij, ndaj qasjes tradicionale liberale në raport me minoritetet kulturore, Kymlicka konsideron se as tradita socialiste, edhe pse e karakterizuar nga dy parime kryesore *bashkësia dhe vëllazëria*, nuk ka qenë bujare ndaj të drejtave për minoritetet kulturore ngaqë socializmi si teori merr pikënisje në ekspansionin evolutiv të njësive të shoqërisë njerëzore, nga familja dhe fisi te lokalja, regjionalja, nacionalja dhe eventualisht globalja. Në kuptimin se bashkësitë më të vogla kulturore duhet t'u japin hapësirë bashkësive më të mëdha. Madje kur Marksi dhe Engelsi, e akceptuan idenë e nënndarjes së madhe kombëtare të Evropës, duke e përkrahur unifikimin e Francës, Italisë, Polonisë, Gjermanisë, dhe duke mbështetur pavarësinë e Hungarisë, Spanjës, Anglisë dhe Rusisë, e hodhën

[187] Po aty: 3-4

poshtë mendimin se ketë të drejtë të njëjtë e kishin edhe 'kombësitë' më të vogla: çekët, kroatët, baskët, uellsianët, bullgarët, rumunët dhe sllovenët. Në këtë mënyrë, kombet e mëdha, me strukturat e tyre të mëdha të centralizuara politike dhe ekonomike, konsideroheshin si bartëse të zhvillimit historik. Ndërsa 'kombësitë' më të vogla konsideroheshin si të prapambetura dhe se kontinuiteti i ekzistencës së tyre nuk ishte asgjë më shumë sesa një protestë kundër fuqive të mëdha lëvizëse të historisë. Prandaj pritjet ishin që këto 'kombësi' më të vogla të asimiloheshin nga 'kombet e mëdha', pa përfitimin e ndonjë të drejte, qoftë të drejtat e gjuhës, qoftë të autonomisë kombëtare. Megjithëkëtë, sipas Kymlickas, pavarësisht këtij restrikcioni teorik marksist, socialistët në praktikën e tyre, shpeshherë i kanë apeluar identitetit kulturor. Por kryesisht në rastet kur kjo ka qenë e dobishme për të fituar ose ruajtur pushtetin, siç është shembulli i bolshevikëve, të cilët, pasi që e morën pushtetin në Rusi, e kuptuan se duhej t'i akomodonin kulturat minoritare dhe në këtë vazhdë i mbështetën lëvizjet nacionaliste në vendet jokomuniste, me qëllimin për t'i destabilizuar vendet perëndimore ose aleancat e shteteve perëndimore me Botën e Tretë. Kështututje, përpjekjet strategjike të socialistëve për ta akomoduar diversitetin kulturor, rezultuan kryesisht si përpjekje ad hoc dhe jokohezive. Dhe u zhvilluan pa ndonjë themel të qëndrueshëm teorik në lidhje me vlerën e identitetit kulturor, duke mos dhënë ndonjë shpjegim të qëndrueshëm, pse ose nëse identiteti kulturor ka ndonjë vlerë, përtej rolit strategjik të betejës së socializmit. Rrjedhimisht, në përgjithësi, shumica e socialistëve, ashtu edhe shumë liberalë, i kanë lënë pas dore ose i kanë denigruar të drejtat e minoriteteve nëpërmes konceptit internacionalist dhe të individualizmit abstrakt. Dhe njëkohësisht, duke operuar me modelin e shtetit-komb, nuk kanë provuar të tejkalojnë/zgjidhin ndarjet/dallimet kombëtare brenda shtetit komb, por kanë priorituar që shteti-komb të përmbajë dhe të

promovojë një identitet të vetëm kombëtar,[188] përkatësisht kulturën e grupit kulturor majoritar shtetformues/shtetkontrollues.

Vlen të theksohet se Marksi dhe Engelsi nuk kanë qenë të vetmit mendimtar nga bashkëkohësit e tyre që kanë pasur një pikëpamje në kundërshtim me të drejtat e "minoriteteve kombëtare". Për shembull, bashkëkohësi i tyre dhe mendimtari me ndikim të madh në kuadër të traditës liberale, John Stuart Mill, përveç të tjerash, është i njohur edhe për sugjerimin e tij se një zgjidhje më e mirë është që basku të asimilohet në francez sesa të këmbëngulë ta ruajë reliktin gjysmë të egër të kohëve të kaluara.[189] Madje Hobsbawm konsideron se është 'anakronizëm i pastër' të kritikohen Marksi, Milli etj. për këtë pikëpamje ngaqë gjatë kësaj periudhe kjo ishte pikëpamje edhe e çdo vëzhguesi të paanshëm.[190] Prandaj, shikuar nga ky këndvështrim historik, parimi për Vetëvendosjen e Popujve, i iniciuar nga Lenini në kuadër të traditës socialiste dhe nga Woodrow Wilson, në kuadër të traditës liberale, shënon njëkohësisht një pikënisje inkurajuese për kërkesat e të drejtave për "minoritetet kombëtare".

Pas Luftës së Ftohtë konfliktet etno-kulturore u bënë shkaku më i zakonshëm i dhunës politike në botë, duke minuar përpjekjet për të krijuar institucione demokratike liberale në Evropën Lindore, ish-Bashkimin Sovjetik dhe në Botën e Tretë. Gjithashtu, mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat e imigrantëve, të popujve indigjenë dhe minoriteteve të tjera kulturore, i sfiduan edhe sistemet politiko-demokratike të shteteve perëndimore. Rrjedhimisht, me përfundimin e Luftës së Ftohtë të drejtat për minoritete u kthyen fuqishëm në kuadër të agjendës ndërkombëtare. Në vitin 1991 Konferenca për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (KSBE) e miratoi një deklaratë për të drejtat e minoriteteve kombëtare dhe në vitin

[188] Po aty: 69-70, 72-74
[189] Mill 1972: 363-364
[190] Hobsbawm 2012: 34-35

1993 e emëroi komisionarin e lartë për minoritetet kombëtare. Në ndërkohë, në vitin 1992 Këshilli i Evropës e miratoi një Deklaratë për të Drejtat Gjuhësore për Minoritetet (Karta Evropiane për Gjuhët Rajonale ose Minoritare). Në këtë vazhdë, në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB) u debatua për një Deklaratë për të Drejtat e Personave që i Përkasin Minoriteteve Kombëtare ose Etnike, Fetare dhe Gjuhësore (1993) dhe në lidhje me një Draft Deklaratë Universale për të Drejtat e Popujve Indigjenë (1988) etj.[191] Megjithëkëtë, sipas Kymlickas:

> "... këto deklarata mbeten të diskutueshme. Disa u miratuan me nguti, për të ndihmuar në parandalimin e përshkallëzimit të konfliktit në Evropën Lindore. Si rezultat, janë mjaft të paqarta dhe shpesh duken të motivuara më shumë nga nevoja për t'i qetësuar minoritetet e rebeluara sesa nga ndonjë arsye e qartë se çka kërkohet nga drejtësia. Që të dyja, arsyetimi themelor i këtyre të drejtave, dhe kufijtë e këtyre të drejtave, mbeten të paqarta. Unë besoj se është legjitim dhe në të vërtetë i pashmangshëm, plotësimi i të drejtave tradicionale të njeriut me të drejtat e minoriteteve. Një teori gjithëpërfshirëse e drejtësisë në një shtet multikulturor do të përfshijë që të dyja: të drejtat universale të caktuara për individët pavarësisht anëtarësisë së tyre grupore, dhe të drejtat e veçanta grupore të diferencuara ose 'statusin e veçantë' për kulturat minoritare. Njohja e të drejtave të minoriteteve ka rreziqe të qarta. Gjuha për të drejtat e minoriteteve është përdorur dhe keqpërdorur jo vetëm nga nazistët, por edhe nga apologjetët për ndarje racore dhe aparteid. Është përdorur, gjithashtu, nga nacionalistët intolerantë dhe armiqësorë dhe fundamentalistët në të gjithë botën, për ta justifikuar dominimin e njerëzve jashtë grupit të tyre, dhe shtypjen e kundërshtarëve brenda grupit. Prandaj, një teori liberale e të drejtave të minoriteteve duhet të shpjegojë sesi të drejtat e minoriteteve mund bashkëjetojnë me të drejtat e njeriut dhe sesi të drejtat e minoriteteve kufizohen nga parimet e lirisë individuale, demokracisë dhe drejtësisë sociale" (Kymlicka 1995: 5-6).

Më konkretisht, në kuadër të argumentimit të tij normativ, Kymlicka konsideron se bashkësitë shoqërore brenda shteteve

[191] Kymlicka 1995: 1, 5

multikombëtare ose të shteteve polietnike (por shpesh që të dyja) mund të definohen si bashkësi multikulturore. Një shtet multikombëtar është i karakterizuar nga diversiteti kulturor ku si rrjedhojë shteti i ka inkorporuar minoritetet kombëtare, që janë të karakterizuara si njësi historiko-territoriale-gjuhësore. Shtetet polietnike janë të karakterizuara nga diversiteti kulturor si rrjedhojë e ardhjes së emigrantëve në planin individual dhe në planin familjar. Për shembull, Kanadaja, ShBA-ja, Australia dhe një pjesë e shteteve të ngjashme, janë shtete multikombëtare, njëkohësisht shtete polietnike.[192] Më tutje, Kymlicka konsideron se të drejtat nuk janë as vetëm kolektive dhe as vetëm individuale, por edhe individuale edhe kolektive dhe, për këtë arsye, është me rëndësi që të ketë balancë në mes të këtyre të drejtave.[193] Për shembull, kur një fëmije me prapavijë etnike minoritare i jepet mundësia e mësimit në gjuhën amtare, kjo është një e drejtë individuale njëkohësisht edhe e drejtë kolektive, duke marrë parasysh se fëmija në këtë rast është edhe anëtar i një grupi minoritar. Me fjalë të tjera, Kymlicka mëton të argumentojë për një organizim më të drejtë të bashkësive politike, dhe si teoricien liberal i kundërvihet mendimit klasik liberal për organizimin e bashkësive politike të bazuar vetëm në të drejtat qytetare (citizenship rights). Për këtë arsye shpesh keqinterpretohet se pikënisja e tij është komunitariste, pasi që ai, për dallim nga teoricienët e tjerë liberalë, është edhe pro të drejtave grupore.

Duke e marrë parasysh se të qenit individ autonom është koncept i rëndësishëm brenda teorisë liberale, shtrohet pyetja se si ka mundësi që Kymlicka të jetë njëkohësisht multikulturalist dhe liberal? Sipas tij, që të mund të jemi individë autonomë duhet të kemi një identitet që i përmbahemi për të mundur të bëjmë zgjedhje të lira. Kështu që ne e kemi një prapavijë si pikënisje kur i bëjmë zgjedhjet tona të lira, dhe kjo

[192] Po aty: 17-18
[193] Po aty: 34-35

prapavijë/pikënisje është identiteti grupor.[194] Në këtë mënyrë i arsyeton të drejtat grupore, jo për shkak të grupit domosdoshmërisht si vlerë në vete, por për shkak të individit. Gjithashtu, sipas tij, pushteti shtetëror nuk mund të jetë neutral, sepse pushteti shtetëror në mënyrë aktive e stimulon gjuhën e përgjithshme (gjuhën e grupit kulturor shtetformues) dhe njëkohësisht stimulon një kulturë shoqërore ("societal culture"), e asocuar me kulturën kombëtare, duke zgjedhur ditët e festave zyrtare, planprogramet arsimore në shkollat publike, ndarjen e subjekteve politike etj. Kështu që, pothuajse të gjitha shtetet moderne në mënyrë aktive stimulojnë kombndërtimin nëpërmjet një gjuhe dominuese, simboleve kombëtare etj., dhe ky kombndërtim favorizon anëtarët e kulturës shumicë/majoritetit. Ndërsa minoritetet kombëtare i kundërpërgjigjen këtij kombndërtimi të kulturës shumicë/majoritetit, duke u përpjekur t'i mirëmbajnë ose rindërtojnë kulturat e veta shoqërore,[195] të asocuara me kulturat kombëtare. Prandaj, multikulturalizmi i Kymlickas si projekt politik parasheh domosdoshmërinë e institucionalizimit të grupeve kulturore/minoriteteve joshtetformuese. Në radhë të parë kjo vlen për minoritetet kombëtare duke përfshirë popullatat indigjene, por deri në një masë vlen edhe për minoritetet etnike si rezultat i emigrimit në bazë individuale ose familjare. Kjo ndarje e Kymlickas, në mes të këtyre dy llojeve të minoriteteve (kombëtare dhe etnike), që nganjëherë iu referohet si grupe kulturore dhe nganjëherë si minoritete kulturore, në raport me grupin majoritar kulturor brenda një shteti. Është pothuajse ndarje e zakontë që bëjnë shumica e shteteve perëndimore në politikat e tyre ndaj minoriteve. Përkatësisht ndarja në mes të minoriteteve kombëtare që definohen/karakterizohen bazuar në kontinuitetin e tyre historik-territorial duke përfshirë gjuhën, kulturën ose/dhe religjionin e përbashkët dhe minoriteteve etnike si rezultat i emigracionit në bazë individuale ose familjare (për shkak të përndjekjeve ose

[194] Po aty: 105
[195] Kymlicka 2001: 25-28, 38

arsyeve të tjera), që definohen/karakterizohen bazuar në një gjuhë, kulturë ose/dhe religjion të përbashkët. Megjithëkëtë, duhet të kihet parasysh se Kymlicka nëpërmes konstruksionit të tij teorik, të ndarjes në mes të minoriteteve kombëtare dhe minoriteteve etnike, përveçse i përfshinë edhe popullatat indigjene në kuadër të minoriteteve kombëtare, njëkohësisht konstaton se shtetet që kanë brenda tyre minoritete kombëtare nuk janë shtete-kombe (shtete-unikombëtare), por janë shtete multikombëtare:

> "Një burim i diversitetit kulturor është bashkekzistenca brenda një shteti të caktuar e më shumë se e një kombi, ku 'komb' do të thotë një komunitet historik me një gjuhë dhe kulturë të veçantë, më shumë ose më pak institucionalisht e kompletuar, që përmbush një territor ose atdhe të caktuar. Në këtë kuptim sociologjik, një 'komb' është i lidhur ngushtë me idenë e një 'populli' ose një 'kulture'. Në fakt, këto koncepte shpesh definohen në lidhje me njëra-tjetrën. Prandaj, një vend që përmban më shumë se një komb nuk është një shtet-komb, por një shtet-multikombëtar, edhe kulturat më të vogla formojnë 'minoritetet kombëtare'. Inkorporimi i kombeve të ndryshme në një shtet të vetëm mund të jetë i pavullnetshëm si në rastet e pushtimit dhe mposhtjes të një komuniteti kulturor nga një komunitet tjetër kulturor, ose rastet e dorëzimit të një komuniteti kulturor nga një fuqi perandorake te një fuqi tjetër perandorake, ose kur atdheu i një komuniteti kulturor vërshohet nga kolonizimi i kolonëve. Por, formimi i një shteti multikombëtar mund të ngritet edhe vullnetarisht në rastet kur kulturat e ndryshme bien dakord të formojnë një federatë për dobinë e tyre të ndërsjellë" (Kymlicka 1995: 11).

Sa i përket institucionalizimit të minoriteteve kulturore, Kymlicka argumenton nëpërmes ndarjes analitike "mbrojtjes nga jashtë dhe restrikcioneve të brendshme" ("external protections, and internal rectrictions"), ku shpjegon se si mund të mbahet balanca në mes të drejtave individuale dhe të drejtave grupore. "Mbrojtja nga jashtë" ("external protections") përfshinë të drejtat që i mbrojnë minoritetet, politikisht dhe ekonomikisht, nga majoriteti, dhe kanë të bëjnë me të drejtat për arsimin, gjuhën, kulturën, territorin dhe resorët. Duke përfshirë edhe të

drejtat e reprezentimit politik për minoritete, sepse procesi politiko-demokratik nuk është i mjaftueshëm për ta pasqyruar tërë popullin, dhe të drejtat e reprezentimit për minoritete kontribuojnë që të mos injorohen minoritetet gjatë vendim-marrjes në nivel vendor. Rrjedhimisht për të bërë diçka në këtë drejtim minoriteteve duhet t'u jepen të drejtat e reprezentimit special, për shembull duke i ndryshuar barrierat strukturore; nominimi në listat partiake, rezervimi i një numri të caktuar të ulëseve në parlament për minoritetet etj. Këto të drejta vlejnë në radhë të parë për minoritetet kombëtare, por nuk përjashtohet mundësia që të drejtat në kuadër të "mbrojtjes nga jashtë" deri në një shkallë të mund të vlejnë edhe për grupet etnike si rezultat i migrimit, për shembull, për ta mbrojtur të drejtën e mësimit në gjuhën amtare, praktikat religjioze etj. Në këtë mënyrë, të drejtat në kuadër të "mbrojtjes nga jashtë" konsiderohet se kontribuojnë për t'i barazuar grupet e ndryshme kulturore me pjesën tjetër të popullsisë dhe për ta shkurtuar pushtetin e majoritetit. Ndërsa kur bëhet fjalë për 'restrikcionet e brendshme', kjo ka të bëjë me kërkesën e grupeve minoritare (në raport me shoqërinë si tërësi në kuadër të shtetit), që t'u vënë frerë anëtarëve të vet, në kuptimin e ushtrimit të pushtetit dhe përcaktimit të rregullave ndaj anëtarëve të vet, edhe pse kjo mund të shkojë në dëm të të drejtave të autonomisë individuale të anëtarëve të grupeve minoritare. Shembull për restrikcione të tilla që e kufizojnë të drejtën individuale mund të jetë ndalimi i anëtarëve të grupit minoritar për të marrë pjesë në zgjedhjet nacionale, ndalimi i anëtarëve të grupit minoritar (për shembull vajzave) për të shkuar në shkollë etj. Sipas Kymlickas, asnjë shtet liberal nuk duhet të lejojë që t'i jepet e drejta për restrikcione të brendshme grupeve minoritare, që shkojnë në dëm të autonomisë individuale të anëtarëve të grupeve minoritare. Por apelon vetëm për të drejtat në kuadër të 'mbrojtjes nga jashtë' dhe konsideron se kërkesa për këto të drejta është legjitime në mënyrë që grupet minoritare të jenë të mbrojtura nga normat, idealet dhe vendimet politike të

majoritetit.[196] Prandaj vlen të theksohet se Kymlicka përfaqëson formën e moderuar të multikulturalizmit si projekt politik, që nënkupton mbështetjen politike për minoritetet, me kushtin që kjo mbështetje të bazohet në platformën e vlerave liberale. Njëkohësisht përpjekja e tij është një lloj sinteze në mes të qasjes egalitare-liberale të Rawlsit (lirisë dhe barazisë) dhe qasjes komunitariste që i jep rëndësi domethënëse bashkësisë.

Rrjedhimisht, multikulturalizmi, si një pozicion në mes të komunitarizmit dhe liberalizmit, fokuson më shumë në rregullimin e konflikteve në mes të majoritetit dhe minoriteteve dhe është më pak i preokupuar me identitetin e përbashkët kombëtar, por nuk e përjashton mundësinë e një patriotizmi mbigrupor. Me fjalë të tjera, pikënisja e modelit multikulturalist si projekt politik nënkupton se identitetet grupore janë bazike dhe se individët nuk mund të shihen vetëm si individë, por edhe si anëtarë të grupit. Kjo qasje parasheh se minoritetet kombëtare dhe etnike duhet të kenë të drejtën eksplicite që t'i shprehin dallimet dhe kjo nënkupton se shteti duhet t'i përkrahë minoritetet që dëshirojnë të kenë mundësi për t'i shprehur identitetet kulturore. Në lidhje me këtë, Kymlicka, përveç të tjerash, shkruan:

> "... shumë njerëz e ndiejnë një tundim të fortë ta shtyjnë anash çështjen e të drejtave të minoriteteve. Pse, pyesin ata, a nuk mundemi thjesht 't'i trajtojmë njerëzit si individë', pa marrë parasysh identitetin e tyre etnik ose kombëtar? Pse nuk mund të përqendrohemi në gjërat e përbashkëta si njerëz, në vend se çfarë na dallon? Supozoj se shumica prej nesh e ka pasur këtë reagim në një moment kur kemi të bëjmë me politikën e re dhe të ndërlikuar 'politikën e diferencës'. Megjithatë, ky reagim është çudhëzues. Nuk është problemi se është tepër 'individualist'. Në shumë pjesë të botës një dozë e shëndetshme e individualizmit do ta sigurojë pushimin e mirëpritur nga konflikti me bazë grupore. Më saktësisht, problemi është se reagimi është thjesht jokoherent. Siç jam përpjekur të dëftej, jeta politike e ka një dimension të pashmangshëm kombëtar qoftë për shënjimin e kufijve dhe për shpërndarjen e pushteteve, apo për vendimet në lidhje me gjuhën e

[196] Kymlicka 1995: 36-38

shkollimit, gjykatave dhe burokracive, ose për zgjedhjen e festave zyrtare. Për më tepër, këto aspekte të pashmangshme të jetës politike u japin një favor të madh anëtarëve të majoriteteve kombëtare. Ne duhet të jemi të vetëdijshëm për këtë, dhe për mënyrën që kjo mund t'i tëhuajsojë dhe të disfavorizojë të tjerët, dhe t'i ndërmarrim hapat për parandalimin e çdo rezultimi të padrejtësisë. Këta hapa mund t'i përfshijnë të drejtat polietnike dhe të drejtat e përfaqësimit për t'i akomoduar grupet etnike dhe grupet e tjera të pafavorizuara brenda çdo grupi (majoriteti) kombëtar, dhe të drejtat për vetëqeverisje për ta mundësuar autonominë për minoritetet kombëtare përkrah majoritetit kombëtar. Pa masa të tilla biseda për "trajtimin e njerëzve si individë" është vetvetiu vetëm një mbulesë për padrejtësitë etnike dhe kombëtare. Është njëjtë e rëndësishme të theksohen limitet e të drejtave të tilla. Unë në veçanti kam argumentuar se duhet të respektohen dy kufizime: të drejtat për minoritetet nuk duhet të lejojnë që një grup të dominojë ndaj grupeve të tjera; dhe nuk duhet të lejojë që një grup t'i shtypë anëtarët e vet. Me fjalë të tjera, liberalët duhet të përpiqen të sigurojnë që të ketë barazi *midis* grupeve dhe liri dhe barazi *brenda* grupeve. Në kuadër të këtyre limiteve, të drejtat e minoriteteve mund të luajnë një rol të vlershëm brenda një teorie më të gjerë të drejtësisë liberale. Në fakt, duhet të luajnë një rol nëse liberalizmi nuk do që të jetë i ndëshkuar me irelevancë në shumë pjesë të botës. Në vendlindje (et) tradicionale të teorisë liberale - Britani, Francë dhe ShBA, të drejtat e minoriteteve janë injoruar, ose trajtuar vetëm si kuriozitete ose anomali. Kjo është veçanërisht e vërtetë për kërkesat e popujve indigjenë. Por është bërë gjithnjë e më e qartë se të drejtat e minoriteteve janë thelbësore për të ardhmen e traditës liberale kudo në botë. Në shumë vende të botës - përfshirë demokracitë në zhvillim në Evropën Lindore, Afrikë dhe Azi - statusi i minoriteteve kombëtare dhe i popujve indigjenë është, ndoshta, çështja më urgjente. Njerëzit në këto vende janë duke shikuar punët e liberalëve perëndimorë si udhëzim në lidhje me parimet e kushtetutshmërisë liberale në një shtet multikombëtar. Por tradita liberale ofron vetëm këshilla konfuze dhe kontradiktore në këtë çështje. Të menduarit liberal në lidhje me të drejtat e minoriteteve ka qenë shumë shpesh fajtor për supozime etnocentrike, ose për tejpërgjithësimin e rasteve të veçanta, ose për mundësinë e unifikimit të strategjisë politike me parime të qëndrueshme morale. Kjo pasqyrohet në gamën e gjerë të politikave që shtetet liberale kanë miratuar historikisht në lidhje me grupet kombëtare dhe etnike, duke filluar nga asimilimi i detyruar te segregimi i detyruar, nga pushtimi dhe kolonizimi te federalizmi

> dhe vetëqeverisja. Rezultati ka qenë shpesh padrejtësia e rëndë ndaj minoriteteve kombëtare dhe etnike në shumë demokraci perëndimore. Por dështimi për të zhvilluar një qasje konsistente dhe parimore për të drejtat e minoriteteve mund të ketë kosto edhe më të mëdha në demokracitë në zhvillim. Aktualisht, fati i grupeve kombëtare dhe etnike nëpër botë është në dorë të nacionalistëve ksenofobë, ekstremistëve fetarë dhe diktatorëve ushtarakë. Nëse liberalizmi do që të ketë ndonjë shans të kapet në këto vende, duhet t'i adresojë në mënyrë të qartë nevojat dhe aspiratat e minoriteteve kombëtare dhe etnike" (Kymlicka 1995: 193-195).

Modeli i Kymlickas për multikulturalizmin si projekt politik ka hasur në kritika nga këndvështrime të ndryshme dhe jo vetëm nga këndvështrimi i liberalëve dhe socialistëve. Për shembull, një teoricien tjetër i mirënjohur i multikulturalizmit, sociologu Tariq Modood, e vlerëson pragmatizmin e Kymlickas, kur sugjeron se në disa raste të veçanta duhet njohur të drejtat e praktikave të veçanta fetare. Por kjo, sipas tij, nuk është e mjaftueshme dhe konsideron se Kymlicka në teorinë e tij, duke konstruktuar ndarjen në mes të minoriteve kombëtare dhe minoriteteve etnike, nuk i kushton mjaftueshëm vëmendje aspektit fetar të minoriteteve dhe, rrjedhimisht, teoria e tij nuk është e frytshme në lidhje me situatën evropiane, ku sfidë kryesore është integrimi i myslimanëve, dhe ku aspekti fetar ka domethënie të madhe. Sipas Modood, shtetet perëndimore karakterizohen nga sekularizmi i moderuar dhe në këtë kuadër feja islame mund dhe duhet të ketë status të barabartë me fetë e tjera[197] dhe se përpjekjet për barazi fetare janë të ngjashme sikurse përpjekjet për barazi etnike dhe gjinore.[198] Në këtë vazhdë, sipas Modood, integrimi duhet të përfshijë: "Masa antidiskriminuese në fusha të tilla si punësimi, veprimet pozitive për të arritur një përfaqësim të plotë dhe të drejtë politik të myslimanëve në fusha të ndryshme të jetës publike, përfshirjen e historisë myslimane si histori evropiane etj"

[197] Moddod 2007: 34-35, 78
[198] Moddod 2009: 164

(Modood 2009: 185). Nga ana tjetër, kritika dhe skepticizmi ndaj modelit teorik të Kymlickas, nga një pjesë e liberalëve dhe socialistëve, bazohet se në praktikë është vështirë të menaxhohet dhe të mirëmbahet balanca në mes të drejtave individuale dhe të drejtave grupore, sidomos kur kemi të bëjmë me minoritetet kulturore anti-liberale. Në kuptimin se pritjet dhe presioni i brendshëm në grupet minoritare i pengon anëtarët e grupeve minoritare t'i ushtrojnë të drejtat e tyre individuale (si individë) që janë të garantuara në demokracitë liberale. Rastet tipike ku individët sanksionohen nga grupi i tyre minoritar janë ata individë që, për shembull, dëshirojnë të martohen apo që martohen jashtë grupit të tyre minoritar apo jashtë preferencave të prindërve të tyre. Individë që dëshirojnë të konvertohen apo që konvertohen në religjion tjetër, si dhe individë që dëshirojnë të jetojnë publikisht si homoseksualë etj. Gjithashtu, kritika e një pjese të liberalëve dhe socialistëve nënkupton se institucionalizmi i esencializmit grupor mbi bazën kulturore (i minoriteteve kombëtare dhe etnike) e fragmenton bashkësinë politike në një shtet dhe, rrjedhimisht, e zbeh ndjenjën e solidaritetit brenda shtetit.

Në fakt, Kymlicka nuk e shpërfill situatën sfiduese në praktikë në lidhje me organizimin e bashkësive politike në mes të majoritetit dhe minoriteteve dhe nuk pretendon se e ka gjetur zgjidhjen në kuptimin final, por konsideron se kjo sfidë kërkon menaxhim paqësor dhe korrekt, duke përfshirë parakushtin e njëfarë niveli të vullnetit të mirë. Përndryshe, sipas tij, alternativa e një pjese të liberalëve dhe socialistëve, që parasheh asimilimin e minoriteteve ose eliminimin e ndjenjës së identitetit të veçantë të minoriteteve, nuk është e mundshme edhe nëse ka qenë dikur e mundshme. Madje nuk mund të pritet në të ardhmen as asimilimi i tërësishëm në kulturat dominuese (në kulturat shtetformuese) i minoriteteve etnike si rezultat i emigracionit që janë të interesuara të mirëmbajnë disa veçanti të tyre etnike. Jo në kuptimin e mirëmbajtjes së disa veçantive të tyre etnike për t'u mos integruar në kulturat dominuese, por në kuptimin e ndryshimit të mënyrës së

integrimit të tyre në kulturat dominuese. Prandaj, Kymlicka sugjeron që minoriteteve etnike (si rezultat i emigrimit) t'u jepen të drejtat e ashtuquajtura polietnike, përkatësisht të drejtat permanente për gjuhën amtare dhe për praktikat religjioze (hebrenjve, myslimanëve, sikhëve etj.). Qëllimi me këto të drejta është të ndihmohen grupet etnike dhe fetare që ta shprehin veçantinë dhe krenarinë e tyre kulturore pa e penguar kjo suksesin e tyre në sferën ekonomike dhe politike në shoqërinë si tërësi dhe, njëkohësisht, të promovohet integrimi i tyre (si individë dhe si grup) në shoqërinë si tërësi. Ndërsa për minoritetet kombëtare sugjeron të ketë një nivel më të lartë të të drejtave, ku përfshihen edhe të drejtat për vetëqeverisje, përveç të tjerash, për dy arsye kryesore. Njëra arsye është se, për dallim të minoriteteve kombëtare, minoritetet etnike si rezultat i emigracionit (në bazë individuale ose familjare), vendosen/shpërndahen në të gjithë shoqërinë si tërësi brenda shteteve ku emigrojnë. Domethënë nuk e kanë një kontinuitet të gjatë historik-territorial-gjuhësor në shtetet ku kanë emigruar sikurse që e kanë minoritetet kombëtare, duke i përfshirë edhe popujt indigjenë. Arsyeja tjetër është se, shikuar historikisht, kulturat dominuese (kulturat shtetformuese) kanë pasur shumë më pak sukses t'i integrojnë minoritetet kombëtare krahasuar me minoritetet etnike si rezultat i emigracionit ngaqë minoritetet kombëtare gjithnjë janë përpjekur dhe kanë kërkuar ta mbrojnë ekzistencën e tyre të veçantë në drejtim të konsolidimit të kulturave të tyre shoqërore (kulturave kombëtare). Për shembull, përkundër përpjekjeve në Kanada dhe Amerikë, ku qeveritë herë pas here kanë përdorur të gjitha mjetet në dispozicion të tyre për zhbërjen e ndjenjës së identitetit të veçantë të minoriteteve të tyre kombëtare, nëpërmes shkollave rezidenciale për fëmijët indianë dhe ndalimin e zakoneve tribale, deri në ndalimin e shkollave në gjuhën frënge ose spanjolle. Megjithëkëtë, përkundër shtypjes, diskriminimit, paragjykimeve ose indiferencës, këto minoritete kombëtare e kanë mirëmbajtur ndjenjën e tyre të identitetit kombëtar. Ngjashëm, përpjekjet për ta zhdukur gjuhën dhe

identitetin e minoriteteve kombëtare, kurdëve, baskëve etj., kanë pasur pak ose aspak sukses. Duke përfshirë dështimin e regjimeve diktatoriale dhe autoritare (edhe pse e kanë pasur monopolin e plotë mbi arsimin dhe median), për t'i bërë kroatët, sllovakët, ukrainasit etj., ta ndiejnë veten e tyre parësisht si 'jugosllavë', 'çekosllovakë', 'sovjetikë' etj. Gjithashtu, përpjekjet për t'i promovuar 'panlëvizjet' (shtetet pansllave, shtetet panarabe etj.)., me qëllim të zhdukjes së identiteteve kombëtare, kanë rezultuar me dështim. Kjo, sipas Kymlickas, dëshmon se identiteti në kuptimin e ndjenjës të të qenit një kulturë e veçantë kombëtare, është treguar historikisht i qëndrueshëm dhe, njëkohësisht, pajtohet me mendimin e Anthony D. Smithit se, pasi që të jetë formuar një identitet kombëtar, është jashtëzakonisht e vështirë, për të mos thënë e pamundur (përveç gjenocidit total) për ta zhdukur. Për më tepër, konsideron se bota moderne është e ndarë në kulturat shoqërore (societal cultures) që asocohen në mënyrë tipike me kulturat e grupeve kombëtare dhe janë veçanërisht relevante për lirinë individuale[199]: "Kulturë e cila u siguron anëtarëve të vet mënyra kuptimplote të jetesës në të gjithë gamën e plotë të veprimtarive njerëzore, duke përfshirë jetën shoqërore, arsimore, fetare, rekreative dhe ekonomike dhe që rrok që të dyja, sferën publike dhe private" (Kymlicka 1995: 76).

Përveç të drejtave polietnike, dhe të drejtave për vetëqeverisjen, Kymlicka operon edhe me një kategori të tretë të drejtave, në kuadër të drejtave të diferencuara grupore. Përkatësisht me të drejtat e veçanta të përfaqësimit, që vlejnë edhe për grupe të tjera shoqërore joetnike, këto tri lloje të të drejtave mund të përkojnë pjesërisht me njëra-tjetrën, në kuptimin se disa grupe mund të kërkojnë më shumë se një lloj të drejtash:

> "Për shembull, grupet indigjene mund të kërkojnë që të dyja, përfaqësimin e veçantë në qeverinë qendrore, në saje të pozitës së tyre të disfavorshme, dhe pushtete të ndryshme të vetëqeverisjes, në

[199] Kymlicka 1995: 31, 75, 77 -79, 184-185, 193

> saje të statusit të tyre si 'popull' ose 'komb'. Por nuk do të thotë se këto të drejta duhet të bëhen bashkë. Një grup i shpërfillur, si personat me aftësi të kufizuara, mund të kërkojë përfaqësim të veçantë, por nuk ka asnjë bazë për të kërkuar të drejta të vetëqeverisjes ose të drejta polietnike. Anasjelltas, një grup imigrant i suksesshëm ekonomikisht mund të kërkojë të drejta polietnike, por nuk ka asnjë bazë për të kërkuar të drejta të veçanta të përfaqësimit ose të vetëqeverisjes etj." (Kymlicka 1995: 33).

Rrjedhimisht, sipas qasjes multikulturaliste, niveli më i lartë i të drejtave iu atribuohet minoriteteve kombëtare. Pra, jo vetëm thjesht të drejtat e veçanta të përfaqësimit (për arsyen e të qenit në disfavor në kuadër të bashkësisë politike), dhe jo vetëm thjesht të drejtat polietnike (për arsye se bashkësia politike është kulturalisht diverse), por edhe të drejtat për vetëqeverisjen, sepse duke marrë parasysh se demokracia është qeverisje 'e popullit', minoritetet kombëtare pretendojnë se ka më shumë se një popull brenda shtetit (minoritetet kombëtare), secili me të drejtë të vetëqeverisjes. Kështu që, autoriteti qendror i shtetit nuk mund ta shpërfillë autoritetin e bashkësive përbërëse kombëtare (minoriteteve kombëtare).[200]

Njëkohësisht, vlen të precizohet se të drejtat për vetëqeverisjen nuk nënkuptojnë një decentralizim të përgjithshëm të pushtetit, por vetëm njohjen eksplicite të minoriteteve kombëtare, përkatësisht njohjen e së drejtës gjuhësore dhe të drejtën për tokat, territoret dhe burimet natyrore (land claims), duke e përfshirë shpërndarjen asimetrike të pushteteve dhe riskicimin e kufijve politikë. Megjithëkëtë, përderisa të drejtat e përfaqësimit dhe të drejtat polietnike mund ta promovojnë integrimin shoqëror dhe unitetin politik, duke e marrë si të mirëqenë bashkësinë më të madhe politike dhe kërkimin për përfshirje më të madhe në të, të drejtat për vetëqeverisje paraqesin një sfidë më serioze për funksionin integrues të bashkësisë politike (shtetësisë), sepse kërkesat për vetëqeverisje, njëkohësisht reflektojnë një dëshirë për t'i dobësuar lidhjet me bashkësinë më të madhe politike si tërësi brenda shtetit dhe, në këtë mënyrë, e

[200] Po aty: 182

vënë në dyshim autoritetin dhe qëndrueshmërinë e bashkësisë politike. Prandaj mund të duket më tunduese të injorohen kërkesat e minoriteteve kombëtare për vetëqeverisje në mënyrë që të shmanget çdo referim ndaj grupeve të tilla në Kushtetutë dhe të insistohet që qytetaria/shtetësia (citizenship), të jetë identiteti i përbashkët i të gjithë qytetarëve si individë, pa marrë parasysh anëtarësinë grupore. Madje strategjia/regjimi i qytetarisë së përbashkët (common citizenship strategy), interpretohet shpesh si strategji amerikane për trajtimin e pluralizmit kulturor por, sipas Kymlickas, ky nuk është interpretim i saktë sepse amerikanët e kanë zbatuar këtë strategji vetëm në kontekstin e integrimit të emigrantëve vullnetarë dhe skllevërve të pavullnetshëm, të ardhur dhe të sjellë në Amerikë si individë ose si familje. Ndërsa për indianët amerikanë, eskimezët alaskianë, portorikanët, havaianët vendas etj., është zbatuar njëfarë niveli i vetëqeverisjes brenda federatës amerikane. Dhe në rastet kur është tentuar të zbatohet strategjia e shtetësisë/qytetarisë së përbashkët (common citizenship) ndaj minoriteteve kombëtare në Amerikë, ka rezultuar shpesh me dështime mbresëlënëse. Siç është shembulli me ushtrimin e presionit politik ndaj fiseve indiane për të hequr dorë nga statusi i tyre i veçantë politik, i njohur si 'politika e përfundimit' (termination policy), që ka pasur pasoja të rënda dhe, rrjedhimisht, është tërhequr nga zbatimi në vitet '50. Në fakt, shumë pak shtete demokratike multikombëtare e ndjekin strategjinë strikte të qytetarisë së përbashkët (common citizenship strategy), dhe kjo nuk është befasuese, ngaqë refuzimi i kërkesave për të drejtat e vetëqeverisjes vetëm e përkeqëson tëhuajsimin e minoriteteve kombëtare dhe e rritë dëshirën e tyre për shkëputje. Përndryshe, strategjia/regjimi strikt i qytetarisë së përbashkët imponon mbështetjen e kulturës kombëtare të majoritetit, në kuptimin se gjuha e kulturës së majoritetit bëhet gjuhë zyrtare e shkollave, gjykatave, legjislaturës, dhe festat e kulturës së majoritetit bëhen festat për ditë pushime zyrtare. Për më tepër, strategjia strikte e qytetarisë së përbashkët nënkupton se kufijtë dhe pushtetet e njësive të

brendshme politike janë të definuara që t'i përshtaten komoditetit administrativ të majoritetit, dhe jo kërkesave vetëqeverisëse të minoritetit. Prandaj në kuadër të një strategjie të tillë minoriteti nuk ka asnjë mënyrë për ta kufizuar cenimin e mundshëm nga vendimet ekonomike dhe politike të majoritetit dhe, rrjedhimisht, nuk është për t'u habitur që minoritetet kombëtare u kanë rezistuar përpjekjeve për ta imponuar mbi ta regjimin e qytetarisë së përbashkët.[201]

E gjithë kjo determinon një sfidë të madhe. Nga njëra anë, refuzimi i të drejtave për vetëqeverisje për minoritetet kombëtare në emër të qytetarisë së përbashkët (common citizen ship) është shtysë për tëhuajsim, lëvizje separatiste dhe konflikt. Nga ana tjetër, dhënia e drejtave për vetëqeverisje për minoritetet kombëtare ka të ngjarë të çojë në një dëshirë për një autonomi gjithnjë në rritje, madje edhe në ndarje (pavarësi). Këtë sfidë Kymlicka e cilëson si një "nyje gordiane" dhe, sipas tij, edhe pse priremi të supozojmë se ndarja është një katastrofë morale dhe politike, do të duhej të ishim më të gatshëm ta marrim në konsideratë ndarjen, sidomos kur ndodh në mënyrë paqësore. Për shembull, sikurse në të kaluarën ndarja në mes të Norvegjisë dhe Suedisë në vitin 1905 nëpërmes një procesi relativisht paqësor. Ose ndarja eventuale në të ardhmen e Kebekut nga Kanadaja, do të ishte ngjashëm paqësore. Në fund të fundit, liberalizmi është i preokupuar parësisht me lirinë dhe mirëqenien e individëve dhe jo me fatin e shteteve dhe, në këtë kuptim, ndarja nuk do duhej të shihet si dëmtim i të drejtave individuale. Megjithëkëtë, ndarja s'është gjithmonë e mundur ose e dëshirueshme, sipas Kymlickas, ngaqë disa minoritete kombëtare, veçanërisht popujt indigjenë, do ta kishin pasur problem për të formuar shtete të pavarura të suksesshme e, në raste të tjera, pretendimet konkurruese mbi tokën dhe resorët, e bëjnë ndarjen paqësore praktikisht të pamundur. Gjithashtu, duhet të kihet parasysh fakti se ka më shumë kombe në botë sesa mundësi për shtete. Prandaj, Kymlicka sugjeron se meqë

[201] Po aty: 71, 181-183

nuk është e mundur të ç'rrënjoset vetëdija kombëtare dhe, duke marrë parasysh se kërkesat e minoriteteve kombëtare do të vazhdojnë, duhet provuar të gjendet mënyra për t'i akomoduar minoritetet kombëtare, përkatësisht duhet gjetur një mënyrë për ta mbajtur të bashkuar shtetin multikombëtar.[202]

Ende nuk e kemi një përgjigje të shkoqur, të qartë ose të lehtë, se cilat janë burimet e mundshme të unitetit që afirmojnë, në vend se të refuzojnë diferencën kombëtare në një shtet multikombëtar. Madje edhe mbrojtësit e parimit të vetëqeverisjes për minoritetet kombëtare kanë qenë më të prirë ta kundërshtojnë asimilimin si një mënyrë e dështuar për arritjen e unitetit sesa t'i ofrojnë argumentet e tyre alternative se me çfarë duhet zëvendësuar asimilimin si burim i mundshëm i unitetit në një shtet multikombëtar. As Kymlicka nuk pretendon se ka arritur të japë një përgjigje përfundimtare, megjithëkëtë ka arritur (në një mënyrë sokratike) ta shtjellojë më thelbësisht këtë çështje. Sipas tij, brenda shteteve multikombëtare shpesh ekzistojnë vlera të përbashkëta politike, duke përfshirë konceptin e përbashkët të drejtësisë liberale. Megjithëkëtë, nuk është e sigurt se ndarja e këtyre vlerave të përbashkëta siguron që dy ose më shumë grupe kombëtare të qëndrojnë të bashkuara. Për shembull, edhe pse ekziston një konvergjencë e jashtëzakonshme e vlerave midis qytetarëve të Norvegjisë dhe Suedisë, nuk ekziston ndonjë gjasë që ata të ribashkohen në një shtet. Ose sikur konvergjenca e theksuar e vlerave midis kanadezëve anglisht-folës dhe frëngjisht-folës të ishte një pikënisje e sigurt për ta forcuar unitetin, atëherë do të duhej të ishte dëshmuar një rënie në aspiratën për shkëputjen e Kubekut por, përkundrazi, ndjenja nacionaliste për ndarje është rritur vazhdimisht. Dhe fakti që anglofonët dhe frankofonët në Kanada ndajnë të njëjtat parime të drejtësisë, kjo nuk është një arsye e fortë për të mbetur së bashku, pasi kubekianët me të drejtë supozojnë se shteti i tyre kombëtar do të kishte mundur t'i respektonte të njëjtat parime. E njëjta gjë vlen edhe për flamanët në Belgjikë.

[202] Po aty: 185-186

Në fakt, kjo pasqyron një prirje shumë të përgjithshme ngaqë ka një konvergjencë të vlerave politike në të gjithë botën perëndimore, midis të dy grupeve, përkatësisht majoriteteve kombëtare dhe minoriteteve kombëtare. Për shembull, për sa iu përket vlerave politike të majoriteteve kombëtare perëndimore, danezët, gjermanët, francezët dhe britanikët, nuk kanë qenë kurrë më të ngjashëm se tani. Por kjo nuk ka ndikuar në zbehjen e dëshirës së këtyre kombeve majoritare për ta ruajtur pavarësinë e tyre kombëtare. Prandaj, nuk mund të pritet të zvogëlohet as dëshira e minoriteteve kombëtare për vetëqeverisje.[203] Rrjedhimisht, sipas Kymlickas:

> "… vlerat e përbashkëta nuk janë të mjaftueshme për unitetin social. Fakti që dy grupe kombëtare ndajnë të njëjtat vlera ose parime të drejtësisë, nuk u jep domosdoshmërisht ndonjë arsye të fortë për t'u bërë (ose të qëndrojnë) bashkë sesa të mbesin (ose të ndahen në) dy vende të ndara. Çfarë më shumë, ose çfarë tjetër, nevojitet për unitetin social? Elementi përbërës që mungon duket se është ideja e një identiteti të përbashkët. Një konceptim i përbashkët i drejtësisë në kuadër të bashkësisë politike nuk gjeneron domosdoshmërisht një identitet të përbashkët e lëre më identiteti i përbashkët qytetar që mëton t'i zëvendësojë identitetet rivale kombëtare. Njerëzit vendosin me kë duan të ndajnë një vend duke pyetur se me kë identifikohen, me kë ndiejnë solidaritet. Ajo që i mban amerikanët së bashku, pavarësisht prej mungesës së vlerave të tyre të përbashkëta, është fakti se ata e bashkëndajnë një identitet si amerikanë. Anasjelltas, ajo që i mban ndaras suedezët dhe norvegjezët, pavarësisht pranisë së vlerave të përbashkëta, është mungesa e një identiteti të përbashkët. Nga vjen ky identitet i përbashkët? Në shtetet kombe, përgjigjja është e thjeshtë. Identiteti i përbashkët rrjedh nga bashkësia historike, gjuhësore dhe, mbase, fetare! Por këto janë pikërisht gjërat që nuk janë të përbashkëta në shtetet multikombëtare. Nëse shikojmë vendet me fuqi patriotike, por me diversitet kulturor si Shtetet e Bashkuara ose Zvicra, baza e një identiteti të përbashkët shpesh duket të jetë krenaria për arritjet e caktuara historike (p. sh., themelimi i Republikës Amerikane). Kjo krenari e përbashkët është një nga bazat e ndjenjës së fortë të identitetit politik amerikan, e përforcuar vazhdimisht në literaturën e tyre të qytetarisë dhe kurrikulën shkollore. Por në shumë vende

[203] Po aty: 187-188

multikombëtare historia është një burim i indinjatës dhe ndarjes midis grupeve kombëtare, dhe jo burim i krenarisë së përbashkët. Njerëzit dhe ngjarjet që ngjallin krenari në mesin e majoriteteve kombëtare, e gjenerojnë shpesh sensin e tradhtisë në mesin e minoriteteve kombëtare. Për më tepër, mbështetja në histori kërkon shpesh shumë selektim, madje përsëritjen manipuluese të saj. Ernest Renan thoshte se identiteti kombëtar përfshin harrimin e së kaluarës po aq shumë sa edhe të kujtuarit e saj. Për të ndërtuar një ndjenjë të identitetit të përbashkët në një shtet multikombëtar ndoshta kërkon një kujtesë edhe më selektive të së kaluarës. Vlerat e përbashkëta dhe një histori inspiruese pa dyshim ndihmojnë në mbajtjen e solidaritetit në një shtet multikombëtar, por është e pasigurt dhe jo e mjaftueshme vetvetiu. Si pra mund të ndërtohet një identitet i përbashkët në një vend i cili përmban dy ose më shumë komunitete, që e konsiderojnë veten si kombe vetëqeverisëse? Variacioni i madh në situatat historike, kulturore dhe politike në shtetet multikombëtare sugjeron që çdo përgjigje e përgjithësuar në këtë pyetje, ka të ngjarë të mbivlerësohet. Ajo që është e qartë, mendoj unë, është se nëse ekziston një mënyrë e zbatueshme për ta promovuar ndjenjën e solidaritetit dhe qëllimit të përbashkët në një shtet multikombëtar, kjo do të përfshijë më shumë akomodimin sesa subordinimin e identiteteve kombëtare. Njerëzit nga grupe të ndryshme kombëtare do ta ndajnë besnikërinë ndaj një forme shtetërore më të madhe, vetëm nëse e shohin atë si kontekstin brenda të cilit ushqehet identiteti i tyre kombëtar, në vend se të subordinohet. Kjo është mjaft e vështirë në një vend i cili thjesht përmban dy kombe (p. sh., Belgjika). Kjo bëhet shumë më e ndërlikuar në vendet të cilat nuk janë vetëm multikombëtare, por edhe polietnike, të përbëra nga disa grupe kombëtare dhe indigjene, shpesh me përmasa shumë të pabarabarta, si dhe nga emigrantët nga çdo pjesë e botës… (…). Siç e kam përmendur më herët, ca shtete multikombëtare e kanë sensin e fortë të identifikimit të përbashkët. Kjo është e vërtetë në mënyrë të dukshme në rastin e zviceranëve. Edhe kanadezët e kanë një sens me bazë të fortë solidariteti. Për shembull, përderisa mbi gjysma e kubekianëve i japin përparësi vetidentifikimit me statusin e tyre si qytetarë të Kubekut, krahasuar me më pak se 30 për qind të cilët i japin përparësi shtetësisë kanadeze. Ende 70 % e kubekianëve thonë se do të ishin të gatshëm të bënin sakrifica personale në dobi të kanadezëve jashtë Kubekut. Kjo siguron një nivel të vullnetit të mirë, që nuk është i pranishëm në shtetet e tjera multikombëtare. Dhe fokusi në vlerat e përbashkëta, historinë mitike ose ngazëllimin e diversitetit të thellë, mund të ndihmojë në mbajtjen e këtij niveli të

> solidaritetit. Por nuk është e qartë se si shtetet e tjera multikombëtare do të mund të provojnë të krijojnë një nivel të tillë solidariteti kur nuk ekziston paraprakisht. Nëse dy ose më shumë grupe kombëtare thjesht nuk duan të jetojnë së bashku, mund të jetë e pamundshme të krijohet solidariteti nga fillimi… (…). Prandaj, sfida themelore me të cilën përballen teoricienët liberalë është identifikimi i burimeve të unitetit në një shtet demokratik multikombëtar. Teoriku anglez i shekullit nëntëmbëdhjetë A. V. Dicey thoshte se një federatë e qëndrueshme multikombëtare kërkon 'një gjendje shumë të veçantë të ndjenjës' midis qytetarëve të saj, pasi që 'ata duhet ta dëshirojnë unionin dhe nuk duhet ta dëshirojnë unitetin'. Henry Bourassa ka argumentuar ngjashëm kur është shprehur se 'zhvillimi i veçantë' i kombit francez-kanadez 'duhet të vijë në ndërthurje me zhvillimin e më shumë patriotizmit të përgjithshëm që na bashkon pa na fuzionuar'. Teoria liberale nuk ka arritur ende të ketë sukses në qartësimin e llojit të kësaj 'ndjenje të veçantë'. (Kymlicka 1995: 188-189,191,192).

Për të konkretizuar më shumë se çfarë nënkupton multikulturalizmi si projekt politik, mund të bëjmë një krahasim në mes të "multikulturalizmit amerikan" dhe "multikulturalizmit si projekt politik". "Multikulturalizmi amerikan" nganjëherë merret si shembull i multikulturalizmit si projekt politik. Mirëpo, kjo nuk qëndron sepse në Amerikë integrimi ndodh nëpërmes një procesi dhe dinamike të bashkëshkrirjes në një identitet më të madh, përkatësisht në identitetin amerikan. Amerika ka prirje për tolerancë ndaj diversitetit kulturor dhe njëkohësisht politikat e asimilimit nuk i ka politika asimiluese aktive, që në kombinim me historinë dhe perceptimin për Amerikën si "shtet i emigrantëve" është një incentivë e rëndësishme dhe vendimtare që emigrantët, dhe sidomos pasardhësit e tyre (gjatë një procesi dhe dinamike të bashkëshkrirjes), të asimilohen dhe të bëhen pjesë e kombit amerikan. As politikat e aksionit afirmativ ("affirmative action"), që në praktikë ndërlidhen më së shumti me diskriminimin pozitiv të afroamerikanëve, nuk janë masa integruese në kuptimin e multikulturalizmit si projekt politik. Kështu është sepse, përderisa aksioni afirmativ është një masë e përkohshme për integrim për arritjen e barazisë

në kuadër të bashkëshkrirjes identitare kulturore amerikane, multikulturalizmi si projekt politik nuk e ka qëllim kryesor bashkëshkrirjen në një identitet kulturor të përbashkët, por në radhë të parë ka qëllim që nëpërmes masave permanente të krijojë dhe mirëmbajë institucionalizimin e minoriteteve kulturore (minoriteteve kombëtare dhe deri në një masë minoriteteve etnike) për t'i mbrojtur nga hegjemonia e majoritetit shtetformues dhe shtetkontrollues në të ashtuquajturat shtetet kombëtare, përkatësisht shtetet unikombëtare. Gjithashtu, qëllimi i multikulturalizmit si projekt politik në shtetet kombëtare është stabiliteti politik në mënyrë që shteti, duke institucionalizuar dhe mirëmbajtur financiarisht identitetin e minoriteteve kulturore, krijon stabilitet duke i integruar në shtet (por jo domosdoshmërisht duke i integruar në një identitet kombëtar të përbashkët), në mënyrë që minoritetet kulturore së paku ta ndiejnë veten pjesë të shtetit dhe ta humbin legjitimitetin dhe incentiven që të rebelohen dhe ta kërcënojnë stabilitetin e shtetit me kërkesat e tyre grupore. Rrjedhimisht, multikulturalizmi si projekt politik u kushtohet më shumë shteteve kombëtare (shtetit komb) si një zgjidhje për integrim të minoriteteve në shtet, sepse në shtetet kombëtare nuk ekziston përfytyrimi dhe perceptimi i "shtetit të emigrantëve" ku, për shembull, të gjithë jemi më herët ose më vonë emigrantë dhe ku nëpërmes procesit dhe dinamikës së bashkëshkrirjes barazohemi (asimilohemi) të gjithë në një identitet të përbashkët kulturor siç është shembulli me identitetin e "multi-kulturalizmit" amerikan që mund të cilësohet më shumë si kozmopolitanizëm sesa si multikulturalizëm.

Për më tepër, ngjashëm sikurse minoritetet kulturore që tradicionalisht i kundërvihen (më shumë dhe më pak) asimilimit, në kuadër të kulturave majoritare shtetformuese në shtetet kombëtare. Edhe majoritetet kulturore shtetformuese në shtetet kombëtare, tradicionalisht i kundërvihen (më shumë dhe më pak) ngritjes së identiteteve mbi shtetet-kombe, madje edhe në kontekstin evropian. Kjo është edhe arsyeja kryesore pse shtetet kombëtare në Evropë e bëjnë të brishtë dhe e

ngadalësojnë dinamikën e federalizimit të shteteve evropiane (Unionin Evropian) që ta arrijë nivelin e federatës amerikane (ShBA-së) sepse federalizmi amerikan bazohet në territorializëm, "shtete" territoriale. Ky parim i territorialitetit federativ në ShBA determinon përfshirje sado që, për shembull, vendimet politike në organet qendrore federative mund t'i prekin interesat e "shteteve" territoriale në ShBA. Mungesa e identitetit nacional në këto "shtete" territoriale dekurajon mundësinë domethënëse të mobilizimit kundër vendimmarrësve dhe vendimmarrjeve në organet qendrore në ShBA. Ky fakt, fatmirësisht, e mirëmban dhe e stimulon identitetin amerikan duke i zbehur edhe më shumë identitetet e tjera konkurruese dhe linjat e tjera etnike të konfliktit brenda Amerikës. Ndërsa duke marrë parasysh se 'federalizmi evropian' (Unioni Evropian), bazohet në shtetet kombëtare, përkatësisht në shtetet unikombëtare, të bazuara në majoritetet kulturore shtetformuese, është i predispozuar të pësojë lëkundje për çështjet edhe më të vogla politike. Me fjalë të tjera, federalizimi i Unionit Evropian nuk nënkupton se qëllimi parësor është shkrirja e kombeve/shteteve evropiane në një identitet/komb evropian të përbashkët (sikurse në rastin e identitetit amerikan), por nënkupton federalizimin e diversitetit kombëtar të shteteve evropiane. Megjithëkëtë, kjo nuk e përjashton krejtësisht mundësinë e një identiteti/patriotizmi të përbashkët mbikombëtar evropian.

Pavarësisht prej pikëpamjeve teorike të kombformimit (parakushteve dhe kufizimeve teorike), ngritja e një identiteti kombëtar evropian do të kishte qenë më e suksesshme sikur paralelisht të bazohej edhe në trashëgiminë e përbashkët kulturore evropiane dhe jo vetëm në federalizimin e diversitetit kombëtar të shteteve evropiane. Në kuptimin e promovimit të trashëgimisë së përbashkët kulturore evropiane në një gjuhë të përbashkët (ose, së paku, në kuadër të një kornize shumëgjuhëshe, por me referenca të përbashkëta), dhe masmediave të përbashkëta (mjeteve të komunikimit në përmasa të mëdha), duke përfshirë sistemin e përgjithshëm dhe të standardizuar arsimor

që nga shkollat fillore (kurrikulës së përbashkët) etj. Sepse të gjithë popujt evropianë në një mënyrë ose tjetër janë kontribuues dhe pjesë e trashëgimisë kulturore evropiane. Në këtë mënyrë një identitet i përbashkët kombëtar evropian (i bazuar në trashëgiminë e përbashkët kulturore të popujve evropianë) do të kishte shërbyer si konkurrent pozitiv dhe gradualisht si zëvendësues eventual i identiteteve kombëtare të shteteve evropiane. Njëkohësisht do të kishte shërbyer për dekurajimin e aspiratave të minoriteteve kombëtare brenda shteteve kombëtare evropiane, për ndarje (separatizëm dhe irredentizëm). Prandaj zgjidhja më e mirë do të kishte qenë zbatimi i një lloj modeli identitar evropian, i ngjashëm me atë amerikan. Por, kjo kërkon sakrificë, kompromis dhe tejkalim të vetvetes, në radhë të parë nga kombet/shtetet e mëdha evropiane. Në këtë kuptim, sugjerimi i dikurshëm (në një kontekst tjetër) i John Stuart Millit, se një zgjidhje më e mirë është që basku të asimilohet në francez sesa të këmbëngulë ta ruajë reliktin gjysmë të egër të kohëve të kaluara, është sugjerim më relevant në lidhje me kontekstin integrues të Unionit Evropian, në kuptimin se më mirë është që anëtarët e majoriteteve kombëtare dhe të minoriteteve kombëtare në Evropë (francezët, anglezët, gjermanët, spanjollët, baskët etj.)., t'i tejkalojnë reliktet e tyre të së kaluarës dhe të asimilohen bashkërisht në evropianë.

Rastet e konflikteve/gjakderdhjeve në mes të popujve evropianë në të kaluarën konsiderohet se kanë lënë pasoja të pariparueshme në kuptimin e pamundësisë për ndërtimin e një identiteti (nacionalizmi/patriotizmi) të përbashkët evropian, të bazuar në trashëgiminë e përbashkët kulturore të popujve evropianë. Megjithatë, ky nuk mund të konsiderohet si një argumentim shumë i qëndrueshëm sepse pothuajse të gjithë popujt, qoftë në të kaluarën e tyre si bashkësi etnike gjatë antikitetit, qoftë gjatë Mesjetës, por edhe gjatë historive të tyre të mëvonshme si kombe, kanë pasur (më shumë dhe më pak) konflikte të brendshme, por kanë arritur t'i tejkalojnë nëpërmes nacionalizmit/patriotizmit. Për më tepër, si individë kemi identitete të shumëfishta, për shembull, brenda shtetit kemi një

identitet lokal (të qenit nga një qytet, fshat ose rajon i caktuar), ndërsa jashtë shtetit kemi të gjithë një identitet kombëtar, gjithashtu kemi edhe identitetet klasore, profesionale etj. Madje ndodh që jashtë kontinentit evropian të paraqitemi vetëm si evropianë. Por kjo nuk do të thotë se të gjitha këto identitete të shumëfishta dhe konkurruese janë njësoj të forta ose po aq të rëndësishme politikisht sikurse identiteti kombëtar i bazuar në nacionalizëm/patriotizëm. Rrjedhimisht, pa një nacionalizëm/patriotizëm evropian (i cili s'është i pamundshëm) nuk mund të ketë as identitet të fortë kombëtar evropian në atë shkallë saqë të tejkalojë (pa pasur nevojë t'i zhdukë krejtësisht) identitetet kombëtare të popujve evropianë. Një identitet i tillë kombëtar evropian është i mundshëm nëse në radhë të parë zhvillohet duke u bazuar në një nacionalizëm/ patriotizëm të trashëgimisë së përbashkët kulturore evropiane, që në një mënyrë ose tjetër arrin deri në një masë të ushqejë dhe akomodojë identitetet kombëtare të popujve evropianë në kuadër të një identiteti kombëtar të përbashkët evropian.

Vlen të theksohet se organizimi i bashkësive politike në shtetet e ndryshme, në mes të majoritetit dhe minoriteteve, në kohë dhe hapësirë, i ka pasur dhe i ka sfidat e veta varësisht nga konteksti historik, kulturor, politik, gjeografik etj. Në lidhje me këtë, edhe Kymlicka e bën një dallim në mes të situatës së minoriteteve kombëtare në Amerikën Veriore dhe në Evropë:

> "Ngjarjet e fundit në ish-Jugosllavi dëshmojnë se kërcënimi për paqen ndërkombëtare nga minoritetet irredentiste është ende shumë real. Probabiliteti i dhunës rritet dramatikisht kur një minoritet shihet (ose e sheh veten) se i përket një 'vendi amë' ngjitur me, i cili e shpallë veten si mbrojtës legjitim i minoritetit. Qeveria e Hungarisë e ka shpallur veten mbrojtëse të hungarezëve etnikë në Sllovaki dhe Rumani; liderët në Rusi dhe Serbi kanë bërë deklarata të ngjashme për rusët etnikë në Baltik dhe serbët etnikë në Bosnjë dhe Kroaci. Mbrojtja e të drejtave të minoriteteve kombëtare në këso rrethana mund të bëhet një pretekst i agresionit territorial nga shteti i vetëshpallur mbrojtës. Kjo dëshmon për domosdoshmërinë e ngritjes së një mekanizmi të duhur ndërkombëtar për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare që nuk mbështetet në destabilizimin

> kërcënues të ndërhyrjes nga shtetet amë. Problemi i irredentizmit është shumë më i madh në Evropë sesa në Amerikën Veriore. Popujt indigjenë në Amerikën Veriore nuk kanë asnjë shtet mbrojtës për t'i apeluar dhe kanë kaluar mbi 100 vjet prej që ndokush e ka konsideruar Francën mbrojtësen e Kubekut në Kanada. Pothuajse njëjtë ka kaluar kohë e gjatë, prej që ndokush e ka konsideruar Spanjën si mbrojtësen e portorikanëve. Në këto kontekste, ndonëse të drejtat e minoriteteve mund ta prekin stabilitetin e brendshëm, nuk paraqesin kërcënim të madh për paqen ndërkombëtare" (Kymlicka 1995: 58).

Ngjashëm argumenton edhe sociologu Rogers Brubaker, sipas të cilit, nacionalizimi masiv i hapësirës politike i ka lënë miliona njerëz jashtë hapësirës së "vet" nacionalterritoriale. Megjithëkëtë, minoritetet nuk janë gjithmonë në konflikt me shtetin. Por në disa raste kjo ka rezultuar me një relacion sfidues, në kuadër të një konfiguracioni të trefishtë, në mes të: minoriteteve kombëtare, shteteve kombëtare në të cilat jetojnë këto minoritete, dhe shteteve eksterne kombëtare - "amë" të cilave u takojnë, ose thuhet se u takojnë minoritetet e caktuara, bazuar në lidhjet etnokulturore në mes të këtyre minoriteteve dhe shteteve eksterne kombëtare - "amë". Rrjedhimisht, në Evropën e re, ngjashëm si në Evropën në mes dy luftërave botërore, ky konfiguracion në vijim e ka një tendencë për të krijuar konflikt: 1) Elitat dominuese promovojnë gjuhën shtetbartëse të kombit, kulturën, zhvillimin ekonomik dhe hegjemoninë politike. 2) Minoritetet me vetëdije kombëtare dhe (në shkallë të ndryshme) të organizuara politikisht dhe të tëhuajësuara nga majoriteti (grupi kulturor shtetformues dhe shtetkontrollues), kërkojnë autonomi kulturore ose territoriale dhe i rezistojnë asimilimit ose diskriminimit. 3) Shtetet eksterne kombëtare - "amë" përcjellin me vëmendje (në shkallë të ndryshme) situatën e "vëllezërve të tyre", në këto shtete, dhe protestojnë fuqishëm, duke pretenduar për shkeljet e të drejtave të "vëllezërve të tyre", duke u thirrur në të drejtën dhe obligimin e tyre për t'i mbrojtur interesat e "vëllezërve të tyre". Për shembull, relacioni i Hungarisë me tre milionë hungarezë etnikë në Rumani, Sllovaki, Serbi dhe Ukrainë. Relacioni i Shqipërisë me dy milionë

shqiptarë në Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi, (duke i përfshirë shqiptarët e Kosovës deri në vitin 1999). Relacioni i Serbisë me gati dy milionë serbë (para luftës), në Kroaci dhe Bosnje Hercegovinë. Gati një milion turq në Bullgari. Armenët në Azerbajxhan, veçanërisht në Nagorno-Karabakh. Uzbekët në Taxhikistan dhe taxhikët në Uzbekistan. Polakët në Lituani dhe në shtetet e tjera të ish-Bashkimit Sovjetik etj.[204] Në këtë vazhdë, Brubaker merr si shembull konsekuencën e traditës së gjatë politike serbe të shtetit ekstern kombëtar – "amë":

> "... Qëndrimet e vendit amë – duke përfshirë identifikimin me, deklarimet e përgjegjësisë për, dhe kërkesat për të mbështetur apo madje për t'i 'rimarrë' dhe për t'i inkorporuar serbët etnikë jashtë territorit të shtetit serb - kanë një traditë të gjatë në politikën serbe. Marrëdhënia ndërmjet "Serbisë së vogël" ekspansioniste (e themeluar si një mbretëri e pavarur, megjithëse ende nën mbikëqyrjen formale osmane, në vitin 1829 dhe e njohur plotësisht si e pavarur në vitin 1878) dhe komuniteteve të mëdha serbe nën Perandorinë Osmane dhe Austro-Hungareze, ka qenë çështje e ndezur në dekada para Luftës së Parë Botërore, dhe njëra që preku luftën kur një revolucionar nacionalist serb nga Bosnja, vrau në Sarajevë arqidukën Franz Ferdinand, trashëgimtar i fronit të Habsburgëve. Pas luftës, me formimin e një shteti të sllavëve të jugut të dominuar nga serbët, që përfshiu shumicën e madhe të serbëve që kishin qenë më herët nën perandoritë austro-hungareze dhe osmane, problemi i politikës së vendit amë u reduktua. Nuk u rishfaq në mënyrë të hapur as pas Luftës së Dytë Botërore në Jugosllavinë e rikonstruktuar (dhe më të balancuar kombëtarisht) të Titos. Mu si rusët që e shihnin si një tërësi Bashkimin Sovjetik si shtet 'të tyre' (dhe jo vetëm republikën ruse), edhe serbët e shihnin si një tërësi shtetin jugosllav si shtet 'të tyre', (dhe jo vetëm Serbinë), dhe kufijtë e brendshëm si të parëndësishëm ose 'vetëm si administrativë'. Sidoqoftë, politika e vendit amë u ringjall në Serbi dhe u shfaq në Rusi, kur 'nacionalizimi' i njësive përbërëse të Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik trazoi ndjenjën e serbëve dhe rusëve e të qenit 'në shtëpi' në të gjithë shtetin. Ringjallja e politikës së vendit amë në Serbi - shqetësimi i politizuar për serbët jashtë Serbisë - u përqendrua fillimisht në Kosovë..." (Brubaker 1999: 73).

[204] Brubaker 1999: 55-57

Në rastin e popujve në ish-Jugosllavi, projekti kombëtar ekspansionist serb *Naçertanje* ka qenë shkaku kryesor për mosarritjen e paqes së qëndrueshme dhe zhvillimin politik, demokratik dhe ekonomik në këtë rajon dhe më gjerë. Me fjalë të tjera, projekti *Naçertanje* i Ilia Grašanin-it, veçanërisht qasja politike e pasuesve të tij (Nikolla Pašić, Vasa Čubrillović, Aleksandar Ranković, Sllobodan Millošević etj.), të cilët madje keqpërdoren, politizuan dhe kriminalizuan edhe kishën ortodokse serbe, ka ndikuar që politika shtetërore serbe të zbatojë një politikë shtetërore fashiste ndaj të tjerëve, veçanërisht ndaj shqiptarëve. Përndryshe, pa projektin *Naçertanje* të Ilia Grašanin-it, veçanërisht pa qasjen politike të pasuesve të tij, ka pasur gjasë të madhe që çështjet kombëtare në ish-Jugosllavi të zgjidhen me më pak konflikt, për shembull, ngjashëm sikurse në rastin e popujve skandinavë.

Qasja e OKB-së për organizimin e bashkësisë politike në Kosovë

Marrëdhëniet në mes të shtetit serb dhe shqiptarëve të Kosovës, të karakterizuara nga konflikti gjatë disa dekadave, u përkeqësuan edhe më shumë gjatë periudhës së luftës 1998-1999. Përveç të tjerash, ndikuan që edhe minoriteti serb në Kosovë prej shumë shqiptarëve të shihej si bashkëfajtorë për krimet e ushtrisë dhe të forcave paramilitare serbe ndaj popullatës civile shqiptare të Kosovës. Rrjedhimisht, pas përfundimit të luftës në vitin 1999, shumica e pjesëtarëve të minoritetit serb të Kosovës ishin fshehur në enklava, pjesërisht për shkak se në situata të caktuara ishin në shënjestër për hakmarrje nga anëtarët e majoritetit shqiptar të Kosovës dhe pjesërisht për shkak të kaluarës së tyre, si grup i privilegjuar në Kosovë, në kuptimin se nuk mund ta pranonin realitetin e ri në Kosovën e pasluftës, sepse Kosova nuk udhëhiqej më nga Qeveria e Beogradit.

Në bazë të Rezolutës 1244, të datës 10 qershor 1999, të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB-së), u themelua Misioni i Përkohshëm Administrativ i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, në cilësinë e shefit të UNMK-ut, kishte autoritetin më të lartë në Kosovë në bazë të kompetencave që përfshinin pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe administrimin e drejtësisë. Që në fillim, UNMIK-u kërkonte nga liderët politikë shqiptarë të Kosovës për ta ulur tensionin ndëretnik që mbretëronte pas luftës në Kosovë. Por mungesa e konkretizimit të rregullave për bashkëveprim politik në mes të UNMIK-ut dhe liderëve politikë shqiptarë përdorej për shfajësim nga këta të fundit. Liderët politikë shqiptarë të Kosovës deklaronin se nuk kishin pushtet ta përmirësonin situatën ndëretnike në Kosovën e pasluftës sepse vetëm UNMIK-u e kishte pushtetin real mbi policinë, gjyqësinë dhe institucionet e tjera relevante në Kosovë.

Në vitin 2001 UNMIK-u arriti ta imponojë kornizën kushtetuese si një pikënisje për organizimin e bashkësisë politike në Kosovë që përfshinte edhe rregullat për bashkëveprim politik në mes të UNMIK-ut dhe liderëve politikë të Kosovës. Nga kjo periudhë, deri në fillimin e procesit të njohjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, UNMIK-u në kontinuitet është ballafaquar me dy sfida kryesore në lidhje me organizimin e bashkësisë politike në Kosovë. Nga njëra anë, "politika serbe e shtetit ekstern - amë", në mënyrë aktive e ka penguar minoritetin serb të Kosovës që të bashkëpunojë dhe t' pranojë kërkesat e UNMIK-ut për organizimin e bashkësisë politike në Kosovë. Nga ana tjetër, liderët politikë shqiptarë të Kosovës, duke qenë më shumë të shqetësuar nga lufta për pushtet, dhe duke mos ofruar ndonjë alternativë/platformë të vetën të përbashkët për organizimin e bashkësisë politike në Kosovë në mes majoritetit shqiptar dhe minoritetit serb etj., nuk tregoheshin mjaftueshëm seriozë ndaj kërkesave të UNMIK-ut. E vetmja gjë që i bashkonte liderët politikë shqiptarë ishte kërkesa për njohjen e pavarësisë së Kosovës, që bëhej më pak e më

shumë për konsum të brendshëm politik, sepse tashmë, (pas gjithë asaj që kishte ndodhur në Kosovë), kërkesa për pavarësinë e Kosovës nuk ishte vetëm kërkesë politike, por kishte rezultuar edhe si kërkesë jetike. Me fjalë të tjera, pas gjithë përvojave të hidhura me regjimet e Serbisë, prej vitit 1912 deri në vitin 1999, ishte e pamundshme të bindeshin dhe detyroheshin shqiptarët e Kosovës që të mbesin prapë nën Serbi. Prandaj, liderët politikë shqiptarë të Kosovës ishin të vetëdijshëm se legjitimiteti i tyre varej nga kërkesa e pakthyeshme e popullit shqiptar të Kosovës për pavarësinë e Kosovës.

UNMIK-u nuk kishte kompetenca që të mund të ushtrojë një ndikim të drejtpërdrejtë ndaj "politikës serbe të shtetit ekstern - amë", në kuptimin e ndikimit të drejtpërdrejtë në raportin në mes të shtetit serb dhe minoritetit serb në Kosovë. Por kishte kompetenca të mjaftueshme që të ushtrojë ndikim të drejtpërdrejtë ndaj udhëheqjes politike të shqiptarëve të Kosovës (duke përfshirë mundësitë për përdorimin e sanksioneve si mjete presioni) si në aspektin e organizimit të përmbajtjes së bashkësisë politike në Kosovë, si në aspektin e mundësisë eventuale të pavarësimit të Kosovës. Rrjedhimisht, ndikimi i UNMIK-ut, prej vitit 2001 deri në vitin 2008, për organizimin e bashkësisë politike në Kosovë, është i karakterizuar nga tri faza. Faza e parë fillon në vitin 2001 dhe fillimisht karakterizohet nga ndikimi i UNMIK-ut, për t'i detyruar liderët politikë shqiptarë për t'i pranuar rregullat konstitucionale, përkatësisht kornizën kushtetuese. Faza e dytë fillon në vitin 2003, me kërkesën e UNMIK-ut për përmbushjen e "Standardeve për Kosovën". Faza e tretë fillon në vitin 2005, me hapjen e negociatave për zgjidhjen e statusit final për Kosovën.

Faza I

Hartimi i kornizës kushtetuese është një pikënisje e rëndësishme e ndikimit të UNMIK-ut për organizimin e bashkësisë politike në Kosovë dhe për definimin e rregullave për

bashkëveprimin politik në mes të UNMIK-ut dhe liderëve politikë të Kosovës. Shefi i UNMIK-ut, Hans Hækkerup, e emëroi një komitet (që përbëhej nga liderët politikë dhe ekspertët juridikë të Kosovës, dhe nga ekspertët juridikë ndërkombëtarë) që të hartojnë një kornizë kushtetuese për qeverisjen e përkohshme të Kosovës, që do të vlejë deri me rastin e zgjidhjes përfundimtare të statusit të Kosovës. Gjatë procesit të hartimit të kornizës kushtetuese s'u morën parasysh kërkesat e përfaqësuesve politikë shqiptarë të Kosovës. Nuk u përfill as kërkesa që të vihet një klauzolë në kornizën kushtetuese që do ta hapte mundësinë për mbajtjen e referendumit për pavarësinë e Kosovës. Shefi i UNMIK-ut i refuzoi lehtësisht kërkesat e përfaqësuesve politikë të shqiptarëve të Kosovës të cilët, përveç të tjerash, duke qenë të përçarë, nuk mundën të imponojnë veten si një palë serioze dhe e përgjegjshme negociuese gjatë hartimit të kornizës kushtetuese.

Me miratimin e Kornizës Kushtetuese, më 15 maj 2001, u krijuan Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPV), që përfshinin strukturat udhëheqëse, siç janë Kuvendi, Qeveria, Zyra e Presidentit e Kosovës etj. Megjithëkëtë, në bazë të kësaj kornize, shefi i UNMIK-ut u definua si autoriteti suprem në Kosovë mbi disa fusha dhe institucione të rëndësishme: mbrojtjen e minoriteteve, politikën e jashtme, Trupat e Mbrojtjes së Kosovës, Shërbimin Policor të Kosovës, Doganat, administrimin e pronës publike, politikën monetare, autoritetin për ta miratuar buxhetin. Më tutje, shefi i UNMIK-ut kishte të drejtë t'i emërojë dhe t'i shkarkojë prokurorët, gjykatësit, në fakt të drejtën për ta shpërndarë Kuvendin e Kosovës dhe për t'i shpallur zgjedhjet e reja në rast se puna e Kuvendit binte në kundërshtim me Rezolutën 1244 të OKB-së.

Përmbajtësisht, korniza kushtetuese u dha rëndësi të veçantë të drejtave për minoritetet në Kosovë. Fillimisht, kreu i III i kësaj kornize përcakton respektimin e të drejtave për minoritetet, në kuptimin se të gjithë personave në Kosovë duhet t'u respektohen të drejtat themelore të njeriut. Dhe se institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes (IPV) duhet të vëzhgojnë dhe ta

sigurojnë respektimin e konventave të mirënjohura ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke iu referuar:

(a) Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut;
(b) Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e Saj;
(c) Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike të Njeriut dhe Protokollet e Saj;
(ç) Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial;
(d) Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
(dh) Konventës për të Drejtat e Fëmijëve;
(e) Kartës Evropiane të Gjuhëve Rajonale dhe Minoritare dhe
(ë) Kornizës së Konventës të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare[205]

Sipas Kymlickas, standardet tradicionale të të drejtave të njeriut të ngulitura në konventat e ndryshme nuk janë në gjendje t'i zgjedhin disa nga pyetjet kontroverse që kanë të bëjnë me minoritetet kombëtare. Prandaj, sipas tij, bazuar në teorinë normative për të drejtat e minoriteteve, të drejtave për minoritete duhen shtuar disa të drejta shtesë, duke përfshirë të drejtat e veçanta të përfaqësimit, përkatësisht të drejtat e ashtuquajtura për 'mbrojtjen e minoriteteve nga jashtë'. Në përputhje me këtë qasje multikulturaliste për organizimin e bashkësive politike, në kreun IV dhe IX të kornizës kushtetuese, u jepet rëndësi e veçantë të drejtave shtesë për minoritetet, duke përfshirë të drejtat e përfaqësimit të veçantë:

Kreu 4
Të drejtat e komuniteteve dhe të anëtarëve të tyre

Dispozitat e përgjithshme

[205] Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, 2001: f. 10-11: http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/FrameworkPocket_ALB_Dec2002.pdf

4.1 Banorët e komuniteteve që i përkasin të njëjtit grup (komunitet) etnik, fetar ose gjuhësor kanë të drejtat e parashtruara në këtë kaptinë me qëllim që të ruhet, të mbrohet dhe të shprehet identiteti i tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor.

4.3 Institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes në politikën dhe praktikën e tyre udhëhiqen nga nevoja për ta nxitur bashkëjetesën e për ta mbështetur pajtimin midis komuniteteve si dhe për t'i krijuar kushtet e duhura për t'u mundësuar komuniteteve që të ruajnë, të mbrojnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre. Gjithashtu, institucionet nxisin ruajtjen e trashëgimisë kulturore të të gjitha komuniteteve të Kosovës pa diskriminim.

Të drejtat e komuniteteve dhe të anëtarëve të tyre

4.4 Komunitetet dhe anëtarët e tyre kanë të drejtë:

(a) Të përdorin lirisht gjuhën dhe alfabetin e tyre, duke përfshirë përdorimin e saj para gjykatave, organizmave dhe organeve të tjera publike të Kosovës;

(b) Të arsimohen në gjuhën e tyre;

(c) Të gëzojnë të drejtën për informacion në gjuhën e tyre;

(ç) Të gëzojnë të drejta të barabarta në lidhje me punësimin në organet publike të të gjitha niveleve dhe në shërbimet publike të të gjitha niveleve;

(d) Të kenë kontakte të papenguara me njëri-tjetrin dhe me anëtarët e komuniteteve të tyre brenda dhe jashtë Kosovës;

(dh) T'i përdorin dhe t'i shfaqin simbolet e komunitetit sipas ligjit;

(e) Të krijojnë shoqata për t'i nxitur interesat e komunitetit;

(ë) Të kenë kontakte të papenguara dhe të marrin pjesë në organizatat lokale, rajonale dhe ndërkombëtare joqeveritare në përputhje me procedurat e këtyre organizatave;

(f) Të ofrojnë informacion në gjuhën dhe alfabetin e komunitetit të tyre, duke përfshirë krijimin dhe mbajtjen e mediave të tyre;

> (g) Të ofrojnë arsim dhe të krijojnë institucione arsimore, në veçanti për shkollimin në gjuhën, alfabetin dhe kulturën e tyre si dhe në historinë e komunitetit të tyre për të cilën ofrojnë ndihmë financiare, duke përfshirë fondet publike në përputhje me ligjin e zbatueshëm, me kusht që planprogrami ta respektojë ligjin e zbatueshëm dhe ta reflektojë frymën e tolerancës midis komuniteteve dhe respektin për të drejtat e njeriut dhe traditat kulturore të të gjitha komuniteteve;
>
> (gj) Ta nxisin respektin për traditat e komuniteteve;
>
> (h) T'i ruajnë vendndodhjet me rëndësi fetare, historike ose kulturore për komunitetin në bashkëpunim me autoritetet publike përkatëse;
>
> (i) Të marrin dhe të sigurojnë shërbime shëndetësore publike dhe shërbime shoqërore, mbi baza jodiskriminuese, në përputhje me standardet e aplikueshme;
>
> (j) Të venë në funksionim institucionet fetare;
>
> (k) T'u garantohet qasje dhe përfaqësim në mediat elektronike publike, si dhe të kenë programe në gjuhët përkatëse dhe
>
> (l) T'i financojnë veprimtaritë e tyre duke mbledhur kontribute vullnetare nga anëtarët e tyre ose nga organizata jashtë Kosovës, ose duke marrë financime të tilla të cilat mund të ofrohen nga institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes ose nga autoritetet publike lokale përderisa financimi i tillë të bëhet në një mënyrë plotësisht transparente.[206]

Gjithashtu, në përputhje me argumentimin e Kymlikas, për gjetjen e një balance në mes të të drejtave individuale dhe të drejtave kolektive dhe parandalimit të 'restrikcioneve të brendshme ndaj individëve', në kuadër të minoriteteve, në mënyrë që minoritetet mos të mund t'u vënë frerë anëtarëve të vet dhe rrjedhimisht të mos dëmtohet e drejta e autonomisë

[206] Po aty: f. 11-12

individuale e anëtarëve të grupeve minoritare. Në kreun IV të kornizës kushtetuese është e precizuar:

> 4.2 Askush nuk do të detyrohet të deklarojë se cilit komunitet i përket ose të deklarohet anëtar i ndonjë komuniteti. Nuk ka asnjë pengesë nga ushtrimi i të drejtës së individit që të deklarohet ose të mos deklarohet anëtar i një komuniteti.[207]

Në këtë vazhdë, në kreun IX, përfshihen të drejtat e përfaqësimit të veçantë, përkatësisht të drejtat e rezervuara për minoritetet në nivel qendror (legjislativ dhe ekzekutiv) ku, përveç të tjerash, përcaktohet se Kuvendi i Kosovës do t'i ketë 120 vende. 100 vende shpërndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur në proporcion me numrin e votave të vlefshme që i kanë fituar në zgjedhjet për Kuvend, kurse 20 vende rezervohen për përfaqësim plotësues të komuniteteve joshqiptare të Kosovës. Nga 20 vende për komunitetet, 10 vende iu ndahen partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur që kanë deklaruar vetë se përfaqësojnë komunitetin serb të Kosovës. Këto vende iu shpërndahen partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të tillë të pavarur në proporcion me numrin e votave të vlefshme që ata kanë marrë në zgjedhjet për Kuvend dhe 10 vende iu ndahen komuniteteve të tjera: romëve, ashkalinjve dhe komunitetit egjiptian (4), komunitetit boshnjak (3), komunitetit turk (2) dhe komunitetit goran (1). Vendet për secilin komunitet iu ndahen partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të tillë të pavarur në proporcion me numrin e votave të vlefshme që ata marrin në zgjedhjet për Kuvend. Ndërsa në përbërje të qeverisë, të paktën dy ministra do të jenë gjithmonë nga komunitetet e tjera, përveç komunitetit që ka shumicën në Kuvend. Një nga këta të paktën do të jetë nga komuniteti serb dhe një tjetër nga një komunitet tjetër. Në rastin kur emërohen më shumë se dymbëdhjetë ministra, një ministër i tretë emërohet nga një komunitet që

[207] Po aty: f. 11

s'përbën shumicë. Zgjedhja e këtyre ministrave dhe përcaktimi i përgjegjësive të tyre vendoset pas konsultimeve me partitë politike ose grupet që përfaqësojnë komunitetet që nuk përbëjnë shumicë.[208]

Përpjekjet e UNMIK-ut, për ta organizuar bashkësinë politike në Kosovë, nuk vareshin vetëm nga shqiptarët e Kosovës, por edhe nga marrëdhënia në mes të UNMIK-ut dhe autoriteteve politike në Beograd që, faktikisht, i kurdisnin qëndrimet politike të minoritetit serb në Kosovë. Me fjalë të tjera, pavarësisht prej krimeve të luftës që kishin ndodhur nga regjimi neofashist i Millošević-it ndaj popullatës civile shqiptare në Kosovë, autoritetet politike të Beogradit vazhduan edhe pas vitit 1999 ta kenë ndikimin e vet destruktiv, duke minuar çdo proces të iniciuar dhe të inkurajuar nga UNMIK-u për bashkëpunimin në mes të majoritetit shqiptar dhe minoritetit serb në Kosovë. Ky ishte edhe shkaku kryesor pse liderët e serbëve të Kosovës nuk ishin veçanërisht të motivuar që të bashkëpunonin në lidhje me kornizën kushtetuese dhe morën pjesë vetëm ditën e parë dhe të fundit në hartimin e këtij dokumenti. Kështu që, për UNMIK-un ishte e rëndësishme të etablojë një marrëdhënie të mirë me Qeverinë e Beogradit, ndërsa për Qeverinë e Beogradit ishte me rëndësi që të ketë një influencë praktike (dhe jo vetëm formale) në ushtrimin e mëtutjeshëm të sovranitetit të Serbisë mbi Kosovën. Për këtë arsye, Qeveria e Beogradit themeloi një qendër për koordinimin e politikës serbe mbi Kosovën. Udhëheqësi i kësaj qendre, Nebojša Čović, gjatë një vizite në OKB, në shtator të vitit 2001, hapi rrugën për bashkëpunim dhe propozoi që lidhjet në mes të UNMIK-ut dhe qeverisë serbe të institucionalizohen. Më pastaj, kjo rezultoi me një marrëveshje bashkëpunimi në mes të UNMIK-ut dhe Qeverisë së Serbisë (dokumenti i përbashkët UNMIK-FRY, i datës 5 nëntor 2001), e ashtuquajtura marrëveshje, Hækkerup - Čović. Kjo marrëveshje konfirmoi, përveç të tjerash, sovranitetin e Republikës Federale të Jugosllavisë mbi Kosovën në bazë të

[208] Po aty: 19-20, 27-28

Rezolutës 1244 të OKB-së. Edhe pse, sipas Rezolutës 1244, çështja e statusit përfundimtar të Kosovës ishte çështje e hapur, marrëveshja siguroi (sikurse që siguronte edhe korniza kushtetuese) që Institucionet e Vetëqeverisjes së Përkohshme të Kosovës të mos e kenë autoritetin për të ndërmarrë veprime të njëanshme për zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Më tutje, marrëveshja rekomandoi që serbët e Kosovës të marrin pjesë në zgjedhje dhe në Institucionet e Vetëqeverisjes së Përkohshme të Kosovës.[209]

Më 17 nëntor 2001 u mbajtën zgjedhjet e para demokratike në historinë e Kosovës. Sipas rezultateve të zgjedhjeve, fitoi Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e udhëhequr nga Ibrahim Rugova me 46.2 % të votave, duke rezultuar me 47 vende në Kuvend. Partia e dytë më e madhe rezultoi të jetë Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e udhëhequr nga Hashim Thaçi, me 25.5 % dhe 26 vende në Kuvend. Koalicioni politik serb i sapoformuar "Kthimi", doli me 10.9 % të votave dhe 22 vende në Kuvend (duke përfshirë vendet e rezervuara). Partia e tretë më e madhe shqiptare e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e udhëhequr nga Ramush Haradinaj, mori 7.8 % të votave dhe 8 vende në Kuvend, ndërsa vendet e mbetura u ndan në mes të përfaqësuesve të minoriteteve të tjera në Kosovë. [210]

Meqë asnjëra nga partitë nuk e fitoi shumicën e duhur për të formuar vetë qeverinë, ishin të nevojshme koalicionet partiake. Përkundër situatës së vështirë politike në Kosovë, dy partitë më të mëdha LDK-ja (që, përveç të tjerash, e kishte siguruar pozitën e presidentit) dhe PDK-ja nuk merreshin vesh në mes vete për një koalicion qeveritar, sepse kryetari i PDK-së, Hashim Thaçi, nuk konsiderohej i pranueshëm për postin e

[209] UNMIK - FRY Common Document (2001): http://www.kosovo.net/unfry.html

[210] The news and views of Southeast Europe (2001): Kosovo Parliamentary Elections, 17 November 2001: http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/infoElections/setimes/resource_centre/elections/kosovo_assembly_2001

kryeministrit. Fatkeqësisht, liderët shqiptarë të Kosovës, në vazhdën e divergjencave në mes tyre, para, gjatë dhe pas Konferencës së Rambujesë, nuk gjenin konsensus të duhur, duke i vënë interesat e tyre personale (protagonizmin personal), para interesit të Kosovës. Pikënisje e këtyre divergjencave ishin disa deklarata skeptike të Ibrahim Rugovës në vitin 1997 në lidhje me shfaqjen publike të UÇK-së. Megjithëkëtë, Ibrahim Rugova u tregua konstruktiv gjatë Konferencës së Rambujesë (1999), i cili, pas ngurrimit që kishte shprehur fillimisht, pranoi që drejtori politik pranë shtabit të përgjithshëm të UÇK-së, Hashim Thaçi, të jetë kryesues i delegacionit të Kosovës në Rambuje. Në fakt, ky ishte një insistim i drejtë i (mentorit të Hashim Thaçit në Rambuje), Rexhep Qoses, sepse në këtë mënyrë legjitimohej edhe më shumë UÇK-ja në arenën ndërkombëtare.[211] Por, në përfundim të Konferencës së Rambujesë, kur u themelua Qeveria e Përkohshme e Kosovës në krye me Hashim Thaçin, çuditërisht nuk u insistua që kjo qeveri të njohë Ibrahim Rugovën president i Kosovës në kuadër të unifikimit të faktorit politik të shqiptarëve të Kosovës. Kështu që, në vazhdën e këtyre divergjencave politike, LDK-ja (partia e cila doli e para në zgjedhjet parlamentare të vitit 2001), nuk e pranonte Thaçin për kryeministër. Dhe pas shumë peripecive dhe ndikimit të bashkësisë ndërkombëtare, u arrit një kompromis që një kandidat tjetër nga radhët e PDK-së të bëhet kryeministër i koalicionit qeverisës në mes të LDK-së dhe PDK-së. Kryeministër nga radhët e PDK-së u emërua Bajram Rexhepi dhe, në kuadër të kësaj qeverie (në përputhje me kornizën kushtetuese), u zgjodh një ministër nga minoriteti serb i Kosovës dhe një ministër si përfaqësues i minoriteteve të tjera në Kosovë. Në këtë vazhdë, prej vitit 2001 deri në vitin 2004 Qeveria e Kosovës u udhëhoq nga një koalicion i gjerë në mes të LDK-së dhe PDK-së dhe përfaqësuesve të minoriteteve në Kosovë. Njëkohësisht vazhduan divergjencat politike në mes të liderëve politikë shqiptarë të Kosovës, dhe e patën ndikimin e

[211] Qosja 1999: 46-48

vet, përveç të tjerash, për vonimin e pavarësimit të Kosovës, për mungesën e forcimit të sistemit gjyqësor, duke përfshirë menaxhimin e dobët të gjendjes së përgjithshme politike në Kosovë, që rezultoi me trazirat e marsit në vitin 2004 etj.

Rrjedhimisht, gjatë fazës së parë, nga njëra anë UNMIK-u arriti t'i detyrojë përfaqësuesit politikë të shqiptarëve të Kosovës që ta akceptojnë kornizën kushtetuese, që rezultoi me një qasje të theksuar multikulturaliste për organizimin e bashkësisë politike në Kosovë. Korniza kushtetuese hapi njëkohësisht mundësinë për ndërtimin e institucioneve kyçe vendore të bazuara në zgjedhjet demokratike (Kuvendin, Qeverinë dhe Presidencën), megjithëkëtë UNMIK-u rezervoi pushtetin mbi institucionet kyçe në Kosovë. Nga ana tjetër, marrëdhëniet në mes të UNMIK-ut dhe Qeverisë së Beogradit u përmirësuan nëpërmes marrëveshjes Hækkerup - Čović dhe rezultuan me pjesëmarrjen e serbëve të Kosovës në zgjedhjet demokratike dhe në institucionet politike në Kosovë. Gjithashtu, relacioni ndëretnik në mes të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës u përmirësua pak pas zgjedhjeve të vitit 2001 por, jo mjaftueshëm, sepse politika shtetërore serbe e vendit ekstern "amë", vazhdonte në mënyrë perfide të minojë dhe sabotojë çdo përparim institucional në Kosovë (nëpërmes inkurajimit dhe financimit të strukturave paralele në enklavat serbe në Kosovë etj.).

Në ndërkohë, liderët politikë shqiptarë të Kosovës në mënyrë të pakoordinuar në mes vete insistonin (më shumë dhe më pak), që UNMIK-u të delegojë më shumë kompetenca tek Institucionet e Qeverisjes së Përkohshme të Kosovës dhe që të futet në agjendë çështja e zgjidhjes së statusit të Kosovës. Por, strategjia e UNMIK-ut ishte që delegimi i më shumë kompetencave tek institucionet e qeverisjes së përkohshme në Kosovë duhej të ndodhte gradualisht dhe se paraprakisht duhej përmbushur disa kritere, para se të vendoset që të shqyrtohet çështja e statusit final të Kosovës. E tëra rezultoi me strategjinë/kërkesën e UNMIK-ut "Standardet për Kosovën",

që shënon hyrjen në fazën e dytë të ndikimit edhe më të madh të UNMIK-ut për organizimin e bashkësisë politike në Kosovë.

Faza II

Dokumenti "Standardet për Kosovën" u prezantua nga shefi i UNMIK-ut, Michael Stainer (pasues i Hans Hækkerupit), gjatë një takimi në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në prill të vitit 2003, ku e mori edhe aprovimin. Qëllimi kryesor ishte që serbët e Kosovës të kenë parasysh se interesat e tyre do të merren seriozisht dhe do të mbrohen nga bashkësia ndërkombëtare. Njëkohësisht, konsiderohej se nëpërmes përmbushjes së "Standardeve për Kosovën" do të krijohen parakushtet për zgjidhjen e statusit final të Kosovës.

Në fillim të dokumentit "Standardet për Kosovën", që u bë publik më 10 dhjetor 2003, shkruan: "Një Kosovë ku të gjithë - pa marrë parasysh përkatësinë etnike, racën ose fenë - janë të lirë të jetojnë, punojnë dhe udhëtojnë pa frikë, armiqësi ose rreziqe dhe ku ka tolerancë, drejtësi dhe paqe për të gjithë".[212] Më tutje, në këtë dokument janë të konkretizuara tetë standardet e parapara për t'u përmbushur në përputhje me Rezolutën 1244: 1. Institucionet demokratike funksionale, 2. Sundimi i ligjit, 3. Liria e lëvizjes, 4. Kthimet e qëndrueshme dhe të drejtat e komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre, 5. Ekonomia (zhvillimi i një ekonomie të tregut), 6. Të drejtat pronësore (të drejtat e plota pronsore për të gjithë qytetarët), 7. Dialogu (dialog dhe normalizim të marrëdhënieve me Serbinë), 8. Trupat Mbrojtëse të Kosovës (demilitarizimi i TMK-së - me detyra të mbrojtjes civile).[213]

[212] Standards for Kosovo 2003: f. 1 : https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Kos%20Standards.pdf

[213] Po aty: f. 3, 5-15

Qasja e UNMIK-ut ishte që standardet duheshin plotësuar para se të mund të fillonin negociatat për statusin final të Kosovës. Kjo qasje e UNMIK-ut, nga njëra anë, binte ndesh me qëndrimin e përfaqësuesve politikë të shqiptarëve të Kosovës të cilët pajtoheshin me përmbajtjen e standardeve, por ishin kundër strategjisë "Standardet para statusit" dhe deklaronin se nuk kanë pushtet të mjaftueshëm politik për t'i përmbushur standardet. Sipas tyre, njohja e pavarësisë së Kosovës do ta mundësonte përshpejtimin e përmbushjes së "Standardeve për Kosovën". Nga ana tjetër, ndikimi i politikës serbe të Beogradit ndaj serbëve të Kosovës, duke e përfshirë financimin e strukturave paralele të enklavave serbe në Kosovë, binte në kundërshtim të drejtpërdrejtë me strategjinë e UNMIK-ut për plotësimin e standardeve. Sepse standardet për Kosovën përfshinin edhe kërkesën për shuarjen e këtyre strukturave paralele serbe në Kosovë që financoheshin nga Beogradi dhe që e pengonin integrimin e minoritetit serb në Kosovë.

Liderët serbë të Kosovës dhe përfaqësuesit e Qeverisë së Serbisë më 3 mars 2004 e refuzuan edhe formalisht pjesëmarrjen e tyre në punën e standardeve. Sipas tyre, strategjia "Standardet për Kosovën" ishte një udhërrëfyes drejt pavarësisë së Kosovës. Një ditë më parë, më 2 mars 2004, kryeministri i Serbisë, Vojislav Koštunica, lansoi një plan për zgjidhjen e statusit të serbëve në Kosovë. Ky plan parashihte një nivel të lartë të autonomisë për Kosovën në kuadër të unionit Serbi - Mali i Zi dhe autonomi për serbët dhe shqiptarët brenda Kosovës që, në fakt, nënkuptonte kantonizimin e Kosovës. Shefi i ri i UNMIK-ut, Harri Holkeri (pasuesi i Michael Stainerit), pas një takimi me kryeministrin e Serbisë në Beograd, më 8 mars të vitit 2004, përveç të tjerash, deklaroi se ishte kundër kantonizimit të Kosovës dhe se, duke u bazuar në Rezolutën 1244, deklaratat për ndarje të Kosovës nuk mund të ishin tema shqyrtimi. Gjithashtu, potencoi se pa implementimin e standardeve negociatat për statusin final të Kosovës do të shtyhen dhe se,

sipas tij, mungesa e pjesëmarrjes së serbëve në punën e standardeve ishte një gabim i madh.[214]

Kërkesa për përmbushjen e standardeve, për një vend si Kosova që sapo kishte dalë nga një konflikt i armatosur, shihej si një plan shumë ambicioz. Vetëm një muaj pasi që ishte publikuar dokumenti "Standardet për Kosovën", eksperti i njohur i Ballkanit, Janusz Bugajski, në një analizë kritike, kishte shkruar:

> "Asnjë shtet i ri dhe me aspirata nuk mund t'i përsosë të gjitha këto tetë standarde dhe nënndarjet e tyre në kuptimin e muajve apo edhe të viteve. Ato më parë do të duhej të shikoheshin si harta rrugësh dhe destinimesh drejt të cilave çdo shtet që bazohet në sundimin e ligjit duhet të synojë. Progresi do të varet jo vetëm nga vetë kosovarët, por edhe nga aftësitë e OKB-së që t'i delegojë autoritetet dhe t'i lejojë institucionet e zgjedhura që të funksionojnë dhe t'i kontrollojnë çështjet e veta. Paradoksalisht, shumica e shteteve anëtare të OKB-së as vetë s'kanë përmbushur shumicën e standardeve të specifikuara. Sa shtete veprojnë sipas sundimit të ligjit, pluralizmit demokratik, bashkëjetesës ndëretnike dhe ekonomisë së tregut? Pa dyshim se së paku dy shtete anëtare të Këshillit të Sigurimit të OKB-së duhet të diskualifikohen menjëherë nga pavarësia, së bashku me shumicën e shteteve në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së. Interesant është se dokumenti në mënyrë të përsëritshme u referohet "standardeve evropiane" më shumë se atyre të OKB-së apo standardeve globale kundër të cilave Kosova do të gjykohet. Kjo tregon se sa shumë tenton trupi botëror që ta mbulojë mungesën e vet demokratike, duke u fshehur pas anëtarëve të vet evropianë. Kosovarët duhet ta mirëpresin dokumentin e OKB-së si një plan të arritshëm në aksionin për pavarësinë. Ata duhet t'u ndihmojnë vëzhguesve të rezultateve dhe t'i saktësojnë dështimet, çfarëdo qofshin arsyet apo prej kujt vijnë pengesat. Prishtina duhet të tregojë vullnet të mirë dhe angazhime të hershme si dhe ta zgjasë ndihmën ndërkombëtare dhe dypalëshe për t'i arritur të gjitha synimet e specifikuara". (Bugajski 2006: 287).

[214]Agjencia Informative e Kosovës 2004: Hari Holkeri i hodhi poshtë propozimet e Koshtunicës për kantonizimin e Kosovës: http://www.trepca.net/2004/03/040309_lajme.htm

Gjatë kësaj klime politike ndodhën trazirat e marsit 2004 dhe e përkeqësuan situatën edhe më shumë. Një ndër faktorët që shkaktuan trazirat ishte dëshpërimi për vdekjen e tre të miturve shqiptarë që u mbytën në lumin Ibër në qytetin e ndarë të Mitrovicës. Një nga të miturit që mbijetoi tha për mediat se i ndoqën serbët drejt lumit. Në ndërkohë, serbët e Kosovës në Qagllavicë e mbanin të bllokuar për rreth tri ditë rrugën kryesore drejt kryeqytetit të Prishtinës, si reaksion për një serb që ishte qëlluar dhe plagosur nga persona të panjohur. KFOR-i nuk e mori përgjegjësinë për zhbllokimin e rrugës kryesore në drejtim të Prishtinës dhe kjo nga shqiptarët e Kosovës u konsiderua si një shprehje e paaftësisë së KFOR-it për të vepruar kundër ekstremizmit serb, gjë që rezultoi në trazirat e dhunshme mes protestuesve shqiptarë të Kosovës dhe forcave të KFOR-it. Nga këndvështrimi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB-së), trazirat në Kosovë më 17 dhe 18 mars u panë si një dështim i madh i udhëheqësve politikë shqiptarë të Kosovës. 19 persona vdiqën gjatë trazirave (11 shqiptarë dhe 8 serbë të Kosovës) dhe 954 persona u lënduan gjatë përleshjeve. Përveç kësaj, u lënduan edhe 65 policë ndërkombëtarë, 58 policë lokalë dhe 61 ushtarë të KFOR-it. Sipas raportit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së të datës 30 prill 2004, trazirat e marsit ishin etnikisht të motivuara dhe kjo konsiderohej si një prapakthim në përpjekjet për të ndërtuar një Kosovë demokratike dhe shumetnike. Raporti konstatonte se trazirat ishin tregues se në kuadër të një pjese të madhe të popullit shqiptar të Kosovës, ende ekzistonte një mungesë e përkushtimit për krijimin e një shoqërie të vërtetë shumetnike në Kosovë, se politikanët duhet të mbajnë përgjegjësi, se ekstremizmi duhet luftuar dhe dhuna nuk duhet shpërblyer. Njëkohësisht, në raport potencohej se nuk mund të ketë të ardhme paqësore dhe prosperuese për Kosovën pa respektin për diversitetin e njerëzve. Më tutje, kërkesa në këtë raport ishte që udhëheqësit e Kosovës duhej të tregonin një vullnet të qartë për zbatimin e standardeve dhe ta respektojnë autoritetin dhe përgjegjësitë e rezervuara për përfaqësuesin e sekretarit të

përgjithshëm të OKB-së në Kosovë në përputhje me Kornizën Kushtetuese. Edhe pse raporti i adresoi fajin për trazirat e marsit kryesisht njërës palë, përkatësisht politikanëve shqiptarë të Kosovës dhe majoritetit shqiptar të Kosovës në përgjithësi, në raport u potencua se do të ndërmerret një hulumtim i plotë për ta vlerësuar rolin e të gjitha palëve në lidhje me trazirat e marsit.[215] Në këtë vazhdë, diplomati norvegjez Kai Eide u emërua nga sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Kofi A. Annan, për të bërë një hulumtim të plotë për rolin e të gjitha palëve në Kosovë në lidhje me trazirat e marsit dhe për t'i bërë rekomandimet për të ardhmen.

Kai Eide, pas hulumtimit të tij të plotë, e paraqiti raportin më 30 nëntor 2004. Në bazë të këtij raporti bashkësia ndërkombëtare ishte befasuar nga dhuna në Kosovë për shkak se nuk kishte arritur të kuptojë disponimin në popull, përkatësisht thellësinë e pakënaqësisë së shumicës së shqiptarëve dhe ndjeshmërinë e pakicës serbe. Raporti vuri në dukje se si UNMIK-u është perceptuar si një pengesë për zhvillim dhe se as shqiptarët e Kosovës dhe as serbët e Kosovës nuk ishin të kënaqur me situatën. Njëkohësisht, në raport u konstatua se edhe UNMIK-u ishte viktimë e një politike ndërkombëtare që i mungonte vizioni. Nga perspektiva e majoritetit shqiptar, si shkak i dhunës nuk shihej parësisht konflikti ndëretnik, por mungesa e zhvillimit ekonomik dhe mungesa e një rrugëtimi prosperues politik. Ndërsa serbët e Kosovës konsideronin se ishin viktima të një fushate eksodi nga Kosova. Më tutje në këtë raport, Eide potencoi se gjatë vizitës së tij në Kosovë kishte vënë re se është krijuar një klimë pozitive si rezultat i mesazheve të qarta nga OKB, në kuptimin se shqiptarët e Kosovës e pranojnë se kanë bërë "shumë pak, shumë vonë", për ta ndaluar dhunën që ndodhi në muajin mars, dhe e kanë kuptuar se trazirat e marsit e kanë dëmtuar reputacionin dhe mbështetjen ndaj tyre në kuadër të bashkësisë ndërkombëtare

[215]Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo, 2004: 1, 14-16: https://undocs.org/en/S /2004/348

dhe se duhet të bëjnë përpjekje serioze për ta qetësuar bashkësinë ndërkombëtare dhe minoritetin serb. Në kuadër të propozimeve në këtë raport, Eide përmend dy kërkesa kryesore të shqiptarëve të Kosovës, përkatësisht transferimin e më shumë kompetencave tek Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes dhe zgjidhjen e statusit final të Kosovës, në kuptimin se transferimi i më shumë kompetencave nga UNMIK-u tek Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes do t'i forcojë këto institucione me përvojën relevante. Dhe se OKB do të duhej t'i inicionte parapërgatitjet për zgjidhjen e statusit final të Kosovës sepse nuk do të ketë "kohë ideale" për t'i filluar përgatitjet e tilla. Gjithashtu, në raport Eide e kritikon qasjen e punës me standardet si qasje gjeneraliste dhe e parealizueshme. Sipas tij, prioritizimi i standardeve bazuar në kërkesat realiste dhe realizuese do ta lehtësonte punën me standardet, duke mobilizuar presion dhe duke dërguar një mesazh më bindës te të gjithë se çfarë pritet prej tyre. [216]

Në këtë vazhdë, strategjia e re e iniciuar nga Kai Eide në lidhje me standardet për Kosovën rezultoi pozitivisht. Ndryshimi nga strategjia se "të gjitha standardet duhet të arrihen" në strategjinë "progresi real dhe i dukshëm në terren duhet të arrihet" para se të fillojnë negociatat për statusin, çoi në një ndryshim pozitiv në mesin e shqiptarëve. Standardet tani perceptoheshin si një mjet për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe jo si një pengesë. Pas zgjedhjeve parlamentare të 23.10.2004, kryetar qeverie u zgjodh Ramush Haradinaj, i cili e pranoi qasjen e re të iniciuar nga Eide dhe nisi një fushatë për t'i përmirësuar përpjekjet e institucioneve të Kosovës në lidhje me punën me standardet. Pas dorëheqjes së kryeministrit Haradinaj në mars 2005, pas njoftimit për aktakuzë ndaj tij nga Tribunali Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (ICTY), puna me

[216]Kai Eide: *Report on the situation in Kosovo* (2004): 3, 4: http://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/kos%20S2004%20932.pdf

standardet vazhdoi në krye me kryeministrin Bajram Kosumi.[217]

Më 27 maj 2005, gjatë seancës së Këshillit të Sigurimit, u pranua se autoritetet e Kosovës kanë bërë shumë dhe janë duke punuar për zbatimin e standardeve, dhe se kishte ardhur koha për përgatitjen e një raporti për situatën në Kosovë nga një ekspert i pavarur. Përvoja dhe bashkëpunimet e mëparshme të Kai Eides me OKB-në dhe njohuritë e tij të thella për Ballkanin ishin vendimtare që Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Kofi A. Annan, përsëri ta emërojë më 03.06.2005, si ekspert të pavarur për të përgatitur një raport mbi situatën politike në Kosovë dhe njëkohësisht t'i përgatisë rekomandimet për rrugën e mëtejme. Kjo shënoi fillimin e periudhës më intensive të punës me standardet. Në qershor të vitit 2005 Qeveria e Kosovës hartoi një plan - veprimi dhe bëri një përpjekje të veçantë për t'i implementuar masat shumetnike për minoritetet e ndryshme në Kosovë. Pas përfundimit të planveprimit të parë, u vazhdua me vendimet e Qeverisë së Kosovës për planveprimet e tjera të cilët u realizuan. Pavarësisht prej kapacitetit të dobët në institucionet e Kosovës dhe bojkotit në punën e standardeve nga serbët e Kosovës dhe Qeveria e Beogradit, sipas raportit të UNMIK-ut, udhëheqësit politikë shqiptarë të Kosovës arritën ta bëjnë prioritet punën për zbatimin e standardeve.[218]

Kai Eide e paraqiti raportin e dytë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së më 7 tetor 2005, ku vuri në dukje se përparimi në implementimin e standardeve kishte ndodhur si rezultat i një dinamike të re në punën e qeverisë. Në përgjithësi në këtë raport përshkruhet situata faktike në Kosovë, duke përfshirë edhe fushat ku përparimi s'ishte i mjaftueshëm dhe paraqiten propozimet për rrugën e mëtutjeshme. Përveç të tjerash, konstatohet se pjesëmarrja e serbëve të Kosovës dhe e minoriteteve të tjera ishte e ulët në strukturat burokratike dhe

[217] UNMIK report (2007): *The Kosovo standards process 2003-2007*: 2-3: http://www.unmikonline.org/standards/docs/KSP2003- 2007.pdf
[218] Po aty: 3

rekrutimi i minoriteteve në këto struktura ishte konsideruar shpesh si një çështje e përmbushjes së kuotës, në vend të krijimit të një pjesëmarrje kuptimplotë. Dhe se shqiptarët e Kosovës do të duhej t'i kishin rritur përpjekjet e tyre për të krijuar një administratë shumetnike. Gjithashtu, serbët e Kosovës do të duhej të tregonin interesim për të aplikuar për pozita në strukturat udhëheqëse dhe të merrnin pjesë në mënyrë aktive. Më tutje, në raport thuhet se liderët politikë serbë të Kosovës kishin vendosur të mos marrin pjesë në institucionet politike dhe se liderët politikë shqiptarë nuk kishin bërë mjaft për t'i inkurajuar liderët politikë serbë që të marrin pjesë në institucionet politike. Potencohet edhe qëndrimi negativ i autoriteteve të Beogradit, duke e përfshirë mungesën për t'i inkurajuar serbët e Kosovës që të marrin pjesë në zgjedhjet e tetorit 2004 në Kosovë, gjë që ka ndikuar dukshëm për mungesën e serbëve në institucionet qendrore politike në Kosovë. Dhe se, sikur serbët e Kosovës të merrnin pjesë në zgjedhjet e tetorit 2004, me vende të zgjedhura dhe të rezervuara, do të ishin në gjendje të ndikojnë në debatet në kuvend dhe në formimin e qeverisë. Ndërsa sa iu përket strukturave paralele për shërbimet shëndetësore dhe arsimore që shtrihen në zonat me popullsi serbe të Kosovës, dhe që kryesisht financohen nga Qeveria e Beogradit, konstatohet se ekzistenca e vazhdueshme e strukturave të tilla paralele është një demonstrim politik dhe reflekton mosbesimin në raport me shqiptarët e Kosovës dhe se njëkohësisht është një shprehje e ndikimit politik të Beogradit. Megjithëkëtë, në raport thuhet se deri në vitin 2005 nga pala shqiptare kanë munguar përpjekjet reale dhe vullneti politik për decentralizim në Kosovë dhe se dëshira për të arritur rezultate të shpejta për decentralizimin gjatë verës të vitit 2005 ka rezultuar me një qasje më pak ambicioze dhe me konsultimin e pamjaftueshëm me të

përfshirit. Rezultati ka qenë "shumë pak, shumë vonë", dhe se përparimi ka ndodhur në pilotprojektet në zonat joserbe.[219]

Vlen të theksohet se në raportin e tij të dytë, Eide i kushtoi vëmendje të veçantë decentralizimit, duke e konsideruar të nevojshëm për minoritetet ngaqë, sipas tij, decentralizimi do t'u mundësojë minoriteteve në Kosovë që ta mbrojnë më mirë identitetin e tyre dhe ta rritin besimin në të ardhmen, si dhe do t'i inkurajojë që të marrin një rol më aktiv në institucionet qeverisëse të Kosovës. Kështututje, në raport sugjerohet që decentralizimi të merret seriozisht, në kuadër të një kornize më të madhe, që rezulton me liberalizimin e pushtetit dhe rritjen e kompetencës në nivel lokal. Dhe se një kornizë e tillë mund të nënkuptojë krijimin e një numri të komunave të reja, ku veçanërisht serbët e Kosovës do ta përbënin shumicën dhe ku parashihen edhe kompetencat e sforcuara në fusha të tilla si policia, gjyqësori, arsimi, kultura, media dhe ekonomia, duke e përfshirë emërimin e zyrtarëve kyçë. Kjo do të mund të hapte mundësinë për lidhje horizontale midis komunave ku serbët e Kosovës janë shumicë dhe do të mund të lejoheshin lidhje të veçanta midis këtyre komunave dhe Beogradit pa i dhënë Beogradit ndonjë autoritet mbi këto komuna. Po ashtu, në raport sugjerohet se një plan ambicioz i decentralizimit, me kompetencë të veçantë për të gjitha komunat, nuk duhet t'i kërcënojë institucionet qendrore në Kosovë apo ta dobësojë autoritetin e Prishtinës, se bashkësia ndërkombëtare duhet të asistojë për krijimin e rregullave për decentralizim më të madh ngaqë decentralizimi do të krijojë garanci efektive institucionale për minoritetet, do ta rrisë besimin në institucionet qendrore në Kosovë dhe do të kontribuojë për një situatë ku komunat e tilla do t'i absorbojnë strukturat paralele serbe, nën autoritetin e Prishtinës. Në këtë vazhdë, përkundër rezervave të tij, Eide

[219] Kai Eide: *Report on the situation in Kosovo* (2005): 2, 8, 10, 17: https://undocs.org/pdf?symbol=en/S/2005/635

propozoi që procesi i përcaktimit të statusit final të Kosovës të fillojë.[220]

Faza e dytë karakterizohet nga zgjerimi i kërkesave dhe presioni i UNMIK-ut ndaj liderëve politikë shqiptarë të Kosovës në lidhje me minoritetin serb në Kosovë. Nëpërmjet përmbushjes së standardeve, konsiderohej se do të jetë më lehtë të zgjidheshin konfliktet ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë. Megjithëkëtë, kërkesa për standarde u interpretua në mënyra të ndryshme nga shqiptarët dhe serbët. Shqiptarët e Kosovës ishin të pajtimit për përmbajtjen e standardeve, por e kundërshtuan strategjinë "Standardet para statusit". Insistonin që Kosova të bëhej e pavarur dhe se Kosova e pavarur do të ishte në gjendje më të mirë për t'i përmbushur standardet sepse përmbushja e standardeve kërkonte angazhim disavjeçarë. Serbët e Kosovës interpretonin kërkesën për standardet si një udhërrëfyes drejt pavarësisë së Kosovës dhe duke qenë të ndikuar nga Qeveria e Beogradit, e bojkotuan punën me standardet. Kritika e sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, në lidhje me trazirat e marsit, kontribuoi që udhëheqësit politikë të shqiptarëve të Kosovës ta kuptojnë më mirë rolin dhe përgjegjësinë e tyre në lidhje me minoritetin serb. Megjithëkëtë, roli i diplomatit Kai Eide ishte vendimtar për përmirësimin e situatës politike pas trazirave të marsit dhe kjo nuk ishte ndonjë befasi e madhe. Duke e marrë parasysh se, përveçse ishte një diplomat me përvojë, ka pasur edhe mundësinë të njoftohet në mënyrën më të mundshme objektive me zhvillimet politike në Kosovë, që nga vitet '80 ngaqë bashkëshortja e tij, Gro Holm, për të parën herë e kishte vizituar Kosovën në vitin 1988, për ta vëzhguar nga afër situatën shoqëroro-politike, në cilësinë e gazetares hulumtuese dhe politologes dhe, rrjedhimisht, kishte njohuri të thella për zhvillimet politike në Kosovë që nga vitet '80 dhe në vazhdimësi. Përndryshe, Gro Holm ka qenë edhe shoqe e ngushtë e Berit Backer-it.

[220] Po aty: 17-18

Duke e marrë parasysh se Eide i identifikoi shkaqet themelore të trazirave të marsit dhe propozoi zgjidhje pragmatike, si në lidhje me punën e standardeve të bazuara në kërkesa realiste dhe të arritshme, gjithashtu duke përshpejtuar përgatitjet për zgjidhjen e statusit final të Kosovës, kjo i motivoi udhëheqësit politikë shqiptarë të Kosovës ngaqë përparimi i dukshëm në terren në punën me standardet filloi të perceptohet si një mjet për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Njëkohësisht, trazirat e marsit 2004 dhe pragmatizmi i Kai Eides me vlerësimet dhe propozimet e tij ndikuan mbi mënyrën e organizimit të marrëdhënieve ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë, që forcoi edhe më shumë bindjen se qasja multikulturaliste ishte zgjidhja më e mirë e mundshme për organizimin e bashkësisë politike në Kosovë. Bazuar në vlerësimet dhe propozimet e Eides, sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Kofi A. Annan, e emëroi ish-presidentin finlandez Marti Ahtisaari të dërguarin e posaçëm të tij për negociatat mbi statusin final të Kosovës. Ky emërim i Ahtisaarit u miratua nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së më 10 nëntor 2005.

Faza III

Negociatat për zgjidhjen e statusit të Kosovës filluan në shkurt 2006 në Vjenë dhe u drejtuan nga i emëruari i posaçëm i sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, Martti Ahtisaari dhe zëvendësi i tij Albert Rohan, të asistuar nga një sekretariat, përkatësisht zyra e OKB-së e të emëruarit të posaçëm, e stacionuar në Vjenë (UNOSEK).[221] Në këtë vazhdë, më 24 korrik 2006 Ahtisaari mblodhi palët në Vjenë për bisedime të nivelit të lartë. Presidenti i Serbisë, Boris Tadić dhe presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, paraqitën planet e tyre për statusin e

[221] Weller, 2009: 323

ardhshëm të Kosovës.[222] Palët kishin qëndrime diametralisht të kundërta për zgjidhjen e statusit të ardhshëm të Kosovës. Pala serbe këmbëngulte për konfirmimin e sovranitetit territorial mbi Kosovën, ndërsa pala shqiptare këmbëngulte për pavarësinë e Kosovës.[223]

Delegacioni i shqiptarëve të Kosovës nuk mund të pranonte alternativa që nënkuptonin më pak se pavarësi për Kosovën, sepse vetë kërkesa për pavarësi ishte kompromis. Përkatësisht, që nga viti 1912 diskursi i brendshëm i elitës politike shqiptare ka qenë i dominuar nga kërkesa për ribashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Ky qëndrim ndryshoi vetëm formalisht në fillimvitet '80, kur Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK) për arsye pragmatike dhe realpolitike e shkurtoi formalisht kërkesën për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, në kërkesën për Republikën e Kosovës në kuadër të Federatës Jugosllave. Dhe pas shpërbërjes së Jugosllavisë në vitet '90, elita politike e shqiptarëve të Kosovës (LPK, LDK etj.), zgjodhi të përpiqej për realizimin e një Kosove të pavarur, të cilën e perceptoi si një kompromis midis status quos dhe preferencës së parë, e cila do të ishte bashkimi me Shqipërinë. Në këtë vazhdë edhe UÇK-ja, si kulminacion i përpjekjeve (prej vitit 1912), për çlirimin e Kosovës, tregoi pragmatizëm. Sipas zëdhënësit të UÇK-së, dhe historianit Jakup Krasniqi, "UÇK-ja në programin e vet kishte çlirimin dhe bashkimin e tokave të pushtuara të Shqipërisë. Kjo ishte edhe pjesë e betimit ushtarak në radhët e UÇK-së. Lufta çlirimtare krijoi një realitet të ri. Lufta u shpërnda në tërë hapësirën administrative të Kosovës. Duke qenë edhe nën presionin e diplomacisë euroamerikane, udhëheqja politike e UÇK-së redukton kërkesën e saj në shërbim të Kosovës së Pavarur" (Krasniqi 2010: 109). Veçanërisht, duke i marrë parasysh përvojat e hidhura me regjimet e Serbisë, prej vitit 1912 deri në vitin 1999, nuk mund të bindeshin dhe të dety-

[222] UNOSEK report (2007): *The Status Process*: http://www.unosek.org/ dhe https://www.unosek.org/the-status-process/
[223] Weller, 2009: 327, 332

roheshin shqiptarët e Kosovës (as nga liderët e tyre politikë dhe as nga Bashkësia Ndërkombëtare), që të pranojnë ndonjë zgjidhje më pak se pavarësia e Kosovës dhe të mbesin prapë nën Serbi. Me fjalë të tjera, mbetja e Kosovës nën Serbi nënkuptonte luftë të re në Ballkan, ndërsa bashkimi i Kosovës me Shqipërinë nuk gjente përkrahje në kuadër të bashkësisë ndërkombëtare dhe, në një kontekst të tillë politik, si zgjidhje reale shihej një pavarësi për Kosovën që përfshin të drejtat e veçanta për serbët e Kosovës.

Gjatë negociatave Ahtisaari e përqendroi presionin te pala shqiptare, duke u vënë kushtëzime përfaqësuesve politikë shqiptarë të Kosovës për t'i dhënë të drejta të veçanta minoritetit serb në Kosovë. Në fakt, rruga për këtë ishte shtruar bazuar në Kornizën Kushtetuese të vitit 2001, veçanërisht (pas trazirave të marsit në vitin 2004), bazuar në propozimet e Kai Eides për decentralizimin që, në fakt, ishin një pikënisje e rëndësishme për negociatat në Vjenë. Sepse nga 15 takimet e drejtpërdrejta midis palëve (gjatë negociatave në Vjenë, në vitin 2006), 13 nga 15 takimet negociuese kishin të bënin me minoritetet (8 takime për decentralizimin, tri takime për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare, dy takime për të drejtat e minoriteteve), dhe një takim për çështjet ekonomike.[224]

Sipas Marc Weller (këshilltar i delegacionit të shqiptarëve të Kosovës), pala shqiptare kishte shprehur rezervat për qasjen e ndarjes së pushtetit në mes të minoriteteve dhe majoritetit në nivel qendror në mënyrë që të mos bëhet vendi i paqeverisshëm në praktikë, duke u bazuar edhe në përvojën e keqe të Bosnjës. Përkatësisht, pala shqiptare kishte shprehur hezitimin për vazhdimin e vendeve të rezervuara për minoritetet në Kuvend dhe për propozimin e vetos për minoritetet në lidhje me çështjet që i prekin "interesat e tyre jetike". Duke argumentuar se një përfaqësim i tepërt i minoriteteve do ta forcojë sistemin e ndarjes etnike, në vend se të mundësojë një politikë të bazuar

[224] UNOSEK report (2007): *The Status Process*: http://www.unosek.org/ dhe https://www.unosek.org/the-status-process/

në interesa që duhet ta kapërcejnë sistemin e politikës etnike. Mirëpo, ndërmjetësit në krye me Ahtisaarin kanë vazhduar me insistim për ndarjen e pushtetit në nivel qendror midis minoriteteve dhe majoritetit, duke u bazuar, përveç të tjerash, në kornizën kushtetuese të vitit 2001, mbi të drejtat e rezervuara të përfaqësimit.[225]

Në kuadër të negociatave, Ahtisaari arriti të imponojë që të drejtat e veçanta për serbët e Kosovës si në nivelin qendror ashtu edhe në nivelin lokal, të pranohen nga delegacioni shqiptar i Kosovës, por nuk arriti të imponojë një konsensus midis serbëve dhe shqiptarëve për statusin e ardhshëm të Kosovës. Kështu që, i takonte Ahtisaarit të vendoste vetë se çfarë statusi duhej të ketë Kosova. Dhe në këtë vazhdë, më 3 prill 2007, e paraqiti në Këshillin e Sigurimit planin e tij me propozimet për organizimin e bashkësisë politike në Kosovë dhe për zgjidhjen e statusit të Kosovës.

Me fjalë të tjera, plani i Ahtisaarit për Kosovën parasheh "mbrojtjen nga jashtë" për minoritetet në raport me majoritetin shqiptar si në nivelin qendror, ashtu edhe në nivelin lokal të Kosovës sepse përcakton që Kuvendi i Kosovës (bazuar në reprezentim proporcional), duhet të vazhdojë t'i ketë 120 vende, 20 vende të rezervuara për minoritetet; 10 vende për minoritetin serb dhe 10 vende për minoritetet e tjera. Përveç kësaj, parashihet vendimmarrja nëpërmes shumicës së dy palëve në Kuvend si për përfaqësuesit e majoritetit, po ashtu edhe për përfaqësuesit e minoriteteve në Kosovë. Kjo do të thotë se disa ndryshime legjislative kërkojnë jo vetëm një shumicë në Kuvend, por edhe një shumicë të përfaqësuesve të minoriteteve në Kuvend. Ndryshimet e mëdha legjislative kërkojnë pothuajse pëlqimin e të gjithëve, për shembull, çdo ndryshim i ardhshëm i Kushtetutës kërkon miratimin nga dy të tretat e përfaqësuesve të Kuvendit të Kosovës, njëkohësisht kërkon miratimin nga dy të tretat e përfaqësuesve të minoriteteve. Gjithashtu, qeveritë e Kosovës duhet të vazhdojnë të kenë

[225] Weller 2009: 337-338

një ministër serb dhe një ministër nga minoritetet e tjera.[226] Plani përfshiu edhe të drejtat kulturore për minoritetet, të sanksionuara edhe në Kornizën Kushtetuese të vitit 2001 dhe disa të drejta shtesë ku, përveç të tjerash, autoritetet e Kosovës janë të obliguara t'u mundësojnë minoriteteve dhe pjesëtarëve të tyre që të ruajnë, mbrojnë dhe zhvillojnë identitetet e tyre. Njëkohësisht çdo pjesëtar i grupeve etnike në Kosovë do të ketë të drejtën të zgjedhë lirisht të trajtohet ose të mos trajtohet pjesëtar i grupit të caktuar etnik dhe të mos diskriminohet për zgjedhjen e tij.[227] Më tutje, ky plan përcakton se Gjykata Supreme e Kosovës dhe Gjykata e Apelit duhet të kenë së paku 15 % të gjyqtarëve nga grupet minoritare dhe përfaqësimin e tyre në nivelin e gjykatave. Gjithashtu, gjuha shqipe dhe gjuha serbe duhet të jenë gjuhë zyrtare në Kosovë (ndërsa turqishtja, boshnjakishtja dhe gjuha rome të jenë gjuhë zyrtare në nivel komunal) dhe se Kosova duhet t'i ketë simbolet e veta të veçanta nacionale: flamurin, logon dhe himnin që pasqyrojnë karakterin shumetnik të vendit.[228]

Në nivelin lokal, plani i Ahtisaarit parasheh vetëqeverisjen (të drejtën e organizimit të brendshëm dhe të drejtën e pronës) për Kishën Ortodokse Serbe si dhe vetëqeverisjen territoriale nëpërmes decentralizimit në baza etnike për minoritetin serb. Përveç të tjerash, Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë (përfshirë manastiret, kishat dhe objektet e tjera që shfrytëzohen për qëllime fetare), do të ketë mirënjohje të plotë si pjesë integrale e Kishës Ortodokse Serbe në Beograd, dhe do të përfitojë nga të drejtat, privilegjet dhe imuniteti në kuadër të organizimit intern, duke përfshirë hierarkinë dhe aktivitetet e saj. Prona e luajtshme dhe e paluajtshme, përfshirë edhe asetet e tjera të Kishës Ortodokse Serbe, do të jenë të paprekshme dhe nuk do t'i nënshtrohen eksproprijimit. Autoritetet e Kosovës mund të

[226] Marti Ahtisaari: Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, 2007: 14-17, http://www.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Final%20Settlement%20Proposal%20AL.pdf

[227] Po aty: 20-23

[228] Po aty: 3, 36

kenë qasje në pronën e Kishës Ortodokse Serbe vetëm me pajtueshmërinë e kishës dhe në rastet e urdhrit gjyqësor në lidhje me veprimtaritë joligjore dhe në rast rreziku të drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin. Gjithashtu, një numër i zgjedhur i manastireve, kishave dhe objekteve të tjera fetare të Kishës Ortodokse Serbe (duke përfshirë objektet historike dhe kulturore të rëndësisë së veçantë për komunitetin serb të Kosovës), do ta gëzojnë mbrojtjen e zonave të veçanta, që nënkupton ndalimin e çdo aktiviteti të ri në kuadër të këtyre zonave, përveç të tjerash: Ndërtimi ose zhvillimi industrial siç është zbulimi dhe eksploatimi i resurseve minerale, ndërtimi i pendëve, i centraleve për prodhimin e energjisë ose rrjetit të energjisë elektrike, furrave dhe fabrikave, dhe rrugëve transit në viset rurale etj.[229]

Decentralizimi, përkatësisht vetëqeverisja lokale në Kosovë, sipas planit të Ahtisaarit bazohet në parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, veçanërisht në parimin e subsidiaritetit dhe ka qëllim mbrojtjen dhe promovimin e standardeve të pranuara ndërkombëtarisht të të drejtave të njeriut, duke marrë parasysh veçanërisht nevojat e minoriteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë. Fillimisht parashihen kompetencat e plota ekskluzive për të gjitha komunat në Kosovë, në fushat në vijim: Zhvillimi lokal ekonomik; Planifikimi urban dhe rural; Përdorimi dhe zhvillimi i tokës; Implementimi i rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve të kontrollit të ndërtimit; Mbrojtja lokale e mjedisit; Ofrimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, duke përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugët lokale, transportin lokal dhe skemat e ngrohjes lokale; Përgjigjja ndaj situatave emergjente lokale; Ofrimi i arsimit publik parashkollor, primar dhe sekondar, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve të arsimit, punësimin, pagimin e rrogave dhe trajnimin e drejtuesve dhe

[229] Po aty: 40-42

administratorëve të arsimit; Ofrimi i shërbimeve të kujdesit familjar dhe i atyre të mirëqenies sociale siç është kujdesi për njerëzit e lëndueshëm, kujdesi për të birësuarit, kujdesi për fëmijët, kujdesi për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave të kujdesit, rekrutimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale; Sigurimin, shërbimet familjare dhe shërbimet e tjera; Banimi publik; Shëndetësia publike; Licencimi i shërbimeve dhe objekteve lokale, përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitetet kulturore dhe ato të kohës së lirë, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit e rrugës, transportin lokal publik dhe taksitë; Emërimi i rrugëve, lagjeve dhe vendeve të tjera publike; Ofrimi dhe mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave publike; Turizmi; Aktivitetet kulturore dhe të kohës së lirë. Çdo çështje tjetër që në mënyrë të shprehur nuk përjashtohet nga kompetenca e tyre apo që nuk i është përcaktuar një autoriteti tjetër.[230]

Decentralizimi përfshin edhe themelimin e komunave të reja në rastet ku serbët e Kosovës përbëjnë së paku 75 % të popullsisë në një vendbanim të përqendruar me popullsi të gjithëmbarshme prej së paku 5 000 banorësh. Të gjitha komunat me shumicë serbe do të kenë gjykatat, të drejtën për bashkëpunim ndërkomunal dhe të drejtën e bashkëpunimit me institucionet në Serbi. Gjithashtu, shkollat në gjuhën serbe në Kosovë do të kenë të drejtën të zbatojnë planprograme apo tekste shkollore të hartuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë, përderisa këto planprograme dhe tekste nuk bien në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës.[231] Përveç kësaj, në kuadër të decentralizimit parashihen edhe kompetencat e zgjeruara vetjake për disa nga komunat me shumicë serbe:

> Neni 4. Kompetencat e zgjeruara vetjake komunale
>
> 4.1 Disa komuna të caktuara në Kosovë do të kenë kompetenca vetjake të zgjeruara si vijon:

[230] Po aty: 24-25
[231] Po aty: 27, 29-30, 32, 36

4.1.1 Komuna e Mitrovicës Veriore do të ketë kompetenca për arsimin e lartë, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, punësimin, pagimin e rrogave dhe trajnimin e drejtuesve dhe administratorëve të arsimit;

4.1.2 Komuna e Mitrovicës Veriore, e Graçanicës dhe e Shtërpcës do të kenë kompetenca për ofrimin e kujdesit shëndetësor sekondar, përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor, punësimin, pagimin e rrogave dhe trajnimin e personelit dhe administratorëve të kujdesit shëndetësor;

4.1.3 Të gjitha komunat në të cilat komuniteti serb është shumicë do të kenë:

a. Autoritetin për ta ushtruar përgjegjësinë për çështje kulturore, duke përfshirë mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë fetare dhe kulturore të serbëve dhe të tjerëve brenda territorit komunal si dhe përkrahjen për komunitetet fetare lokale në pajtim me dispozitat e Aneksit V të kësaj zgjidhjeje;

b. Të drejta të avancuara pjesëmarrëse në zgjedhjen dhe shkarkimin e komandantëve të stacioneve policore, siç përcaktohet në nenin 2.6 të Aneksit VIII të kësaj zgjidhjeje.

4.2 Për sa iu përket këtyre kompetencave të zgjeruara vetjake, Kosova do ta nxjerrë legjislacionin kornizë për të ofruar qasje të barabartë ndaj shërbimeve publike; standarde minimale cilësore dhe sasiore për ofrimin e shërbimeve publike; kualifikime minimale të personelit dhe objekteve të trajnimit; parime të përgjithshme mbi licencimin dhe akreditimin e ofruesve të shërbimeve publike.

4.3 Komunat që zbatojnë kompetencat e zgjeruara vetjake mund të bashkëpunojnë me çdo komunë tjetër për ofrimin e shërbimeve të tilla.[232]

Faza e tretë karakterizohet kryesisht nga përpjekjet e të dërguarit të posaçëm të OKB-së, Martti Ahtisaari, që t'i bindë dhe t'i detyrojë liderët politikë shqiptarë të Kosovës, t'i

[232] Po aty: 25-26

pranojnë të drejtat e zgjeruara për minoritetet në Kosovë, veçanërisht për minoritetin serb. Rrjedhimisht, plani i Ahtisaarit për organizimin e bashkësisë politike në Kosovë, nuk e ka pikënisje modelin kulturor (që parësisht parasheh se përmbajtja e bashkësisë politike duhet të bazohet në gjuhën, kulturën dhe historinë e majoritetit) dhe as modelin qytetar (që parësisht parasheh njohjen/përparësinë e identitetit qytetar mbi identitetet grupore). Por e ka pikënisje modelin multikulturalist, ku bashkësia politike bazohet kryesisht në institucionalizimin dhe mirënjohjen reciproke të grupeve kulturore. E veçanta me këtë plan është se, edhe pse nuk i përcakton shqiptarët komb titullar, të cilët përbëjnë përafërsisht 90 % të popullsisë së Kosovës, nuk e definon Kosovën as si një vend të shqiptarëve të Kosovës, të serbëve të Kosovës dhe të të gjitha komuniteteve të tjera në Kosovë. Madje ky plan e tejkalon edhe modelin multikulturalist sa i përket përcaktimit të të drejtave për minoritetet kombëtare brenda një shteti, në kuptimin se bën dallim në të drejta, në mes minoritetit serb dhe minoriteteve të tjera në Kosovë. Për këtë, nuk mund të fajësohen Martti Ahtisaari, Kai Eide etj., sepse janë përpjekur dhe kanë arritur ta gjejnë zgjidhjen më të mirë të mundshme në kuadër të kontekstit politik të Kosovës. Në fakt, dallimi në të drejta në mes të minoritetit serb dhe minoriteteve të tjera në Kosovë është kryesisht rezultat i dy faktorëve. Nga njëra anë, Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) ende nuk ka arritur të përcaktojë dhe të zbatojë një standard universal për të drejtat e minoriteteve kombëtare, pavarësisht se a ka një minoritet kombëtar në afërsi vendin amë ose jo. Përndryshe, nëse minoritetet kombëtare që kanë në afërsi vendet amë, duhet të kenë të drejta më të veçanta sesa minoritetet e tjera kombëtare (që nuk kanë në afërsi vendet amë, ose që nuk kanë fare vende amë), atëherë të drejtat e njëjta duhet të vlejnë për të gjitha minoritetet kombëtare që kanë në afërsi vendet amë, dhe jo vetëm për një grup të caktuar sikurse rasti i serbëve në Kosovë. Nga ana tjetër, liderët shqiptarë të Kosovës, përveçse nuk janë treguar vigjilentë për t'i parandaluar trazirat e marsit 2004, nuk

janë treguar as paraprakisht (që nga viti 1999) të përgjegjshëm, unikë dhe kreativë për të përpiluar dhe ofruar një platformë serioze negociuese për organizimin e bashkësisë politike në Kosovë në mes të majoritetit shqiptar dhe minoriteteve që nuk bën dallim në të drejta në mes të minoriteteve të tjera dhe minoritetit serb, siç bën dallim plani i Ahtisaarit. Kështu që, delegacioni i shqiptarëve të Kosovës (me shpresën se procesi i negociatave në Vjenë do të rezultojë edhe me njohjen e pavarësisë së Kosovës), nuk ka pasur alternativë tjetër përpos pranimit të drejtave të veçanta për minoritetin serb në Kosovë.

Sidoqoftë, sikur të kishte vullnet të mirë edhe nga minoriteti serb i Kosovës (sikurse nga minoritetet e tjera dhe majoriteti shqiptar në Kosovë), për ta pranuar Planin e Ahtisaarit, si bazë për organizimin e bashkësisë politike në Kosovë, duke e përfshirë pranimin e pavarësisë së Kosovës, kjo do të ishte zgjidhja më e mirë e mundshme. Por kjo zgjidhje është penguar nga qasja destruktive e autoriteteve politike të Beogradit (ende të pashkëputura nga trashëgimia politike e Miloševićit), duke e ushtruar në vazhdimësi ndikimin dhe presionin për kurdisjen politike bojkotuese të serbëve të Kosovës. Në kuadër të këtyre zhvillimeve, pas publikimit të planit të Ahtisaarit, serbët e Kosovës (nën ndikimin dhe presionin e Qeverisë së Beogradit) i bojkotuan edhe zgjedhjet e 17 nëntorit 2007. Ndërsa deputetët shqiptarë dhe deputetët nga radhët e minoriteteve të tjera (joserbe) në Kuvendin e Kosovës, e shpallën pavarësinë e Kosovës më 17 shkurt 2008. Dhe më 7 prill 2008 u hartua Kushtetuta e Kosovës, e cila përfshiu edhe propozimet e Ahtisaarit për të drejtat e veçanta për serbët e Kosovës. Njëkohësisht, Qeveria e Beogradit i mobilizoi të gjitha forcat politiko-diplomatike për ta zhvlerësuar dhe diskreditуar shtetësinë e Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe vazhdoi t'i përdorë si mjet serbët e Kosovës, për të mos lejuar Kosovën të bëhet shtet funksional.

Kosova pas vitit 2008

Të njëjtën ditë që u shpall Pavarësia e Kosovës më 17 shkurt 2008 pati reagime të ashpra në Serbi, madje edhe nga presidenti Boris Tadić, sidomos kryeministri Vojisllav Koštunica, i cili, përveç të tjerash, "akuzoi presidentin e ShBA-së, George W. Bush dhe evropianët që e ndoqën diktatin amerikan për krijimin e shtetit të rrejshëm të Kosovës" dhe, sipas tij, "ShBA-ja dhe këto shtete të Evropës do të shkruhen me shkronja të zeza në historinë e Serbisë si dhe në çdo histori të së drejtës ndërkombëtare", dhe se "nëse ShBA-ja ka arritur ta poshtërojë dhe ta detyrojë UE-në ta ulë kokën dhe t'i shkelë parimet mbi të cilat mbështetej, Serbia nuk do të nënshtrohet". [233] Ky prononcim i kryeministrit serb u shoqërua edhe me masën që u ndërmor nga qeveria e tij për kthimin urgjent të ambasadorit të Serbisë nga Uashingtoni në Beograd dhe se kjo masë do të vlejë edhe për shtetet e tjera që do ta njohin pavarësinë e njëanshme të Kosovës.[234] Në kuadër të reagimeve pati edhe demonstrata në Serbi, madje edhe sulme ndaj përfaqësive diplomatike të ShBA-së, Turqisë, Kroacisë etj., si shprehje e hidhërimit kundër shteteve që kishin njohur apo kishin deklaruar se do ta njihnin pavarësinë e Kosovës. Gjithashtu, nuk munguan reagimet edhe nga qarqe të caktuara të bashkësisë ndërkombëtare siç është shembulli i veçantë i senatorit zviceran Dick Marty, i cili e kritikoi hapur njohjen e shpejtë të pavarësisë së Kosovës nga Zvicra dhe vetëm para pak muajsh më herët për gazetën zvicerane "Tages Anzeiger", kishte rishprehur mllefin e tij ndaj UÇK-së: "Unë nuk mendoj se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka qenë aq e pafajshme"[235]. Kjo nuk ishte ndonjë befasi e madhe ngaqë Dick

[233] B92, BETA, TANJUG, *Srbija poništava nezavisnost* (2008): https://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2008&mm=02&dd=17&nav_category=640&nav_id=285213

[234] Po aty

[235] Ballkaninsight: *Dick Marty, Controversial Investigator* (2010): https://balkaninsight.com/2010/12/16/dick-marty-controversial-investigator/

Marty ishte i njohur më përpara edhe për prononcimet e tij kundër intervenimit të NATO-s në Kosovë.

Rrjedhimisht, siç u sinkronizuan propaganda e regjimit të Miloševićit me disa qarqe të caktuara ndërkombëtare anti-amerikane, kundër UÇK-së dhe kundër intervenimit të NATO-s në Kosovë, ngjashëm tani regjimi i "ri" i Beogradit dhe qarqe të caktuara ndërkombëtare antiamerikane shpalljen e pavarësisë së Kosovës e shihnin si një komplot të bashkëpunimit në mes të ish-strukturave të UÇK-së dhe ShBA-së, (duke përfshirë shtetet evropiane që ndoqën diktatin nga ShBA-ja), me qëllim për ta mbajtur bazën ushtarake amerikane në Kosovë etj. Kjo propagandë bëhej përkundër faktit të ditur botërisht, se lufta e UÇK-së ishte legjitime si mjet i fundit për çlirimin e Kosovës nga regjimi neofashist i Miloševićit dhe shpallja e Pavarësisë së Kosovës ishte vullnet politik i mbi 90 % të qytetarëve të Kosovës. Në këtë vazhdë, regjimi i Beogradit dhe qarqe të caktuara ndërkombëtare antiamerikane e rinisën një fushatë të egër stigmatizuese dhe propaganduese kundër ish-strukturave udhëheqëse të UÇK-së që pas luftës identifikohen kryesisht me parti politike dhe që nga viti 2008 dominojnë në skenën politike të Kosovës. Madje që nga viti 2005 skenës politike të Kosovës iu kishte shtuar edhe subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LV) në krye me ish-sekretarin e përgjithshëm të UÇK-së dhe intelektualin Albin Kurtin. Ndërsa Partia Demokratike e Kosovës (PDK), që ishte themeluar më herët, përkatësisht në vitin 1999, udhëhiqej ende në këtë kohë nga Hashim Thaçi. Gjithashtu, pjesë e skenës politike me trashëgimi nga ish-strukturat e UÇK-së ishin edhe partia Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) e themeluar në vitin 2000, dhe Lëvizja për Bashkim e themeluar në vitin 2007. Kryetari i AAK-së, ish-komandanti i famshëm i UÇK-së, Ramush Haradinaj (pas çlirimit të Kosovës), u ballafaqua me një proces të gjatë gjyqësor në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë në Hagë (ICTY) dhe u lirua më 03 prill 2008. Më herët, nga e njëjta gjykatë, ishte ballafaquar edhe një komandant tjetër i njohur i UÇK-së, Fatmir Limaj, dhe ishte liruar më 30 nëntor

2005. Lirimi i Haradinajt ndodhi vetëm rreth dy javë pas shpalljes së pavarësisë dhe rrjedhimisht ishte një goditje e rëndë për të gjithë ish-kundërshtarët e luftës legjitime të UÇK-së dhe kundërshtarët e pavarësisë së Kosovës, sepse pavarësia e Kosovës në radhë të parë shihej si një fitore e dytë e UÇK-së, pas fitores së parë të UÇK-së, përkatësisht çlirimit të Kosovës. Ndërsa lirimi i Haradinajt shihej si një fitore morale e UÇK-së.

Në kuadër të këtyre zhvillimeve ishte befasues prononcimi i Carla Del Pontes në lidhje me shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Sipas saj, ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Sidomos ishin befasuese supozimet në librin e saj (që u botua vetëm një javë pas lirimit të Haradinajt), që ngërthejnë akuzë të rëndë ndaj disave prej ish-udhëheqësve të UÇK-së. Me fjalë të tjera, Del Ponte, duke e ditur paraprakisht se aktakuza ndaj Haradinajt s'ishte bindëse dhe se Haradinaj do të lirohej, përpiqej, me supozime në librin e saj, të kompensojë mosdënimin e Haradinajt etj. me një "dënim publik" ndaj UÇK-së. Më pastaj këto supozime të Del Pontes u politizuan skajshmërisht nga senatori Dick Marty. Veçanërisht befasuese është se këto supozime e kanë burimin në materialin propagandistik të regjimit të Miloševićit, që paradoksalisht stigmatizon UÇK-në edhe si organizatë terroriste me pikëpamje fondamentaliste islamike, edhe si organizatë marksist-leniniste dhe staliniste, edhe si organizatë kriminale, duke përfshirë akuzën ndaj disa ish-udhëheqësve të UÇK-së, për krimet e përbindshme deri në trafiqe organesh, dhe si udhëheqës të "mafies shqiptare". Në lidhje me këtë propagandë shtetërore të Serbisë, që u vazhdua edhe nga regjimet postmillosheviqiane, dhe që gjeti mbështetje te disa qarqe të caktuara ndërkombëtare antiamerikane, lexuesi mund të informohet më gjerësisht në librin e politologut Bardhyl Mahmuti, *Mashtrimi i madh* (2015), i cili autor, bazuar në dhjetëra libra, qindra artikuj gazetash në gjuhë të ndryshme dhe në mijëra dokumente dhe raporte të institucioneve ndërkombëtare, argumenton me fakte dhe prova se Dick Marty, Carla Del Ponte dhe dhjetëra personalitete të spektrit të majtë dhe të djathtë në Evropë si burim informativ u

mbështetën në materialin propagandistik të shtetit serb. Në vijim, duke u bazuar në këtë libër dhe në burime të tjera relevante, do të shtjellojë shkurtimisht vetëm efektet politiko-juridike të supozimeve të Carla Del Pontes që u politizuan dhe u keqpërdorën skajshmërisht nga Dick Marty etj.

Me rastin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, në një intervistë ekskluzive për "Swissinfo"-s, ish Prokurorja e Përgjithshme në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, Carla Del Ponte deklaroi: "… për mua si juriste - dhe këtu e jap mendimin tim tërësisht profesional - pavarësia e Kosovës nuk më duket aspak në përputhje me dis-pozitat e vendosura nga tradita e të drejtës ndërkombëtare…"[236]. Ndërsa libri i saj autobiografik, "*Përndjekja: unë dhe kriminelët e luftës*" (2008), pati jehonë të madhe në media, veçanërisht për shkak të supozimit për "trafikimin e organeve njerëzore" që gjoja ishte bërë nga udhëheqësit e UÇK-së. Për këtë veprim të Del Pontes pati reagime, madje edhe nga ish-zëdhënësja e Del Pontes, Florence Hartmann, e cila, në një shkrim të publikuar në gazetën zvicerane "Le Temps", të titulluar "Carla Del Ponte dhe thashethemet për trafikimin e organeve në Kosovë", e shprehi habinë e vet se si është e mundshme që "Carla Del Ponte, puna e së cilës konsistonte që të kërkohet e vërteta, përkundër pengesave, dhe në këtë mënyrë të luftohet mohimi dhe manipulimi, sot të na fundosë në kohën më të errët të propagandës". Edhe më befasues ishte fakti se Del Ponte nuk e përmend në librin e saj, se për "trafikimin e organeve njerëzore" është njoftuar nga zyrtarët serbë që i kishin dorëzuar disketën me 27 mijë faqe materiale për krimet e komandantëve të UÇK-së, dhe "Librin e bardhë" në të cilin akuza për "trafikim të organeve njerëzore" përbën njërën nga akuzat e shumta të propagandës serbe. Por kjo gjë u bë

[236] Të gjitha citatet e mëposhtme rreth kësaj çështje janë marrë nga libri "Mashtrimi madh" i autorit Bardhyl Mahmuti. Të interesuarit për saktësinë e burimeve mund t'i verifikojnë në këtë libër, që është edhe në variantin online.

publike nga Nebojša Čović (shef i Qendrës Koordinuese për Serbinë Jugore dhe për Kosovën dhe Metohinë në Qeverinë e Serbisë), i cili, kur e bëri publike se materiali përkatës i është dorëzuar Del Pontes, njëkohësisht shprehi revoltën e tij pse Del Ponte nuk e kishte publikuar librin më herët dhe pse nuk i kishte hapur hetimet për "trafikimin e organeve njerëzore".[237]

Në këtë mënyrë Del Ponte ishte intriguar nga propaganda shtetërore serbe që, në fakt, e ka një traditë të gjatë për t'i stigmatizuar shqiptarët, duke filluar nga periudha e formimit të shteteve kombëtare në Ballkan, kur propaganda serbe i stigmatizonte shqiptarët si "mbeturina të Perandorisë Otomane, që dëshironin ta ruanin praninë e Turqisë në Evropë". Dhe në këtë vazhdë, edhe pas Luftës së Dytë Botërore, në kohën kur Jugosllavia kishte marrëdhënie të mira me Bashkimin Sovjetik, shqiptarët u cilësuan "antikomunistë" dhe "shërbëtorë të nazistëve dhe të fashistëve". Pas prishjes së marrëdhënieve të Jugosllavisë me Bashkimin Sovjetik, shqiptarët akuzoheshin si "stalinistë". Ndërkaq, pas demonstratave të vitit 1981 shqiptarët akuzoheshin si "nacionalistë", si "irredentistë", si "separatistë" etj. Ndërsa në kohën e shpërthimit të luftës së armatosur dhe të shpartallimit të Jugosllavisë federale, "terrorizmi me motive fetare" ishte etiketimi më negativ në kontekstin politik ndërkombëtar. Prandaj, në rrafshin ndërkombëtar, etiketimi i UÇK-së si "organizatë terroriste me pikëpamje fundamentaliste islamike" përbënte një nga shtyllat kryesore propaganduese të Shtabit Strategjik të pushtetit të Miloševićit që kontrollohej drejtpërdrejt prej tij. Në përbërjen e këtij shtabi ishin pjesëtarë të Shërbimit Sekret të Serbisë në krye me ish-shefin e këtij shërbimi, Radomir Marković, që kishin përgatitur materialin propagandistik të titulluar "Libri i bardhë: Terrorizmi i separatistëve shqiptarë në Kosovë dhe në Metohi". Ky libër u botua në gjuhën angleze dhe frënge në shtator të vitit 1998, dhe Ministria e Punëve të Jashtme, e asaj që kishte mbetur nga Jugosllavia, ua shpërndau falas institucioneve me ndikim në

[237] Mahmuti, 2015: 377-378, 384-386, 416, 447, 452-453

marrëdhëniet ndërkombëtare, institucioneve shtetërore të shteteve anëtare të OKB-së, mediave ndërkombëtare, bibliotekave universitare dhe personaliteteve me ndikim në fusha të ndryshme. Më pastaj, në vitin 1999 dhe në vitin 2000, u ribotua versioni i këtij libri ("Libri i bardhë"), dhe në vitin 2001 dhe 2003 u publikua prapë nga regjimi i "ri" i Beogradit, me plotësime dhe modifikime.[238]

Vlen të theksohet se edhe pas ekstradimit të Millošević-it në Hagë në vitin 2001, mbijetuan disa nga ish-strukturat politike të regjimit të tij. Madje edhe Nebojša Čović ishte ngritur në karrierën politike si ish-bashkëpunëtor i Millošević-it në të kaluarën, veçanërisht i paprekur mbeti Shërbimi Sekret (Bezbednosno Informativna Agencia - BIA) dhe për këtë arsye një nga qëllimet kryesore të qeverisë së Zoran Đinđićit ishte reforma e këtij Shërbimi. Por ai u vra më 12 mars 2003 nga strukturat e këtij shërbimi që më herët kishin bërë atentate kundër Ivan Stambolić-it, Vuk Drašković-it, Slavko Ćuruvija-s etj. Për mosreformimin e këtij shërbimi, madje edhe pas vrasjes së kryeministrit Đinđić, dëshmon hulumtimi ekskluziv i gazetarit Dejan Anastasijević për gazetën beogradase "Vreme", i cili alarmoi se, përkundër faktit që "u dëshmua se 15 të akuzuarit për atentatin kundër kryeministrit serb ishin zyrtarë aktivë ose bashkëpunëtorë shumëvjeçarë të BIA-s, Qeveria e Serbisë edhe sot e kësaj dite nuk e sheh të nevojshme të ndryshojë diçka thelbësore në këtë shërbim". Për këtë hulumtim, gati i kushtoi me jetë Anastasijević-it dhe familjes së tij, të cilët i shpëtuan një atentati që u bë ndaj tyre.[239] Kjo dëshmon, përveç të tjerash, se propaganda shtetërore serbe kundër UÇK-së, tashmë edhe kundër pavarësisë së Kosovës, e ka burimin tek ish-strukturat e mbetura politike e sidomos ish-strukturat e shërbimit sekret të Miloševićit. Veçanërisht nëpërmes akuzës së përbindshme për "trafikimin e organeve njerëzore" bëheshin përpjekjet e fundit të dëmtohet imazhi i

[238] Po aty: 400-402
[239] Po aty: 415-417

luftës legjitime të UÇK-së e, bashkë me të, edhe legjitimiteti i pavarësisë së Kosovës. Në fakt, (pas përfundimit të luftës në Kosovë), qasja e regjimit të "ri" të Beogradit në krye me Koštunica-n në raport me shqiptarët, nuk dallonte nga qasja e regjimit të Millošević-it. Edhe pse Koštunica (në cilësinë e ish-presidentit të Jugosllavisë nga tetori 2000 deri në shkurt 2003 kur Jugosllavia u shndërrua në Unionin Serbi - Mali i Zi, dhe në cilësinë e kryeministrit të Serbisë në periudhën 2004-2008), gjithnjë pohonte se Serbia e sotme është demokratike dhe nuk është ajo e Millošević-it. Në lidhje me këtë avokati dhe intelektuali serb Srđa Popović, në një mbledhje të mbajtur në Beograd (pas luftës në Kosovë), është shprehur:

> "Kur Miloševići e solli pushtetin policor në Kosovë, sepse i tillë ka qene ai, një shtet policor, ku mund të vrisje çdo shqiptar, pa u ndëshkuar fare, për të mbijetuar, shqiptarët u detyruan të ndërtojnë një shoqëri paralele. Opozita serbe kurrë, as me një fjalë të vetme nuk iu kundërvu Millošević-it. Dhe mua më ka rënë ndërmend, kur kam dëgjuar Koštunicën para Kombeve të Bashkuara, kur u mundua të sqarojë se Serbia e sotme është një Serbi Demokratike dhe jo Serbia e Millošević-it. Unë mendova se sikur të isha shqiptar duhet të konstatoja se nuk shoh asnjë ndryshim në mes të raporteve të Millošević-it ndaj shqiptarëve dhe të opozitës serbe. Koštunica, ishte, kinse, opozitar i Millošević-it, sepse ai thuajse ishte një komunist, por ai më se paku ishte një komunist. Në fushën e politikës nacionale dhe të luftës, Koštunica ka qenë edhe më radikal se Miloševići. Dhe tani kur e dëgjojnë shqiptarët, ata nuk mund të pranojnë çfarë është duke bërë politikisht në raport me ta, sepse regjimi që ka ardhur pas Millošević-it, veçanërisht politika ndaj shqiptarëve, asgjë më ndryshe se në kohën e Millošević-it. Për mendimin tim, popullata shqiptare ka bërë një luftë çlirimtare. Ajo doli nga një pozicion kolonial, u mbrojt nga një politikë raciste dhe pësoi viktima të tmerrshme. Hakmarrjet e tyre pas luftës nuk mund të jenë të njëjta si ato tonat, por të cilat unë nuk i justifikoj."[240]

[240] Intelektuali serb: *Kosova bëri luftë çlirimtare*… (2020): https://telegramisot.com/intelektuali-serb-kosova-beri-lufte-clirimtare-ndersa-serbia-ka-kryer-gjenocid-te-paster-video/

Veprimi skandaloz i Carla Del Pontes me supozimet për "trafikim të organeve njerëzore" u përdor si pretekst nga të gjitha qarqet që kishin qenë kundër luftës legjitime të UÇK-së, kundër intervenimit të NATO-s dhe tani edhe kundër pavarësisë së Kosovës.

Më 15 prill 2008 Konstantin Kosachev, deputet rus i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, e dorëzoi propozimin për rezolutë në lidhje me "trajtimin çnjerëzor të personave dhe tregtinë ilegale me organet e njerëzve". Deputetët që përkrahën dhe nënshkruan këtë propozim u mbështetën vetëm në librin e Carla del Pontes. Një ditë pas kësaj projektrezolute, delegacioni parlamentar zviceran dhe ai suedez propozuan të hapet debat lidhur me "pasojat e shpalljes së pavarësisë së Kosovës". Gjatë këtij debati, në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës që u zhvillua më 16 prill 2008, një vend të rëndësishëm zuri fjala e Dick Martyt, i cili, përveç të tjerash, i ripërsëriti kundërshtimet e tij për intervenimin e NATO-s, për pavarësimin e Kosovës etj. Çuditërisht, përkundër këtij "neutraliteti" të Dick Martyt, ai u emërua nga Komisioni për Çështje Juridike dhe të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës për ta udhëhequr hulumtimin lidhur me thëniet e Carla Del Pontes për supozimet rreth një "trafiku me organe njerëzore që ishin rrëmbyer nga UÇK-ja". Në këtë vazhdë propaganda e regjimit të Beogradit u mbështet nga disa qarqe të caktuara në botë për shkak të verbërimit nga "antiamerikanizmi" dhe Qeveria e Beogradit e shfrytëzoi rastin të ndërmarrë iniciativën për të gjetur mbështetje në kuadër të OKB-së kundër shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Më 8 tetor 2008, në sesionin e 63 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë, Vuk Jeremić, e paraqiti për miratim një projektrezolutë përmes së cilës kërkohej që kjo asamble të kërkonte mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND) në lidhje me shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Rezoluta u miratua të njëjtën ditë dhe të nesërmen, më 9 tetor, sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki-Moon, ia

dërgoi këtë kërkesë kryetarit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.[241]

Në korrik 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GjND) konstatoi se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk e ka shkelur as të drejtën e përgjithshme ndërkombëtare, as Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit, as Kornizën Kushtetuese të Kosovës dhe asnjë rregull të aplikueshëm të së drejtës ndërkombëtare.[242] Qeveria e Beogradit, edhe pse vetë kishte kërkuar vlerësimin e GjND-së, lidhur me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, s'reflektoi as pas konstatimit të GjND-së se shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte e ligjshme. Përkundrazi, vazhdoi ta mbajë qëndrimin e njëjtë dhe të deklarohet se Serbia kurrë nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës, duke vazhduar me aludime mbi të drejtën historike dhe juridike mbi Kosovën. Në fakt, historiografia serbe, sikurse që ka ngritur argumentet në mënyrë të pabazë për të drejtën historike mbi Kosovën (duke mos qenë e preokupuar aspak për periudhën e para pushtimit dhe sundimit serb të Kosovës, sikur të kishte qenë Kosova një trevë krejtësisht e zbrazur dhe e pabanuar, para invadimit serb në Kosovë). Ngjashëm, në mënyrë të pa bazë, ka ngritur edhe argumentet për të drejtën juridike mbi Kosovën. Por faktet dëshmojnë se Kosova nuk ka qenë kurrë as në kuptimin legal pjesë e Serbisë. Në lidhje me këtë, Malcolm shkruan:

> … ligjërisht, Kosova nuk u inkorporua në Mbretërinë Serbe në vitin 1912. Ajo mbeti territor i okupuar deri ca kohë pas vitit 1918. Pastaj, përfundimisht u inkorporua, jo në një shtet serb, por në një jugosllav. Dhe me një ndërprerje të madhe (Lufta e Dytë Botërore) mbeti pjesë e një lloj shteti jugosllav deri në qershor 2006. Deri në shkatërrimin e Jugosllavisë së vjetër federale nga Miloševići, Kosova kishte një status të dyfishtë. Quhej pjesë e Serbisë, por quhej edhe njësi e federatës. Kjo në kuptimin e dytë, në të gjitha mënyrat praktike, mbizotëroi: Kosova kishte parlamentin dhe qeverinë e saj dhe përfaqësohej drejtpërdrejt në nivelin federal përkrah Serbisë.

[241] Mahmuti, 2015: 386-389

[242] International Court of Justice (2010): 53 : https://www.icj-cij.org/files/case-related/141/141-20100722-ADV-01-00-EN.pdf

> Ishte, në fakt, një nga tetë njësitë e sistemit federal. Pothuajse të gjitha njësitë e tjera janë bërë shtete të pavarura. Historikisht, pavarësia e Kosovës vetëm e kompleton këtë proces. Kështu që, Kosova është bërë një shtet i ish-Jugosllavisë.[243]

Pas konstatimit të GjND-së se shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte e ligjshme, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 9 shtator 2010 e miratoi një rezolutë të sponsorizuar nga 27 vendet e atëhershme të Unionit Evropian (UE) dhe Serbisë, e cila hapi rrugën për nisjen e një dialogu në mes të Serbisë dhe Kosovës. Kjo rezolutë (GA/10980) përshëndeti konstatimin e GJND-së dhe e mirëpriti gatishmërinë e UE-së për ta lehtësuar procesin e dialogut ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, duke theksuar se ky dialog do të shërbejë si faktor i paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon, dhe se do ta promovojë bashkëpunimin, përmirësojë jetën e qytetarëve dhe do t'i ndihmojë të dyja vendet të arrijnë progres në rrugën e tyre drejt Unionit Evropian.[244] Por Qeveria e Beogradit u koncentrua në dy prioritete kryesore me një synim të përbashkët. Nga njëra anë dialogun (negociatat e reja Serbi - Kosovë) e identifikoi si një mundësi të fundit që të insistojë të marrë diçka me shumë nga Kosova, përtej planit të Ahtisaarit, në kuptimin e aneksimit të një pjese të territorit të Kosovës, ose formimin e një Srpska Republike në Kosovë sikurse në Bosnje. Në fakt, grupi ndërkombëtar i krizave (ICG), në raportin e vitit 2009 dhe në këtë vazhdë, edhe në raportin e vitit 2011, paralajmëronte se Qeveria e Beogradit është duke i përdor si një mjet të rëndësishëm serbët që jetojnë në veri të Kosovës për ta minuar pavarësinë e Kosovës[245], dhe se do të vazhdojë ta përdorë

[243] The Guardian (2008): *Is Kosovo Serbia? We ask a historian, Noel Malcolm.* https://amp.theguardian.com/world/2008/feb/26/kosovo.serbia

[244] Organizata e Kombeve të Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme, Rezoluta GA/10980, 9 shtator 2010: https://www.un.org/press/en/2010/ga10980.doc.htm

[245] ICG (2009): Serb integration in Kosovo: Taking The Plunge. EuropeReport N° 200 – 12 May 2009, http://www.crisisgroup.org/~/media/Files/

ndikimin mbi serbët në veri të Kosovës për ta arritur qëllimin kryesor, përkatësisht për ta rimarrë pjesën veriore si një fitore e kufizuar për ta kompensuar humbjen e Kosovës.[246] Nga ana tjetër, nëpërmes propagandës shtetërore kundër UÇK-së, të ndihmuar nga Dick Marty dhe njerëz të tjerë të verbuar nga ideologjia e antiamerikanizmit, Qeveria e Beogradit u përpoq të relativizonte krimet që kishte kryer Serbia ndaj shqiptarëve dhe të tërhiqte vëmendjen në krimet që ia vishte UÇK-së.

Dick Marty, i cili ishte ngarkuar nga Këshilli i Evropës për ta udhëhequr hulumtimin rreth supozimeve të Carla Del Pontes kundër UÇK-së, lidhur me "trafikimin e organeve njerëzore", më 12 dhjetor 2010 e dorëzoi projektraportin për "Trajtimin çnjerëzor të personave dhe trafikimin kundërligjor me organe njerëzore në Kosovë", i cili u miratua unanimisht më 16 dhjetor nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës. Në këtë vazhdë u dorëzua në formën e Rezolutës më 7 janar 2011 dhe u miratua nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës më 25 janar 2011. Meqë Carla Del Pontes i ishin bërë vërejtje të shumta në lidhje me supozimin për "trafikimin e organeve njerëzore" për shkak të vështirësive teknike që paraqiste transportimi i "organeve", madje vërejtje kishte edhe nga specialistë të kirurgjisë, ngaqë Del Ponte, në librin e saj, kishte shkruar se "viktimave që u ishte nxjerrë vetëm njëra veshkë, ishin qepur dhe ishin kthyer në kolibe ku mbaheshin në pritje të shtrohen në tavolinën e operacionit një herë tjetër për t'iu nxjerrë organet e tjera vitale". Dick Marty, duke qenë në dijeni për këtë dhe për t'iu shmangur këtyre vërejtjeve, kishte bërë modifikime në raportin e tij, me qëllim që të përgatisë terrenin për t'u dukur të besueshme supozimet për "trafikimin e

europe/200_serb_integration_in_kosovo___t aking_the_plunge.ashx dhe: http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/kosovo.aspx

[246] ICG (2011): North Kosovo: Dual Sovereignty in Practice. Europe Report N° 211 – 14 March 2011: http://www.crisisgroup.org/~/media/Files/europe/balkans/kosovo/211%20North%20Kosovo%20---%20Dual%20Sovereignty%20in%20Practice.ashx dhe: http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/kosovo.aspx

organeve njerëzore". Njëkohësisht, në këtë raport, përveçse shpreh mllefin dhe stigmatizon UÇK-në, në përputhje të plotë me orientimin propagandistik të regjimit të Miloševićit ("Librin e bardhë") etj. Në pamundësi që të ofrojë dëshmi, pretendon se mbështetet në dëshmitarë porse, sipas tij, dëshmitarët janë të frikësuar të dëshmojnë. Gjithashtu, për mungesë provash kritikon punën e Forcës në Kosovë (KFOR-it), Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-ut), Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX-it), madje edhe Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (ICTY) etj.[247] Edhe pse ICTY kishte bërë përpjekje maksimale, pas ankesës së prokurorisë lidhur me vendimin e 3 prillit 2008 për lirimin e Ramush Haradinajt, urdhëroi në korrik 2010 një rigjykim të pjesshëm kundër Haradinajt etj. Por rezultati qe përsëri në favor të Haradinajt dhe dy komandantëve të tjerë të UÇK-së, të cilët u liruan nga akuzat në nëntor 2012. Përkundër kësaj, për Dick Martyn kjo gjykatë nuk ishte e besueshme, dhe më e besueshme për të ishte propaganda shtetërore serbe që, në fakt, është bazë e raportit të tij dhe që përpiqet ta fshehë, madje edhe duke i maskuar burimet. Në lidhje me këtë maskim të burimeve, autori i librit *Mashtrimi i madh*, Bardhyl Mahmuti, shkruan:

> "Për t'u dalluar nga burimi i vërtetë i informatave, në raportin 'e vet' ai nuk e inkorporoi skemën organizative që kishte publikuar Shërbimi Sekret Serb për 'Grupin e Drenicës', edhe pse ishin kopjuar me besnikëri të plotë të gjitha thëniet e 'Librit të Bardhë'. Emrat, mbiemrat, lidhjet e tyre dhe llojet e veprimtarive kriminale që u vishen personave të apostrofuar nga Shërbimi Sekret Serb u kopjuan tërësisht nga Dick Marty. Është interesante të theksohet se përmes referimeve në 'degët' e një 'lumi informatash', autorët e raportit në fjalë përpiqen ta fshehin 'plagjiaturën' për burimin e vërtetë të 'informatave' ('Libri i Bardhë'). Në funksion të kësaj fshehjeje, Dick Marty deklaroi me mburrje se gjatë 'hulumtimit' të tij ai ishte mbështetur 'në shërbimet e informimit të NATO-s dhe të katër shteteve'. Por, së paku, një nga këta katër shërbime të inteligjencës, ku pretendon të jetë mbështetur Dick Marty, e pranon

[247] Mahmuti 2015: 458, 461-463, 468, 471-472

> se është bazuar në të dhënat e ofruara nga Shërbimi Sekret Serb. Në raportin e Shërbimit Sekret të Gjermanisë (BND-së), në faqen 14, pika 2.2.1, thuhet qartë se burim informate ishte Shërbimi Sekret Serb (BIA)" (Mahmuti 2015: 466).

Në kuadër të këtij konteksti të ri të krijuar pas miratimit të raportit të Dick Martyt, diplomacia serbe u rimobilizua për t'i paraqitur serbët si "viktima" të luftës në Kosovë. Në seancën e 16 shkurtit 2011 të Këshillit të Sigurimit, ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë, Vuk Jeremić, shtroi kërkesën për krijimin e një mekanizmi të drejtësisë që do të merrej me krimet e supozuara nga Dick Marty. Këtë kërkesë, Jeremići vazhdoi ta përsërit, përveç të tjerash, në letrën që i dërgoi sekretarit të përgjithshëm të OKB-së më 19 prill 2011 dhe në seancën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së më 12 maj 2011. Në fakt, që nga Rezoluta 1782 e Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Evropës askush s'e kundërshtoi domosdoshmërinë e hetimeve për të ndriçuar supozime të tilla, përfshirë përfaqësuesit e përhershëm të shteteve anëtare të Këshillit të Sigurimit të OKB-së e deri te ministrat e Punëve të Jashtme të Serbisë dhe të Kosovës. Kundërshtitë u shfaqën kur duhej të përcaktohej se nën mandatin e cilit institucion duhej të zhvilloheshin hetimet. Ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë, Vuk Jeremić, theksoi se gjoja "EULEX-i nuk ishte i kualifikuar për të zhvilluar hetime të tilla sepse mandati i tij nuk e lejonte të zhvillonte hetime jashtë Kosovës" dhe këmbëngulte që "OKB-ja të krijojë një mekanizëm hetimi ad hoc e që do t'i përgjigjej vetëm Këshillit të Sigurimit". Edhe shtetet që nuk e njihnin pavarësinë e Kosovës, sidomos Rusia dhe Kina, kërkonin që mandatin ta ketë OKB-ja. Ndërsa Franca, Anglia dhe ShBA-ja ishin të mendimit që hetimet të zhvilloheshin nga EULEX-i. Në këtë vazhdë, në përputhje me Rezolutën 1782 të Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Evropës, John Clint Williamson u emërua shef i TASK Forcës Speciale të EULEX-it (TFHS), për t'i udhëhequr hetimet lidhur me thëniet për tregti me organe

njerëzore. Williamson, përveç të tjerash, ka qenë shef i Departmentit të Drejtësisë dhe të Drejtave të Njeriut të UNMIK-ut gjatë periudhës 2001-2002. Dhe është i njohur edhe për bashkëpunimin që ka pasur me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë. Madje një zyrtar i kësaj ministrie, Vladimir Božović, deklaronte se kishin pasur bashkëpunim të mirë me Williamsonin-in, dhe "ishte shumë i kënaqur me punën e tij" [248]

TFHS zhvilloi dy vjet e gjysmë hetime të hollësishme dhe gjatë kësaj periudhe u ndihmua nga prokurorët, hetuesit, oficerët ligjorë, analistët dhe specialistë të tjerë, nga 18 shtete të BE-së, Kanadasë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Madje edhe nga Qeveria e Serbisë, e veçanërisht nga kryeprokurori serb për krimet e luftës, Vladimir Vukčević.[249] Pas këtyre hetimeve, kryeprokurori i TFHS-së, Williamson, në deklaratën e tij më 29 korrik 2014, për pretendimet e Dick Martyt në lidhje me "trafikimin e organeve", deklaroi se për t'i ndjekur veprat e tilla penale:

> "… duhet një nivel provash që ende nuk i kemi siguruar. Mirëpo, kjo nuk do të thotë që këto prova nuk do të materializohen dhe sigurisht ne do të vazhdojmë t'i kërkojmë ato. Kështu, në asnjë mënyrë nuk e kemi hedhur poshtë vërtetësinë e këtyre pretendimeve. Megjithëse unë ende nuk e ndiej se ka bazë mjaft të fortë të provave për të ardhur te përfundimi se mund të ngrihet aktakuza në lidhje me këtë aspekt të lëndës…."[250]

Çuditërisht, Williamsoni vazhdoi të mos e mbyllë këtë çështje edhe pas dy vjet e gjysmë hetimesh të hollësishme të TFHS-së. Në fakt, gjithsej 15 vjet hetimesh, që nga sajimi në Beograd, i akuzës së përbindshme për "trafikimin e organeve njerëzore nga UÇK-ja". Për më tepër, Williamsoni, tashmë i gjendur nën

[248] Po aty: 475-477

[249] Statement of the Chief Prosecutor of the Special Investigative Task Force 29 July 2014: 6 http://recom.link/wp-content/uploads/2014/07/Download-full-statement-here.pdf

[250] Po aty: 3

një presion enorm politiko-propagandistik kundër UÇK-së, dhe në mungesë provash që të përgatisë një aktakuzë për "trafikim organesh", e orientoi hetimin e TFHS-së në drejtim tjetër:

> "Edhe pse nuk ka qenë përgjegjësia jonë kryesore, ne e kemi ndier për detyrim të fortë të bëjmë gjithçka që kemi mundur për të mësuar për fatin e njerëzve që u zhdukën në vitet 1998 dhe 1999 dhe vendndodhjet e të cilëve ende nuk dihen. Për fat të keq, deri tani ne kemi sjellë vetëm pak informata që do të na drejtonin në vendet ku ishin varrosur trupat ose që do ta ndriçonin fatin e atyre të cilët u zhdukën (…). Pavarësisht nga këto vështirësi, ne besojmë se TFHS-ja do të jetë në gjendje të ngrejë një aktakuzë kundër zyrtarëve të lartë të caktuar të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Këta individë mbajnë përgjegjësinë për fushatën e persekutimit që ishte drejtuar kundër popullsive serbe, rome dhe pakicave të tjera në Kosovë si dhe kundër bashkëkombësve shqiptarë të Kosovës gjatë viteve 1998 dhe 1999, të cilët i etiketuan si bashkëpunëtorë të serbëve…".[251]

Edhe pse me akuzat për krime lufte të supozuara se janë kryer nga pala shqiptare janë marrë paraprakisht UNMIK-u, EULEX-i, ICTY etj., pas kësaj deklarate të Williamsonit pasoi një fushatë për ta bindur Qeverinë e Kosovës që të formohet një mekanizëm i drejtësisë për t'u marrë me supozimet për këto krime. Kërkohej që të themelohej një gjykatë që do të jetë e vendosur jashtë Kosovës, me të punësuar nga jokosovarët, me arsyetimin për ta lehtësuar mbrojtjen e dëshmitarëve dhe mbrojtjen ndaj korrupsionit dhe ndërhyrjeve politike. Në këtë vazhdë pati kundërshtime në Kuvendin e Kosovës dhe nga struktura të tjera të shoqërisë në Kosovë. Konsiderohej se një gjykatë e tillë kishte qasje "raciste" dhe pyetjet më të shpeshta që shtroheshin ishin se: A do të gjykohen vetëm shqiptarët e Kosovës apo të gjithë qytetarët, pavarësisht prej përkatësisë etnike? Kush do të merret me krimet dhe masakrat serbe ndaj shqiptarëve të Kosovës? Megjithëkëtë, pas presionit të rritur ndërkombëtar, Kuvendi i Kosovës u detyrua ta miratojë nenin 162 të Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjin për Dhomat e

[251] Po aty: 1-2

Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Përkatësisht, në gusht 2015 u miratua ligji për themelimin e të ashtuquajturës Gjykata Speciale.

Gjatë këtij procesi deri te themelimi i Gjykatës Speciale ishte befasuese dhe zhgënjyese sjellja e kryeministrit Hashim Thaçi i cili nuk tregoi gatishmërinë e duhur të kundërpërgjigjet ndaj supozimeve të ngritura nga Carla Del Ponte kundër UÇK-së lidhur me "trafikimin e organeve njerëzore". Dhe kur këto supozime i politizoi edhe më shumë, senatori zviceran Dick Marty, sidomos kur pas dy vjetësh e gjysmë hetimesh sistematike të TFHS-së nuk rezultuan të vërteta supozimet e Carla Del Pontes dhe pretendimet e Dick Martyt (të bazuara në propagandën e shtetit serb), lidhur me akuzën e përbindshme për "trafikimin e organeve njerëzore". Në fakt, pasi që shefi i TFHS-ës, Williamson, në deklaratën e tij më 29 korrik 2014, në mungesë të provave për trafikim organesh, i orientoi hetimet në një drejtim tjetër, në këtë vazhdë Kuvendi i Kosovës, veçanërisht kryeministri Hashim Thaçi, nuk duhej ta pranonin krijimin e një gjykate që ka në shënjestër vetëm palën shqiptare, por të insistojnë për krijimin e një gjykate, ku procedohen krimet shtetërore serbe të luftës në Kosovë dhe rastet e supozuara të hakmarrjeve të shqiptarëve si individë në fazën përfundimtare të luftës në Kosovë në vitin 1999. Ky mosreflektim i Hashim Thaçit, duke i përfshirë edhe këshilltarët e tij, nuk mund të kuptohet ndryshe pos pjesërisht si mungesë e dijes së mjaftueshme për procesin politiko-juridik që rezultoi me themelimin e Gjykatës Speciale dhe pjesërisht si shpërfillje e këtij procesi politiko-juridik nga vetë Hashim Thaçi, duke e konsideruar veten se është i paprekshëm dhe më i rëndësishëm se edhe vetë UÇK-ja dhe se edhe vetë Kosova. Njëkohësisht, Hashim Thaçi me deklarimet e tij të pamatura e dëmtonte imazhin e UÇK-së. Madje në një intervistë për "Euro News" në vitin 2014, duke u përpjekur të distancohet nga lufta e UÇK-

së, u shpreh: "Kam qenë larg nga frontet e luftës".[252] Dhe përkundër se ishte më i shënjestruari, bazuar në supozimet e Carla Del Pontes, pretendimet e Dick Martyt dhe tashmë edhe nga Gjykata Speciale, insistonte të bëhet gjithsesi edhe president i Kosovës, duke mos u brengosur fare se një president me imazh të keq e dëmton edhe imazhin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Në këtë vazhdë, më 26 shkurt 2016, pas dështimit në dy raunde për t'i marrë votat e mjaftueshme në Kuvend për t'u zgjedhur president i Kosovës, u kap nga kamerat televizive duke e urdhëruar me gjeste partnerin e tij të koalicionit, kryetarin e LDK-së, Isa Mustafa, për t'i siguruar votat e nevojshme në Kuvend, dhe në raundin e tretë të votimit arriti të zgjidhet president i Kosovës. Gjithashtu, në cilësinë e udhëheqësit të negociatave nga pala e Kosovës (në dialogun e nisur në vitin 2010, në mes të Kosovës dhe Serbisë), nuk i ka dhënë llogari të duhur as Kuvendit të Kosovës dhe asnjë institucioni tjetër në Kosovë në lidhje me ecurinë konkrete të këtyre negociatave. Për më tepër, në kuadër të këtyre negociatave ka pranuar një marrëveshje për formimin e një lloj asociacioni shtesë (përtej pakos së Ahtisaarit) për komunat me shumicë serbe në Kosovë, nëpërmes të cilit shteti serb, në krye me ish-ministrin e Informatave në Qeverinë e Miloševićit, tani president i Serbisë, Aleksandar Vučić, etj., përpiqet ta krijojë bazën për një "Republika Serpska" në Kosovë sikurse në Bosnjë. Kjo formë e asociacionit rezultoi të jetë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës bazuar edhe në vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, e cila konstatoi se: "Parimet për Asociacionin/Bashkësinë e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë nuk janë në përputhje me kushtetutën".[253] Megjithëkëtë, pranimi i marrëveshjes për këtë formë të

[252] Telegrafi.com (2014: *Thaçi në Euronews: Kam qenë larg nga frontet e luftës*:https://telegrafi.com/thaci-ne-euronews-kam-qene-larg-nga-frontet-e-luftes/

[253] New Perspektiva (2015): *Parimet për AKS-në nuk janë në përputhje me kushtetutën, thotë Gjykata*: https://www.new-perspektiva.com/sq/parimet-per-aks-ne-nuk-jane-ne-perputhje-kushtetuten-thote-gjykata/

asociacionit nga Hashim Thaçi (i mbështetur në këtë proces negociues edhe nga kryetari i LDK-së, Isa Mustafa), dhe krijimi i Gjykatës Speciale, si e tillë, që ka në shënjestër vetëm palën shqiptare, përveç të tjerash, e kanë dobësuar pozicionin e Kosovës në negociatat me Serbinë.

Gjykata Speciale me të vërtetë është shumë speciale. Thuhet se dallon nga ish-Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (ICTY), duke u cilësuar si gjykatë hibride. Por, njëkohësisht, dallon më shumë nga gjykatat hibride që janë zbatuar në Timorin Lindor, Bosnjë-Hercegovinë, Kamboxhia, duke përfshirë "Regulloren 64 - kolegjet penale të UNMIKU-t" në Kosovë (si pararendës të EULEX-it) etj., ngaqë karakteristikë e përgjithshme e gjykatave hibride është kombinimi i ligjit vendor dhe ndërkombëtar dhe përbërja e stafit ku gjyqtarët ndërkombëtarë, prokurorët dhe ekspertët punojnë me homologët e tyre vendorë, ndërsa Gjykata Speciale nuk e ka stafin gjyqësor të kombinuar me vendorët dhe, sa i përket kombinimit të ligjit vendor me ndërkombëtar, ka të bëjë vetëm me institucionalizimin simbolik/formal të kësaj gjykate brenda sistemit të drejtësisë së Kosovës, bazuar në Kushtetutën e Kosovës, nenin 162. Me fjalë të tjera, kjo gjykatë është në thelb e pavarur dhe e ndarë nga sistemi gjyqësor i Kosovës, duke përfshirë edhe Kushtetutën e Kosovës, në kuptimin se nuk ka ndonjë ndërveprim me ligjet e Kosovës sepse, përveçse nuk financohet nga Kosova, dhe e ka selinë jashtë Kosovës (në Hagë), është njëkohësisht mbizotëruese ndaj ligjeve të Kosovës. Sipas ligjit të kësaj gjykate, përveç të tjerash, nenit 3.4, thuhet: "Çdo ligj, rregullore, rregullore dytësore, rregull ose zakon tjetër dhe praktikë e Kosovës, që nuk janë përfshirë shprehimisht në këtë ligj, nuk zbatohen për organizimin, administrimin, funksionet apo juridiksionin e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Ky ligj mbizotëron mbi çdo dispozitë kundërthënëse të çfarëdo ligji

apo rregulloreje tjetër".[254] Ndërsa neni 10.1 përcakton se: "Brenda juridiksionit lëndor të tyre, Dhomat e Specializuara kanë përparësi mbi të gjitha gjykatat e tjera të Kosovës".[255] Me fjalë të tjera, emërimi, shkarkimi i gjyqtarëve dhe i prokurorëve, procedurat disiplinore, rregullat administrative etj., të kësaj gjykate janë tërësisht jashtë kontrollit të Kosovës. Gjithashtu, stafi i kësaj gjykate, përveçse gëzon të drejtën të lidhë marrëveshje ndërkombëtare, gëzon edhe imunitetin dhe privilegjet që janë të përcaktuara në nenin 52.1, ku thuhet: "Statusi, privilegjet dhe imunitetet që i kanë zyrat dhe personeli i EULEX Kosova, sipas Ligjit nr. 03/L-033 për statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike dhe konsullore në Republikën e Kosovës dhe personelit ndërkombëtar ushtarak, shtrihet për objektet, pronën, dokumentet dhe personelin e Dhomave të Specializuara dhe Prokurorinë e Specializuar në Kosovë".[256] Për më tepër, Kosova nuk ka qasje në dokumentet dhe arkivin e kësaj gjykate. Në lidhje me këtë në nenin 62.1 thuhet: "Duke i pasur parasysh rrethanat e sigurisë dhe privatësisë, dokumentet, letrat, të dhënat dhe arkivat e Dhomave të Specializuara, Zyrës së Regjistrimit dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar nuk konsiderohen dokumente publike të Kosovës. E drejta e përgjithshme për të pasur qasje në të dhënat apo arkivat e Dhomave të Specializuara, përfshirë të Zyrës së Regjistrimit dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, nuk ekziston".[257] Rrjedhimisht, Gjykata Speciale nuk është gjykatë vendore, por është në thelb gjykatë ndërkombëtare, njëkohësisht selektive, duke qenë e drejtuar vetëm kundër palës shqiptare. A nënkupton kjo se qarqe të caktuara kundër UÇK-së, kundër intervenimit të NATO-s, dhe kundër pavarësisë së Kosovës, me qëllimin për ta rehabilituar historinë e re politike të shtetit serb, kanë ndikuar me presione

[254] Ligji nr. 05/L-053: Për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (2015): f. 2 : https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11036
[255] Po aty: 4
[256] Po aty: 33
[257] Po aty: 38

politiko-propagandistike në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, për ta krijuar bindjen dhe terrenin se gjithsesi duhet themeluar një gjykatë që dënon/sakrifikon ndonjë ish-komandant/ish-udhëheqës të UÇK-së, për ta sinonimizuar me Miloševićin, në mënyrë që së paku simbolikisht të barazohet krimi? Megjithëkëtë, Williamson në kuadër të deklaratës së tij më 29 korrik 2014 ka insistuar se nuk është në shënjestër UÇK-ja si tërësi, por individët brenda grupeve të veçanta dhe as nuk është qëllimi për ta rishkruar historinë:

> "Në përmbyllje, unë dua ta nënvizoj këtë pikë të rëndësishme. Disa, për të mbrojtur veten, janë përpjekur ta portretizojnë këtë hetim si një sulm ndaj luftës së Kosovës për liri ose ndaj UÇK-së si një organizatë. Shumë kosovarë iu bashkuan UÇK-së me qëllimet më të mira dhe ata kundërshtuan kriminalitetin e shfrenuar që shfaqej pas luftës (…). Kështu që, duhet të jetë e qartë se ky hetim dhe çdo akuzë që vjen nga ai janë të drejtuara ndaj veprimeve kriminale të individëve brenda grupeve të veçanta, dhe jo ndaj UÇK-së si një tërësi. Dhe as nuk është një përpjekje për ta rishkruar historinë, siç disa janë përpjekur ta paraqesin këtë. Unë kam qenë në Kosovë më 1998 dhe 1999 dhe kam mbikëqyrur hetimin pasues nga ICTY për krime të kryera nga serbët gjatë asaj periudhe, duke bashkautorizuar aktakuzën fillestare kundër Slobodan Milošević-it dhe të tjerët për krimet e drejtuara kundër viktimave shqiptare të Kosovës. Kam pasur një rol udhëheqës në zhvarrosjet e varreve masive që ndodhën në verën e vitit 1999, ku u gjetën trupat e mijëra viktimave shqiptare të Kosovës. Kam shkuar në vendngjarje të shumta krimesh në të gjithë Kosovën dhe kam kaluar shumë orë duke folur me viktimat dhe me familjarët e atyre që kanë të zhdukur ose të vrarë. Kështu që, nga përfshirja ime shumë e drejtpërdrejtë, e kuptoj qartë se çfarë ka ndodhur në Kosovë në vitet që çuan deri në luftën në 1999 dhe në vetë luftën".[258]

Por a e ka kuptuar plotësisht Williamsoni se çfarë ka ndodhur në Kosovë deri në vitin 1999, pas okupimit të Kosovës nga Serbia në vitin 1912, ku nga njëra anë politika e shtetit serb, e

[258] Statement of the Chief Prosecutor of the Special Investigative Task Force 29 July 2014: 7 http://recom.link/wp-content/uploads/2014/07/Download-full-statement-here.pdf

bazuar në projektin *Naçertanje*, në krye me Nikola Pašićin, Vaso Čubrilovićin, Aleksandar Rankovićin, Slobodan Miloševićin etj., në mënyrë të organizuar shtetërore (nëpërmes programeve fashiste shtetërore për dëbimin dhe zhdukjen e shqiptarëve, duke përfshirë kolonizimin e Kosovës), në vazhdimësi i ka vrarë, masakruar, dëbuar, burgosur, persekutuar dhe diskriminuar shqiptarët. Nga ana tjetër, Lëvizja Kombëtare Shqiptare për Çlirimin e Kosovës prej vitit 1912, që kulmoi me UÇK-në, ishte përpjekje e vazhdueshme çlirimtare, me program të qartë çlirimtar kundër politikës shtetërore fashiste serbe, dhe jo kundër popullsisë civile serbe. Me fjalë të tjera, Williamsoni dhe çdokush tjetër duhet ta ketë të qartë se në harkun kohor 1912-1999 krimet dhe shtypja kundër shqiptarëve, të organizuara dhe të zbatuara në mënyrë sistematike nga politika shtetërore serbe, nuk mund të krahasohen dhe barazohen me ndonjë hakmarrje individuale në kohë dhe hapësirë nga shqiptarët si individë, kryesisht për shkak se u është marrë toka, u janë vrarë, masakruar ose dhunuar familjarët e të ngjashme. Dhe sa i përket mendimit të Williamsonit, që shpreh në fund të deklaratës së tij, më 29 korrik 2014, se: "Pa marrë parasysh se cilat janë rrethanat që çuan në atë konflikt, megjithatë nuk ka asgjë që justifikon targetimin e qëllimshëm ndaj individëve të pafajshëm"[259] Vlen të theksohet se askush nga pala shqiptare nuk justifikon vrasjet e civilëve të pafajshëm, duke përfshirë edhe rastet eventuale të hakmarrjeve të shqiptarëve si individë, në fazën përfundimtare të luftës në Kosovë në vitin 1999. Por kjo duhet të bazohet në fakte dhe prova të qëndrueshme dhe jo të bazohet në propagandën e Milošević-it, duke e hiperbolizuar këtë fenomen dhe duke iu atribuuar ekskluzivisht UÇK-së për ta diskreditуar si organizatë çlirimtare.

Kur do të përgjigjet shteti serb për krimet në Kosovë? Kur do të ndriçohet fati i mbi 1600 civilëve shqiptarë të vrarë nga forcat serbe, për të cilët edhe pas më shumë se dy dekadave shteti serb vazhdon me logjikën e fshehjes së gjurmëve të krimit, dhe kur

[259] Po aty: 7

do t'i nxjerrë shteti serb para drejtësisë të gjithë ata që zbatuan dhunën seksuale si formë krimi të luftës ndaj mbi 20 000 femrave shqiptare në Kosovë? Kur do t'i dëmshpërblejë shteti serb viktimat e krimit dhe riparimin e dëmeve të luftës, dhe kur do t'ia kthejë Kosovës pasurinë dhe fondet e plaçkitura? Nuk duhet harruar, (pa u thelluar në histori deri në vitin 1912), se vetëm në periudhën 1998-'99 u vranë rreth 10 mijë shqiptarë civilë, u masakruan qindra shqiptarë, u përdhunuan mijëra gra, u deportuan rreth një milion shqiptarë, u dogjën dhe u shkatërruan rreth 100 mijë shtëpi etj. Rrjedhimisht, lind pyetja vetvetiu, pse në vend të Gjykatës Speciale nuk u iniciua themelimi i një gjykate ku procedohen krimet shtetërore serbe me përmasa gjenocidiale dhe, gjithashtu, rastet e supozuara të hakmarrjeve të shqiptarëve si individë? Një gjykatë e tillë, përveçse do të kishte qenë në pikënisje e drejtë, gjithashtu do të shërbente për reflektim dhe pajtim. Prandaj, edhe nëse nuk e vëmë në dyshim "qëllimin e mirë për drejtësi" të Williamsonit, inicimi për themelimin e një gjykate në thelb "ndërkombëtare" që ka në shënjestër vetëm palën shqiptare, është në pikënisje i padrejtë. Sepse një gjykatë e tillë identifikohet më shumë si instrument në shërbim të propagandës shtetërore serbe dhe përkrahësve të saj në botë, që si qëllim parësor ka barazimin e krimit dhe rehabilitimin e historisë politike të shtetit serb.

Por, në fund të fundit, edhe nëse ky presion dhe ndikim i propagandës shtetërore serbe dhe përkrahësve të saj në botë, e arrin qëllimin e vet që nëpërmes kësaj gjykate të dënohet ndonjëri nga ish-komandantët/ish-udhëheqësit e UÇK-së, kjo gjykatë nuk mund t'i diskreditojë as heronjtë dhe dëshmorët e UÇK-së, as luftën e drejtë dhe legjitime të UÇK-së si mjet i fundit për çlirimin e Kosovës nga regjimi neofashist i Miloševićit, dhe as frymëzuesit emblematikë, themeluesit emblematikë dhe komandantët emblematikë të UÇK-së: Adem Demaçin, Metush Krasniqin, Ukshin Hotin, Jusuf Gërvallën, Kadri Zekën, Bardhosh Gërvallën, Rexhep Malën, Nuhi Berishën, Afrim Zhitinë, Bahri Fazliun, Ahmet Haxhiun, Xhavit Hazirin, Bejadin Hallaqin, Adem, Hamzë dhe Shaban

Jasharin, Zahir Pajazitin, Edmond Hoxhën, Hakif Zejnullahun, Luan Haradinajn, Adrian Krasniqin etj. Të gjithë të sipërpërmendurit, përveç Adem Demaçit, vdiqën si pasojë e vrasjeve dhe torturave në ballafaqim me strukturat policore dhe ushtarake të regjimeve të Beogradit. Ndërsa Adem Demaçi, me urdhër të regjimeve të Beogradit, u mbajt në burg plot 28 vjet, por qëndroi stoik në burg dhe pas daljes nga burgu më 1990, duke rezultuar në simbolin e rezistencës kombëtare dhe i të drejtave të njeriut (fitues i çmimit Sakharov), në këtë vazhdë edhe në cilësinë e përfaqësuesit të përgjithshëm politik të UÇK-së. Prandaj, Gjykata Speciale, edhe po të dojë, nuk mund ta diskreditojë rolin historik dhe imazhin çlirimtar të UÇK-së, por efektet anësore të ekzistencës së kësaj gjykate mund të kenë ndikuar negativisht në një mënyrë të tërthortë, për ta dobësuar pozicionin negociues të palës shqiptare në dialogun Kosovë - Serbi që filloi në vitin 2010. Në kuptimin e përdorimit të kësaj gjykate si mjet, për kërcënimin e tërthortë dhe eventualisht për shantazhin e tërthortë ndaj presidentit të Kosovës, Hashim Thaçit, i cili, faktikisht, si personi më i sulmuar në raportin e Dick Martyt, do të duhej të tërhiqej nga të gjitha pozitat udhëheqëse të Kosovës, sidomos pas themelimit të Gjykatës Speciale në gusht 2015.

Pas kërkesës së Qeverisë së Beogradit, që të bëhet vlerësimi i shpalljes së pavarësisë së Kosovës nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GjND), dhe pas konstatimit të kësaj gjykate se shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte e ligjshme, në vend se t'i bëhej presioni i duhur Serbisë (për ta njohur pavarësinë e Kosovës), 27 shtete të Unionit Evropian (UE), plus Serbia, e sponsoruan rezolutën, e cila u miratua nga OKB-ja më 9 shtator 2010 dhe përcaktoi nisjen e një dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë nën regjimin e UE-së, duke rezultuar fillimisht si dialog teknik. Më pastaj, nga fundviti 2012 u shndërrua në dialog politik, i karakterizuar në vazhdimësi nga mungesa e transparencës dhe llogaridhënies. Në fundvitet 2010, ShBA-ja u përfshi më shumë në dialogun Kosovë - Serbi dhe, në këtë vazhdë, u paracaktua një takim i rëndësishëm më 27.06.2020

në Shtëpinë e Bardhë në ShBA, në mes të delegacionit të Kosovës në krye me presidentin Hashim Thaçi dhe delegacionit të Serbisë në krye me presidentin Aleksandar Vučić. Madje përflitej se gjatë këtij takimi është e mundshme të nënshkruhet një marrëveshje përfundimtare dhe historike në mes të Serbisë dhe Kosovës. Por vetëm tri ditë para këtij takimi, më 24.06.2020, prokurori i Gjykatës Speciale e bëri publik propozimin e tij për aktakuzën ndaj presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe disa ish-komandantëve/ish-udhëheqësve të tjerë të UÇK-së, që ndikoi që të anulohet takimi në Shtëpinë e Bardhë. Megjithëkëtë, ky takim u realizua pas rreth dy muajsh në Shtëpinë e Bardhë, përkatësisht më 4 shtator 2020, në mes të presidentit të ShBA-së, Donald Trump, presidentit të Serbisë AleksandarVučić dhe kryeministrit të Kosovës Avdullah Hoti. Por, rezultati i takimit nuk ishte ai që pritej pas rreth 10 vjetësh negociata sepse nuk u arrit një marrëveshje përfundimtare dhe historike, që kryesisht nënkupton njohjen reciproke në mes të Serbisë dhe Kosovës.

Në fakt, ky takim në Shtëpinë e Bardhë rezultoi me katër dokumente të nënshkruara, përkatësisht dy letra të nënshkruara nga presidenti Trump, njëra drejtuar kryeministrit Hoti, tjetra drejtuar presidentit Vučić, një tekst i nënshkruar nga kryeministri Hoti me titullin "Normalizimi ekonomik" dhe një tekst tjetër me përmbajtje pothuajse të njëjtë i nënshkruar nga presidenti Vučić.[260] Në aspektin përmbajtjesor, kjo marrëveshje ka shpërputhje të konsiderueshme me titullin e dokumentit "Normalizimi ekonomik" ngaqë një pjesë e konsiderueshme e tekstit nuk ka asnjë lidhje me ekonominë, madje disa prej pasuseve nuk kanë asnjë lidhje as me zhvillimet në rajon. Ndërsa në aspektin e marrëdhënieve ndërkombëtare mund të kualifikohet si marrëveshje joformale dhe juridikisht jodetyruese midis palëve (marrëveshje gjentelmene) sepse, duke marrë parasysh se këto tekste dhe letrat e presidentit Trump nuk janë

[260] Lajmi.net (04 shator 2020): *Dokument: Kjo është marrëveshja Kosovë - Serbi*: https://lajmi.net/dokument-kjo-eshte-marreveshja-kosove-serbi/

marrëveshje ndërkombëtare dhe ndërshtetërore, nuk mund të dërgohen në parlamentet respektive për ratifikim dhe nuk kanë konsekuenca legale dhe obligime ligjore.

Është shpresuar se dialogu i zhvilluar rreth 10 vjet mund të determinojë një marrëveshje përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë, me njohje reciproke që siguron dhe forcon paqen në rajon. Por kjo nuk ndodhi për shkak të refuzimit të vazhdueshëm të Serbisë që ta njohë pavarësinë e Kosovës, por edhe për shkak të mënyrës së dobët dhe në vazhdimësi jotransparente të negocimit nga pala shqiptare e Kosovës në krye me Hashim Thaçin etj., veçanërisht për shkak të mosinsistimit të mjaftueshëm të UE-së (si fasilitatori kryesor në vazhdimësi i këtyre negociatave), për të bindur/detyruar Serbinë ta njohë Pavarësinë e Kosovës si alternativën e vetme për paqen e qëndrueshme në rajon dhe normalizimin e plotë të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Megjithëkëtë, mbetet të shpresohet se në një të ardhme të afërt do të ndodhë një marrëveshje përfundimtare në mes të Serbisë dhe Kosovës, që kryesisht bazohet në konstatimin e GjND-së (se pavarësimi i Kosovës është në përputhje me të Drejtën Ndërkombëtare) dhe në Planin e Ahtisaarit. Në këtë vazhdë, plani i Ahtisaarit nuk duhet të mbetet një shembull i izoluar që vlen vetëm për Kosovën, por një shembull që shërben si referencë edhe për rajonin dhe më gjerë, për organizimin/ri-organizimin më të drejtë të bashkësive politike në mes të majoritetit dhe minoriteteve sepse, siç ka thënë Gandi: "Një komb tregon shkallën e qytetërimit të tij në mënyrën se si i trajton minoritetet".

Përfundim

Shikuar nga këndvështrimi qoftë i qasjes teorike etnosimboliste, qoftë i qasjes teorike moderniste, nuk ka qenë e mundur të organizohet përmbajtja e bashkësisë politike në Kosovë në kuptimin e një identiteti kombëtar kosovar pasi që për etnosimbolistët si Smith etj., parakusht i rëndësishëm për ngritjen e identitetit kombëtar është prania e trashëgimisë së përbashkët kulturore e bazuar në mitet, kujtimet dhe simbolet e përbashkëta. E në rastin e organizimit të bashkësisë politike në Kosovë, nuk ka qenë e pranishme një trashëgimi e tillë e përbashkët kulturore që do të mund të bashkidentifikonte /gjithëpërfshinte majoritetin shqiptar, minoritetin serb dhe minoritetet e tjera në Kosovë. Në këtë kuadër, edhe pse kriteri i modernistëve për trashëgiminë e përbashkët kulturore është më i ulët sesa kriteri i etnosimbolistëve, nuk ka qenë e mundur të zbatohet në rastin e organizimit të përmbajtjes së bashkësisë politike në Kosovë. Për shembull, pikënisja teorike e Gellnerit, për ngritjen e 'kulturës së madhe' (kulturës kombëtare) bazuar në një gjuhë të përbashkët (bashkësinë e përbashkët gjuhësore) dhe në sistemin e përgjithshëm dhe të standardizuar arsimor, nuk ka mundur të shërbejë si pikënisje për organizimin e përmbajtjes së bashkësisë politike në Kosovë sepse s'ka pasur gjasë që minoriteti serb, majoriteti shqiptar dhe minoritetet e tjera në Kosovë të pajtohen për një gjuhë të vetme, ose eventualisht t'i zëvendësojnë gjuhët e tyre me një gjuhë të vetme, që do të shërbente edhe për konsolidimin e një sistemi të përbashkët dhe të standardizuar arsimor në nivel të Kosovës, si bazë për ngritjen e një identiteti kombëtar kosovar. Ngjashëm edhe Anderson parasheh ngritjen e bashkësisë së imagjinuar (kombit) nëpërmes një bashkësie komunikuese të bazuar në gjuhën e përbashkët. Por vlen të saktësohet se Anderson me përkufizimin e tij për kombet si bashkësi të imagjinuara, i jep më shumë rëndësi dimensionit subjektiv sesa dimensionit objektiv të kombit, kështu që kriteri i tij për gjuhën është më shumë veçori funksionale sesa veçori përkufizuese e kombit.

Kjo nënkupton se veçoria përkufizuese e kombit është në radhë të parë korniza e referencave të përbashkëta brenda një bashkësie të imagjinuar që vlen edhe për bashkësitë e imagjinuara shumëgjuhëshe, për shembull sikurse rasti i kombit zviceran. Madje Anderson është eksplicit në lidhje me këtë kur shprehet: "Në një botë në të cilën shteti kombëtar është normë dërrmuese, e gjithë kjo do të thotë se kombet tani mund të imagjinohen pa bashkësinë gjuhësore" (Anderson 2006: 135). Megjithëkëtë, në rastin e organizimit të përmbajtjes së bashkësisë politike në Kosovë, nuk ka pasur gjasë të arrihet pajtueshmëria në mes të minoritetit serb, majoritetit shqiptar dhe minoriteteve të tjera në Kosovë për ndërtimin e një kornize me referenca të përbashkëta nëpërmes arsimimit të standardizuar etj. Gjithashtu, edhe pikënisja teorike e Hobsbawmit, në lidhje me ngritjen e identitetit kombëtar nëpërmes shpikjes së traditave të përbashkëta, nuk ka qenë e mundur të zbatohet, në kuptimin shpikjes së traditave të përbashkëta që bashkidentifikojnë/gjithëpërfshijnë, sidomos që pranohen bashkërisht nga minoriteti serb, majoriteti shqiptar dhe minoritetet e tjera në Kosovë. Edhe pse historia e shqiptarëve dhe e serbëve në Kosovë nuk është krejtësisht bardh e zi, madje ka edhe raste kur shqiptarët dhe serbët kanë luftuar së bashku kundër armiqve të përbashkët, për shembull gjatë betejës së Kosovës (1389) kundër Perandorisë Osmane, gjatë Luftës së Dytë Botërore kundër nazifashistëve etj.

Shikuar edhe nga këndvështrimi praktik, nuk ka qenë i mundur organizimi i përmbajtjes së bashkësisë politike në Kosovë, në kuptimin e një identiteti kombëtar kosovar sepse, përveç të tjerash, shqiptarët e Kosovës përgjatë pothuajse më shumë se gjysmës së kufirit të tyre, kufizohen me shqiptarët në Shqipëri, me shqiptarët në Maqedoni, me shqiptarët në Serbi dhe me shqiptarët në Mal të Zi. Gjithashtu, një pjesë e serbëve të Kosovës kufizohen me serbët në Serbi. Dhe, për më tepër, as kombi serb si tërësi dhe as kombi shqiptar si tërësi nuk kanë pësuar qarje brendakombëtare në të kaluarën, të tilla siç është shembulli i kombit bullgar etj., nga i cili ka rezultuar kombi

"bullgar-maqedonas" ose kombi "maqedonas-bullgar" në Maqedoninë e Veriut. E gjithë kjo e vështirëson edhe praktikisht ngritjen e një identiteti kombëtar kosovar në mes të minoritetit serb, majoritetit shqiptar dhe minoriteteve të tjera në Kosovë. Prandaj, marrë parasysh aspektin teorik dhe praktik, dhe kontekstin historiko-politik të Kosovës në përgjithësi, mundësia e vetme reale për organizimin e bashkësisë politike në Kosovë ka qenë modeli multikulturalist (ku bashkësia politike bazohet kryesisht në institucionalizimin dhe mirënjohjen reciproke të grupeve kulturore), që rezultoi edhe me planin e Martti Ahtisaarit. Në fakt, plani i Ahtisaarit e tejkalon modelin multikulturalist për organizimin e bashkësive politike sepse, përveç të tjerash, edhe pse nuk i përcakton komb titullar shqiptarët, të cilët përbëjnë përafërsisht 90 % të popullsisë së Kosovës, nuk e definon Kosovën as si një vend të shqiptarëve të Kosovës, të serbëve të Kosovës dhe i të gjitha komuniteteve të tjera në Kosovë.

Sidoqoftë, nuk është krejtësisht e pamundshme ngritja e një identiteti kosovar, me një nivel të përbashkët të patriotizmit shtetëror. Në kuptimin e një identiteti që në një mënyrë ose tjetër arrin deri në një masë ta ushqejë identitetin kombëtar të majoritetit shqiptar, identitetin kombëtar të minoritetit serb dhe të minoriteteve të tjera në Kosovë. Me fjalë të tjera, një identitet shtetëror që mirënjeh, respekton dhe promovon trashëgiminë kulturore ilire-dardane të shqiptarëve të Kosovës që nga antikiteti, dhe trashëgiminë kulturore kishtare të serbëve të Kosovës që nga Mesjeta (që njëkohësisht është edhe trashëgimi kulturore e shqiptarëve të Kosovës) dhe trashëgimitë kulturore të minoriteteve të tjera në Kosovë. Në këtë kuadër, siç siguron Plani i Ahtisaarit, që shkollat në gjuhën serbe në Kosovë të kenë të drejtën të zbatojnë planprograme apo tekste shkollore të hartuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë, edhe shqiptarët (bazuar në parimin e reciprocitetit) duhet të kenë të drejtën për konsolidimin e një planprogrami të përbashkët arsimor pavarësisht prej kufijve politikë, duke përfshirë konsolidimin e një akademie të shkencave dhe të arteve të

përbashkët. Gjithashtu, siç i siguron plani i Ahtisaarit, Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë (përfshirë manastiret, kishat dhe objektet e tjera që shfrytëzohen për qëllime fetare), që të kenë mirënjohje të plotë si pjesë integrale e Kishës Ortodokse Serbe në Beograd. Edhe shqiptarët, pavarësisht prej kufijve politikë, duhet të kenë të drejtën për institucionalizimin e një Këshilli Kombëtar Ndërfetar Gjithëshqiptar, i përbërë nga përfaqësuesi i kishës kombëtare ortodokse gjithëshqiptare, nga përfaqësuesi i xhamisë kombëtare islame gjithëshqiptare dhe nga përfaqësuesi i katolicizmit gjithëshqiptar. Kjo ka rëndësi të veçantë sepse shqiptarët, për shkak të rrethanave historike, ndikimeve dhe okupimeve perandorake që nga antikiteti, u ndan në disa fe të ndryshme dhe nuk arritën të formësojnë një institucion të përbashkët fetar. Megjithëkëtë, me stoicizëm arritën ta ruajnë vazhdimësinë etnolinguistike dhe gjatë epokës së nacionalizmit arritën të konsolidohen si komb etnolinguistik me një tolerancë dhe harmoni unike ndërfetare. Me fjalë të tjera, ideologët dhe agjitatorët e kombformimit shqiptar që nga fillimvitet 1800 deri në vitin 1912 (gjatë fazës a, b dhe hyrjes në fazën c të kombformimit shqiptar), arritën ta shndërrojnë tolerancën dhe harmoninë ndërfetare shqiptare në një kulturë patriotike, por s'arritën ta formalizojnë institucionalisht. Ndërsa shtetarët si mbreti Zog, Enver Hoxha etj., edhe pse arritën t'i zhdukin (më pak ose më shumë) tribalizmat dhe disa prapambeturi të tjera në dobi të integrimit brendakombëtar shqiptar (në kuadër të fazës c), nuk e patën vizionin e duhur që ta institucionalizojnë tolerancën dhe harmoninë ndërfetare shqiptare për ta kultivuar paralelisht me procesin e integrimit brendakombëtar shqiptar. Madje Enver Hoxha me metodat e tij të dhunshme (duke dalë edhe në ekstreme qesharake, duke e shpallur Shqipërinë shtet ateist) jo vetëm se nuk e institucionalizoi tolerancën dhe harmoninë ndërfetare shqiptare, por me metodat e tij krijoi vetëm efekte perverse - afatshkurtra. Rrjedhimisht, nga njëra anë toleranca dhe harmonia ndërfetare shqiptare është pasuri unike e kombit shqiptar, dhe e dallon kombin shqiptar nga kombet e tjera konservative

të Ballkanit që e kanë fenë kriter inkludues dhe ekskludues kombëtar. Nga ana tjetër, mosinstitucionalizimi i tolerancës dhe harmonisë ndërfetare shqiptare ka ndikuar që kombi shqiptar të mbetet i brishtë në aspektin fetar. Prandaj vetëm një Këshill Kombëtar Ndërfetar Gjithëshqiptar si institucion do të mund të sigurojë dhe kultivojë në plan afatgjatë tolerancën dhe harmoninë ndërfetare brendakombëtare të shqiptarëve, t'i mbrojë vlerat e mirëfillta fetare dhe, duke u distancuar publikisht nga çdo lloj ekstremizmi fetar, do të mund t'i dobësojë/ delegjitimojë bazat e ekstremizmit fetar në praktikë. Shikuar nga kjo perspektivë, vlen të theksohet se sa i përket një bashkimi eventual kombëtar të shqiptarëve në të ardhmen, nuk pretendohet për një bashkim klasik kombëtar (edhe pse shqiptarët përbëjnë 90 % të popullatës në Kosovë), në kuptimin e ndryshimit të kufijve dhe unifikimit të parlamenteve Kosovë - Shqipëri etj. Por, mjaftohet, për shembull, me një president simbolik të përbashkët, që në rrotacion mund të zgjidhet nga parlamentet përkatëse Kosovë dhe Shqipëri, me mandat të caktuar pesëvjeçar dhe/ose simbolika të tjera të ngjashme.

Plani i Ahtisaarit, përveç propozimeve për organizimin e brendshëm të bashkësisë politike në Kosovë, përfshiu edhe propozimin për njohjen ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës si zgjidhje e drejtë dhe që kontribuon për stabilitetin politik në Ballkan. Në këtë vazhdë, më 17 shkurt 2008 Kuvendi i Kosovës e shpalli pavarësinë e Kosovës, ndërsa në korrik 2010 Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë konstatoi se shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte e ligjshme dhe në përputhje me të Drejtën Ndërkombëtare. Kjo ishte një dëshmi se kërkesa e vazhdueshme e shqiptarëve për republikë dhe pavarësi të Kosovës ka qenë legjitime. Në fakt, shpallja e Pavarësisë së Republikës së Kosovës më 17 shkurt 2008 ishte rishpallje. Përkatësisht rikonfirmim i shpalljes së parë të Republikës së Kosovës në demonstratat masive të vitit 1981 që rezultuan si një referendum popullor për Republikën e Kosovës dhe, gjithashtu, rikonfirmim i shpalljes së Pavarësisë së Kosovës më 2 korrik 1990. Këto tri akte historike drejt pavarësimit të plotë të

Kosovës janë komplementare (edhe pse nuk mund të jenë të barasvlershme) me shpalljen e autonomisë së Shqipërisë nga Lidhja e Prizrenit 1878 dhe me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor 1912, që si dy akte historike më të rëndësishme gjithëkombëtare, e përfshijnë edhe Kosovën me vise.

Krejt në fund vlen të theksohet se mënyra e akomodimit e të drejtave për minoritetet në Kosovë, e bazuar në Planin e Ahtisaarit, nuk duhet të mbetet një shembull i izoluar, sepse pa respektimin e parimit të reciprocitetit për të drejtat e minoriteteve në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe më gjerë nuk mund të ketë paqe të qëndrueshme në Ballkan. Prandaj, parimi i reciprocitetit për të drejtat e minoriteteve duhet të jetë një ndër parimet bazë në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë të nisur në vitin 2010. Përndryshe, ky dialog ka qenë dhe është një test i rëndësishëm për politikën e jashtme të Unionit Evropian (UE), që tradicionalisht nuk është treguar mjaftueshëm efektiv dhe parimor për zgjidhjen e konflikteve etnike në ish-Jugosllavi sepse që nga fillimvitet '90, kur Jugosllavinë e kaploi kriza e përgjithshme politike, UE (që atëherë quhej Bashkimi Evropian - BE), ishte fillimisht kundër shpërbërjes së Jugosllavisë. Por pasi që shpërbërja e Jugosllavisë u bë e pashmangshme, UE u përcaktua pro njohjes së pavarësisë për njësitë federative (republikat) duke përfshirë garantimin e të drejtave për minoritetet brenda këtyre njësive federative. Për dallim nga republikat e tjera (Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia dhe Mali i Zi), vetëm Serbia ishte kategorikisht kundër kësaj qasje të UE-së, duke vënë kushte se shkëputja e republikave mund të ndodhë vetëm nëse territoret e banuara kryesisht me serbë etnikë do të mbeten brenda Jugosllavisë së cunguar që, në fakt, nënkuptonte qëllimin për ta konstituuar Serbinë e Madhe. Për këtë qëllim, Serbia përdori Armatën Jugosllave të cilën e kontrollonte dhe e nisi agresionin luftarak kundër të tjerëve, madje edhe me përmasa gjenocidiale në Bosnjë dhe më pastaj edhe në Kosovë. Dhe përkundër kësaj qasjeje agresive dhe destruktive të Serbisë,

në Konferencën e Dejtonit (1994) u vendos që rreth 30 % të serbëve në Bosnjë-Hercegovinë ta kenë republikën e tyre, e njohur me emrin Srpska Republika. Por ky kriter nuk vlen ende për rreth 30 % të shqiptarëve në Maqedoni, për themelimin e Republikës Shqiptare në Maqedoni sikurse Srpska Republika në Bosnje. Gjithashtu, gjatë negociatave në Vjenë për statusin e Kosovës, që rezultoi me planin e Ahtisaarit, u vendos që rreth vetëm 5 % të serbëve të Kosovës t'i kenë të garantuara të drejtat për minoritetet me standardet më të larta si në nivel qendror, po ashtu edhe në nivelin lokal. Por ky kriter nuk vlen ende për minoritetin shqiptar në Serbi etj. Rrjedhimisht është hipokrizi të trumbetohet paqja e qëndrueshme në Ballkan, e sidomos në mes të serbëve dhe shqiptarëve, përderisa nuk insistohet për respektimin e parimit të reciprocitetit në lidhje me të drejtat e minoritetit shqiptar në Serbi dhe të minoritetit serb në Kosovë etj. Gjithashtu, është hipokrizi që parimi për përfaqësimin e minoriteteve në parlament, që përfshinë edhe minoritetet që nuk kufizohen me vendet amë, ose që nuk kanë fare vende amë, për shembull sikurse minoriteti romë etj., të vlen si parim vetëm në Kosovë si shembull i izoluar (bazuar në planin e Ahtisaarit). Dhe ende ky parim i drejtë nuk vlen për Serbinë që ka një numër më të madh të romëve sesa në Kosovë, ose për Rumaninë që ka një numër edhe më të madh të romëve sesa në Serbi dhe që njëkohësisht është edhe shtet anëtar i UE-së etj.

E gjithë kjo është tregues se sa i domosdoshëm është formulimi dhe respektimi i një standardi universal për të drejtat e minoriteteve kombëtare pa marrë parasysh se a kufizohen apo jo minoritetet kombëtare me vendin amë ose nëse kanë ose jo vende amë. Mungesa e një standardi të tillë është veçanërisht sfiduese për raportin ndërshtetëror në mes të Serbisë dhe Kosovës dhe rasteve të ngjashme. Megjithëkëtë, në këso raste duket qartë se ka vetëm dy mënyra si zgjidhje për minoritetet që garanton paqen dhe që duhet dhe mund të realizohet vetëm në mënyrë paqësore nëpërmes marrëveshjeve ndërshtetërore që garantohen nga mekanizmat përkatës ndërkombëtarë. Zgjidhja e parë nënkupton respektimin e parimit të reciprocitetit për të

drejtat e minoriteteve, ndërsa zgjidhja e dytë nënkupton modifikimin e kufijve politikë në bazë të vijave etnike, në kuptimin se aty ku minoritetet kufizohen gjeografikisht (janë të ngjitura në kufij) me vendet eksterne amë, t'u bashkohen vendeve amë. Kjo nuk nënkupton krijimin e shteteve krejtësisht homogjene kombëtare, pa minoritete, sepse krijimi i shteteve krejtësisht homogjene kombëtare pa minoritete nuk është as i drejtë dhe as i nevojshëm. Por kjo nënkupton zhdukjen e problemit të separatizmit dhe irredentizmit dhe, rrjedhimisht, zhdukjen e potencialit të konfliktit ndërshtetëror, i karakterizuar nga minoritetet që kufizohen gjeografikisht (që janë ngjitur në kufij), me vendet eksterne amë, që gjithnjë politizohen nga vendet eksterne amë, dhe që nuk heqin dorë nga seperatizmi dhe irredentizmi.

Zgjidhja e parë është më e drejtë, njëkohësisht presupozon një nivel të vullnetit të mirë për bashkëjetesë (në mes të majoritetit dhe minoriteteve - përkatësisht pjesëtarëve të një minoriteti që kufizohet gjeografikisht me vendin ekstern amë), në kuadër të hapësirave politike/shteteve në Ballkan. Dhe kjo është më e mundshme nëse respektohet parimi i reciprocitetit në mes të shteteve në lidhje me të drejtat e minoriteteve. Prandaj, përgjegjësia morale dhe politike e UE-së, ShBA-së dhe e elitave në Ballkan është angazhimi për paqe të qëndrueshme dhe fqinjësi të mirë. Barazia kombëtare dhe respektimi i parimit të reciprocitetit për të drejtat për minoritetet, përveçse është i drejtë, është edhe i domosdoshëm për paqe dhe për stabilitet sepse ende jetojmë në epokën e nacionalizmit dhe (pavarësisht se a e konsiderojmë nacionalizmin si "aksident historik" apo si proces historik drejt organizimit më të avancuar të shoqërisë njerëzore), kemi obligim moral dhe politik ta interpretojmë nacionalizmin në mënyrën më konstruktive të mundshme: si përpjekje për barazi dhe respekt të ndërsjellë me të tjerët dhe jo si urrejtje ndaj të tjerëve.

PASTHËNIE

Nisur nga fakti se objektiviteti është një ndër qëllimet e rëndësishme të shkencës, para se të filloja ta shkruaja këtë libër në lidhje me kombformimin dhe përpjekjet e shqiptarëve për liri dhe barazi, e kisha një dilemë se sa do të mund të jem objektiv. Duke e marrë parasysh ndjeshmërinë e temës të këtij libri dhe subjektivitetin që bart unë me vete, veçanërisht si pjesë e një trashëgimie familjare që në vazhdimësi ka qenë e angazhuar në përpjekjet e shqiptarëve për liri dhe barazi, nga babai im Rexhep Ujkani, gjyshi Ujkan Haziri, stërgjyshi Hazir Selmani e në këtë vazhdë, Selman Uka, Ukë Osmani, Osman Leka, deri te Lekë Gjeka, emrin e të cilit e mbaj mbiemër me krenari.

Lekë Gjeka, së bashku me babanë e vet, Gjekë Prenin (i njohur edhe si Gjekë Stanishi - Rugovalia), dhe vëllezërit e tij, Dedën, Lucen dhe Palin, para rreth 350 vjetësh organizuan rezistencën e parë në Rugovë kundër ekspeditave të Perandorisë Osmane, përkatësisht në fshatin Koshutan të trevës së Rugovës. Që nga kjo kohë pasardhësit e kësaj vëllazërie (Dedës, Lekës, Lucës dhe Palit), e njohur si vëllazëria Muriqi e fisit Kelmend, e fshatit Koshutan të Rugovës, në vazhdimësi kanë dhënë disa ndër figurat e rëndësishme në kuadër të përpjekjeve të shqiptarëve për liri dhe barazi, përveç të tjerëve: Sali Jahën (pjesëtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit), Zhuj Selmanin, Kajë Galën, Kadri Bajrin, Sadik Ramën, Rizë Zymerin, Sak Faslinë dhe shumë të tjerë, deri në çlirimin e Kosovës në vitin 1999. E, gjithashtu, bazuar në vijën trashëguese nga gjyshja ime (nëna e babait tim) Shkurte Haxhaj - Hoti, bijë e familjes së bajraktarit të Hotit të Kujit, Alush Smajl Hotit, i cili është i mirënjohur si kushtrimdhënësi i betejës së Nokshiqit (1879), si një ndër betejat më të fuqishme të shqiptarëve nën udhëheqjen e Ali Pashë Gucisë, kundër copëtimit të territoreve shqiptare.[261]

[261] Fazli Sh. Muriqi - alias Bajraktari (2016): *Koshutani heorik i Rugovës kreshnike*, f. 5-10, 36. Shih edhe Fazli Sh. Muriqi - alias Bajraktari (2018): *Osman-lekajt e Koshutanit*, f. 5-8, 15-16, 24, 37, 46, 110-113, 115-126, 128-129

Duke përfshirë bashkëfamiljarët e nënës sime, Hasnije Feratit, përkatësisht Feratajt e Gucisë, të nënfisit Bokeqi, të Hotit.[262] Përveç të tjerëve, gjyshi im Ramë Ferati u plagos në luftën e Çeremit më 28. 02. 1913. Ndërsa, bazuar edhe në aktgjykimet nga arkivi, të publikuara në librin e historianit Zekeria Cana, *Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar 1912-1913 (dokumente),* rezulton se dy kushërinjtë e Ramë Feratit, pjesëmarrës në luftën e Çeremit, An Jakup Ferati dhe Medi Omer Ferati, pasi që u arrestuan, u dënuan me vdekje. Kurse vëllai i Medit, Hysi dhe djali i Hysit, Jonuzi, e vazhduan rezistencën në kuadër të Lëvizjes Kaçake[263]. Prandaj, për ta shmangur tërësisht ose së paku, për ta zvogëluar sa më shumë subjektivitetin tim dhe duke marrë parasysh ndjeshmërinë e temës së këtij libri, jam bazuar kryesisht në burimet e autorëve të huaj meqë konsiderohen burime më neutrale, madje në disa raste të domosdoshme edhe duke i cituar drejtpërdrejt, përfshirë pjesërisht përdorimin e dokumenteve të cilësuara si burime primare dhe burime të tjera relevante - plotësuese.

Në aspektin metodologjik e kam përdorur qasjen teoriko-interpretuese si pjesë e studimeve kualitative, përkatësisht si pjesë e të ashtuquajturit rast studimor ose studim i rastit (case study), që zakonisht përdoret edhe në veprimtarinë kërkimore të shkencës politike.

Për të sqaruar në një mënyrë më koncize statusin e rastit studimor, në kuadër të veprimtarisë kërkimore të shkencës politike, fillimisht duhet nënvizuar faktin se metodologjia e shkencës politike qëndron në mes të idealeve të shkencave natyrore, në kuptimin e përqendrimit në observime të matshme për t'i zbuluar lidhjet kausale dhe për t'i kuptuar ligjet natyrore nëpërmes testimit të teorive, bazuar në metodën deduktive, dhe

[262] As. prof. dr. Kahreman Ulqini (2016): *Si u formua Krahina Malësi e Madhe?*: https://zanimalsise.com/si-u-formua-krahina-malesi-e-madhe/ Shih edhe prof. Riza Gruda (2021): *Prejardhja e banorëve të Plavë-Gucisë*... https://www.plavgusinje.me/2019/12/porijeklo-stanovnistva-plava-i-gusinja.html?m=1&fbclid=IwAR18_OGB_muG-bf3KI9norpQGfPpJqdVJpE1vpR2x7l-f2myZxNdej8tuPY

[263] Cana 1996: 163-164, 174-176

idealeve të shkencave humane, në kuptimin e përqendrimit të të kuptuarit dhe interpretuarit të ngjarjeve dhe individëve, bazuar në metodën hermeneutike ose në metodën induktive.

Tradicionalisht, rasti studimor qëndron më afër shkencave humane, ku studiuesi është më shumë i shqetësuar për veçantinë dhe thellësinë sesa për gjerësinë dhe testimin teorik. Kështu që, në veprimtarinë kërkimore të shkencës politike nuk ka konsensus të plotë sa i përket mundësisë së përdorimit të rastit studimor edhe për testimin e hipotezave/teorive. Për shembull, studiuesi amerikan John Gerring është më pak optimist dhe konsideron se rasti studimor është më i përshtatshëm për pjesën eksploruese të kërkimit, përkatësisht për zhvillimin e nocioneve/koncepteve, hipotezave/teorive.[264] Me fjalë të tjera, konsiderohet se vetëm studimet kuantitative që kanë pikënisjen e tyre në traditën e shkencave natyrore janë të përshtatshme për t'i testuar hipotezat dhe teoritë. Ndërsa studiues të tjerë sikurse, për shembull, studiuesi norvegjez Svein Andersen dhe studiuesi amerikan Robert Yin, janë më optimistë dhe konsiderojnë se rasti studimor, përveçse mund të përdoret për t'i zhvilluar nocionet/konceptet, hipotezat/ teoritë, mund të përdoret edhe për testimin e hipotezave/ teorive. Andersen e paraqet një kategorizim të pesë llojeve të rastit studimor, varësisht prej ambicies teorike të studiuesit. Kategoria e parë është qasja a-teorike, e cila qëndron afër formës më tradicionale të rastit studimor dhe nënkupton studimin e një fenomeni thjesht për shkak të vlerës së brendshme të fenomenit, pa përdorimin e teorisë. Kategoria e dytë është qasja teoriko-interpretuese, e cila merr pikënisje në një kornizë teorish dhe konceptesh për të realizuar një rast studimor. Kategoria e tretë e rastit studimor nënkupton zhvillimin e nocioneve/koncepteve të reja të cilët rezultojnë shpesh si biprodukt që, për shembull, e përshkruajnë një grup, mënyrën specifike në të cilën grupi ndërvepron ose aspekte specifike të ekzistencës së grupit. Nocionet/konceptet

[264] Gerring 2004: 349

e Max Weberit (tipit ideal) mbi burokracinë, është një shembull i mirë për këtë. Gjithashtu, studimi i Robert Michelsit për ligjin e hekurt të oligarkisë, i cili është shembull i rastit studimor për zhvillim të nocioneve/koncepteve, por edhe shembull i rastit studimor për zhvillim teorik, që rrjedhimisht hyn edhe në kategorinë e katërt. Pra, kategoria e katërt është rasti studimor për zhvillimin teorik që, gjithashtu, është një formë klasike e përdorimit të rastit studimor. Në kuptimin e një lloj studimi paraprak brenda një fushe formësohen hipotezat dhe teoritë që mund të testohen më sistematikisht në kontekste të tjera. Ndërsa kategoria e pestë nënkupton se rasti studimor mund të shërbejë edhe për testimin e hipotezave/teorive.[265] Sipas Yinit, edhe pse rasti studimor nuk ka fuqinë e reprezentimit statistikor, megjithëkëtë, nëse rasti studimor përzgjidhet sa më me mençur-i, ka përfaqësim analitik, në kuptimin që kur një rast studimor riparaqet një rast studimi kritik, atëherë mund të shërbejë që të vërtetojë, të çvërtetojë, të zgjerojë ose të sfidojë një teori të përkufizuar empirikisht.[266]

Kategoria e parë, qasja a-teorike e rastit studimor, është më pak e rëndësishme ngaqë mungesa teorike është problematike në kuadër të shkencave shoqërore, posaçërisht në kuadër të shkencës politike. Politologët nuk janë të shqetësuar vetëm me studimin e vlerës së brendshme të fenomeneve, por edhe me studimin e fenomeneve që potencialisht kanë një vlerë të përgjithshme. Kështu që, përveç kategorisë së parë, katër kategoritë e tjera që Anderseni paraqet janë të rëndësishme në kuadër të veprimtarisë kërkimore të shkencës politike sepse më pak dhe më shumë kontribuojnë për të vendosur një rast studimor në kuadër të një konteksti më të gjerë.

Përdorimi i qasjes teoriko-interpretuese si metodë në këtë libër renditet në kategorinë e dytë, përkatësisht në atë që Andersen e cilëson rast studimor teoriko-interpretues, ku merret pikënisje në një kornizë teorish dhe konceptesh për të realizuar një studim.

[265] Andersen 2010: 61-86
[266] Yin 2009: 15, 47

Rrjedhimisht, duke marrë pikënisje në një kornizë teorish dhe konceptesh, dhe duke u bazuar kryesisht në burimet e autorëve të huaj, pjesërisht edhe në dokumente dhe burime të tjera plotësuese. Qëllimi im me këtë libër është që të hidhet më shumë dritë, sa më objektivisht, sistematikisht dhe të përmbledhur, mbi procesin e kombformimit dhe përpjekjet e shqiptarëve për liri dhe barazi.

BIBLIOGRAFIA:

Librat:

Anthony D. Smith (2008): *Nationalism; Theory, Ideology, History*. Cambridge Polity Press.
Anthony D. Smith (2006): *Nationalism and Modernism*. Oxon Routledge.
Alex J. Bellamy (2003): *The formation of Croatian nacional identity*. Manchester University Press.
Benedict Anderson (2006): *Imagined Communities*. Verso.
Bedri Islami & Ibrahim Kelmendi (2012): *Lëvizja, lindje e përgjakur: bashkëbisedim me Ibrahim Kelmendin*. Tetovë: Tringa Design.
Berit Backer (2003): *Behind the stone walls: changing household organization am ong the albanians of Kosova*. Dukagjini Balkan Books.
Bardh Hamzaj (1999): *Rrëfimi për luftën dhe lirinë (dialog me komandantin Ramush Haradinaj)*. Prishtinë: Drita press.
Bardhyl Mahmuti (2015): *Mashtrimi i madh*. Çabej.
Didie Zhylia (1994): *Fjalor i Filozofisë*. Tiranë: Shtëpia Botuese Enciklopedike.
Ernest Gellner (1998): *Nasjonalisme*. Spartacus Forlag.
Ernest Gellner ((2006): *Nations and Nationalism*. Black well Publishing Ltd.
Eric Hobsbawm & Terence Ranger (2012): *The Invention of Tradition*. Cambridge University Press.
Eric Hobsbawm (2012): *Nations and Nationalism since 1780*. Cambridge University Press.
Edwin Jacques (1995): *Shqiptarët: Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*. Shtëpia Botuese "Kartë e Pendë".
Fazli Sh. Muriqi - Alias Bajraktari (2016): *Koshutani heroik i Rugovës kreshnike*. Shtypshkronja Dukagjini, Pejë.
Fazli Sh. Muriqi - Alias Bajraktari (2018): *Osman - Lekajt e Koshutanit* (Monografi). Shtypshkronja Dukagjini, Pejë.
Florian Bieber &Židas Daskalovski (2003): *Understanding the War in Kosovo*. Routledge.
Historia Popullit Shqiptar II (2002): *Rilindja Kombëtare, vitet '30 të shek. XIX-1912*. Botimet Toena.
John Gerring (2004): *What is a Case Study and What is it Good for?* American Political Science Review: Kopisamling.
John Rawls (1999): *A Theory of Justice*. Cambridge: Harvard University Press.
John Stuart Mill (1972): *Considerations on Representative Government, in Utilitarianism, Liberty, Representative Goverment*, ed. H. Acton (J. M. Dent, London).

Janusz Bugajski (2006): *Ngritja e Kosovës; artikuj dhe fjalime nga okupimi deri te pavarësia.* Prishtinë: KOHA.
Jakup Krasniqi (2010): *Kosova në kontekst historik.* Prishtinë: Gjon Buzuku.
Kristo Frashëri (2005): *Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke në shek. XV*. Tiranë: Botimet Toena.
Kenneth Anderson (1990): *Yugoslavia: Crisis in Kosovo*. International Helsinki Federation and Human RightsWatch, New York.
Liman Rushiti (2016): *Lëvizja Kaçake në Kosovë (1918-1928).* Instituti i Historisë "Ali Hadri", Prishtinë.
Milorad Bošnjak & Slobodan Jakovljević (2006): *Karđorđevići – Sakrivenaistorija*. Publisher Lio.
Miroslav Hroch (2000): *Social Preconditions of National Revival in Europe*. New York: Columbia University Press.
Marc Weller (2009): *Shtetësia e kontestuar; administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*. Prishtinë: KOHA.
Madeleine Albright (2005): *Min lange reise: Memoarer*. N-W-Damm & Søn AS.
Noel Malcolm (2001): *Kosova, një histori e shkurtër*. Prishtinë: KOHA.
Nuray Bozbora (2002): *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*. Shtëpia Botuese DITURIA.
Natalie Clayer (2009): *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar: Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë*. Tiranë: Përpjekja.
Nicola Guy (2012): *Lindja e Shqipërisë: Nacionalizmi etnik, Fuqitë e Mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare*. Botime Pegi.
Nancy Fraser & Axel Honneth (2003): *Redistribution or Recognition?*. Verso.
Nufri Lekaj (2014): *Politika Nordike dhe një rrëfim për veprimtarinë në kuadër të organizatës Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK).* Prishtinë: Epoka e re.
Paul Roe (2005): *Ethnic violence and the societal security dilemma*. Routledge.
Robert K. Yin (2009): *Case Study Research: Design and Methods*. California: SAGE Publications, Inc.
Robert C. Austin (2004): *Greater Albania: The Albanian State and the Question of Kosovo, 1912-2001*, në Lampe, J. R. & Mazower, M. (përg.), *Ideologies and National Identities: The Case of Twentieth – Century South eastern Europe*. Budapest; New York: Central European Universit Press.
Robert Michels (2016): *Political Parties: A sociological Study of the Oligarchial Tendencies of Modern Democracy*. Martino Fine Books.
Richard Clogg (1992): *A Concise History of Greece, New York.* Cambridge University Press.
Reneo Lukic & Allen Lynch (1996): *Europe From the Ballkans to the Urals. The Desintegration of Yugosllavia and the Soviet Union.* SIPRI Publications.
Rogers Brubaker (1999): *Nationalism Reframed: Nationhood and the National Question in the New Europe*. Cambridge University Press.

Rexhep Qosja (1999): *Paqja e përgjakshme: Konferenca ndërkombëtare për Kosovën, Rambuje 6-23.02.1999, Paris 14-19.03.1999*. Botime Toena.
Svein S. Andersen (2010): *Case – studier og generalisering: Forskningsstrategi og design*. Bergen: Fagbok forlaget.
Svein Mønnesland (2006): *Før Jugoslavia og etter*. Oslo: Syspress Forlag.
Sabri Kiçmari (2017): *Fitorja diplomatike: Kujtime nga përfaqësimi diplomatik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës*. Prishtinë: Epoka e re.
Shkëlzen Gashi (2010): *Adem Demaçi, biografi e paautorizuar.* Shtëpia Botuese Rrokullia.
Tariq Modood (2009): *Muslims, religious equality and secularism*. Në: Secularism, Religion and Multicultural Citizenship. Levey, Geoffrey Brahm and Tariq Modood (red.). New York: Cambridge University Press.
Tariq Modood (2007): *Multiculturalism, A Civic Idea*. Polity Press.
Ukshin Hoti *(1995): Filozofia politike e çështjes shqiptare.* Tiranë.
Wesley Clark (2001): *Waging Modern War*. Public Affairs Ltd.
Will Kymlicka (1995): *Multicultural Citizenship. A liberal theory of minority rights*. New York: Oxford University Press.
Will Kymlicka (2001): *Politics in the Vernacular: Nationalism, Multiculturalism, and Citizenship*. Oxford University Press.
Zekeria Cana (1996): *Gjenocidi i Malit të Zi, mbi popullin shqiptar 1912-1913* (Dokumente). Prishtinë, 1996.
Zekeria Cana (2001): *Apeli i 215 intelektualëve shqiptarë*, Rilindja, Prishtinë.

Dokumente dhe burime të tjera relevante:

Raportimi i Edward Grey në parlamentin britanik më 12 gusht 1913: https://api.parliament.uk/historic-hansard/commons/1913/aug/12/war-in-balkans-statement-by-sir-edward

Rambouillet Accords: Interim Agreement for Peace and Selv-Government in Kosovo 1999: https://peacemaker.un.org/sites/peacemaker.un.org/files/990123_RambouilletAccord.pdf

Clausula rebus sicstantibus in internationalsconventions (international agreements or treaties): Vienna Conventionon the law of treaties (withannex). Concluded at Vienna on 23 May 1969, article 62: https://www.law.cornell.edu/wex/rebus_sic_stantibushttps://treaties.un.org/doc/publication/unts/volume%201155/volume-1155-i-18232-english.pdf

Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, 2001: http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/FrameworkPocket_ALB_Dec2002.pdf

UNMIK - FRY Common Document (2001): http://www.kosovo.net/unfry.html

Standards for Kosovo 2003: https://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Kos%20Standards.pdf

Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo, 2004: https://undocs.org/en/S/2004/348

Kai Eide: *Report on the situation in Kosovo* (2004): http://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/kos%20S2004%20932.pdf

UNMIK report (2007): *The Kosovo standards process 2003-2007*: http://www.unmikonline.org/standards/docs/KSP2003- 2007.pdf

Kai Eide: *Report on the situation in Kosovo* (2005): https://undocs.org/pdf?symbol=en/S/2005/635

UNOSEK report (2007): *The Status Process*: http://www.unosek.org/ dhe https://www.unosek.org/the-status-process/

Marti Ahtisaari: Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, 2007: http://www.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Final%20Settlement%20Proposal%20AL.pdf

International Court of Justice (2010): https://www.icj-cij.org/files/case-related/141/141-20100722-ADV-01-00-EN.pdf

Organizata e Kombeve të Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme, "Rezoluta GA/10980", 9 shtator 2010: https://www.un.org/press/en/2010/ga10980.doc.htm

Ligji nr. 05/L-053: për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (2015): https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11036

Statement of the Chief Prosecutor of the Special Investigative Task Force 29 July 2014: http://recom.link/wp-content/uploads/2014/07/Down load-full-statement-here.pdf

Convention and protocol relating to the status of refugees: https://www.unhcr.org/3b66c2aa10

Elisabeth Bakke (1995): *Mot ein europeisk identitet?* (PDF) Mot eineuropeisk identitet? (researchgate.net).

Elisabeth Bakke (2000): *How voluntary is national identity?* Conference paper, the 8. National Political Science Conference, Tromsø 2000: http://folk.uio.no/stveb1/How_voluntary.pdf

Bernard J. Fischer 2014: 28, *Albanian Nationalism And Albanian Independence*: https://www.researchgate.net/publication/307842058_Albanian_Nationalism_and_Albanian_Independence/fulltext/57d1903a08ae6399a38b7ff4/307842058_Albanian_Nationalism_and_Albanian_Independence.pdf?origin=publication_detail

Roel Schuyt: (s.a.): *Greeks, Albanians, Romanians and Vlachs: Antagonism and Symbiosis in the nineteenth century*", page 2: http://cf.hum.uva.nl/natlearn/Balkan/athens_schuyt.html

Robert Elsie (s. a.): *Marko Miljanov: The Life and Customs of the Albanians*: Marko Miljanov: The Life and Customs of the Albanians (albanian history.net)

Robert Elsie 2012: *Kosovo and the Bar Tragedy of March 1945,* page 2: http://www.elsie.de/pdf/articles/A2012BarTragedy.pdf

James Pettifer & Miranda Vickers: The challenge to preserve the cham heritage (2005): 236:https://www.professorjamespettifer.com/uploads/files/pdf/The%20challenge%20to%20preserve%20the%20cham%20heritage.pdf

Tim Judah: *The Kosovo Liberation Army* (2000): http://sam.gov.tr/wp-content/uploads/2012/01/Tim-Judah.pdf

The Guardian (2008): *Is Kosovo Serbia? We ask a historian, Noel Malcolm*: https://amp.theguardian.com/world/2008/feb/26/kosovo.serbia

ICG (2009): Serb integration in Kosovo: Taking The Plunge. Europe Report N° 200 – 12 May 2009, http://www.crisisgroup .org/~/ media/Files/europe/200_serb_integration_in_kosovo___taking_the_plung e.ashx dhe: http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/ kosovo.aspx

ICG (2011): North Kosovo: Dual Sovereignty in Practice. Europe Report N° 211 – 14 March 2011: http://www.crisisgroup.org/~/media/Files/ europe/balkans/kosovo/211%20North%20K osovo%20--- %20Dual%20Sovereignty%20in%20Practice.ashx dhe: http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/kosovo.aspx

30 - vjet të Institutit të Historisë në Prishtinë (1967-1997), Instituti i Historisë - Prishtinë, 1998.

Tridhjetë vjet të Institutit Albanologjik (1967-1977), Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1997.

Qazim Berisha (2020) : *Vrasjet e ushtarëve shqiparë në Armatën Jugosllave1981-1991:* https://fjala.info/vrasjet-e-ushtareve-shqipare-ne-armaten-jugos llave-1981-1991/).

Emrush Xhemajli (2009): *Në Ligjin për dëshmorët dhe familjet e tyre të përfshihen edhe të rënët para fillimit të luftës së UÇK-së.* Konferencë shtypi e deputetit Emrush Xhemajli, kryetar i LPK-së (beepworld.de)

Programi i Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës. Botues: Kolegjiumi i Redaksisë i Zërit të Kosovës, organ i LPRK-së. Dhjetor, 1989.

Mehmet Bislimi (2011): *Bislim Luti - Lutfia – një kapitull i veçantë:* AlbaniaPress.com/ShqiperiaPress.com

Adil Pireva (2014): *Osman Dumoshi, kryeorganizator i demonstratave të '68-s*: http://illyriapress.com/osman-dumoshi-kryeorganizator-demonstratave-te-68-es/

Zymer Ujkan Neziri (2016): *Isa Demaj është figurë emblematike e brezit '68 të Republikës*: https://www.radiokosovaelire.com/zymer-ujkan-neziri-isa-demaj-eshte-figure-emblematike-e-brezit-68-te-republikes/

Intervistë e Jusuf Gërvallës botuar në gazetën gjermane "Tagische Zeitung":https://m.gazetaexpress.com/arkiva/interviste-e-jusuf-gervalles-botuar-ne-gazeten-gjermane-tages-zeitung-131866/?arch_tb=temphttps://

rajonipress.com/interviste-e-jusuf-gervalles-botuar-ne-gazeten-gjermane-tagische-zeitung/

Telegrafi.com (2014): *Kujtesë: 25 vjet nga suprimimi i dhunshëm i autonomisë së Kosovës*: https://telegrafi.com/kujtese-25-vite-nga-suprimimi-i-dhunshem-i-autonomise-se-kosoves-fotovideo/

Emrush Xhemajli (2002): *Lëvizja Popullore e Kosovës 1982-2002*: http://lpk-kosova.com/historiku.html

Shkruan: Qazim Doda, New York: *Rrok Nikçi ishte kelmendasi që vlente më shumë se qeveritë e dy shteteve tona*: https://www.google.no/amp/s/qazimdoda.wordpress.com/2015/11/20/rrok-nikci-ishte-kelmendasi-qe-vlente-me-shume-se-qeverite-e-dy-shteteve-tona/amp/

Intervistë me Ramiz Llapatincën, ish-drejtues i Klubit Kombëtar "Jusuf Gërvalla", në Nju-Jork, botuar në librin *Shqiptarët e Amerikës:* http://illyriapress.com/na-la-ramiz-llapatinca-atdhetari-piktori-i-urti-e-i-palodhuri/

Intervistë me Shpend Haxhaj – Hoti dhënë AA Vision *Me shqiptarët e Amerikës*: https://www.google.no/amp/plavaeguciasot.com/interviste-me-shpend-haxhaj-hoti-dhene-aa-vision-me-shqiptaret-e-amerikes/amp/

Intervistë me veprimtarin Gazmend Lleshi dhënë AA Vision *Me shqiptarët e Amerikës*: https://www.facebook.com/watch/?v=2385085775117207

Emisioni "Rasti V - VI", pjesa 1 dhe 2, mysafir: Ibish Neziri etj (2019): https://www.youtube.com/watch?v=RBW2PLxy9K4 dhe https://www.youtube.com/watch?v=JGS8QgABPSw&feature=youtu.be

Zëri i Kosovës, nr. 15, 15 shtator 1993, programi i LPK-së, f. 4. Organ i Lëvizjes Popullore të Kosovës

Imi Egriu (2011): *Ju flet radio Zëri i Kosovës*: http://zerikosoves.com/ju-flet-radio-zeri-i-kosoves/

Gazeta Express (2020): *Rezistenca heroike e familjes Jashari nga viti 1991 deri më 1998*: https://www.google.no/amp/s/www.gazetaexpress.com/rezistenca-heroike-e-familjes-jashari-nga-viti-1991-deri-ne-1998/amp/

Besim Muhadri (2010): *Fronti i Rezistencës dhe i Bashkimit Kombëtar u themelua si një organizatë politiko-ushtarake* http://www.zemrashqiptare.net

/news/14320/besim-muhadri-fronti-i-rezistences-dhe-i-bashkimit-kombetar-u-themelua-si-nje-organizate-politiko-ushtarake.html?skeyword=a

Lajmi.net (2020): *22 vjet nga Epopeja e Dukagjinit*: https://lajmi.net/22-vjet-nga-epopeja-e-dukagjinit/

Klan Kosova (2018): *Kujtohet beteja e Likoshanit dhe Qirezit*:https://klankosova.tv/kujtohet-beteja-e-likoshanit-dhe-qirezit-1/

Kultplus (2020): *20 vjet nga beteja e Likoshanit dhe Qirezit*: https://www.kultplus.com/trashegimia/20-vjet-nga-beteja-e-likoshanit-dhe-qirezit/

Gazeta Mapo (2019): *Masakra e Abrisë së Epërme, u vranë 23 anëtarë të familjes Deliu:* https://gazetamapo.al/masakra-e-abrise-se-eperme-u-vrane-23-anetare-te-familjes-deliu

Norsk Biografisk Leksikon; Kristoffer Gjøtterud (2009): https://nbl.snl.no/Kristoffer_Gjøtterud

Kristoffer Gjøtterud: En åpen horisont: https://www.apollon.uio.no/portretter/1995/horisont.html

The Albanian American civic league: "*changing history for twenty five years"*: https://www.aacl.com/our-25-year-history

Dashnor Kaloçi (2018) "*Letra sekrete e ambasadorit shqiptar në OKB: Kongresmenit DioGuardi ia financoi fushatën vëllai i Xhemës…..*": https://gazetamapo.al/letra-sekrete-e-ambasadorit-shqiptar-ne-okb-kongresmenit-dioguardi-ia-financoi-fushaten-vellai-i-xhemes-qe-njihet-si-psikopat/

Die Morina (2016): *Kosovo Dissident's Serbian Assassins Given Life Sentences:* https://balkaninsight.com/2016/11/24/kosovo-dissident-s-serbian-assassins-jailed-for-life-11-24-2016/

Lajmi net (2015): *Milazim Krasniqi zbulon bisedat brenda takimit Zimmermann - Rugova*: https://lajmi.net/milazim-krasniqi-zbulon-bisedat-brenda-takimit-zimmermann-rugova/

Rifat Blaku (2016): *Referendumi i parë shqiptar në Kosovë u mbajt në mënyrë dinjitoze*: https://www.kosova-sot.info/opinione/140682/referendumi-i-pare-shqiptar-ne-kosove-u-mbajt-ne-menyre-dinjitoze/

Intervistë televizive e Xhafer Shatrit më 08.09.2020: Telashet e Kosovës - Xhafer Shatri, DESKU, 08.09.2020 - YouTube

Gazeta Bujku (10 dhjetor 1997): *Mjetet skandinave të informimit rreth ekzistimit dhe aksioneve të UÇK-së.*

Zëri (2014): *Preshevari që bëri stemën e UÇK-së*: https://zeri.info/aktuale/8711/preshevari-qe-beri-stemen-e-uck-se/

Takimi më 29 qershor 1998, në Forumin Ndërkombëtar të Crans-Montanas, i përfaqësuesve të UÇK-së, në krye me Bardhyl Mahmutin, me të dërguarin special të ShBA-së për Ballkanin, Richard Holbrooke: http://www.zemrashqiptare.net/news/19040/ina-interviste-me-bardhyl-mahmutin.html

Gazeta zvicerane "Le Temps": *Genève: un attentat vise le très discret Ministère kosovar de l'information*, 2 korrik 1998: https://www.letemps.ch/suisse/geneve-un-attentat-vise-tres-discret-ministere-kosovar-linformation

Kosovo: Investigation in to Raçak killings (2015): https://mail.google.com/mail/u/0/?pc=no-ha-emea-no-bk#inbox/FMfcgxwGCkmVvGVSXhHXNpnZfNKGZwZB?projector=1

Radio-Kosova e Lirë (2016): *Një histori autentike e informimit në luftë e në liri*: https://www.radiokosovaelire.com/radio-kosova-e-lire-nje-histori-autentike-e-informimit-ne-lufte-e-ne-liri/

The news and view sof South east Europe (2001): Kosovo Parliamentary Elections, 17 November 2001: http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/infoElections/setimes/resource _centre/elections/kosovo_assembly_2001

Agjencioni Informativ i Kosovës 2004: Hari Holkeri i hodhi poshtë propozimet e Koshtunicës për kantonizimin e Kosovës: http://www.trepca.net/2004/03/040309_lajme.htm

B92, Beta, Tanjug, *Srbija poništava nezavisnost* (2008): https://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2008&mm=02&dd=17&nav_category=640&nav_id=285213

Ballkan insight: *Dick Marty, Controversial Investigator* (2010): https://balkaninsight.com/2010/12/16/dick-marty-controversial-investigator/

Historia e Shqipërisë (Ilirisë) që nga viti 2500 p.e.s, sipas historianit grek: https://www.youtube.com/watch?v=7qWXSwRblKw&feature=youtu.be

Bajraktari i Hotit të kujit, Alush Smajl Hoti: Alush Smajli Hoti - YouTube

Fjalimi i Ramiz Alisë në vitin 1990 në Asamblenë e OKB-së në New York: https://www.youtube.com/watch?v=00A3bb_mh54&feature=youtu.be

Albanian President Sali Berisha meeting President George Bush, June 1992: https://www.youtube.com/watch?v=1M11iRWQGiY&feature=yo utu.be

Fehmi Lladrovci, 9 nëntor 1997, mbledhje e LPK-së në Köln, Gjermani: https://youtu.be/2HjxmeBvONE

Dalja e UÇK-së në skenë, 28 nëntor 1997: https://www.youtube.com/ watch?v=MiMm5MaaIb8&feature=youtu.be

Intervista e parë publike e përfaqësuesve të sektorit të rëndësisë së veçantë, Xhavit Halitit, Azem Sylës etj.: https://youtu.be/q58Oujsu-Dshttps ://api.parliament.uk/historic-hansard/commons/1913/aug/12/war-in-balkans-statement-by-sir-edward

Paraqitja e parë publike e zëdhënësit të UÇK-së, Jakup Krasniqit etj.: https://youtu.be/qDbQg2sS9ac

Takimi me 24 qershor 1998, në Junik të Kosovës, i përfaqësuesve të UÇK-s, në krye me Hajdin Abazin, me të Dërguarin special të ShBa-së për Ballkanin, Richard Holbrooke: https://youtu.be/qzMxZKu2KWQ

Intelektuali Serb: Kosova bëri luftë Çlirimtare…(2020): https://telegramisot.com/intelektuali-serb-kosova-beri-lufte-clirimtare-ndersa-serbia-ka-kryer-gjenocid-te-paster-video/

Telegrafi.com (2014: Thaçi në Euronews: Kam qenë larg nga frontet e luftës: https://telegrafi.com/thaci-ne-euronews-kam-qene-larg-nga-frontet-e-luftes/

New Perspektiva (2015): Parimet për AKS-në nuk janë në përputhje me kushtetutën, thotë Gjykata:https://www.new-perspektiva.com/sq/parimet-per-aks-ne-nuk-jane-ne-perputhje-kushtetuten-thote-gjykata/

Lajmi. Net (2020): DOKUMENT: Kjo është marrëveshja Kosovë – Serbi : https://lajmi.net/dokument-kjo-eshte-marreveshja-kosove-serbi/

Prof. Riza Gruda (2021): "Prejardhja e banorëve të Plavë -Gucisë….": https://www.plavgusinje.me/2019/12/porijeklo-stanovnistva-plava-i-gusinja.html?m=1&fbclid=IwAR18_OGB_muG-bf3KI9norpQGfPpJqdVJpE1vpR2x7l-f2myZxNdej8tuPY

As. prof. dr. Kahreman Ulqini (2016): "Si u Formua Krahina Malësi e Madhe?" : https://zanimalsise.com/si-u-formua-krahina-malesi-e-madhe/

Autor:
FATMIR LEKAJ

Titulli:
KOMBFORMIMI DHE PËRPJEKJET E SHQIPTARËVE PËR LIRI DHE BARAZI
një qasje teoriko-interpretuese

Botoi:
ARMAGEDONI
+383 44 835 499
shbarmagedoni@gmail.com

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

323.1(=18)
327(496.51)

Lekaj, Fatmir
Kombformimi dhe përpjekjet e shqiptarëve për liri dhe barazi : një qasje teoriko-interpretuese / Fatmir Lekaj. – Prishtinë : Armagedoni, 2021. – 307 f. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-780-55-1